

**POLITIKAT PENALE TË REPUBLIKËS SOCIALISTE FEDERATIVE TË
JUGOSLLAVISË DHE TË REPUBLIKËS SOCIALISTE TË SERBISË NË
KRAHINËN SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS GJATË VITEVE 1981–
1999**

Florim Salihu

D o r ë z u a r

Universiteti Evropian i Tiranës

Shkolla Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkencat Juridike, Profili Penal, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Shefqet Muçi

Numri i fjalëve: 69860

Tiranë, Janar 2021

Deklarata e autorësisë

Idetë dhe mendimet e shprehura në këtë material janë tërësisht nga studiuesi, përkatësisht konceptimi i tij është bërë sipas kërkesave ligjore dhe akademike dhe reflektojnë mendimet, konstatimet dhe/apo qëndrimin zyrtar të autorit.

Autori garanton se nuk ka shtrembërim të fakteve dhe kopjime të pa referuara të krijimeve dhe mendimeve nga autorë apo publikime të tjera.

ABSTRAKT

Në këtë studim është përfshirë periudha kohore që pasqyron përpjekjet e popullit shqiptar të Kosovës për liri dhe raportet-sfidat në më shumë se dy dekada përballje politike dhe juridike në mes të Kosovës dhe ish-Jugosllavisë, respektivisht të Republikës së Serbisë. Këto përballje i kemi zhvendosur dhe trajtuar në sfondin historik, politik, juridik dhe socio-ekonomik. Në pjesën e parë të këtij punimi me theks të veçantë është trajtuar pozita historike, politike, juridike dhe socio-ekonomike e Kosovës në etapa të ndryshme të historisë në kuadër të ish-Jugosllavisë. Në fokus të pjesës historike elaborohen përpjekjet dhe e drejta e Kosovës për mëvetësi dhe vetëvendosje politike në kuadër të ish-Federatës Jugosllave dhe mohimi i kësaj të drejte nga RSFJ dhe Republika e Serbisë pas Luftës së Dytë Botërore. Në pjesën e dytë, kemi vendosur theksin mbi pozitën politike dhe juridike të Kosovës në kuadër të Kushtetutës së vitit 1974, të cilin akt politiko-juridik e kemi radhitur si fitoren më të madhe të KSA të Kosovës në kuadër të RSFJ, në rrafshin politik, juridik dhe ekonomik. Tema bosht e këtij studimi është çështja pas rrënimit dhe suprimimit të Autonomisë së Kosovës të vitit 1974, nga organet federative të ish-Jugosllavisë dhe Republika e Serbisë. Në rrjedhën e ngjarjeve të zhvilluara në Kosovë pas demonstratave të viteve 1968, 1981 dhe 1989 dhe pas suprimimit të Autonomisë së KSA të Kosovës, pasuan reprezaljet intensive dhe sistematike të pushtetit shtetëror serbo-jugosllav, kundër popullit shqiptar të Kosovës. Pra, duke u bazuar në zhvillimet në kontekst të ngjarjeve të ndodhura në harkun kohor 1981–1999, në Kosovë, me theks të veçantë janë trajtuar shkeljet e lirive dhe të drejtave të njeriut nga organet e rendit dhe drejtësisë, të Republikës Socialiste Federative të ish-Jugosllavisë dhe Republikës Socialiste të Serbisë. Në dimensionin e përgjithshëm të këtij punimi do të trajtohen ndjekjet penale me karakter politik, torturat, keqtrajtimet, arrestimet, burgosjet dhe vrasjet nga aparati shtetëror i RSFJ dhe Republikës së Serbisë, kundër qytetarëve shqiptarë në KSA të Kosovës. Rëndësi të

posaçme në këtë punim i është kushtuar ndërhyrjes politike në aplikimin e politikave penale në Kosovë gjatë viteve 1981–1999. Kjo materie në thelb trajton manifestin e politikës mbi drejtësinë. Pra, trajton të gjitha format e keqpërdorimit dhe abuzimit të politikës në emër të pushtetit juridik. Mozaiku i shkeljeve dhe lirive të të drejtave të njeriut nga organet e pushtetit shtetëror të RSFJ, të Serbisë, kundër shqiptarëve të Kosovës në harkun kohor 1981–1999, ishte i përmasave të panjohura që nga pas Lufta e Dytë Botërore. Format e dhunës që manifestonte aparati i pushtetit shtetëror kundër shumicës shqiptare ishin: arrestime në masë, izolime, torturat, keqtrajtimet, akuza në grup, gjykime dhe dënime në grup, helmime, linçime, plagosje, vrasje dhe gjymtime. Karakteristikë themelore e abuzimit të politikës mbi sistemin e drejtësisë ishte instrumentalizimi i drejtësisë në funksion të interesave dhe qëllimeve politike. Pra, të gjitha shkeljet e lirive dhe të drejtave të njeriut që ndodhnin në harkun kohor 1981–1999 në Kosovë, ishin urdhra dhe interesa të politikës, që zbatoheshin nga sistemi i drejtësisë në interes të politikës dhe bartnin vulën dhe fluskën e pushtetit juridik. Për të arritur një rezultat studimi sa më objektiv, në fokus të këtij hulumtimi i kemi targetuar katër fokus grupe të cilët i kemi anketuar në funksion të interesit shkencor të studimit. Këto katër fokus grupe janë targetuar për rëndësinë të cilën e bartin në zhvillimin e ngjarjeve të zhvilluara në sistemin e drejtësisë në Kosovë gjatë viteve 1981–1999. Grupi i personave të dënuar për vepra penale me natyrë politike, grupi i avokatëve mbrojtës, grupi i prokurorëve dhe i gjyqtarëve, të cilët kanë qenë akterë të zhvillimit në ngjarjet e ndodhura në sistemin e drejtësisë gjatë viteve 1981–1999.

Fjalë Kyçe

Histori, politikë, sistem, drejtësi, penale, ndërhyrje, keqtrajtim, torturë, dënim, persekutim, vrasje, burgosje, demonstratë, gjyqësi, liri, kushtetutë, ligj, ndikim, faktor, montim, qëllim, motiv, etj.

Abstract

As part of this treatment of our doctoral research, we have included a period of time that reflects the efforts of the Kosovo Albanian people for freedom, and the relations-challenges in more than two decades of political and legal confrontations between Kosovo and the former Yugoslavia, respectively Republic of Serbia. We have shifted and addressed these confrontations in the historical, political, legal and socio-economic background. In the first phase of this paper, special emphasis was placed on the historical, political, legal and socio-economic position of Kosovo at different stages of history within the former Yugoslavia. In the focus of the historical part, are elaborated the efforts and the right of Kosovo for independence and political self-determination within the former Yugoslav Federation, and the denial of this right by the FRY and the Republic of Serbia after the Second World War. Within this substance in the second phase, we have placed the emphasis on the political and legal position of Kosovo within the Constitution of 1974, which we have listed as the greatest political-legal act of the SAP of Kosovo within the SFRY as in the political, legal and economic field. The central theme of this doctoral dissertation is the issue after the dilapidation and supremacy of the Autonomy of Kosovo in 1974 by the federal bodies of the former Yugoslavia and the Republic of Serbia. In the course of events in Kosovo after the demonstrations of 1968, 1981 and 1989 and after the abolition of the Autonomy of the SAP of Kosovo, followed the intensive and systematic reprisals of the Serbian-Yugoslav state power against the Albanian people of Kosovo. Thus, based on the developments in the context of the events that took place in the time frame 1981-1999 in Kosovo, with special emphasis, the violations of freedoms and human rights by the law enforcement agencies of the Socialist Federal Republic of the former Yugoslavia and the Socialist Republic of Serbia were treated. In the general dimension of this paper, criminal prosecutions of a political nature, torture, ill-treatment, arrests, imprisonment

and murder by the state apparatus of the SFRY and the Republic of Serbia, against Albanian citizens in the SAP of Kosovo will be treated. Special importance in this paper was paid to the political intervention in the application of criminal policies in Kosovo during the years 1981–1999. This material essentially treats the policy manifesto on justice. So it deals with all forms of misuse and abuse of politics in the name of the rule of law. The mosaic of human rights violations and freedoms by the state authorities of the SFRY or Serbia, against Kosovo Albanians in the period 1981–1999, was of unknown proportions since after the Second World War. The forms of violence manifested by the state power machinery against the Albanian majority were: mass arrests, torture, maltreatment, group charges, group trials and convictions, poisoning, lynching, wounding, murder and mutilation. The basic characteristic of the abuse of politics over the justice system was the instrumentalisation of justice in the function of political interests and goals. Thus, all violations of human rights and freedoms that occurred in the period 1981–1999 in Kosovo, were orders and interests of politics, implemented by the justice system in the interest of politics and carried the seal and logo of legal power. In order to achieve the most objective study result, in the focus of this research we have targeted four focus groups which we have surveyed in function of the scientific interest of the doctoral thesis. These four focus groups are targeted for the importance they carry in the development of events in the justice system in Kosovo during the years 1981–1999. The group of people convicted of criminal offenses of a political nature, the group of defense lawyers, the group of prosecutors and judges, who were actors in the events that took place in the justice system during the years 1981–1999.

K e y w o r d s

History, politics, system, justice, criminal, intervention, maltreatment, torture, punishment, persecution, murder, imprisonment, demonstrations, judiciary, freedom, constitution, law, influence, factors, assembly, purpose, motive, etc.

F A L E N D E R I M E

Studimi “Politikat Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe Republikës Socialiste të Serbisë në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës Gjatë Viteve 1981–1999” është një studim me karakter specifik shkencor të cilin nuk do të mund ta filloja dhe përfundoja pa ndihmën e shumë personave të cilët për asnjë moment nuk hezituan dhe nuk kursyen të më përgjigjen lidhur me kërkesat objektive të studimit.

Si autor i këtij punimi, në mënyrë të veçantë falënderoj udhëheqësin doktoral Prof. Asoc. Dr. Shefqet MUÇI, i cili gjatë gjithë punës më këshilloi dhe mbështeti me ide, alternativa dhe rekomandime, si dhe me ofrimin e kritikës objektive në funksion të studimit.

Falënderoj të gjithë personat e anketuar të cilët ndanë kohën e tyre për t’ju përgjigjur kërkesave të mia gjatë hulumtimit të zhvilluar në funksion të këtij studimi.

Gjithashtu falënderoj të gjithë përfaqësuesit e institucioneve publike siç janë, Shoqata e të Burgosurve Politik të Kosovës, Këshillin për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Fakultetin Juridik të Universitetit “HASAN PRISHTINA” në Prishtinë, Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Arkivit të Kosovës, Arkivat e Prokurorive dhe Gjykatave të Kosovës, të cilët më ofruan materiale nga arkivat e tyre.

Veçanërisht falënderoj familjen time e cila si në çdo hap të jetës, më mbështeti edhe në fushën e studimeve.

Faleminderit të gjithëve!

P ë r m b a j t j a

KAPITULLI I	1
PROCESI I ZHVILLIMIT TË STATUSIT JURIDIKO-POLITIK TË KOSOVËS	1
1.1. Vështrim i përgjithshëm	1
1.1.1. Pozita e Kosovës pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë	7
1.2. Statusi i Kosovës Pas Luftës së Dytë Botërore.....	10
1.2.1. Pozita juridiko-politike e Kosovës në periudhën 1945–1974.....	15
1.2.2. Pozita juridiko-politike e Kosovës me Kushtetutën e vitit 1974-1989 ..	23
1.3. Legjislacioni penal i aplikueshëm në Kosovë gjatë viteve 1945–1989 ...	26
1.3.1. Harmonizimi i ligjeve në ish-RFSJ me normat ndërkombëtare	28
1.4. Okupimi i dhunshëm i Kosovës nga Serbia në vitin 1989	30
1.4.1. Aktet juridike paralele në Kosovë në vitet 1989–1999.....	32
KAPITULLI II	39
FORMAT E MANIFESTIMIT TË DHUNËS SHTETËRORE NË KOSOVË GJATË VITEVE 1981–1999	39
2.1. Format e manifestimit të dhunës dhe arbitraritetit të pushtetit shtetëror kundër qytetarëve me bindje të kundërt politike	39
2.1.1. Ndjekjet politike në Kroaci	40
2.1.2. Ndjekjet politike në Bosnjë e Hercegovinë	41
2.1.3. Ndikimi akademik në dhunën e ushtruar të regjimit shtetëror serb ndaj shqiptarëve	47
2.1.4. Politika si faktor nxitës në krimet e kryera nga pushteti shtetëror serb ndaj shqiptarëve të Kosovës në vitet 1981–1999.....	53
2.1.5. Vrasjet – “Vetëvrasjet” e ushtarëve shqiptarë në Ushtrinë Jugosllave gjatë viteve 1981–1991.....	56
2.1.6. Dhuna e ushtruar nga organet e rendit dhe sigurisë të ish-RSFJ dhe Serbisë, ndaj demonstruesve shqiptarë në vitin 1981	63
2.1.7. Dhuna e ushtruar nga organet e rendit dhe sigurisë të ish-RFJ dhe Serbisë, ndaj demonstruesve shqiptarë në vitin 1989	68
2.1.8. Krimet e pushtetit shtetëror të ish-RFJ dhe Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve 1998–1999.....	71
KAPITULLI III	75
DHUNA JURIDIKE NË KOSOVË PAS VITIT 1989	75
3.1. Shqiptimi i masës së izolimit ndaj personave të papërshtatshëm politikisht 75	
3.2. Aktet dhe ligjet diskriminuese në Kosovë pas vitit 1989	77

3.2.1.	Programi për sendërtimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit të KAS Kosovës.....	78
3.2.2.	Ligji mbi veprimin e organeve republikane në rrethanat e posaçme....	85
3.2.3.	Ligji mbi marrëdhëniet e punës në kushtet e posaçme	87
3.2.4.	Ligji mbi kushtet e veçanta të qarkullimit të patundshmërive	89
3.2.5.	Rregullimi juridik i “vullnetit të qytetarëve”	90
3.2.6.	Deklarata mbi të drejtat njerëzore të pjesëtarëve të pakicave kombëtare 91	
3.2.7.	Ligji mbi mjetet në pronësinë e Republikës së Serbisë.....	93
3.3.	Llojet e veprave penale për të cilat akuzoheshin dhe dënoheshin shqiptarët gjatë viteve 1981–1999	95
	KAPITULLI IV – ANALIZA E REZULTATEVE	99
4.1.	Diskutim dhe analizë mbi rezultatet e pyetësorit për personat e dënuar 99	
4.1.1.	Pyetësi për të dënuar dhe rezultatet e përgjigjeve	99
4.1.1.1.	ANALIZA E FAKTORËVE – KEQTRAJTIMI	104
4.1.2.	Gjinia e personave të dënuar.....	106
4.1.3.	Statusi civil i personave të dënuar	108
4.1.4.	Statusi i punësimit i personave të dënuar	109
4.1.5.	Gjendja ekonomike e personave të dënuar.....	109
4.1.6.	Mosha e personave të dënuar dhe lartësia e dënimit	110
4.1.7.	Gjykime dhe dënime në grup	113
4.1.8.	Trajtimi në hetuesi dhe paraburgim	114
4.1.9.	Trajtimi i personave në burgim	116
4.1.10.	Trajtimi i familjarëve të personave që kanë qëndruar në paraburgim dhe burgim	118
4.1.11.	Shkelja e të drejtës në mbrojtje gjatë fazës së arrestimit, hetimit dhe paraburgimit	120
4.1.12.	Ushtrimi i torturës nga organet e rendit dhe hetuesisë për të pranuar fajësinë 122	
4.1.13.	Vizitat e organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare në institucionet e paraburgimit dhe burgimit.....	124
4.1.14.	Baza juridike e vendimeve të gjyqësorit 1981–1999	126
4.1.15.	Efekti i vuajtjes së dënimit, ndëshkimi apo risocializimi	127
4.1.16.	Ndikimi dhe roli i organizatave joqeveritare në përmirësimin e kushteve në qendrat e paraburgimit dhe burgimit gjatë viteve 1981–1999	128
4.1.17.	Përkujdesja shëndetësore në qendrat e paraburgimit dhe burgimit për personat e privuar nga liria	129

4.1.18.	Cenimi i korrespondencës gjatë kohës së qëndrimit në institucionet e paraburgimit–burgimit	131
4.1.19.	Proceset gjyqësore me motivacion politiko–etnik	132
4.1.20.	Zbatimi i ligjit në procedurë penale 1981–1999	135
4.1.21.	Meritokracia e vendimeve të gjykatës dhe ndikimi i politikës mbi këto vendime	136
4.2.	Diskutim dhe analizë mbi rezultatet e pyetësorit me avokatë.....	138
4.2.1.	Sa kanë pasur liri, siguri dhe pavarësi avokatët në ushtrimin e profesionit të tyre.....	143
4.2.2.	Personat që ju keni mbrojtur në periudhën 1981–1999 për cilat lloji të veprave penale kanë qenë të gjykuar dhe dënuar	144
4.2.3.	Bazuar në eksperiencën tuaj, cila ishte pozita e klientëve tuaj në fazën e hetuesisë	144
4.2.4.	A ka qenë tortura metodë për të marrë pohimin apo deklaratën e të akuzuarit	145
4.2.5.	Si avokat a jeni trajtuar drejtë në raport institucionin e akuzës.....	147
4.2.6.	Qëllimi i dënimit sipas mendimit dhe eksperiencës së avokatëve	148
4.2.7.	Dënime në mungesë provash, ndikimi dhe montimi politik i proceseve gjyqësore	148
4.2.8.	Trajtimi i ligjit me dy standarde.....	154
4.2.9.	Pengesa në realizim i të drejtës ligjore avokat–klient.....	155
4.2.10.	Kushtet në qendrat e paraburgimit	156
4.2.11.	Vendimet e shqiptuara nga gjykatat në raport me aktet ndërkombëtare referuar lirive dhe të drejtave të njeriut	156
4.2.12.	Monitorimi i proceseve gjyqësore nga organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare	158
4.2.13.	Kultura e mos ndëshkueshmërisë së abuzuesve të pushtetit	159
4.2.14.	Fenomeni i akuzave dhe dënimeve në grup	160
4.2.15.	Prapavija e vendimeve juridike	161
4.2.16.	Shkelja e ligjit në procedurë penale.....	168
4.3.	Diskutim dhe analizë mbi rezultatet e pyetësorit për prokurorë.....	170
4.3.1.	Siguria dhe liria në punë e prokurorit	173
4.3.2.	Lloji i akuzave që ka dominuar në harkun kohor 81/99, dukuria kolektive	175
4.3.3.	Shkelja e të drejtave të njeriut në fazën e hetuesisë dhe paraburgimit	176
4.3.4.	Vështrim në retrospektiv–opinion nga prokurorët.....	177
4.3.5.	Pozicioni akuzë–mbrojtje në zhvillimin e procedurës penale 1981–1999	177
4.3.6.	Qëllimi i dënimit sipas organit të akuzës	178

4.3.7.	Ndikimi i gjyqësorit nga politika–montimi i proceseve politike	179
4.3.8.	Nacionaliteti i personave të dënuar për vepra penale të natyrës politike 181	
4.3.9.	Harmonizimi i ligjeve nacionale me aktet ndërkombëtare sipas akuzës 184	
4.4.	Diskutim dhe analizë mbi rezultatet e pyetësorit me gjyqtarë.....	187
4.4.1.	Siguria dhe liria për të ushtruar profesionin e gjyqtarit 1981–1999...	191
4.4.2.	Nacionaliteti i personave të dënuar për vepra penale me karakter politik 192	
4.4.3.	Ankesat e të akuzuarve në gjykatë për ushtrim torture ndaj tyre – kultura e mos ndëshkueshmërisë	193
4.4.4.	Harmonizimi i vendimeve të gjyqësorit me aktet dhe konventat ndërkombëtare.....	194
4.4.5.	Cili ishte qëllimi i dënimit për vepra penale me natyrë politike sipas gjyqtarëve.....	195
4.4.6.	Respektimi i subjekteve në procedurë penale, mbrojtje–akuzë	196
4.4.7.	Të drejtat e njeriut në procedurë penale sipas gjyqtarëve 1981–1999	197
4.4.8.	Ndikimet dhe montimet politike në proceset gjyqësore.....	198
4.4.9.	Qasja e dhënë organizatave vendore dhe ndërkombëtare në monitorimin e gjyqësorit.....	199
4.4.10.	Këndvështrim historik i gjyqeve kolektive dhe dënimeve radikale.....	201
KAPITULLI V –.....		203
Përfundimi – Gjetjet e studimit - Konkluzione		203
•	Përfundimi	203
•	Gjetjet e studimit.....	205
•	Konkluzione	207
•	Shtojcë	210
Pyetësorët		210
Pyetësor për persona të dënuar politikisht!		211
Pyetësori për avokatët mbrojtës.....		214
Pyetësor për prokurorë		218
Pyetësor për gjyqtarë		221
BIBLIOGRAFIA – REFERENCAT – WEBLIOGRAFIA		224
Akte juridike të shfrytëzuara		227

SHKURTESAT

AI – Amnesty International

ASHAK – Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

ASHAS – Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë

AVNOJ – Këshilli Antifashist Nacional i Çlirimit Popullor të Jugosllavisë.

FJ – Fakulteti Juridik

IZBOR – Organizatë Jo – Qeveritare për Mbrojtjen e Viktimave të Pastrimit Etnik

JNA/Jugoslovenska Narodna Armija – Ushtria Popullore Jugosllave

KAK – Krahina Autonome e Kosovës

KAÇKJ – Komiteti Antifashist Çlirimtar i Kombeve të jugosllavisë

KFOR – Prezenca ushtarake e NATO në Kosovë.

KMLDNJ – Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut

KOS/Kontraobaveštajna Služba – Shërbimi i Kundërzbulimit të Ushtrisë Jugosllave

KSAK – Krahina Socialiste Autonome e Kosovës

LP – Ligji Penal

LNÇ – Lëvizja Nacional Çlirimtare

Mbretëria SKS – Mbretëria Serbo–Kroate–Sllovene (1918–1939).

NATO/OTAN – Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian

OZNA/Odeljenje za Zaštitu Naroda – Departamenti për Mbrojtjen e popullit

PKJ – Partia Komuniste e Jugosllavisë

PKSH – Partia Komuniste e Shqipërisë

RS – Republika e Serbisë

RSFJ – Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

SHBA – Shtet e bashkuara të Amerikës

UDB/Uprava Državne Bezbednosti – Drejtoria e Sigurimit të Shtetit

UÇK – Ushtria Çlirimtare e Kosovës

UNMIK – Unioni Ndërkombëtar – Misioni në Kosovë

UP – Universiteti I Prishtinës

VSHLP – Vdekje Shovinizmit Liri Popullit.

HYRJE

Në periudha të ndryshme të zhvillimit historik, çështja kombëtare, në këtë kuadër edhe Kosova që ka synuar zgjidhjen e saj, ka pasur veçoritë dhe problematikën e saj, të kushtëzuara nga rrethanat politike të brendshme dhe ndërkombëtare. Mbi bazën e tyre janë përpunuar pikëpamje e platforma për rrugët, mënyrat dhe mjetet që nevojiteshin për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe zgjidhjen e çështjes kombëtare. Edhe pse, vendimet e Kongresit të Berlinit (1878), Konferencës së Ambasadorëve (1912–1913), Traktati i Fshehtë i Londrës (1915) dhe Konferenca e Versajës (1919), shkatërruan rezidualin që kishte krijuar Perandoria Osmane në Shqipëri, ata e vazhduan copëtimin duke ri kompozuar rrugën e trasuar prej saj që pesë shekuj me radhë, ngaqë kur vendosej për fatin e shqiptarëve, Serbia paraqitej gjithnjë me projektet e saj ndaj territoreve shqiptare. Fatkeqësisht, shqiptarët në vazhdimësi ishin të ekspozuar para projekteve ndërkombëtare, disa prej të cilave edhe për zhdukjen e tyre.

Historia na tregon që në Kosovë, përpjekjet, në mos për rregullimin e kufijve – heqjen e kufijve artificial në mes të Shqipërisë – të paktën për një jetë më të mirë, të lirë dhe të pavarur, kurrë nuk pushuan si politikisht me pjesëmarrjen në institucionet shqiptare administrative, juridike dhe politike – me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, përfaqësimin në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, Qeverinë e parë të Shqipërisë – edhe në ato të Perandorisë Osmane (në Parlamentin Osman) dhe të Jugosllavisë, me Komitetin Krahinor të Partisë Komuniste Jugosllave më 1937 edhe ushtarakisht me kryengritjet dhe luftën kundër pushtuesit.

Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, çështja e Shqiptarëve në Jugosllavi mbeti e pazgjidhur dhe në këtë kuadër, trendi i aktivizmit social të shqiptarëve erdhi duke u

rritur dhe si përgjigje morën represionin sistematik të organeve shtetërore të ish-Jugosllavisë.

Nga viti 1945, deri në vitin 1999, pozita e shqiptarëve në ish-Jugosllavi veç sa vinte e rëndohej më shumë nga ndjekjet, persekutimet dhe diskriminimet, deri në tentativë për zhdukjen e qenies së tyre kombëtare në ish-Jugosllavi. Ky represion pati disa faza më të theksuara si në 1945, 1953, 1968, 1981, 1989, për të arritur ekstremin me gjenocid dhe krime kundër njerëzimit në vitet 1998–1999.

Në këtë studim me fokus të veçantë është trajtuar aplikimi i politikave penale ndaj shqiptarëve në Kosovë në harkun kohor 1981–1999. Në këtë kontekst, janë trajtuar shkeljet e lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë proceseve penale, ndikimet politike në proceset gjyqësore dhe ndjekjet, arrestimet dhe të gjitha format e mohimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut nga organet shtetërore të ish-Jugosllavisë, si dhe monitorimi i këtyre shkeljeve nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Objekt studimi janë edhe ndryshimet juridiko-politike, të Kosovës në kuadër të ish-Federatës, impakti i këtyre ndryshimeve në shoqërinë shqiptare, legjislacioni penal i aplikueshëm gjatë viteve 1981–1999, si dhe politika penale e zbatuar nga organet shtetërore të ish-Jugosllavisë.

Legjislacioni penal i ish-Jugosllavisë, për shkak të rrethanave juridiko-politike, ka qenë i përbërë nga disa ligje penale dhe ligji procedural penal, të cilat do të shqyrtohen në vijimësi në kontekst me kohezionin e tyre.

Interesi shkencor i studimit

Ndriçimi i politikave penale të zbatuara nga ana e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të Republikës Socialiste të Serbisë në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës dhe në Krahinën Autonome të Kosovës në periudhën 1981–1999, ka interes shkencor dhe historik sepse argumenton politikën penale ndëshkimore dhe antiligjore të aplikuar me motivacion politik dhe etnik kundër shqiptarëve në Kosovë.

Po ashtu, ky studim është me rëndësi për faktografinë në fushën e drejtësisë penale për shkak se përveç të tjerash, është i mbështetur në përvojën dhe dëshmitë e drejtpërdrejta të akterëve të përfshirë në zhvillimin dhe aplikimin e këtyre politikave penale në Kosovë, gjatë viteve 1981–1999.

Ky studim, nëpërmjet hulumtimit, ballafaqon faktet dhe argumentet nga katër grupe qytetarësh palë të përfshira direkt në këto procese, sipas rolit dhe përgjegjësisë që kishin, siç janë: personat e dënuar; përfaqësuesit e tyre; prokurorët dhe gjyqtarët të përfshirë në këto procese gjyqësore penale.

Interesi shkencor i studimit është se ballafaqimi i fakteve i përftuar nga të gjitha palët e përfshira, është objektiv nga fakti se në kohën që janë siguruar, kanë pushuar së vepruari të gjithë faktorët objektivë dhe subjektivë, të cilët kanë ndikuar në zhvillimin e këtyre ngjarjeve.

Kufizimet dhe pikat e forta të studimit

Ky studim gjatë zhvillimit të tij, ka hasur në pengesa të natyrës objektive dhe subjektive për shkak të kushtëzimit të rrethanave të cilat kanë paraqitur disa mundësi të kufizuara, siç janë:

- Mungesa e vullnetit të ish-hetuesve policorë dhe zyrtarëve të sigurimit të shtetit për të bashkëpunuar;
- Pamundësia e qasjes në arkivat e ish-Sekretariatit të Punëve të Brendshme;
- Mungesa e vullnetit të ish-gardianëve të burgjeve për të bashkëpunuar;
- Mundësia e kufizuar për të pasur bashkëpunim në hulumtim nga një numër më i madh i qytetarëve ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë, ngase hezitonin.

Këto kufizime konsiderohen si pika të dobëta të studimit për shkak të mundësive të limituara që ofruan këto kategori dhe institucione.

Fakti se një pjesë e konsiderueshme e akterëve të zhvillimit të këtyre proceseve penale jetojnë ende edhe gjatë periudhës së studimit dhe bashkëpunimi i tyre pa rezerva e pasuron dhe përbën pikat e forta të studimit. Këto pika të forta janë, por nuk kufizohen:

- Pjesëmarrësit në hulumtim nga grupi i ish-të akuzuarve/dënuarve politikë;
- Qasja në aktgjykimet e personave të dënuar të lejuar nga vetë qytetarët ish të dënuar;
- Pjesëmarrësit në hulumtim nga grupi i ish-përfaqësuesve – Avokatët mbrojtës;
- Pjesëmarrësit në hulumtim nga grupi i ish-prokurorëve;
- Pjesëmarrësit në hulumtim nga grupi i ish-gjyqtarëve;
- Legjislacioni penal i aplikueshëm në periudhën objekt studimi;
- Materialet nga shtypi i kohës objekt studimi i temës;
- Burime të ndryshme nga studimet universitare, nga arkivat dhe bibliotekat.

Mund ta konsiderojmë si pikë të fortë të këtij studimi, faktin se qytetarët e anketuar nga katër grupet e lartpërmendura, në periudhën që janë përgjigjur, për arsye objektive, kohës, kanë qenë të shkarkuar nga ndikimi i faktorëve emocionalë, politikë, juridik dhe frika për sigurinë e tyre personale dhe familjare.

Hipotezat e studimit

Në kuadër të aplikimit të politikave penale gjatë periudhës kohore 1981–1999, nga RSFJ dhe RSS ndaj shqiptarëve në KSAK dhe KAK, janë ngritur dilema dhe mendime të ndryshme, lidhur me ndikimin dhe qëllimin e këtyre politikave penale. Ngritja e hipotezave, analiza, si dhe vërtetimi ose rrëzimi i tyre lidhur me njohuritë dhe qëndrimet e qytetarëve pjesëmarrës në hulumtim, si dhe faktorët që kanë ndikuar në aplikimin e këtyre politikave, janë trajtuar hap pas hapi në këtë studim.

Hipoteza Themelore: “Politikat penale në Kosovë gjatë viteve 1981–1999, kanë qenë të motivuara dhe ndikuara nga faktorët politikë dhe etnikë.”

Hipotezat ndihmëse:

- Tortura është përdorur si mjet dhe metodë për pranimin e fajësisë, gjatë viteve 1981–1999;
- Gjatë viteve 1981–1999 kanë dominuar akuzat dhe dënimet në grupe me fokus të një nacionaliteti dhe diskriminimit etnik;
- Ligjet dhe sistemi i drejtësisë janë përdorur si mburojë juridike për qëllime politike;
- Procedurat penale të zhvilluara gjatë periudhës 1981–1999, nuk janë mbështetur në shumicën e rasteve në prova dhe fakte juridike.

Metodologjia e studimit

Çështja e shkeljes së lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë procedurës penale ekziston në teori në literaturën profesionale, si dhe në praktikë, prandaj edhe imponon nevojën për studim.

Hipoteza e ngritur mund të identifikohet lehtë nga çdo lexues.

Studimi është brenda kontekstit të kohë hapësirës konkrete që institucionet shtetërore të ish–Jugosllavisë kanë zbatuar politika ndëshkuese penale ndaj shqiptarëve.

Në mënyrë të qartë është identifikuar dhe shpjeguar problemi brenda linjave kërkimore në të cilat mbështetet punimi.

Temat, përkatësisht konceptet shkencore janë të kuptueshme.

Studimi për nga natyra e grumbullimit dhe analizimit të të dhënave, është një gërshetim i metodës sasiore me metodën cilësore të kërkimit (Shamiq, 2009, xix).

Në këtë studim janë përdorur metodat standarde profesionale akademike siç janë hulumtimi nëpërmjet pyetësorëve, shfrytëzimi i burimeve të kohës dhe të studimeve të mëvonshme, qasja e drejtpërdrejtë në dokumentet arkivore dhe aktgjykimet e personave të dënuar.

Po ashtu, studimi është konceptuar në mënyrë sistematike dhe analitike duke pasqyruar faktet dhe rrethanat historike, politike, juridike dhe sociale, duke i krahasuar ato me të dhënat nga pyetësorët respektiv.

Hulumtimi me pyetësorë është bërë drejtpërdrejtë me takim fizik me të anketuarit nga katër grupe të ndryshme me persona të dënuar, avokatë, prokurorë dhe gjyqtarë.

Pyetësorët dhe rezultatet e tyre janë bashkëngjitur si pasqyrë dhe shtojcë në studim.

Duke qenë se të dhënat e përftuara, janë me shumë ndryshore, u përdor programi profesional elektronik për pasqyrimin e rezultateve statistikore – SPSS.

Punimi ka qasje deduktive, duke u bazuar në literaturë dhe duke u kombinuar me qasjen empirike. Për realizimin e hulumtimit është aplikuar metoda sasiore, e cila është realizuar përmes teknikës së anketimit nga një grup i larmishëm i qytetarëve, nga e cila është përzgjedhë mostra reprezentative. Në këtë rast, teknika e anketimit është realizuar përmes pyetësorëve të hartuar për secilën kategori të mostrës së përfshirë në hulumtim.

Metodat të cilat janë përdorur për realizimin e këtij hulumtimi, janë: metoda analizës teorike, historike, metoda e komparacionit, metoda empirike, metoda statistikore deskriptive dhe metoda kauzale.

- Metodat e analizës teorike – përmes kësaj metode është analizuar literatura e autorëve më meritorë që kanë trajtuar problematikën që është objekt studimi.
- Metoda historike – mbështetur në këtë metodë tematikës i është bërë një këndvështrim historik të zhvillimit të proceseve sociale, juridike dhe politike, por me fokus të veçantë periudhën 1981–1999, me qëllim të ndriçimit sa më të saktë të ndryshimeve gjatë dy dekadave të problematikës që e kemi objekt studimi, e bazuar në elaborimin e dokumenteve ligjore, zhvillimin e ngjarjeve gjatë periudhave politike sipas viteve të përshkruara në qëllimin e punimit, definon kornizën teorike. Gjithashtu, mbështetet në dëshmitë e siguruara dhe politikën penale ndëshkimore dhe antiligjore të aplikuar me motivacion politik dhe etnik kundër shqiptarëve në Kosovë.
- Metoda e komparative – krahasimi në këtë studim, është zbatuar me qëllim që të pasqyrojmë problematikën disi dhe ndryshimet në periudhat që përfshijnë dy dekadat e që kryesisht këto të dhëna më shumë janë të natyrës deskriptive dhe kauzale.

Me qëllim që studimi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të elaborojë e ndriçojë saktë problematikën, përveç trajtimit teorik kemi bërë edhe hulumtim duke përdorur instrumente e metoda si:

- Metodën sasiore – pasi që numri i të anketuarve ishte i madh dhe problematika ka përfshirë një spektër të gjerë të çështjeve, është përdorur kjo metodë, në kuadër të së cilës kemi përdorur katër lloje të pyetësorëve. Në këtë kuadër, pyetësorët kanë qenë në anën e antitezës së studimit dhe janë formuluar në mënyrë që të na japin të dhëna objektive, të verifikueshme dhe të sakta. Mangësia e tyre është pamundësia e gjithëpërfshirjes, për shkak të ngurrimit të ish–zyrtarëve policorë dhe të shërbimit sekret të kohës për të bashkëpunuar gjatë hulumtimit.
- Metoda cilësore – ka siguruar qasje të drejtpërdrejtë në terren nga hulumtuesi. Aspekti empirik ka realizuar matjen e fenomeneve reale dhe bazohet në të dhënat e siguruara nga të anketuarit e hulumtimit të cilët na kanë siguruar dëshmi lidhur me periudhat kohore në funksion të hulumtimit. Të pyeturit e përfshirë në hulumtim prezantojnë eksperiencat e tyre sipas përgjegjësi që kanë pasur në periudhat që hulumton ky studim.
- Metoda statistikore – ka siguruar matjen shkencore dhe testimin e hipotezave përmes përshkrimit të të dhënave të siguruara nga hulumtimi. Pyetësorët e përdorur me secilën kategori të participantëve të hulumtimit, kanë siguruar të dhëna relevante për studimin dhe këto të dhëna, në kombinim me kornizën teorike, kanë ndihmuar që të arrihen më lehtë përfundimet kuptimplota të hulumtimit.
- Metoda kauzale – ofroi të dhënat e nevojshme shkak–pasojë mbi objektin e studimit të kësaj teme, për periudhën respektive.

Metodologjia e studimit u orientua që të vërtetohen hipoteza themelore së bashku me hipotezat ndihmëse, përkatësisht të arrihet më lehtë te sinteza e studimit.

Përzgjedhja e kampionëve

Hulumtimi me pyetësorë është bërë drejtpërdrejt me takim fizik me të pyeturit nga katër grupet e ndryshme respektive:

Ish-të dënuar politik; ish-avokatë; ish-prokurorë dhe ish-gjyqtarë.

Kampionët e hulumtimit janë përzgjedhur nga pesë Komunitet më të mëdha të Kosovës ku përveç gjykatave komunale, ka pasur edhe Gjykatë të Qarkut: Prishtinë; Mitrovicë; Pejë; Prizren dhe Gjiilan.

Për konstatimin e hipotezës themelore dhe atyre ndihmëse, janë përdorur pyetësorët të cilët janë dorëzuar drejtpërdrejte tek qytetarët e pyetur.

Pyetësorët u hartuan në mënyrë të përfuturit të të dhënave sociale dhe të të dhënave objekt studimi të temës, sipas grupit respektiv të pjesëmarrësve në hulumtim, siç ishin:

Të dhënat personale sociale: gjinia, mosha kur janë arrestuar/dënuar për herë të parë, mosha e tyre në kohën e realizimit të pyetësorit, niveli ekonomik, arsimimi, statusi civil.

Të dhënat personale objekt studimi: lloji i veprës penale për të cilën është dyshuar/akuzuar, respektimi, përkatësisht cenimi i lirive dhe të drejtave të tij nga organet e hetuesisë, gjyqësisë dhe drejtësisë; lloji i dënimit të shqiptuar.

Fokus grupi – u shtri në nivel vendi, përkatësisht në tërë territorin e Kosovës, me takim të drejtpërdrejtë, duke respektuar metodën profesionale siç përcakton ligji sociologjik. Qytetarët e pyetur nga grupi i ish të dënuarve politik, përveç përgjigjeve të tyre në pyetësor na mundësuan qasjen në aktgjykimin e tyre.

KAPITULLI I

PROCESI I ZHVILLIMIT TË STATUSIT JURIDIKO-POLITIK TË KOSOVËS

1.1. Vështrim i përgjithshëm

“Kosova – i thoshte auditorit të vet kryeministri britanik Toni Bler në ditët e para të Prillit 1999 – gjendet në pragun e Evropës. Megjithatë as edhe një gjeograf nuk do t’i quante Kosovën dhe fqinjët e saj pjesë të Azisë. Po nëse s’është as Evropë e as Azi, ku gjetiu, vallë, shtrihet gadishulli ballkanik? (Glenny, 2000).

Këtu fillon fundi i konfliktit në mes të popullit shqiptar dhe atij serb, i cili daton nga shekuj më parë. Në çështjen shqiptaro-serbe, serbët vazhdimisht i luftonin shqiptarët në tokat e tyre, duke i akuzuar si osmanlinj, islamikë, irredentistë, separatist, kryengritës, armiq, terroristë, egërsira, etj. Të gjitha këto emërtime përcaktonin nocionin shqiptar, për të cilin ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë cariste, në fillim të shekullit XX, kishte deklaruar: “Deri në fund të këtij shekulli shqiptarët duhet të hidhen në det” (Glenny, 2000, 5).

Ky ishte plani i aparatit shtetëror serb, i cili në disa faza edhe u realizua, por falë qëndresës së popullit shqiptar të Kosovës dhe më gjerë dhe bashkësisë ndërkombëtare nuk u përfundua ashtu siç e kërkonte edhe ministri i Jashtëm i Rusisë Cariste. Origjina e konfliktit shqiptaro-serb nuk e ka një datë të caktuar, por që këta dy popuj rrugëtuan në konflikt të përhershëm, kjo nuk mund të kontestohet. Shqiptarët si pasardhës të ilirëve, u sulmuan dhe u pushtuan në vazhdimësi nga sllavët. Në periudhën prej viteve 1180 deri në 1190, shteti serb u zgjerua në rrafshet e Kosovës në kohën e Stefan Nemanja, por betejat për pushtimin e tokave shqiptare nga sllavët nuk kishin të ndalur, Serbia u

zgjerua edhe më shumë në kohën e mbretit serb Stefan Dušan, i cili pushtoi qytetet e tjera maqedonase, tërë Shqipërinë me përjashtim të Durrësit (Ali, 2003, 94–95).

Faktet flasin se pushtues ishin serbët dhe të pushtuar si gjithmonë shqiptarët, por kjo nuk e përjashton faktin e ndonjë kundërsulmi vetëmbrojtës gjatë periudhave të ndryshme kohore të popullit shqiptar ndaj atij serb, të cilat populli shqiptar u detyrua që ta ndër marrë në rrethana vetëmbrojtëse apo nevojës për ekzistencën e tij. Këto ngjarje serbët me mjeshtëri dhe dinakëri i nxirrnin jashtë kontekstit të ngjarjeve, duke i zmadhuar dhe hiperbolizuar para kancelarive evropiane dhe popullin shqiptar e prezantonin si popull të egër. Nëse ju referohemi ngjarjeve historike, është e qartë për çdo studiues objektiv se luftëra, pushtime, aneksime dhe okupime ka sjellë gjithmonë populli serb në Ballkan dhe objekt sulmi ishin shqiptarët dhe tokat e tyre. Historia e vjetër dhe e re, na jep argumente të pakontestueshme se, tokat shqiptare dhe populli shqiptar, u copëtuan dhe u zvogëluar gjatë historisë. Gllabërimi i tokave shqiptare ndodhi në shumicën e rasteve me miratimin e perandorive dhe Fuqive të Mëdha, sa nga interesi i ruajtjeve të balancave të tyre, po aq edhe nga interesi i ruajtjes së miqësive të vjetra.

Në Ballkan nuk është temë e re konflikti në mes të popujve lidhur me origjinën e tyre dhe nuk mungojnë as mitet për bëmat dhe heroizmat e njërit popull apo tjetrit, ashtu siç nuk mungojnë edhe rastet e tentim përvetësimit të ndonjë heroi duke spekuluar mbi origjinën e tij. Është konstatuar se populli shqiptar është pasardhës i popullit ilir, por nuk kanë munguar edhe zërat të cilët e kanë kontestuar origjinën ilire të shqiptarëve. Disa prej këtyre zërave bien në kundërshtim edhe me vet pohimet e tyre mbi origjinën ilire të shqiptarëve. Njëra ndër këta është historiania jugosllave Fanula Papazoglu, e cila, në dy punime të publikuara, konstaton se ka ekzistuar mbretëria ilire si organizim i

formuar dhe i fortë politik, në të cilin kanë zotëruar marrëdhëniet skllavopronare (Ali, 2003, 90)

Me ndryshimet politike, ndryshojnë edhe qëndrimet e shkencëtarëve siç ishte Fanula Papazoglu. Sipas saj, ilirët në vendin e vet kishin një zhvillim ekonomik, politik, kishin qytete, kishin formacion shtetëror të vetin, por jashtë territorit të Kosovës. Në Kosovë kemi dardanët, të cilët janë më primitivë në shkallën e zhvillimit të tyre, që nuk kanë qytete, nuk kanë formacion politik shtetëror të vetin, pra, nuk janë ilirë. Sipas studiuesit dhe shkencëtarit Aleks Buda, kjo është një paturpësi tepër e madhe, sipas tij ky argumentim është antilogjik, sepse mund të kesh një etnos, një popullsi me origjinë të ngjashme, të përbashkët që ka shkallë të ndryshme zhvillimi (Buda, 2006, 468–469).

Në Jugosllavi nuk ishte vetëm politika që lëvizte nga çasti në çast, por ajo tentonte që edhe historinë ta ndryshonte sipas politikës ditore dhe për këtë shfrytëzonte emra të njohur nga fusha të ndryshme, të cilët i kundërvinte përball argumenteve të veta. Radhët e studiueseve të cilët u ndikuan nga politika shoviniste serbomadhe nuk kishin të ndalur. Me rastin e organizimit të Kongresit Ndërkombëtar të Studimeve ilire të mbajtur në Tiranë me 1972, me pjesëmarrje të gjerë të arkeologëve të vendit dhe ndërkombëtar, ku pesëdhjetë ishin nga Jugosllavia dhe objekt diskutimi ishte pikërisht historia e lashtë e ilirëve, vazhdimësia e tyre, vazhdimësia iliro-shqiptare dhe pjesa më e madhe e arkeologëve jugosllavë u konkorduan me pikëpamjet e arkeologëve shqiptar dhe pjesa tjetër nuk nxori asnjë kundër argument për ta sqaruar këtë problem nga pikëpamjet e tyre. Një nga këta historianë M. Garashanini, i cili i dha jehonë këtij kongresi dhe për këtë shkroi edhe një artikull me titull: “Arkeologjia shqiptare hyn me ton madhor në arenën e shkencës arkeologjike ndërkombëtare” (Buda, 2006, 467–468).

Pas vitit 1981, në ish-Jugosllavi, me ndryshimet politike edhe historianë dhe studiues, krahas politikanëve ndërronin qëndrimet dhe pohimet e veta akademike. Njëri ndër ta

ishite edhe historiani Ilija Garašanin (ish–Kryeministër i Serbisë), i cili del me një qëndrim kontradiktor me veten e tij. Sipas Garashaninit, nuk ja vlente të merrej me problemet e historisë së lashtë të popujve ballkanik, por kjo nuk kishte të ndalur kur ishin në pyetje studiues serb, maqedonas, por siç konstatoi Aleks Buda, mbeten tabu e të paprekshme për historianët shqiptarë sepse, aty fillon mallkimi. E qartë ku rreh çekani. Problemi nuk është thjesht kosovar, problemi i gjenezës së shqiptarëve zgjidh për ta problemin e popullsisë, të lashtësisë e të autoktonisë së banorëve të Kosovës (Buda, 2006, 468).

Akademia e Arteve dhe Shkencave e Serbisë në momente mjaft delikate e ka shërbyer popullin e saj me pseudo fakte që edhe ata vetë e kanë pohuar se nuk janë të vërteta. Udhëheqësi i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Serbisë dhe ish–President i RSFJ Dobrica Ćosić, thoshte: *“Gënjejmë për të mashtruar veten dhe për të ngushëlluar tjetrin. Gënjejmë për bamirësi. Gënjeshtër ne nuk na frikëson, por na trimëron. Gënjejmë me dëshirë dhe për njëzillëk. Gënjejmë në shenjë nderimi. Gënjejmë për hir të lirisë. Gënjeshtër është forma e patriotizmit tonë, është dëshmi e zgjuarsisë (inteligjencës) sonë të lindur. Ne gënjejmë në mënyrë krijuese, fantastike, inventive”* (Muja, 2009, 13–14).

Të ushqyerit me mite dhe pastaj besimi se ato janë të vërteta, nga fakti se janë thënë nga njerëz me autoritet dhe institucione zyrtare, pa mëdyshje se ndikon në popull e vet, duke e orientuar në rrugë të gabuara dhe kjo ndodhi pikërisht me popullin serb.

Historianët serb e mohuan atë që me shkencë e kanë argumentuar dhe kjo është bërë sa herë e ka kërkuar politika, por, siç thotë ilirologu i mirënjohur jugosllav, Aleksandar Stipčević, për kroatët, serbët, malazezët, problemi ilir është pjesë e historisë së vendit të

vet, kurse për shqiptarët ai është pjesë e historisë së popullit të vet (Buda, 2006, 481–482).

Kosova që nga e kaluara e lashtë, përbënte tërësi politike–territoriale në pjesën ilire të Dardanisë. Po ashtu, ajo gëzonte mëvetësinë në kohën kur u konstituua si vilajet në vitin 1868. Gjatë luftës antifashiste, ishte njësi e organizuar në pikëpamje politike, juridike dhe ushtarake dhe pjesë integrale e frontit antifashist.

Në faqen e parë të librit: "a journey to the rivers – Justice for Serbia", Petter Hendke citon diplomatin Miloš Crnjanski: "...çfarë ndryshimi do të bëhet me ne, nëse mbysim tre milion njerëz. Qielli mbetet i njëjtë, shumë i kaltër, vdekja kthehet, por paqja vjen. Ne do të bëhemi të lirë dhe të fortë...". Mjerisht, Crnjanski ishte vetëm njëri prej atyre që mbanin këtë mentalitet, të ushqyer mendërisht prej asaj që sot mund të quhet "Akademi Serbe e Shkencave" dhe "Kishë Ortodokse Serbe" (Muja, 2009, 11).

Planet e akademikëve serb, për zhdukjen e kombit shqiptar dhe krijimin e "Serbisë së Madhe", janë të kamotshme. Burimi frymëzues për gjenocid ndaj popullit shqiptar, gjendet në programet e politikës së jashtme të Serbisë, që nga gjysma e parë e vitit 1800, program ky i përpunuar në vitin 1844, në draftin Načertanije* të ish–Ministrit të brendshëm serb Ilija Garašanin që mbështetej në krijimin e "Serbisë së Madhe", ky program u pasua nga Vaso Čubrilović (Shpërngulja e Arnautëve, 1937), projekti i Ivo Andrić (1939) dhe Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (1986) (Bajrami A., 2011, 343).

* Načertanije (drafti) është një ish-program i fshehtë i politikës së jashtme dhe kombëtare të Serbisë, i cili u shkrua në fund të vitit 1844 nga Ministri i Brendshëm Ilija Garašanin (1812–1874) për Princin Aleksandar Karadordević (1842–1858). Ajo u botua për herë të parë në tërësinë e saj në 1906. Sipas Načertani, Serbia duhej të punonte për çlirimin e serbëve dhe sllavëve të tjerë dhe aneksimin e Bosnjës, Hercegovinës, Malit të Zi dhe Shqipërisë Veriore (e cila përfshinte Kosovën dhe Metohinë, atëherë pjesë e Perandorisë Osmane dhe Srem, Backa dhe Banat, atëherë pjesë e Austro-Hungarisë. Aktiviteti kryesor propagandistik i Serbisë do të bazohej në përgatitjen e popullsisë së këtyre zonave për bashkim me Serbinë. Sipas Garašanin, Serbia vendos një "të drejtë të shenjtë historike" mbi këto vende, e cila bazohet në perandorinë Serbe të Dushanit nga shekulli i XIV.

Edith Durham me kohë e kishte kuptuar se “Kisha Ortodokse në programet e saj kundër çifutëve në Rusi dhe me bëmat e saj në Ballkan tani mban rekordin botëror për mizori fetare (Muja, 2009, 24).

Kisha Ortodokse Serbe dhe Akademia e Arteve dhe e Shkencave të Serbisë, luante me një kartë shumë të rrezikshme në disfavor të Kosovës në raport me bashkësinë ndërkombëtare duke bërë përpjekje që konfliktit në mes të shqiptarëve dhe serbëve ti jepte konotacion fetar. Kjo linjë zbatohet nga qeveritarët serbë në Kosovë, ndër ta edhe Miloš Simonović (1992), i cili i thoshte delegacionit rus: “Në Kosovë nuk po mbrohet vetëm serbizimi, por këtu po mbrohet para së gjithash, ortodoksizmi nga invazioni islamik i shqiptarëve...”. (Muja, 2009, 15).

Politika serbe e kishte trilluar këtë çështje, duke tentuar të vendosë në lajthim bashkësinë ndërkombëtare dhe njëkohësisht të shtypte popullin shqiptar të Kosovës në emër të ndjekjes së fundamentalizmit islam. Referuar kësaj problematike, drejtori i Qendrës për Studime Strategjike Ndërkombëtare në Washington DC, Joseph Montuoll, në një intervistë dhënë të përditshmes “The New York Post”, thoshte: “Ç’është e vërteta, propaganda islamike nuk ka ekzistuar as në Bosnje as në Kosovë, në dallim nga fundamentalizmi i krishterë fundamentalist serb. Serbët rëndom përdorin nofkat ‘fundamentalizëm’ e ‘terrorizëm’ si terma sinonime me fjalën ‘islam’.

Në vitin 1937, lideri i Akademisë Serbe, Vasa Çubrilović, shprehu këtë mendim për shqiptarët: “Në kohën kur Gjermania mund t’i përjashtojë me dhjetëra mijëra hebrenj dhe kur Rusia mund t’i transformojë me miliona njerëz nga një pjesë e kontinentit të tjetra, transformimi i disa qindra mijëra shqiptarësh nuk do të shkaktojë fillimin e luftës së re botërore (Weller, 2009, 72–73).

1.1.1. Pozita e Kosovës pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë

Shqiptarët dhe toka e tyre historikisht kanë qenë viktimë e interesave të Fuqive të Mëdha, të cilat fuqi për hir të balancave të tyre politike e strategjike e copëtuan Shqipërinë Etnike. Misha Glenny, një njohës i mirë i konflikteve ballkanike, thoshte se: “Ballkani nuk ishte fuqia e barutit, sikundër mendohet shpesh, kjo metaforë është e pasaktë. Ai ishte thjesht detonatori, vënë nga vetë Fuqitë e Mëdha. Fuqia e barotit ishte Evropa (Glenny, 2000, 243).

Kosova si njësi e veçantë administrativo–juridike kishte një sipërfaqe me 22.900 kilometra katrorë. Shteti serb, duke i shfrytëzuar të gjitha format për aneksimin e tokave shqiptare për një dalje në Adriatik, nuk i kursej instrumentet politike dhe ushtarake për copëtimin e trojeve etnike të Shqipërisë. Pas Kongresit të Berlinit që rezultoi nga paqja e Shën Stefanit, ku Perandoria Osmane ishte mundur nga ajo Ruse, Serbisë ju dhanë territore të tëra të banuara me shqiptarë që në atë kohë ishin në Perandorinë Osmane, duke filluar nga Nishi, Leskovci, Vranja, Toplica. Në këtë kohë Serbia pushtoi Kosovën (Bajrami A., 2011, 31).

Në këtë kohë, në Kosovë u përgatitën dhe u zhvilluan kryengritje masive shqiptare (1910–1912) kundër pushtuesit turk me synim themelimin e shtetit të pavarur kombëtar shqiptar në Ballkan (Zajmi, 1996, 36).

Me gjithë rezistencën e pareshtur, Kosova mbeti jashtë territorit të shtetit shqiptar. Copëtimi i tokave shqiptare, u bë në Kongresin e Berlinit me 1878 dhe u finalizua me Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1913), ku edhe u ri konfirmuan vendimet e Kongresit të Berlinit. Shqiptarët të cilët kishin rezistuar me shekuj, tani si shpërblim nga perëndimi dhe nga fqinjët, morën copëtimin e tokave të tyre. Serbia me 1912 e aneksoi Kosovën nëpërmjet pushtimit ushtarak, pas një agresioni të saj në Perandorinë Osmane

“edhe pse qysh prej kohës Kosova e kishte identitetin e vet historik dhe etnik, të shoqëruar me legjitimitetin e çlirimit të vet (Stavileci, 2008, 317).

Pozita e shqiptarëve të Kosovës të cilët mbetën jashtë territorit të Shqiptar ishte shumë e rëndë. Këtë situatë të mjerueshme më mirë e pasqyron një letër e Isa Boletinit dërguar Ismail Qemalit me 16 Gusht 1913, ku pos të tjerash, shkruhej: “Çdo skutë e Malësisë, gurë, shkëmb, gjithandej është mbushur plot me emigrantë të mjerë, të cilët kanë ardhur në një gjendje jo të lypin, por të vdesin. Nuk ka zemër që duron përpara vajtimit të këtyre bijave të atdheut...” (Shala, 2006, 232).

Kjo ishte goditja më fatale që e pësoi populli shqiptar dhe këtë gjendje të këtyre viteve shumë të vështira për popullin shqiptar, më së miri e përshkruan korrespondenti austriak në Kosovë Leo Freunclih, i cili shkruante: “Mijëra e mijëra burra, pleq e fëmijë, të vrarë e të mbytur në therje, fshatra të djegura e shtëpi të plaçkitura, gra e vajza të çnjerëzuara, një vend i shkatërruar, i plaçkitur i larë në gjak e i turpëruar, tregon se serbët në Shqipëri nuk hynë si çlirimtarë, por si vrasës të shqiptarëve” ata bëjnë krime që nuk mund të përshkruhen, pleqtë e fëmijët mbyten, qindra fshatra digjen, klerikët theren... Një popull i mjerë në fat të trishtueshëm, nga golgota e vet, thërret në ndihmë! A e dëgjon Evropa thirrjen e tij?”

Këtë tragjedi nëpër të cilën po kalonte populli shqiptar e përshkruante edhe gazeta “Rad” (Beograd 5. VIII. 1925), ku thuhej se: “Që disa ditë shtëpitë e shqiptarëve digjen në flakë. Është vështirë të dëgjosh britmat e fëmijëve dhe të pleqve që keqtrajtohen dhe merren nëpër këmbë, me qëllim që të plaçkiten... Atje ndizen fshatra të tëra, vriten shumë njerëz, mizoritë janë të pakufishme. Në këtë vend askush nuk ka turp. Pushteti predikon shfarosjen e një popullsie për shkak të urrejtjes kombëtare, predikon therje e gjakderdhje të reja... fshatrat shqiptare ngajnë në kasaphane të vërteta (Muja, 2009, 6).

Edhe pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, Kosova përsëri kthehet në gjuhë për Fuqitë e Mëdha. Ishte Konferenca e Versajës e vitit 1919, e cila edhe njëherë dënoi popullin shqiptar, duke e lënë mbi 50% të trojeve etnike të popullit shqiptar nën juridiksionin grek dhe jugosllav (Bajrami A., 2011, 33).

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, populli shqiptar u rreshtua në krah me fqinjët dhe aleatët përballë nazi-fashizmit, por e keqja shqiptarëve të Kosovës në fund nuk do t'u vinte nga nazi-fashizmi, por nga vet aleatët e saj. Popujt “miq”, ishin bërë aleatë mbi bazën e një qëllimi, që pas përfundimit të luftës, secili komb të vendosë për fatin e tij dhe këtu Kosova e kishte shumë të qartë fatin e saj, bashkimin me trungun e saj Shqipërinë.

Edhe pse shqiptarët e Kosovës i plotësuan të gjitha premiset e nevojshme për vetëvendosje si ato etnike, historike dhe politike, Jugosllavia veproi sipas raportit të forcave. U shkelën të gjitha garancitë dhe një ndër më të rëndësishmet ajo ndërkombëtare e Kartës së Atlantikut – 14 Gusht 1941, se popujt që luftojnë kundër fashizmit do të kenë të drejtën të vendosin për fatin e vet dhe Kosova përfshihej brenda këtij perimetri. Ngjarjet e mëvonshme të cilat u zhvilluan pas Luftës së Dytë Botërore, për Kosovën nuk sollën asgjë pozitive, veç se robëri të re.

1.2. Statusi i Kosovës Pas Luftës së Dytë Botërore

Komiteti Krahinor i PKJ për Kosovë, më 07 Korrik 1941, formoi Komitetin Ushtarak dhe në fund të vitit 1941, formon Shtabin Kryesor të Përkohshëm të LNÇ për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit (Bajrami A., 2002, 34).

Në Konferencën e Dytë të Komitetit Nacionalçlirimtar/PKSH që u mbajt më 04–09 Shtator 1943, në Labinot/ELBASAN, Enver Hoxha dha një deklaratë për Kosovën, e cila në mes tjerash thoshte: “Lëvizja nacionalçlirimtare ka për detyrë ta bëjë popullin e Kosovës koshient për aspiratat e tij dhe ai do të arrijë ta çlirojë veten vetëm nëpërmjet luftës kundër okupatorëve fashistë ose okupatorit eventual jugosllav, Dragoljub "Draža" Mihailović. Ne duhet të kujdesemi që populli i Kosovës të vendosë vetë se me cilën palë do të bashkohet... dhe të kundërshtojë regjimin jugosllav, që do të përpiqet ta shtypë.” (Hibbert, 1993, 97).

Pas kësaj deklarate, më 29 Nëntor 1943, në Jajcë/JUGOSLLAVI, kur u mbajt Mbledhja e Dytë e Komitetit Antifashist Çlirimtar të Kombeve të Jugosllavisë – KAÇKJ, u përcaktuan bazat e federalizmit jugosllav – nuk qenë të ftuar përfaqësuesit nga Kosova – Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave i dërgoi një letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila në mes tjerash thoshte: “të ngresh çështjen e bashkimit (të Kosovës me Shqipërinë) do të thotë t’u japësh dorën e ndihmës reaksionarëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe vetë armikun... dhe nuk është e nevojshme të theksohet se kjo nuk mund të përbëjë një çështje ndërmjet nesh dhe një Shqipërie demokratike e anti imperialiste... Jugosllavia e re që po ndërtohet, do të jetë një vend i kombeve të lira dhe si rrjedhim, nuk do të ketë vend për shtypje kombëtare të pakicave shqiptare...” (Hibbert, 1993, 142).

Pas shkëmbimit të këtyre letrave kundërshtuese në mes të KQ të PK të dy vendeve respektive, në fund të Dhjetorit 1943, partizanët shqiptarë dhe jugosllavë, krijuan Komitetin Çlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit. Pas përgatitjeve të nevojshme, filloi Konferenca Themeluese e Komitetit Kosovar Nacionalçlirimtar, që njihet si Konferenca e Bujanit, e cila u mbajt më, 31 Dhjetor 1943–02 Janar 1944, ku morën pjesë edhe përfaqësuesit e Ushtrisë Nacional Çlirimtare të Jugosllavisë*.

Këtë Konferencë e drejtonin Fadil Hoxha – koleg i vjetër i Miladin Popović, i cili ishte caktuar nga Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë të merrte komandën në Kosovë – dhe Mehmet Hoxha komisar i tij, i cili bashkë me Dushan Mugoshën, në Mbledhjen e Këshillit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë, të mbajtur në Beograd/SERBI, më 07–09 Prill 1945, si përfaqësues të Kosovës, deklarohen për bashkimin e Kosovës me Serbinë.

Pjesëmarrësit, të frymëzuar nga ideali për bashkim kombëtar, në punimet e Konferencës së Bujanit, njëzëri miratuan një sërë vendimesh, e cila më kryesorja ishte Rezoluta e kësaj Konference, në të cilën shprehimisht thuhej:

“Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është një krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron të bashkohet me Shqipërinë. Prandaj e ndjejmë për detyrë t’i tregojmë rrugën e drejtë që duhet të ndjek populli shqiptar për të realizuar aspiratat e veta. Rruga e vetme, pra, që populli shqiptar i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjakatar e rrogëtareve të tij. Sepse kjo është e vetmja rrugë për të fituar lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe

* Komiteti Krahinor i PKJ, at’botë ka qenë i lidhur me Komitetin Krahinor për Mal të Zi, Sanxhak dhe Bokë. Shih për këtë Dr. Arsim Bajrami, E Drejta e Kosovës në Tranzicion (E Drejta Kushtetuese – Libri II), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2002, fq. 34.

shqiptarët, do të kenë mundësi të vendosin për fatin e vet me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Garanci për këtë është Ushtria Nacional Çlirimtare e Jugosllavisë dhe Ushtria Nacional Çlirimtare e Shqipërisë, më të cilën është ngushtësisht e lidhur. Përveç këtyre, për këtë garantojnë aleatët tonë të mëdhenj: Bashkimi Sovjetik, Anglia, Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe ajo e Teheranit)”, (Bajrami A., 2011, 35).

Ky dokument përcaktonte bazën politiko–juridike të orientimit të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore. Apo siç thoshte, Neol Malcolm, në fakt, Rezoluta e Bujanit paraqiste dokumentin themelor të vetëvendosjes së shqiptarëve të Kosovës (Malcom, 2011, 307–308).

Me të drejtë Dr. Bajrami konstaton se zbërthimi juridiko–politik i saj nxjerr në pah tre elemente qenësore që e përcaktojnë të drejtën e vetëvendosjes së popullit shqiptar në Kosovë:

- elementi etnik;
- elementi historik;
- elementi politik (Bajrami A., 2002, 33).

Në fakt, përveç kësaj, Rezoluta e Konferencës së Bujanit, pasuroi dhe përforcoi faktografinë shqiptare në mënyrë burimore duke ri argumentuar se filozofia politike e Popullit Shqiptar, buron nga vlera dhe parime demokratike, ngase kërkoi zgjidhje politike dhe sipas parimit që forca shërben për një herë, ndërsa edukata përgjithmonë, vetëm kur ju imponua kërkoi edhe zgjidhje ushtarake.

Zgjidhja e çështjes së kësaj pjese shqiptare – Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit – siç thekson Hibbert, nuk ishte dhe aq e thjeshtë sa mendohej në fillim të Luftës së Dytë Botërore, pas përçarjes në mes të shqiptarëve dhe jugosllavëve, që mbollën italianët dhe gjermanët në momentet e para të kapitullimit të tyre (Hibbert, 1993, 22), për vetë faktin

se at 'bote, në udhëheqjet e klasës politike, por edhe në shtabet ushtarake nacionalçlirimtare të Shqipërisë dhe Kosovës, kishte njerëz me ndikim që i përkisnin kombësisë serbe, malazeze, maqedonase dhe bullgare, kështu që çdo vendim dhe veprim që ndërmerrej nga shqiptarët minohej/sabotohej menjëherë nga kundërshtarët serbo-malazez-maqedon dhe bullgarë. Njëkohësisht vetë forcat shqiptare ishin të përcara në mes tyre.

Gjithashtu, Komiteti Qendror i Jugosllavisë nuk ishte aspak i lumtur me këtë pjesë të rezolutës, kështu që në fund të Marsit, njëri ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të mareshal Tito, Millovan Gjilas, i dërgoi një letër (në emër të komitetit Qendror) Komitetit Rajonal, në të cilin ankohej: “Në të vërtetë, çdo ngritje e çështjes së ndryshimit të kufijve u ndihmon gjermanëve që të nxisin një popull kundër tjetrit” (Malcom, 2011, 391).

Në gjysmën e dytë të vitit 1944, deri sa forcat aleate (amerikane-angleze-ruse...) përparonin në të gjitha frontet e luftës kundër ushtrisë hitleriane, Tito do t'i shfrytëzojë këto rrethana, për luftimin e forcave të mbrojtjes kombëtare shqiptare dhe ripushtimin e Kosovës... Për t'i realizuar më lehtë synimet e saj, udhëheqja jugosllave, në fillim të Janarit 1945, urdhëron mobilizimin e “brigadave të Kosmetit” për t'i dërguar në Frontin e ashtuquajtur të Sremit në Serbi. Ndonëse qendra e rezistencës shqiptare në gjysmën e dytë të Dhjetorit 1944-Janar 1945, ishte përqendruar në Drenicë, “Shtabi Operativ i Kosmetit”, urdhëroi Shaban Polluzhën që të largohej nga Drenica dhe të nisej në drejtim të Podujevës, për t'u bashkuar me Brigadën VII, e cila po marshonte për Serbi. Shtabi i Brigadës së Drenicës largimin nga Kosova do ta kushtëzojë me ndërprerjen e vrasjeve dhe të plaçkitjeve mbi popullsinë civile nga ana e ushtrisë jugosllave, mirëpo pas dështimit të nënshtrimit të Shaban Polluzhës më 25 Janar nisin operacionet ushtarake në shkallë të gjerë për asgjësimin e Brigadës së tij (Wikipedia, a.d.).

Shaban Polluzha e kishte kuptuar shumë qartë qëllimin e pushtuesve sllav, por rrethanat e krijuara politike dhe ushtarake, nuk ishin në favor të tij, sepse raporti i forcave ishte në disproporcion të madh. Kjo kryengritje për liri edhe pse nuk rezultoi me fitore, përcolli mesazhin te shqiptarët e Kosovës se sllavët nuk njohin asgjë tjetër, përveç forcës. Në këtë kontekst, në periudhën prej 8 Shkurt e deri në gjysmën e Majit 1945, në Kosovë, me urdhrin e komandantit suprem (Tito), vendoset administrimi ushtarak si organ i pushtetit ushtarak–shtetëror. Aneksimi i dhunshëm i Kosovës u bë në rrethana të administrimit ushtarak, me 10 Korrik 1945, në Kuvendin e Prizrenit (i ashtuquajtur plebishiti i Prizrenit), i cili u organizua nga forcat politike serbe, u miratuar “Rezoluta serbe për bashkimin e Kosovës dhe Metohisë me Serbinë Federale” (Bajrami A., 2011, 35).

Në periudhën e Pasluftës së Dytë Botërore, përveç që nuk u bë përmbushja e vendimeve të Rezolutës që ishin marrë në Konferencën e Bujanit, me urdhrin e Titos, nga 08 Shkurt 1945 deri në gjysmën e Majit 1945, vendoset administrimi ushtarak si organ i pushtetit ushtarak–shtetëror (Mesic, 2001).

Administrimi ushtarak u vendos me qëllim që t’i likuidonte forcat kundërrevolucionare dhe të mundësonte formimin e pushtetit popullor (Stefanović, 1950, 189).

Nga kjo kohë e gjerë me fillimin e shpërbërjes së ish–Jugosllavisë, në fund të viteve ‘80 dhe fillim të viteve ‘90, Kosova administrohej nga Federata Jugosllave. Në këto rrethana, nuk mund të bëhej fjalë më për vullnetin e popullit shqiptar dhe të përfaqësuesve të tyre, sepse populli shqiptar e kishte shprehur shumë qartë vullnetin e vet, nëpërmjet të gjithë përfaqësuesve të tij, pa asnjë kundërshtim, në Konferencën e Bujanit. Kosova u gjend në një situatë shumë të vështirë dhe pa asnjë mbështetje, nisur nga fakti se edhe komunistët shqiptar treguan servilizëm ndaj Titos. Në një mbledhje të

Jashtëzakonshme të Plenumit të Partisë, në Dhjetor 1946, Enver Hoxha pyeste në mënyrë retorike: “A është në interesin tonë që të kërkojmë Kosovën? Kjo nuk është një punë progresive për t’u bërë. Jo, në këtë situatë, përkundrazi, ne duhet të bëjmë çmos që të sigurojmë që kosovarët të vëllazërohen me jugosllavët” Dhe në fillim të atij viti, të dy vendet lidhën “Marrëveshjen e miqësisë” (Malcom, 2011, 403).

Rrethanat e Shqipërisë të asaj kohe edhe mund të diskutohen, por që Partia Komuniste e Shqipërisë shfaqti servilizëm ndaj Jugosllavisë, kjo nuk mund të mohohet. Hoxha i ekzaltuar pas komunizmit, duhej ta dinte se, “miqësia” me popullin sllav nuk kishte dhënë ndonjë shembull pozitiv asnjëherë gjatë historisë, e aq më pak, kur në Kosovë, masakrohej dhe plaçkitesh populli shqiptar, pikërisht në kohën kur, Hoxha me Partinë Komuniste Shqiptare lidhte marrëveshje “miqësie” me Jugosllavinë. Referuar një mungese mbështetje nga udhëheqja komuniste shqiptare, gjendja e popullit shqiptar të Kosovës, të aneksuar me dhunë nga regjimi ushtarak i Titos, nga viti në vit u rëndua. Në veçanti dy dekadat e para të komunizmit në Kosovë, ishin shumë të vështira për shqiptarët, sepse strukturat e sigurimit shtetëror ishin stërmbytur me serbë dhe malazez të cilët përdorën metoda të dhunshme, sistematike ndaj shqiptarëve, me pretekst për dorëzimin e armëve, e njohur kjo në popull, si koha e Rankoviçit.

1.2.1. Pozita juridiko-politike e Kosovës në periudhën 1945–1974

Shqiptarët edhe pse përbënin mbi 90% të banorëve të Kosovës, ata gjithmonë ishin në pozitën e dorës së dytë të qytetarit në Jugosllavi. Kjo ishte politikë e pushtetarëve serbë, të cilët gjithmonë e kishin në fokus sulmin ndaj qytetarit shqiptar të Kosovës dhe diskriminimin e tij në të gjitha format e jetës. Edhe vetë Tito, i cili e kishte vizituar Kosovën pas 16 vitesh, bëri kritika të hapura publike për kushtet në Kosovë; “Nuk mund të flitet për të drejta të barabarta”, deklaroi ai, “kur serbët kanë përparësi kudo

nëpër fabrika, kurse shqiptarët refuzohen edhe pse kanë kualifikime të njëjta apo më të larta”. Kjo pabarazi publike nuk u përmirësua asnjëherë në Kosovë, sepse në vitin 1980, llogaritej se, çdo i pesti serb kishte pagë shtetërore, ndërsa nga shqiptarët çdo i njëmbëdhjeti merrte pagë shtetërore.

Edhe pse Kosova ishte pjesë konstituive e Jugosllavisë Multinacionale dhe e cila kishte vënë resurse njerëzore dhe natyrore në dispozicion të kësaj krijese, ajo asnjëherë nuk kishte pozitë të barabartë politike, juridike dhe ekonomike me njësitë tjera federative. Nga kjo pabarazi, në Kosovë ishte bërë e njohur thënia se: “Trepça radi, Beogradi se gradi” (“Trepça punon, Beogradi ndërton”). Edhe pse u bë progres në disa fusha të jetës, siç ishte hapja e Universitetit të Prishtinës, sporti, kultura etj, në kuptimin e mirëfilltë asnjëherë nuk ekzistoi barazia ekonomike e Kosovës në raport me njësitë e tjera federale të Jugosllavisë dhe për këtë, gjithmonë pengesë ka qenë Serbia dhe politika e saj antishqiptare.

Jugosllavia multinacionale e cila përbëhej nga pesë republika dhe dy krahina, në kthetrat e saj e kishte grabitur edhe një popull, i cili ishte i treti për nga madhësia, brenda kësaj krijese, por ai gëzonte statusin e një krahine. Diskriminimi i shqiptarëve në aspektin politik, juridik dhe ekonomik, bëri që në vitin 1968, masa e pakënaqur në këtë shtet artificial të kërkonte barazi brenda saj, për të parën herë parulla “Kosova Republikë” u dëgjua në rrugë, me 27 Nëntor 1968, kur qindra demonstrues marshuan rrugëve të Prishtinës (Malcom, 2011, 409–411).

Reagimi i pushtetit jugosllav ishte shumë i ashpër, pasuan vrasje, plagosje, tortura e burgosje të cilat në formën më ç ‘njerëzore i ushtronte UDB, linçimet dhe diskriminimet nuk kishin të ndalur. Edhe pse në vitet pasuese u hap Universiteti i Prishtinës, ku në mënyrë të veçantë u ndihmua në zhvillimin e tij me ardhjen e një stafi profesorësh nga Shqipëria, populli shqiptar kishte filluar të vetëdijesohej se kishte të bënte me një

pushtet i cili nuk i trajton të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë. Miratimi i Kushtetutës së Jugosllavisë e vitit 1974, Kosovës edhe pse nuk i jepte statusin e Republikës, dukshëm e kishte ndryshuar pozitën juridike të saj. Ekzistonte pretendimi i Serbisë dhe është në fuqi edhe sot, se Kosova është pjesë e Serbisë. Ky është një pretendim i kamotshëm i politikës serbe, i cili vazhdon edhe sot që Kosova është shtet i pavarur në bazë të vullnetit të qytetarëve të saj dhe vërtetuar edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Nuk mund të quhet koincidence fakti se të gjitha Jugosllavitë e kishin trajtuar politikisht dhe juridikisht njësoj popullin shqiptar. Pra, si ajo e Versajës, e Titos dhe kjo e fundit e shpallur si dhe Federata e shpallur Serbo–Malazeze, kishin mbajtur qëndrim diskriminues ndaj shqiptarëve të Kosovës. Të gjitha këto edhe pse Kosovën e aneksuan, kurrë nuk i'a njohën statusin e barabartë, brenda këtyre krijesave. Pozita juridike e Kosovës në kuadër të ish–Jugosllavisë është atakuar gjithmonë nga shteti serb, duke aluduar se ajo ishte pjesë e Serbisë. Por, Kosova në Federatën e ish–Jugosllavisë, shikuar sipas pozicioneve kushtetuese të Kosovës dhe Serbisë, sipas Kushtetutës së ish–Jugosllavisë të vitit 1974, Kosova dhe Serbia kishin, në esencë, një pozitë plotësisht të pavarur njëra nga tjetra (Stavileci, 2008, 294).

Pozita e Kosovës në Kushtetutën e vitit 1974, ishte arritja më e lartë politiko–juridike që Kosova mundi të sigurojë në ish–Jugosllavi. Sipas Akademik Stavilecit, fakti se Kosova nuk ka qenë pjesë e Serbisë, mbështetet në këto argumente historike dhe politike:

E para – Kosova nuk ishte në përbërje të shtetit sovran dhe të pavarur të Serbisë me subjektivitet juridik–ndërkombëtar të pranuar në Kongresin e Berlinit;

E dyta – Kosova nuk ishte në përbërjen e Serbisë të Kuvendit të Dytë të AVNOJ, 1944;

E treta – Kosova nuk ishte në përbërjen e Serbisë gjatë konstituimit të saj si njësi federale në Këshillin Antifashist të Çlirimit Popullor, 1944;

E katërta – Kosova nuk ishte në përbërjen e Serbisë në strukturën e Asamblesë Kushtetutë dhënëse të Jugosllavisë me rastin e shpalljes së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë;

E pesta – Kosova nuk ishte e inkuadruar në Serbinë sovranë dhe të pavarur, veç në përbërje të “Serbisë Federale në kuadrin e Jugosllavisë Federale”, 1945.

Subjektiviteti i Kosovës në kuadër të ish–Jugosllavisë nuk mund të mohohet, sepse Kosova kishte kufijtë e saj brenda federatës, të ciët nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e saj dhe gjithashtu edhe kufijtë e jashtëm të ish–Jugosllavisë nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e Kosovës. Krahina Socialiste Autonome e Kosovës në Kushtetutën e vitit 1974 të ish–Jugosllavisë, ishte pothuajse, në nivel të barabartë të drejtash me Republikat e Federatës, por nuk e kishte emrin Republikë. Politika serbe çdo herë aludonte se Kosova ishte pjesë e Serbisë, por kjo është kontradiktore me parimet e federatës, sepse po të ishte kështu, Serbia në Federatën Jugosllave do të përfaqësohej me tre vota, nisur nga fakti se edhe Vojvodinën e konsideronte pjesë të saj. Nisur nga ky fakt nuk do të ekzistonte barazia në federatë, një subjekt një votë. Andaj, pretendimet e Serbisë mbi sovranitetin e saj ndaj Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave, nuk kanë bazë juridike. Kosova, në pikëpamje konstitucionale, ishte njësi federale, me Kushtetutën e vet. Ajo nuk ishte pjesë e Serbisë, por vetëm ishte përfshirë “në strukturën komplekse të saj”, po të interpretohej se “ishte pjesë e Serbisë”, do të kishim një situatë paradoksale juridike “të inkuadruarit të Serbisë në Serbi” dhe të inkuadrimin të tri serbive me tri vota në Federatë, ndërkohë që njësitë e tjera federale do të kishin vetëm nga një votë dhe kjo nuk mund të pranohej nga njësitë e tjera federale (Stavileci, 2008, 354).

Shqiptarët e Kosovës nuk u ndalën së kërkuari barazi të plotë në kuadër të ish–Jugosllavisë, ashtu siç nuk u ndalua asnjëherë politika serbe për t’ua mohuar edhe ato të

drejta që i kishin shqiptarët. Në vitin 1981, në Kosovë organizohen demonstrata të fuqishme studentore të mbështetura nga masa e gjerë popullore, të cilët kërkonin Republikë për Kosovën, pra as më pak dhe as më shumë se, barazi për të gjithë në Federatën e ish-Jugosllavisë. Kjo ishte një goditje e rëndë për “pseudo-barazinë” në krijesën artificiale jugosllave. Demonstruesit, ku shumica prej tyre ishin studentë u shtypen barbarisht, me tanke jugosllave, pra kishte shumë të vrarë, të plagosur, të torturuar dhe shumë të arrestuar. Pas demonstratave të vitit 1981, gjendja e shqiptarëve të Kosovës në kuadër të federatës do të rëndohej nga apetitet e pangopura të policisë serbe për shtypjen e shqiptarëve, tani rruga ishte e qartë, ndarja.

Nga viti 1945, përkatësisht me Kushtetutën e RFPJ, të 31 Janar 1946, ku Kosova përcaktohet si Krahinë Autonome dhe element konstituiv i federalizmit, e që njëkohësisht gjendej në kuadrin e strukturës kushtetuese të Serbisë (Bajrami A., 2002, 41), e gjerë në vitin 1974, statusi autonom i Kosovës, në kuadrin e ish-Federatës Jugosllave u përcaktua në mënyrë të dhunshme me këto akte:

Vendimi i Kuvendit Krahinor të Kosovës dhe Metohisë (i shprehur në formë të rezolutës), me të cilin bëhet aneksimi i dhunshëm i Kosovës me Serbinë federale në kuadrin e ish-Jugosllavisë.

Sipas dokumenteve arkivore, të cituara nga Dr. Hakif Bajrami, më 10 Korrik 1945, në Prizren, do të organizohet Mbledhja e Këshillit Popullor Krahinor për Kosovë dhe aty do të aprovohet një rezolutë që Kosova vendosë t’i aneksohet Serbisë. Vendimi ishte shkruar në Beograd, ndërsa nga të pranishmit 2/3 ishin nga OZNA, serbë dhe malazezë. Kishte edhe të atillë shqiptarë që u “vizatuan” se kanë diskutuar, por nuk ishin të pranishëm fare. Me këto krime monstruoze politika e J. B. Titos e siguroi fronin e “pashës” në Beograd deri më 1980 (Bajrami H., 2014, 2).

- Aprovimi i Rezolutës së Këshillit Popullor të Kosovës, nga Kryesia e KAÇKJ (AVNOJ), më 23 Korrik 1945, për aneksimin e Kosovës nga Serbia.
- Vendimi i Mbledhjes së Tretë të KAÇKJ – AVNOJ, më 07 Gusht 1945, me të cilin është miratuar Vendimi kontestues i Kuvendit Krahinor;
- Ligji i Kryesisë së Kuvendit Popullor të Serbisë për themelimin dhe organizimin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë;
- Kushtetuta e RFPJ e 31 Janarit 1946 (Salihu K., 1984, 31).

Sipas Akademik Gazmend Zajmi, pozita kushtetuese hibride e Kosovës në kuadrin e Federatës së ish–Jugosllavisë dhe pjesë konstituive e saj dhe njëkohësisht e strukturuar në kuadër të Serbisë ishte, synim balancimi që shkaktohej përmes tendencave konfliktuoze për status plotësisht të barabartë të Kosovës në federatë, që nënkuptonte pavarësinë e Kosovës dhe daljen e saj nga përbërja kushtetuese e Serbisë dhe tendencat për mbajtjen e Kosovës në suaza kushtetuese të Serbisë në shkallë sa më të theksuar të unitaritetit që ishte e mundur (Zajmi, 1996, 37).

Në këtë kuadër, gjatë periudhës 1945–1974, pozita juridiko–politike e Kosovës ka kaluar nëpërmjet një procesi të kontestuar juridik, por që pala serbe diku me dinakëri e diku me dhunë ka diktuar dhe imponuar kërkesat e saj për të mbajtur nën kontroll territorin dhe banorët rrënjës të Kosovës. Edhe pse, normimi juridik i Kosovës u propozua, hartua dhe përcaktua nën masat e gjendjes së jashtëzakonshme nga 50 mijë trupa ushtarake të Armatës Jugosllave që gjendeshin në Kosovë, aktet respektive siç janë:

- Rezoluta e Kuvendit të Prizrenit, më 08–10 Korrik 1945, për aneksimin e Kosovës dhe Metohisë nga Serbia. Rezoluta u miratua me aklamacion, pa asnjë votim dhe pa asnjë fjalim. Nga 142 anëtarë të Këshillit, vetëm 33 ishin shqiptarë (Malcom, 2011, 399).

- Vendimi i Mbledhjes së Tretë të KAÇKJ, me të cilin është miratuar Vendimi Kontestues i Kuvendit Krahinor të Prizrenit;
- Ligji i Kryesisë së Kuvendit Popullor të Serbisë për themelimin dhe organizimin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, më 03 Shtator 1945;
- Kushtetuta e RFPJ e vitit 1946;
- Kushtetuta e Republikës Popullore të Serbisë në Janar të vitit 1947;
- Statuti i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë më 23 Maj 1948;
- Ligji Kushtetues i RFPJ në vitin 1953;
- Ligji Kushtetues i RP të Serbisë në vitin 1953;
- Kushtetuta e RSFJ e vitit 1963;
- Kushtetutat e Republikave Socialiste të vitit 1963;
- Statuti i Krahinës Autonome të Kosovës më 1963;
- Amendamentet Kushtetuese të vitit 1968, në Kushtetutën e RSFJ të vitit 1963;
- Ligji Kushtetues i KSA të Kosovës më 24 Shkurt 1969;
- Amendamentet Kushtetuese të vitit 1971, në Kushtetutën e RSFJ të vitit 1963;
- Amendamentet Kushtetuese të vitit 1972, në Kushtetutën e RSFJ të vitit 1963.

Nga të gjitha këto akte pozitive, më të rëndësishmet janë amendamentet kushtetuese dhe Ligji Kushtetues i KSA të Kosovës, të cilat gradualisht filluan të përmirësojnë pozitën juridiko-politike të Kosovës dhe popullit të saj dhe që shënuan depërtimin e parë të individualitetit kushtetues të Kosovës dhe me këtë edhe të individualitetit të popullit shqiptar në suazat e multinacionalitetit të ish-Federatës Jugosllave (Zajmi, 1996, 37).

Nga kjo që u theksua më lartë, Dr. Bajrami me të drejtë nxjerr këto përfundime:

- Kosova historikisht ka qenë një territor kompakt, i banuar nga populli shqiptar si popull autokton dhe si një nga popujt më të vjetër të Ballkanit;

- Në saj të politikës jo parimore të Fuqive të Mëdha, trojet etnike shqiptare gjatë gjithë historisë kanë qenë objekt i copëtimeve territoriale dhe i pushtimeve të huaja;
- Çështja e Kosovës nuk mund të paraqesë vetëm një anë të çështjes shqiptare, e cila paraqet një çështje unike, e që mund të zgjidhet vetëm me bashkim kombëtar dhe me krijimin e një shteti shqiptar në kufijtë e tij historikë dhe natyrorë;
- Kosova u aneksua në mënyrë të dhunshme nga ana e Serbisë, në kushtet e gjendjes së administrimit ushtarak në Kosovë;
- Shpërbërja e ish-RSFJ krijoi një gjendje të re gjeopolitike, e cila Kosovës i jep të drejtën e shkëputjes nga ish-Jugosllavia dhe që duke shpallur pavarësinë të vetë përcaktohet që të jetojë me ligjet e veta dhe të ketë institucione dhe organizim të pavarur politik (Bajrami A., 2002, 39–40).

Nga ky dinamizëm faktik dhe juridiko-politik, politika serbe mbi Kosovën, përveç cenimit të sovranitetit territorial të saj, cenonte vazhdimisht edhe liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve kosovarë duke nënshkruar edhe marrëveshje ndërkombëtare për përzënie të shqiptarëve nga territori i tyre. Për këtë çështje historia na jep dy raste publike, siç janë Konventa Jugosllavo-Turke e vitit 1938 dhe Marrëveshja Xhentëlmenësh mes Jugosllavisë-Turqisë-Greqisë, e 28 Shkurtit 1953, e cila njihet si Pakti Ballkanik i Ankarasë.

Me gjithë masat e dhunshme fizike dhe juridike, shqiptarët çdo herë e më shumë forconin pozitën e tyre në PKJ, si dhe në institucionet federative. Në kuadër të kësaj, forconin dhe pozitën juridiko-politike të Kosovës, nëpërmjet ndryshimeve legislative të lartpërmendura. Cikli i ndryshimeve pozitive në favor të Kosovës, por edhe të Vojvodinës njëkohësisht si dy krahinat e vetme autonome të federalizmit jugosllav që përbëhej dhe nga gjashtë (6) republikat tjera, përmbyllet me përforcimin e pozitës kushtetuese duke nxjerrë Kushtetutën e RSFJ të vitit 1974.

1.2.2. Pozita juridiko–politike e Kosovës me Kushtetutën e vitit 1974-1989

Avancimin juridiko–politik më të lartë që e arriti Kosova nën sundimin serbo–jugosllav, ishte me nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës Socialiste të Federatës Jugosllave, në vitin 1974 dhe me Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në vitin 1974, të cilat ndryshe nga Kushtetuta e RPFJ (1946), në të cilën Kosova ishte në kuadrin e strukturës kushtetuese të Serbisë, Kushtetutat e vitit 1974, edhe përse e përcaktonin se Kosova gjendej në kuadër të Serbisë, i dhanë statusin e mëvetësisë politike territoriale dhe e bënë element konstituiv të federalizmit jugosllav. Siç konstaton dhe Malnar (2013), me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974, rikonfigurimi kushtetues i RSFJ, duke përfshirë edhe pozitën e krahinave autonome, po ashtu edhe Kosovën, ishte përfunduar.

Kushtetuta e vitit 1974, e cila në vitin 1985, nga anëtarët e Akademisë së Shkencave të Serbisë, me në krye Dobrica Qosiq, u kritikua ashpër, në Memorandumin 1985 për Kosovën, në të cilin thuhej, se e kishte ndarë Serbinë në tre pjesë (Malcom, 2011, 426), me ri konfigurimin kushtetues përfundimtar të RSFJ, përkatësisht KSAK, Kosovës i dha statusin juridiko–politik më të lartë nën ombrellën jugosllave, e cila ndërroi disa herë, jo veç statusin juridiko–politik, por edhe vetë emrin e saj, nga RPFJ, RSFJ, RFJ, RJ, RSMZ dhe së fundi në RS.

Me gjithë vështirësitë dhe pengesat e vazhdueshme gjatë periudhës 1974–1989, Kosova përveç avancimit juridiko–politik arriti dhe avancimin e saj social–ekonomik, në arsim, kulturë, art, sport, shkencë dhe të gjitha lëmit e jetës, duke hapur shkolla, themeluar Akademinë e Shkencave dhe Arteve, Universitetin e Prishtinës, bibliotekat e saj.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, kërkesat e shqiptarëve për Kosovën Republikë, pavarësi dhe bashkim kombëtar me trungun amë, në njërën anë nuk ndalonin me aktivitetet e tyre politike dhe në anën tjetër kundërpërgjigja e dhunshme nga pushteti serb nuk ndalonte me arrestime, tortura dhe burgosje, të cilat shpesh herë ishin kundërligjore. Sipas shifrave zyrtare, për demonstratat e vitit 1981, në ditët e para të tyre, ishin vrarë 9 demonstrues dhe një polic. U arrestuan më se 2 mijë shqiptarë gjatë kohës së demonstratave; u mbajtën kryesisht gjykime të mbyllura pa publik, ndërsa dënimet me burgim ishin të ndryshme nga një muaj deri në 15 vite. Nga fillimi i qershorit, u shpall zyrtarisht se ishin dënuar me burgim 479 persona; në vjeshtë u organizua një valë tjetër gjykimesh dhe dënimesh. Arrestimet e mëtejme, për shkak të demonstratave vazhduan edhe shumë muaj. Një vëzhgim i persekutimeve pasuese i bërë nga revista e Beogradit “NIN”, më 1986, konkludonte se me burgime të rënda ishin dënuar 1200 veta, kurse 3 mijë të tjerë ishin dënuar deri në 3 muaj (Financial Times Archive, 1981).

Siç konstaton Dr. Bajrami edhe pse dispozitat e Kushtetutës së vitit 1974, këtë nuk e përcaktojnë shprehimisht, mund të thuhet se Kosova, sipas kësaj kushtetute, ishte njësi e mëvetësishme federale dhe element konstituiv, gjë që ka rëndësi të theksohet, nga se pikërisht një pozitë e këtillë e sanksionuar me këtë kushtetutë, Kosovës (njësoj si njësitë të tjera federale), i jep të drejtën e vetë përcaktimit të ri statusor–konstitucional të pozicionit të saj pas shpërbërjes së RSFJ (Bajrami A., 2011, 47).

Në këtë kuadër, Kushtetuta e RSFJ e vitit 1974, me Nenin 3, përkufizonte republikat si shtete dhe me Nenin 4, dy krahinat autonome (Kosovën dhe Vojvodinën), si bashkësi politiko–shoqërore, krahinat, përkatësisht Kosova kishte pozitë të ngjashme me pozitën e republikave me mëvetësinë e saj në sferën kushtetutë dhënëse dhe legislative, organizative, financiare dhe ekonomike, territoriale, juridiko–gjyqësore, marrëdhënieve

ndërkombëtare, mbrojtjes, rendit dhe sigurisë. Kjo shprehej me përcaktimin në Kushtetutë për përfaqësim të barabartë të republikave dhe krahinave autonome në organet federative siç ishin Kuvendi i RSFJ, Kryesia e RSFJ, Këshillin Ekzekutiv dhe Organet Administrative të Federatës, Gjykatën Kushtetuese të Jugosllavisë, Prokurorinë dhe Gjykatën Federative, strukturat e rendit, sigurisë dhe mbrojtjes të federatës. Gjithashtu, kjo shprehej dhe me vlefshmërinë e barabartë të të gjithë legjislacionit pozitiv të federatës, përkatësisht me vlefshmërinë e njëjtë të Legjislacionit penal të Federatës, në të gjitha republikat dhe krahinat autonome.

Në fushën e legjislacionit penal, Ligji për Procedurën Penale të Jugosllavisë ka vlejtur në mënyrë të barabartë në të gjitha gjashtë republikat–shtete (Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Slloveni) dhe dy Krahinat Autonome të RSFJ. Po ashtu, në mënyrë të barabartë është bërë përcaktimi që krahinat autonome, njëjtë si republikat, të kenë Ligjet e tyre Penale.

1.3.Legjislacioni penal i aplikueshëm në Kosovë gjatë viteve 1945–1989

E drejta penale në Federatën Jugosllave hapat e parë i nisi në vitin 1945, me miratimin e disa ligjeve të cilat kishin të bënin me veprat penale mbi mbrojtjen e pasurisë së popullit, ekonomisë shtetërore, ndalimin e nxitjes së urrejtjes dhe llojet e dënimeve.

Më pas, u miratua Kodi Penal – Pjesa e përgjithshme, që hyri në fuqi më 1948 dhe në 1951, miratoi Kodin Penal në tërësi, i cili shfuqizoi ligjet e mëparshme penale. Me ndryshimet e Kodit Penal, në 1959, u zvogëluua maksimumi i dënimeve me privim lirie; u përfshinë vërejtja e gjykatës dhe disa masa sigurimi. Në 1962, përveç tjerash, u përcaktua masa e sigurisë – ndalimi i shfaqjes publike.

Me ndryshimin e Kushtetutës, më 1965–1973, u bënë edhe disa ndryshime në Kodin Penal duke ashpërsuar dënimin me gjobë dhe duke inkriminuar disa vepra të tjera si vepra penale që kishin të bënin me vetëqeverisjen, mbrojtjen e rendit juridik dhe tregut të Jugosllavisë (Fletorja Zyrtare 6/73).

Me miratimin e Kushtetutës së RSFJ, në vitin 1974 (Neni 281, Paragrafi 2), u vendos që të gjitha njësitë federative të nxirrnin ligjet e tyre penale, së bashku me Ligjin Penal Federativ. Që nga 28 Qershor 1977, deri më 23 Mars 1989, në Jugosllavi, në bazë të Kushtetutës, si dhe legjislacionit penal, kompetencat lëndore dhe territoriale kanë qenë ndarë në nivel Federativ dhe Republikan, përkatësisht Krahinor, ku ishin në fuqi nëntë (9) ligje penale dhe një ligj procedural penal, e konkretisht:

- Ligji Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë;
- Ligji Penal i secilës nga gjashtë republikat socialiste (Bosnje–Hercegovinë, Kroaci, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, Slloveni);
- Ligji Penal i secilës nga dy Krahinat Socialiste Autonome (Kosova dhe Vojvodina).

Të gjitha këto ligje, hynë në fuqi më 01 Korrik 1977.

Me qëllim që procedura penale të ishte e njësuar ishte miratuar Ligji i Procedurës Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për tërë territorin federativ.

Në Kosovë ishte në fuqi edhe Ligji Mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale të Serbisë.

Edhe ligjet penale të republikave dhe krahinave, megjithëse vlenin vetëm në territorin republikan, përkatësisht krahinor, në pjesën më të madhe ishin pothuajse identike. Kishin dallime, në raport me kohezionin e marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore të vendit ku vepronin. Kështu, në Ligjin e parë penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, ishin inkriminuar si vepra penale edhe këto veprime:

- Neni 30, Alineja 2, Pika 4 – Vrasja për gjakmarrje;
- Neni 31 – Dhënia ndihmë të miturit në kryerjen e veprës penale të vrasjes;
- Neni 32 – Veprimi përgatitor për veprën penale të vrasjes;
- Neni 47 – Kufizimi i lirisë së lëvizjes nga hakmarrja;
- Neni 85 – Shtërngimi për lidhjen e martesës . (Instituti i Kërkimeve Juridike dhe Shoqërore, 1979).

Ligji penal federativ në pjesën më të madhe rregullonte çështjet e përgjithshme, kurse në pjesën e posaçme përcaktonte vetëm veprat penale që cenonin të mirat juridike në nivel federativ dhe veprat penale që kryheshin nga personat zyrtar në institucionet federative.

Ligjet penale të republikave dhe krahinave autonome ishin më restriktive në raport me Ligjin Penal Federal. Ato ishin konkretizim i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Ligjit Penal Federativ.

1.3.1. Harmonizimi i ligjeve në ish-RFSJ me normat ndërkombëtare

Shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut e bërë vazhdimisht në periudha të ndryshme gjatë luftërave, por edhe në kohë paqe, ka ndikuar që përfaqësuesit e shteteve të ndryshme të hartojnë dhe miratojnë disa konventa dhe protokolle ndërkombëtare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut u përfshi edhe në Kushtetutat dhe ligjet penale në shtete të ndryshme. Po ashtu edhe në Federatën jugosllave në Kushtetutën e vitit 1974 të RSFJ dhe në kushtetutat e krahinave autonome dhe republikave, si dhe në legjislacionin penal u përfshinë dispozita që garantonin liritë dhe të drejtat e njeriut.

Studiuesit kanë vlerësuar pozitivisht secilin shtet apo organizatë që ka normuar garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, pavarësisht se në disa raste po vetë ato shtete i kanë shkelur dispozitat e tyre. Dr. Gruda konstatonte me të drejtë se mishërimi i të drejtave të njeriut në kushtetuta, si është vepruar më së shpeshti, është një fitore e madhe, ndonëse kjo s'ka garantuar edhe respektimin e tyre. Pikërisht duke u nisur nga kjo, është shtruar nevoja e nxjerrjes së të drejtave të njeriut nga sfera ekskluzive e kompetencës së shtetit dhe e transferimit të tyre edhe në kompetencë ndërkombëtare, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet mbrojtja dhe respektimi i tyre i plotë (Gruda, 1989, 93).

Jugosllavia ka qenë nënshkruese e disa konventave, traktateve dhe protokolleve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe me të drejtë Dr. Ante Cariq, shpreh indinjatë se fatkeqësisht Jugosllavia nuk e ka nënshkruar Protokollin që ka të bëjë me Traktatin ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, kështu që qytetarëve tanë, të cilëve u janë cenuar të drejtat dhe liritë, nuk u mundësohet që për

mbrojtjen e të drejtave të veta, t'i drejtohen drejtpërsëdrejti Komitetit për të drejtat e njeriut (Cariq, 1988, 136).

Në kuadër të këtyre, lind pyetja: a është e vërtetë ajo që Spinoza kishte konstatuar treqind vite më parë se shtetet nuk njohin vlera të tjera, përveç sigurisë së vet? Duke u nisur nga rrethanat e Kosovës që ishte pjesë e Jugosllavisë, e cila kishte një sistem te centralizuar të sigurisë e që përfshinte shërbimin sekret të njohur ndryshe edhe si Departamenti i Sigurisë së Shtetit (UDBA). Ky shërbim kishte rol shumë të madh në atë sistem dhe si i tillë shërbente si shtyllë mbrojtëse e konceptit të Jugosllavisë. Megjithatë, aktivitetet e këtij shërbimi kundër të ashtuquajturve “armiqtë” potencial të sistemit jugosllav, dhe atë sidomos pas demonstratave të 1981 në Kosovë, bëri që ky sistem të perceptohej si i dhunshëm që shkaktonte represion dhe pasiguri, fenomen ky i cili ishte mjaft i theksuar sidomos ndaj popullatës shqiptare në Kosovë (Qehaja & DCAF, 2012, 4).

Në vitin 1989 pas suprimimit të dhunshëm që i bëri Serbia autonomisë së Kosovës të vitit 1974, me këtë rast u suprimuan të gjitha ligjet e Krahinës dhe mbetën në fuqi vetëm ligjet e ish-RSFJ dhe ligjet e Republikës së Serbisë të cilat morën karakter diskriminues për shqiptarët e Kosovës, si dhe u nxorën në Serbi plan programe dhe një numër i madh ligjesh dhe rregulloresh që cenonin liritë civile dhe politike të qytetarëve në Kosovë, përkatësisht kontrollonin dhe diktonin jetën e tyre.

1.4.Okupimi i dhunshëm i Kosovës nga Serbia në vitin 1989

Thonë se historia përsëritet dhe Kosova brenda kësaj thënie, mund të qëndrojë si rast unikal. Josip Broz Tito, duke instaluar pushtetin ushtarak në Kosovë, pikërisht duke e shtrënguar Kuvendin e Prizrenit dhe duke shtypur kryengritjen e shqiptarëve, të cilët donin të bashkoheshin me Shqipërinë, në Korrik 1945, me “votat” e ushtrisë komuniste, e aneksoi Kosovën. Pas 44 vitesh me një episod shumë të ngjashëm, por me aktorë të ndryshëm, u dha e njëjta shfaqje, por tash rolin e Titos e kishte, kriminel i mëvonshëm i Ballkanit, Millosheviqi.

Ngjarjet e zhvilluara në vitin 1981, kishin lënë gjurmë gjaku të thella të shqiptarët, sepse policia jugosllave e udhëhequr nga kriminelë serbë, kishte ushtruar terror sistematik ndër vite. Demonstruesit të cilët në masë ishin studentë, u vranë dhe u trajtuan mizorisht, nëpër hetuesitë jugosllave, të cilat mund t'i krahasosh me ato të inkuizicionit mesjetar. Apetitët e politikës për “Serbi të Madhe” tani kishin dalë sheshit, Millosheviqi erdhi në pushtet duke abuzuar me emocionet e masave dhe duke pretenduar se populli serb në Kosovë është në gjendje të rëndë. Kësaj situatë i ndihmuan edhe instrumentet “akademike” serbe, të cilat sa herë u janë dashur politikës serbomadhe, nuk kanë munguar të jenë në shërbim të saj. Shembulli më konkret i kësaj shërbese politike, ishte një shkrim i datës 24 Shtator 1986, në një gazetë të Beogradit, ku u botua një dokument i hartuar nga një ekip anonim i Akademisë Serbe të Shkencave (SANU), në të cilin thuhej se, serbët e Kosovës ndodheshin para shfarosjes nga ana e shqiptarëve agresivë (Glenny, 2000, 625).

“Periudha kur gjarpëri ishte i pranishëm në kopsht, por mbetej i padukshëm, nuk mund të zgjatej shumë” (Gellner, 1997, 56).

Ishte pikërisht viti 1989, kur Millosheviqi në mënyrë të dhunshme, duke dislokuar mijëra trupa ushtarako–policore, e suprimoi Autonominë e Kosovës dhe Kushtetutën e vitit 1974. Me 23 Mars 1989, deputetët e Kuvendit Krahinor të Kosovës u vunë në pozitë të vështirë dhe të rrezikshme, ngase u kërkohej të votonin amendamentet të cilat shumë qartë Kosovën e dërgonin drejt rrënimit të autonomisë së saj. Kësaj situate i paraprinë një varg inskenimesh politike dhe juridike. Në diskutimet e delegates Melihate Tërmkolli, e cila pohonte se amendamentet kushtetuese janë përcaktuar dhe jo harmonizuar, reagoi Kryetari i Kuvendit të Kosovës Vukashin Jovanoviq: “delegatja Tërmkolli i mohon qëndrimet e të gjitha organeve të Kosovës, në Republikë dhe Jugosllavi. Këtu është fjala për mosbindje ose te Shoqja Tërmkolli ”është në pyetje diçka tjetër”, referuar rrethanave politike në Kosovë në atë kohë, është shumë e qartë çfarë fshihej prapa stigmatizimit, ”ose është në pyetje diçka tjetër”, ku në fakt delegatja në fjalën e saj ushtronte të drejtën që Kushtetuta i’a garantonte të jepte apo jo pëlqimin për ndërrimet kushtetuese (Zajmi, 2004, 114–115).

Me rastin e deklarimit për amendamente, bashkë me delegatë u përzier edhe jo delegatë. Në faqen e parë të gazetës “Rilindja” të datës 24 Mars 1989, shihet jo delegati me gisht të ngritur, duke “votuar” për ndryshimet kushtetuese në Kosovë.

Populli shqiptar në Kosovë, duke e parë rrezikun që i vinte nga politika serbe në ish–Jugosllavi, u mobilizua kombëtarisht si asnjëherë tjetër në histori. Minatorët e Trepçës hynë në një grevë urie, të vendosur deri në flijim për t’i realizuar të drejtat e popullit të vet. Më pas pasuan demonstratat paqësore në gjithë Kosovën, të cilat u shtypën brutalisht nga policia dhe ushtria e Federatës, në numër dominues nga serbët. Me 28 Mars 1989, “Autonomia” e Kosovës tash ishte reduktuar vetëm në një kujtim (Malcom, 2011, 430).

1.4.1. Aktet juridike paralele në Kosovë në vitet 1989–1999

Me fillimin e shpërbërjes së ish–Jugosllavisë, në fund të viteve ‘80 dhe fillim të viteve ‘90, përkatësisht, sinjalet e para të shpërbërjes së Jugosllavisë kishin filluar që me ngjarjet politike protestuese dhe demonstruese, si dhe me grevat e urisë të vitit 1981, nga shqiptarët në Kosovë. Ndikimi politik i këtyre ngjarjeve, në një vend ku forma të tilla të protestave të hapura ishin pothuajse të panjohura, qe shumë i madh. Sikur për këto protesta të shkruhej mirëfilli në mediumet e Jugosllavisë, ndikimi i tyre do të ishte edhe më i madh, por fakti se shumë informacione për demonstratat ishin heshtur, është një shenjë e veçantë që dëshmon se sa të brengosura ishin qarqet e pushtetit (Malcom, 2011, 399).

Përveç akademikëve jugosllavë të angazhuar në konceptimin e Memorandumit 1985, të lartpërmendur, kundër shqiptarëve ishin të angazhuar dhe strukturat politike dhe qytetarët nacionalistë serbë në ish–Jugosllavi, më aktivët ishin ata që jetonin apo veprimtarinë e tyre sekrete dhe politike e ushtronin në Kosovë, të cilët edhe ata kishin filluar të mbanin protesta. Nga këto protesta, tre prej tyre janë më të rëndësishmet, njëra në vitin 1987, ku mbi dhjetëmijë (10000) protestues shkuan tek varri i Aleksandar Ranković duke brohoritur me parullën “Shqiptarët jashtë nga Jugosllavia”, e dyta në vjeshtën e vitit 1988, në Beograd, ku u mbledhën rreth 350 mijë qytetarë dhe Slobodan Milošević, i’u drejtua turmës duke ju thënë: “Çdo komb e ka një dashuri që i’a ngroh zemrën përgjithmonë, për Serbinë ajo është Kosova” dhe e treta që ishte edhe më masive, ishte mitopoezia serbe më 28 Qershor 1989, për 600 vjetorin e betejës së Kosovës që u festua tek Shtëpia e Kulturës në Fushë–Kosovë nga mbi një milion (1.000.000) serbë, ku Slobodan Millosheviç, si një shfrytëzues i mirë i situatave, vulosi të ardhmen e tij në krye të Serbisë, përkatësisht të Federatës Jugosllave në zhdukje e

sipër. Për popujt jo serbë në Jugosllavi, ky manifestim ishte kulmimi i qëllimeve serbe për Serbinë e madhe. Por edhe shqiptarët nën Jugosllavi, nuk i ndaluan protestat dhe demonstratat masive dhe të përgjakshme me 500 të plagosur, e cila kulmoi me 30 Tetor 1989, ku ish-Kryetari i Kosovës Azem Vllasi dhe 14 të tjerë ish-zyrtarë politik po dilnin para trupit gjykues.

Klasa politike serbe që erdhi në pushtet në vitin 1988, për shkak të masave të dhunshme kundër kushtetuese si fillim në Kushtetutën e Kosovës me 23 Mars 1989, me Amendamentet Kushtetuese 4–49, abrogoi Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974 dhe rrënoi mëvetësinë politiko-territoriale të Kosovës, pa dy të tretat (2/3) e votave të nevojshme duke e vënë Kosovën nën administrim të plotë të Serbisë dhe më pas në Kushtetutën e Serbisë, më 28 Mars 1989, Kuvendi Republikan i Serbisë, bëri ndryshimet kundër kushtetuese duke mundur më shumë kontroll mbi Kosovën, përkatësisht duke vendosur kontroll të plotë mbi policinë, drejtësinë, ushtrinë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Në Kosovë reagimi ishte i menjëhershëm dhe intensiv. Ditën e votimit (23 Mars 1989), demonstruan tremijë (3000) qytetarë dhe gjuajtën me gurë në qendër të Prishtinës. Një demonstratë më e madhe e organizuar në Ferizaj, u shtyp nga Policia; dhe gjatë pesë (5) ditëve të ardhshme protesta të mëdha do të bëhen së paku në nëntë (9) qytete të Kosovës, përfshirë edhe përleshjen jashtëzakonisht të ashpër me policinë në Podujevë, ku u përdorën armët nga të dy palët. Numri zyrtar i të vrarëve në fund të Marsit 1989, ishte njëzetënjë (21) demonstrues dhe 2 policë; nga fundi i Prillit 1989 numri arriti deri në njëqind (100) (Malcom, 2011, 429–431).

Përleshjet midis trupave të armatosura dhe demonstruesve të pa armatosur etnik shqiptarë janë raportuar në fund të Janarit 1990. Protesta vazhdoi në Glllogoc dhe Stanoc me një total prej 26 personave të vdekur dhe 94 civilë të plagosur. Përforcimet e policisë

serbe që u dërguan në Kosovë (arriti 2000 forca ushtarako–policore) për të ndihmuar trupat federale tashmë të stacionuar në Kosovë.

Paralelisht, pakënaqësi të ndryshme filluan të lindin në mbarë hapësirën Jugosllave, për shkak të veprimeve juridiko–politike dhe ushtarako–policore edhe sekrete, që filloi të zbatojë pushteti Serb me politikën e saj ekstremiste. Kjo bëri që jeta shoqërore, juridiko–politike, morale dhe social–ekonomike në Federatën Jugosllave e cila ishte në hapat e saj më të mirë të tradicionalizmit shtetëror, të shkojë drejt dezintegrimit, për t’u rrënuar gradualisht, përkatësisht shpërbërë plotësisht Federatën. Gjatë Pranverës 1989, pushteti serb i dha impuls kolonizimit të Kosovës duke ju dhënë serbëve që do të vendoseshin për të jetuar në Kosovë financime të ndryshme, si dhe tokë pjellore në zonat më të bereqetshme të Kosovës.

Duke ditur që zhdukja e shteteve është çështje faktike dhe jo juridike (Gruda, 2002, 63), Federata Jugosllave filloi që të shpërbëhet, në hapësirën e saj filluan të lindin shtete të reja, megjithëse jo lirë e paguan çmimin e lirisë dhe pavarësisë së tyre. Fatkeqësisht, ndarjet nuk ishin vetëm administrative dhe etnike, por thelloheshin me ndarje fetare, ushtarake dhe politike, që impononte pushteti serbo–jugosllav.

Ndërkaq, në Kosovë pushteti Serb, duke shkelur të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut, filloi të bëjë paralizimin e jetës në të gjitha lëmit – administrative, juridiko–politike, prodhuese, kulturore, mbrojtjes, sigurisë dhe drejtësisë. Në Janarin e vitit 1990, u bënë përleshje edhe më të dhunshme me policinë: demonstruesit kërkonin dorëheqjen e udhëheqjes krahinore (ende me Morinën në krye) dhe suspendimin e gjendjes së jashtëzakonshme. Këtë herë u vranë së paku 14 veta (Malcom, 2011, 431).

Gjatë viteve ‘90, në të njëjtën kohë kur pushteti serbo–jugosllav po bënte krimet ndaj njerëzimit dhe ushtronte gjenocid në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë duke u

thirrur në emër të ligjit dhe demokracisë, në Kosovë, u larguan nga puna afro 150 (njëqindpesëdhjetë) mijë njerëz, u mbyll Universiteti i Prishtinës, në të cilin studionin dyzetepesë mijë (45.000) studentë dhe në emër të politikës emigruese u detyruan të largohen nga Kosova mbi pesëqindmijë (500.000) të rinj e të reja (Kadriu, 2002, 278), u vranë qindra njerëz dhe u burgosën me mijëra të tjerë, u shkatërrua kultura shqiptare, pushteti serbo–jugosllav filloi të marrë masat e duhura për rikolonizimin serb të Kosovës. Që Kosova të ishte nën kontroll të plotë të Serbisë, pushteti serb, bëri rritjen e numrit të efektivave ushtarako–policore të cilët, “në emër të ligjit” filluan të ushtrojnë dhunë dhe terror psiko–fizik ndaj popullatës shqiptare, me motivacion se ishin të një etnie dhe feje tjetër.

Ndërkohë, intelektualët dhe liderët politik kosovarë, të kësaj periudhe – 1989–1999, filluan me veprime politike pragmatike për të bërë realitet lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Gjatë kësaj kohe në Kosovë u krijuan institucionet paralele të cilat unanimisht udhëhiqeshin nga intelektualë dhe liderë partish, pa ndasi në mes tyre dhe nën terror dhe presion psiçik, për hir të së vërtetës, duke pasur parasysh kushtet dhe rrethanat e kohës që ishin krijuar, kjo klasë e re politike, në aspektin juridiko–politik, bëri më shumë se sa kishte bërë më parë klasa e vjetër politike gjatë dyzetepesë (45) viteve me radhë, duke arritur të ndërmarrin një sërë veprimesh të guximshme politike dhe juridike, të cilat më të rëndësishmet janë:

- a) Deklarata Kushtetuese e 02 Korrikut 1990;
- b) Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 07 Shtator 1990;
- c) Referendumi gjithë popullor për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur i mbajtur më 26–30 Shtator 1991 (kjo Kushtetutë në popull njihet si Kushtetuta e Kaçanikut);
- ç) Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 Tetor 1991;

d) Amendamentet Kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, më 19 Tetor 1991;

dh) Zgjedhjet e lira dhe shumë partiake për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 24 Maj 1992.

Këto dokumente juridiko-politike, me gjithë barrën e rëndë që mbanin mbi supe, duke rishprehur edhe njëherë vullnetin e lirë të popullit shqiptar të Kosovës, rikonfirmuan vullnetin politik të shqiptarëve të Kosovës.

Pas përfundimit të luftërave në Kroaci dhe në Bosnje dhe Hercegovinë, jeta në Kosovë gjithnjë e më shumë përkeqësohej. Nevoja për ekzistencë, liri dhe pavarësi të plotë – bërjen e Kosovës shtet, detyrimisht solli krijimin e një ushtrie çlirimtare me bërthamë popullin shqiptar e cila, do t'i vinte në mbrojtje popullsisë civile të pambrojtur dhe do të çlironte vendin nga pushtuesi.

Të pabarabartë në numër dhe logjistikë, paralelisht me aktet juridiko-politike, në terrenin mbarë shqiptar të përkrahur edhe nga vetë Shteti Shqiptar, kishin filluar përgatitjet, për një luftë çlirimtare për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar, në mes të forcave ushtarake-policore serbo-jugosllave në njërin anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në anën tjetër, e cila nga fundi i saj, u përkrah fuqishëm nga aleatët e saj SHBA dhe NATO. Pas përpjekjeve paqësore që bëri populli shqiptar për të drejta të barabarta si njësi konstituive e federatës jugosllave dhe për krijimin e shtetit të tyre, si dhe dështimit të diplomacisë botërore, për një zgjidhje politike për Kosovën, përkatësisht Jugosllavinë në tërësi, siç konstaton MACMILLAN, Konferenca e Paqes, në kundërshtim me çfarë besojnë shumë njerëz, nuk krijoi Jugosllavinë – ajo tashmë ishte formuar, kur diplomatët e parë arritën në Paris. Shtatëdhjetë vjet më vonë, fuqitë ishin po aq të pa afta të pengonin shpërbërjen e saj (Macmillan, 2001, 110).

Për zgjidhjen diplomatike të situatës juridiko-politike të krijuar në Federatën Jugosllave, përkatësisht në Kosovë, u nxorën një sërë vendimesh dhe rezolutash dhe u organizuan disa konferenca ndërkombëtare – nga këto konferenca, më e rëndësishmja është Konferenca e Rambujesë, më 6–24 Shkurt 1999, në Rambuje të Francës dhe 15–18 Mars 1999, në Paris, Konferencë për të cilën zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, në SHBA, Xheims Rubin, këmbëngul se synimi kryesor i Rambujesë ishte të detyroheshin evropianët, e sidomos italianët që mendonin se shqiptarët janë terroristë dhe trafikantë droge, se në fakt shqiptarët janë “burrat e mirë”. Me fjalë të tjera, Rambuje ishte e nevojshme për t’i bërë evropianët që “të ndalonin fajësimin e viktimave” dhe për të ndërtuar vendosmërinë e nevojshme në NATO për përdorimin e forcës (Ignatieff, 2001, 284) – krimeve ndaj njerëzimit, masakrave, gjenocidit dhe spastrimit etnik, që po ushtronin forcat ushtarake–policore dhe paraushtarake serbo–jugosllave nëpërmjet Operacionit “PATKOI” në Kosovë, ashtu si edhe në Kroaci dhe në Bosnje e Hercegovinë më parë, Millosheviç dhe pushtetarët etj., serbë, për të shtypur popujt e tjerë jo serbë në emër të demokracisë ligjore, bënin krimin e gjenocidit ndaj popujve joserbë, e sidomos ndaj shqiptarëve dhe veprën makabre të masakrës – krimin e klanit demokratike, sepse është e mbështetur në veprim ligjor dhe të interesave të shumicës – popullit serb. Kjo gjë, duke pasur parasysh dhe mos harruar asnjëherë që forca shërben për një herë, kurse edukata përgjithmonë, bëri që Amerika e mbështetur edhe nga NATO meqë forca krijon drejtësinë, në emër të humanizmit – të drejtës për liri, detyrimit për barazi, idealit për vëllazëri të anashkalojnë edhe autoritetin e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të vënë drejtësinë në vend.

Për këtë gjë, më 24 Mars 1999, SHBA dhe NATO nisën fushatën e bombardimeve ajrore kundër Jugosllavisë–Serbisë, fushatë e cila zgjati deri më 10 Qershor 1999, ditë në të cilën në Kumanovë u nënshkrua Marrëveshja Ushtarake–Teknike në mes të Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë – KFOR dhe Qeverive të Republikës Federative të

Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë*, si dhe nga KS i OKB u nxor Rezoluta 1244 (1999), me të cilën Kosovën e vendoste nën protektorat ushtarak dhe administrim ndërkombëtar për një periudhë tranzitore tre vjeçare.

* Për KFOR, këtë marrëveshje e ka nënshkruar Komandanti i KFOR, Gjeneral Mike Jackson. Për Qeveritë e Federatës Jugosllave dhe Republikën e Serbisë e kanë nënshkruar, Gjeneralkolonel Svetozar Marjanoviq – Anëtar i Shtabit Suprem të Jugosllavisë dhe Gjenerallejtnant i Ministrisë së Brendshme të Serbisë – Obrad Stefanoviq.

KAPITULLI II

FORMAT E MANIFESTIMIT TË DHUNËS SHTETËRORE NË KOSOVË GJATË VITEVE 1981–1999

2.1. Format e manifestimit të dhunës dhe arbitraritetit të pushtetit shtetëror kundër qytetarëve me bindje të kundërt politike

Në vitin 1945, pas vendosjes së administrimit ushtarako–policor dhe politik në Kosovë, filloi ndjekja masive kundër shqiptarëve të cilët aspironin të drejtë e tyre të bashkimit me shtetin amë, për të cilën edhe luftuan në Luftën e Dytë Botërore. Të dhënat tregojnë se vetëm gjatë vitit 1945 në burgjet jugosllave kishte mbi 12.000 shqiptarë. Për një kohë të shkurt disa nga ata u vranë, disa u dënuan me burgim të përjetshëm, e shumica i'u dorëzuan gjykatave ushtarake, të cilat i ndëshkuan me vite të shumta burgimi të rëndë. Për t'i realizuar objektivat e tyre pushtetarët serb u përpoqën dhe bënë serbizimin e gjykatave të Kosovës. Me kërkesën e Dushan Mugoshës, në vitin 1946 u formuan gjykatat e qarqeve në Kosovë: Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë. Në të gjitha këto gjykata për kryetarë gjyqesh caktoheshin pjesëtarë të nacionalitetit serb (Keçmezi, 2009, 8).

Elementi i serbizimit të gjykatave bëhej me qëllim që pushtetarët politikë t'i kenë duart e lira në ndjekjen e grupeve shqiptare të targetura nga UDB jugosllave. Për më shumë se pesë dekada, nga viti 1945 deri në 1999, zgjati ndjekja e shqiptarëve nga organet e rendit dhe drejtësisë të ish–Federatës Jugosllave dhe Republikës të Serbisë. Kjo ndjekje ishte në sinkronizim në mes të politikës, sigurimit sekret të shtetit dhe sistemit të drejtësisë të organeve federative dhe republikane të Serbisë, që bëhej me qëllim të satanizimit dhe persekutimit në të gjitha format, kundër popullit shqiptar të Kosovës që ishte shumicë. Sulmet kundër shqiptarëve në ish–Jugosllavi ishin në forma prej më të

ndryshmeve si, politike, juridike, ekonomike, kulturore, shoqërore, etj. Pas luftë së Dytë Botërore, kushtetuta federale i përkufizonte shqiptarët etnikë në Jugosllavi më shumë se një “kombësi”, se sa si një “komb” konstituiv të federatës, ndonëse si grup etnik ishin të tretët për nga numri i popullsisë. Ky ishte një status që dallonte nga ai i grupeve të tjera etnike më të rëndësishme –serbëve, kroatëve, boshnjakëve, sllovenëve dhe maqedonëve (Human Rights Watch, 2002, 21).

Diskriminimi i shqiptarëve nuk ishte vetëm i karakterit fizik, faktik, por përbëhej nga të gjitha llojet si formale dhe material, duke filluar nga kushtetutat dhe vijuar me të gjitha mjetet dhe metodat tjera.

Gjatë periudhës 1945–1990, në shtetin Jugosllav, nuk ishin vetëm shqiptarët që përballeshin me dhunën shtetërore. Ndjekje politike janë zhvilluar edhe ndaj popujve të tjerë të ish–Jugosllavisë, si kroatëve dhe boshnjakëve, pavarësisht faktit se statusi juridiko–politik i Kroacisë dhe Bosnjë–Hercegovinës ishte i barabartë me atë të Serbisë në nivel federativ.

2.1.1. Ndjekjet politike në Kroaci

Përveç faktit tashmë të njohur se populli shqiptarë në Kosovë ishte më i përndjekuri politikisht pas Luftës së Dytë Botërore në ish–Jugosllavi, ndaj ndjekjeve dhe persekutimeve politike, nuk ishin imun as disa popuj të njësive të tjera të federatës së ish–Jugosllavisë, si: Kroacia dhe Bosnja Hercegovina. Në Republikën e Kroacisë, është e njohur shuarja e “Pranverës kroate”. Lëvizja e re politike në Kroaci u ndërpre në mbledhjen e XXI^{të} të Kryesisë së KQ të LKJ, e cila u mbajt në fermën e gjuetisë në vendin e quajtur Karagjorgjevë. Kjo ndodhi në fillim të dhjetorit të vitit 1971. Tito, mund të thuhet, se edhe vetë u frikësua nga përmasat dhe fuqia e asaj lëvizje të re në Kroaci, të cilës në fillim, dukej se i jepte mbështetje të heshtur. Lëvizja e re doli nga

kontrolli i aktorëve të vërtetë, Savka Dabçeviqit dhe Miko Tripallos dhe u derdh nëpër rrugë. Në këtë lëvizje u bashkuan edhe ata të cilët nuk kishin qëllim reformat e Federatës Jugosllave dhe decentralizimin e pushtetit, si dhe kërkesa për më shumë pushtet për Kroacinë, por të cilët kishin qëllime më radikale.

Savka Dabçeviq dhe Miko Tripallo u detyruan të tërhiqen nga funksionet e tyre. Pas tyre edhe shumë të tjerë. Pasi një “spastrim” i madh politik në Kroaci, i cili përfshiu mbi dy mijë persona. Nga skena politike kroate u largua plejada e politikanëve të arsimuar, të shkathët dhe kreativ. Vlerësimi zyrtar i udhëheqjes partiake jugosllave ishte se bëhej fjalë për rrezikimin e rendit kushtetues dhe të vetë Jugosllavisë. Pati edhe vlerësime se bëhej fjalë për tentim kundërrevolucionari. Diçka e ngjashme, por me përmasa shumë më të rënda do të ndodhte në Kosovë, një dekadë më vonë. Me disa liderë të “Pranverës kroate” u mor edhe gjykata dhe këta përfunduan me dënime me burg. Liderët e studentëve siç ishin Budisha. Qiçak, Paraxhik e të tjerë përfunduan në burg (Azem Vllasi, 2017, 110.).

2.1.2. Ndjekjet politike në Bosnjë e Hercegovinë

Me ngadhënjimin e Revolucionit Islamik në Iran dhe vendosjes së *Ajatollah Homeinit* në pushtet, ndihej ndikimi i shtuar në hapësirat ku jetonin myslimanët. Ndikimi islam trajtohej si depërtim religjioz në Evropë, por edhe si pushtim politik i pjesës së hapësirës evropiane. Në RSFJ, kjo ngjarje botërore u vë në bashkim me veprimin irredentist shqiptar.

Pas dëgjimeve të përfunduara në Sigurimin Shtetëror, fillojnë hetimet, në të cilin të pandehurit s’kishin të drejtën e mbrojtjes. Hetimet u besohen Sigurimit Shtetëror, i cili përdorte ndaj të pandehurve dhe dëshmitarëve torturën dhe poshtërimin psikik dhe fizik. Të pandehurit dhe dëshmitarët kanë nënshkruar procesverbalet me pranimin e

dhunshëm të fajësisë. Më në fund, Prokuroria Publike e Qarkut në Sarajevë ngre aktakuzën Nr. PP. 118/83, datë 17 Qershor 1983, kundër:

1. *Alija Izetbegovićit*, jurist i diplomuar në pension, me vendbanim në Sarajevë, i gjykuar për vepra penale kundër popullit dhe shtetit, në paraburgim prej 24 Mars 1983.
2. *Behmen Omeri*, inxhinier i ndërtimtarisë, i punësuar në Ndërmarrjen Hekurudhore Transportuese në Sarajevë, me vendbanim në Sarajevë, i gjykuar për vepra penale kundër popullit dhe shtetit, në paraburgim prej 24 Mars 1983.
3. *Rashid Përgudi*, pensionist, ka të kryer fakultetin ekonomik, me vendbanim në Sarajevë, i gjykuar për vepra penale kundër popullit dhe shtetit, në paraburgim prej 24 Mars 1983, kundër tij është ndarë procedura për shkak të sëmurjes së rëndë. Procedura s'është vazhduar, pasi ka vdekur.
4. *Hasan Çengiq*, imam, me vendbanim në Stoce, i pagjykuar, në paraburgim prej 24 Mars 1983.
5. *Ismet Kasumagiq*, inxhinier i diplomuar i metalurgjisë, profesor i pavarur i Fakultetit Metalurgjik, i punësuar në Institutin "Hasan Bërkic" në Zenicë, me vendbanim në Zenicë, i gjykuar nga Gjykata Ushtarake e Divizionit në Sarajevë për veprën penale nga Neni 4, Pika 8, e KPPSH, në paraburgim prej 24 Mars 1983.
6. *Ed'hem Biçakxhiq*, elektroinxhinier në "Elektro ekonominë e BH" në Sarajevë, i pagjykuar, me vendbanim në Sarajevë, në paraburgim prej 25 Mars 1983.
7. *Haso Zhival*, inxhinier i makinerisë, i punësuar në Institutin për Teknikën Procedurale të Fakultetit të Makinerisë në Sarajevë, me vendbanim në Sarajevë, në paraburgim prej 5 Maj 1983.
8. *Salih Behmeni*, arsimtar i matematikës në Shkollën Fillore "Franjo Kruz" në Mostar, i gjykuar për veprën penale nga Neni 4, Pika 8, e KPPSH, më 1950 me dëmin burgu me punë të dhunshëm në kohëzgjatje prej 12 vjetëve dhe humbjen e të drejtave qytetare, me vendbanim në Mostar, në paraburgim prej 24 Mars 1983.

9. *Mustafa Spahiq*, punëtor fetar, me vendbanim në fshatin Ugarsko, Vogoshqe, në paraburgim prej 24 Mars 1983.
10. *Xhemaludin Latiq*, poet, profesor në Medresenë e Gazihusretbegut në Sarajevë, me vendbanim në Sarajevë, në paraburgim prej 7 Maj 1983.
11. *Melika Salihbegoviq*, shkrimtare, ish-funksionare e Lidhjes Komuniste të BH, me vendbanim në Sarajevë, në paraburgim prej 24 Mars 1983.
12. *Dervish Gjurgjeviq*, jurist në BVI të shkencës në Sarajevë, me vendbanim në Sarajevë, në paraburgim prej 29 Mars 1983, dhe
13. *Gjyle Biçakxhiq*, sekretare teknike e drejtorit të NP “Elektrodistribucion” njësia “Përcjellja e energjisë elektrike” në Sarajevë, me vendbanim në Sarajevë, në paraburgim prej 24 Mars deri 20 Gusht 1983.

Gjykimi është caktuar me datë 19 Gusht 1983. Qartazi, gjykimi medoemos duhej mbajtur në shpejtësi për shkak të efekteve politike. Përgatitja e opinionit kryhej me artikuj të përditshme në të gjitha gazetat e Jugosllavisë mbi “zgjimin e nacionalizmit mysliman dhe fundamentalizmit islam në bashkim me nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar”.

Medoemos duhej gjetur “platformën autentike ideologjike të fundamentalizmit islam në Bosnje e Hercegovinë”. Ajo u zbulua në “Deklaratën Islame” të *Alija Izetbegoviqit*. Por, heshtazi kapërcehej koha se kur është shkruar “Deklarata” dhe fakti se ajo është shtypur në revistën “Preporod” dhjetë vjet më parë. Si shkas për fillimin e procedurës shërbeu vizita e disa të akuzuarve Ambasadës së Iranit në Vjenë dhe prania në solemnitetet në Iran.

Këta trembëdhjetë të akuzuar janë akuzuar për veprën penale rrezikimi kundërrevolucionar i rregullimit shoqëror nga Neni 114 i LP të RSFJ, për këto akuza kryesore:

Akuzat më të rënda ishin se “Bosnja medoemos duhet të islamizohet dhe se s’mund të pritët më”. “Myslimanët dhe shqiptarët janë në pozitë të njëjtë, të pabarabartë në krahasim me të tjerët”. “Shqiptarët kanë të drejtë të kërkojnë Republikën, këtë edhe Myslimanët duhet të kërkojnë, pasi Bosnja duhet të bëhet vend islamik i pastër, për çka duhet luftuar, pasi kroatët kanë Kroacinë, serbët Serbinë, sllovenët Slloveninë dhe sipas të gjitha të drejtave Myslimanët kanë të drejtën në Bosnje”. “Se medoemos duhet vepruar në islamizimin e Bosnjës dhe të Hercegovinës dhe krijimin e shtetit islamik në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës, Sanxhakut dhe Kosovës”¹.

I akuzuari i parë Alija Izetbegoviqi deklaroi se prej trembëdhjetë të akuzuarve, ai s’njeh Latiq Xhemaludinin, Spahiq Mustafën, Përgud Rushitin, Dervisheviq Rashidin dhe Gjyle Biçakxhiqin. Protestoi pse shtypi e shpalli veç të gjykuar. “Në këtë vend s’gjykojnë gazetarët dhe policia, por gjykata. Nëse s’është ashtu, atëherë kjo është ofendim për gjykatën”.

Ka mohuar se ka qenë kundër bashkim-vëllazërimit. Ceku se gjyshi i tij në vitin 1918 ka shpëtuar 40 serbë. “Unë, duke jetuar në këtë familje, kam pranuar islamin dhe se medoemos duhet të ndihmojmë çdo njeri. Jam mirënjohës i partizanëve që kanë vazhduar me këto principe pas vitit 1945”.

Quante si qesharake inkriminimet nga aktakuza se përpiquej që KSA e Kosovës të fitojë qeverinë etj. “Konstatoj se krahinat kanë qeveritë e tyre, kuvendet, kanë flamujt dhe

¹ Aktakuza e PPQ në Sarajevë, PP. 118/83 datë 17 qershor 1983 ka 105 faqe. Ajo është ndryshuar në seancën kryesor me heqjen e shumë fakteve. Dispozitivi është reduktuar në 22 faqe.

krahinat kanë milicinë e tyre. Më vihet në barrë se kërkoj diçka që veç ekziston dhe se iu është pranuar”.

Në këtë kuptim, gjykata më 20 Gusht 1983, shqiptoi këto dënime:

Alija Izetbegović me dënim burgu në kohëzgjatje prej 14 (katërmëdhjetë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al. 1 lidhur me Nenin 114 al. 1 të LP RSFJ,

Behmen Omer me dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al. 1 lidhur me Nenin 114 al. 1 të LP RSFJ,

Hasan Çengiq me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al. 2 dhe 6 (gjashtë) vjet për shkak të veprës penale propagandë armiqësore nga Neni 133 al. 1 të LP RSFJ, gjegjësisht në dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjet.

Ismet Kasumagić me dënim burgu në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al. 2 dhe 3 (tre) vjet për shkak të veprës penale propagandë armiqësore nga Neni 133 al. 1 të LP RSFJ, gjegjësisht në dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjet.

Ed'hem Biçakçiq me dënim burgu në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al. 2 të LP RSFJ;

Haso Zhival me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al. 2 të LP RSFJ;

Salih Behmen me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 133 al. 1 të LP RSFJ;

Mustafa Spahiq me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 133 al. 1 të LP RSFJ;

Xhemaludin Latiq me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 133 al. 1 të LP RSFJ;

Melika Salihbegoviq me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 133 al. 1 të LP RSFJ;

Dervish Gjurgjeviq me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vjet për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 133 al. 1 të LP RSFJ;

Gjyle Biçakçiq me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj për shkak të dhënies ndihmë kryerësit të veprës penale pas kryerjes së veprës penale nga Neni 137 al. 1 të LP RSFJ.*

Lidhur me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Sarajevë, Gjykata Supreme e Bosnjës dhe e Hercegovinës mbajti seancën më 12, 13 dhe 14 Mars 1984 ².

* Aktgjykimi është shkruar në 179 faqe.

² Kjo Gjykatë pjesërisht ka aprovuar ankesat e mbrojtësve dhe të akuzuarve dhe mori aktgjykimin PA Nr. 1208/83, duke zvogëluar dukshëm “sasinë e diskriminimeve kriminale nga aktgjykimi i shkallës së parë”, dhe gjykoi: (1) **Alija Izetbegoviq** u dënua me 14 vjet burgim për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al 1 lidhur me Nenin 114 të LP RSFJ; (2) **Behmen Omeri** u dënua me 11 vjet burgim për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al 1 lidhur me Nenin 114 të LP RSFJ; (3) **Hasan Çengiq** u dënua me 7 vjet burgim për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al 1 të LP RSFJ (është hequr vepra penale e propagandës armiqësore nga Neni 133 al 1); (4) **Ismet Kasumagiq** u dënua me 8 vjet burgim për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al 1 të LP RSFJ (është hequr vepra penale e propagandës armiqësore nga Neni 133 al 1); (5) **Ed’hem Biçakçiq** u dënua me 4 vjet burgim për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al 1 të LP RSFJ (është hequr vepra penale e propagandës armiqësore nga Neni 133 al 1); (6) **Haso Zhival** u dënua me 3 vjet e gjashtë muaj burgim për shkak të veprës penale bashkim për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga Neni 136 al 1 të LP RSFJ (është hequr vepra penale e propagandës armiqësore nga Neni 133 al 1); (7) **Salih Behmen** u dënua me 4 vjet burgim për shkak të veprës penale propagandë armiqësore nga Neni 133 al 2 të LP RSFJ; (8) **Mustafa Spahiq** u dënua me 3 vjet burgim për shkak të veprës penale propagandë armiqësore nga Neni 133 al 2 të LP RSFJ; (9) **Xhemaludin Latiq** u dënua me 4 vjet burgim për shkak të veprës penale propagandë armiqësore nga Neni 133 al 2 të LP RSFJ; (10) **Melika Salihbegoviq** u dënua me 3 vjet burgim për shkak të veprës penale

Është karakteristike se si eksponentë të caktuar të politikës jugosllave dhe të sigurimit shtetëror, procesin gjyqësor të Alija Izetbegoviqit dhe të tjerëve, me dinakëri tentojnë ta ndërlidhin me situatën politike/juridike dhe të sigurisë në Kosovë. Ky tentim për t'i ndërlidhur situatat në Kosovë dhe Bosnjë Hercegovinë, ka pasur për qëllim dhe ka synuar që të bindë dhe manipuloi opinionin e gjerë kritik ndaj këtyre proceseve gjyqësore politike në disa njësi të ish–Jugosllavisë. Duke u nisur nga fakti se në Kosovë pas vitit 1981 në mënyrë sistematike zhvilloheshin procese penale ndaj demonstruesve, në logjikën e politikës ditore dhe të sigurimit sekret shtetëror, kjo ndërlidhje konsideronin se mund ta rëndojë barrën e akuzave ndaj Alija Izetbegoviq, dhe të tjerëve. Andaj, në frymën e kësaj politike, gjykata shqiptoi dënimin me burgim për të gjithë të akuzuarit, dënime të cilat deri në njëfarë shkalle i vërtetoi edhe Gjykata Supreme e Bosnjës.

2.1.3. Ndikimi akademik në dhunën e ushtruar të regjimit shtetëror serb ndaj shqiptarëve

Me një qasje dhe trajtim të veçantë e shpjegon profesori i nderuar, akademiku Pajazit Nushi, etiologjinë e krimit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovën e viteve '90 të shekullit XX. Akademik Nushi, etiologjinë e krimi të pushtetit serb ndaj shqiptarëve, e ndanë në tri faza. Në fazën e parë, i jep rëndësi pozicionimit dhe mendimit akademik serb dhe të mendimit enciklopedik në rrjedhën e organizuar të urrejtës, të armiqësisë të dhunës dhe krimit.

Faza e parë e krimit përbëhet nga energjia e së kaluarës së largët të synimeve të Serbisë ndaj popullit shqiptar dhe tokave të tij. Faza nxitëse e krimit ishte më intensive prej vitit

propagandë armiqësore nga Neni 133 al 2 të LP RSFJ; (11) *Dervish Gjurgjeviq* u dënua me 3 vjet e gjashtë muaj burgim për shkak të veprës penale propagandë armiqësore nga Neni 133 al 2 të LP RSFJ; (12) *Gjyle Biçakçi* dënimi i u vërtetua. Aktgjykimi i shkallës së dytë u shkrua në 75 faqe.

1981, kur shqiptarët kërkuan barazi në nivelit shtetëror republikan me popujt e republikave të tjera të ish-Federatës Jugosllave. Kjo fazë zgjati deri në miratimin e ndryshimeve kushtetuese në Kushtetutën e Serbisë, përkatësisht deri në Mars 1989.

Faza e dytë është faza e derogimit të ligjeve të Kosovës dhe miratimit të ligjeve të reja nga Parlamenti i Serbisë. Kjo fazë karakterizohet nga derogimi i të gjitha ligjeve për zhvillimin ekonomik, politik e kulturor të KSA të Kosovës dhe miratimi i ligjeve të reja të Serbisë të pa marrë parasysh faktin se populli shqiptar në Kosovë ishte shumicë, ato ligje bënë organizimin e jetës qytetare të “minoritetit” shqiptar në Kosovë. Ky organizim bëhej në rend të parë me sistemin policor, ushtarak, sigurimit sekret shtetëror, ku në funksion të tyre ishte vendosur sistemi gjyqësor. Karakteristikë e kësaj faze është shtimi i njësive policore dhe ushtarake serbe në Kosovë dhe largimi masiv i shqiptarëve nga puna dhe këto funksione. Përforcimi i shërbimit sekret të pushtetit të Serbisë në Kosovë, ku pasuan, burgosjet, plagosjet, vrasjet, torturat dhe dëbimi i popullatës shqiptare nga Kosova. Në këtë fazë kushtet dhe raportet e jetës së shqiptarëve në Kosovë u reduktuan në alternativën: jeta në varfëri dhe robëri ose largimi nga Kosova (Nushi, 2001, 17).

Kjo është faza kur goditën rëndë dhe në mënyrë drastike vlerat më të larta njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve dhe institucionet zhvillimore të tyre, duke përfshirë edhe institucionin familjar e farefisnor të tyre. Pas vitit 1989, u bë armatosja e qytetarëve civil serbë dhe malazezë që jetonin në Kosovë, për të ndërmarrë aksione shtetërore dhe para shtetërore kundër shqiptarëve që kërkonin zhvillim të lire dhe të pavarur.

Faza e tretë është faza e mbrojtjes së vlerave njerëzore e kombëtare të shqiptarëve nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe nga forcat e NATO. Kjo fazë pasoi pas një politike dhe përpjekje paqësore që bëri populli i Kosovës për të fituar lirinë nga okupatori

serbo-jugosllav. Sipas Rusos, populli i cili e hedh zgjedhën, e kthen lirinë e vet në bazë të të njëjtës të drejtë, në bazë të së cilës ajo i është marrë... ose ai ka të drejtë ta kthejë ose të tjerët s'kanë pasur të drejtë t'ia marrin dhe si rezyme e krejt kësaj Ruso shkruan: "Populli i lirë dëgjon, por nuk shërben, Ai ka prijës, por nuk ka zotëri, ai i dëgjon vetëm ligjet: falë ligjeve, ai nuk u nënshtrohet njerëzve (Gruda, 1989, 90).

Andaj, në kontekst të kësaj, populli shqiptar i Kosovës pas një dështimi që me rezistencë dhe përpjekje paqësore me fitu lirinë, u detyrua të futet në luftë për të fituar të drejtën e mohuar me shekuj. Në këtë fazë, nga organet e pushtetit shtetëror të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë, nga Kosova u zhvendosën me dhunë dhe terror shtetëror afër 1 milion shqiptarë të Kosovës, në drejtim të Republikës së Shqipërisë, Maqedonisë dhe në vendet të tjera si në Evropë dhe andej oqeanëve. U vranë, u masakruan, u zhdukën rreth 20 mijë shqiptarë të gjinive dhe të moshave të ndryshme.

Si faktorë shtytës, nxitës dhe cytës, në gjenezën e krimit shtetëror të serbëve kundër shqiptarëve të Kosovës, rol të rëndësishëm kanë luajtur këta faktorë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë, politika dhe mekanizmat e saj dhe Kisha Ortodokse Serbe. Roli i këtyre faktorëve në nxitjen dhe kryerjen e krimit në Kosovë, nga organet shtetërore të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë, ndaj shqiptarëve të Kosovës, ka qenë dhe mbetet, vendimtar në gjitha fazat e kryerjes së këtyre krimeve.

Këto akte të fazës së tretë, janë produkt i një procesi të ndërlidhur aktesh dhe veprimesh të të gjitha fazave paraprake. Në bazë të këtyre konstatimeve, mund të thuhet se krimi ndaj shqiptarëve në Kosovë duhet konsideruar aksion i paraparë dhe i planifikuar nga Serbia, respektivisht nga qarqet e saj politike, shkencore, kulturore dhe ushtarake, por edhe nga institucionet e Kishës Ortodokse Serbe (Nushi, 2001, 18).

Mendimet dhe veprimet e akademikëve serbë, ishin të sinkronizuara dhe në koherencë të plotë duke ju paraprirë ngjarjeve parapolitike kur bëhej fjalë për popullin shqiptar. Mendimet, qëndrimet dhe opinionet e shfaqura në platformë dhe memorandume të akademikëve serbë kanë nxitur ndryshimin e qëndrimeve politike, krijuar dhe ushtruar dhunë dhe mendim negative për qenien fizike dhe shpirtërore të popullit shqiptar. Memorandumi i Akademisë Serbe “mbi çështjet aktuale shoqërore në vendin tonë”. Memorandum i përpiluar nga një grup akademikësh të ASSHA dhe është botuar si “dokument i përkryer”. Në këtë memorandum për Kosovën është thënë: Fati i Kosovës së sotme nuk është më kompleks, por shkurt, është çështje e konsekuencave jugosllave. Fati i Kosovës mbetet çështje jetike e mbarë popullit serb. Në qoftë se nuk zgjidhet me të vetmin rezultat të luftës së imponuar, kjo pjesë e Republikës së Serbisë dhe e Jugosllavisë do të bëhet çështje evropiane, me pasoja më të rënda, të paparashikueshme. Në fund të Memorandumit thuhet: “Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve edhe në këtë rast deklaroi se është e gatshme me gjithë zemër dhe me të gjitha forcat e veta për realizimin e detyrave vendimtare dhe detyrimeve historike të gjeneratës sonë” (Memorandumi SANU; 1989).

Mendimet dhe qëndrimet e akademikëve serbë si Dobrica Qosiq, Dushan Kanazir, Mihailo Marković, Dimitrije Bogdanović, Milutin Garashanin, Sima Qirković, Antonije Isaković, Pavle Ivić dhe të tjerë, kanë pasur ndikim në konceptimin dhe në realizimin e akteve të dhunës dhe të krimeve që pasuan, në mënyrë specifike në suprimimin e Autonomisë së Kosovës të vitit 1974 dhe në fazën e miratimit të ligjeve diskriminuese dhe të zbatimit të tyre pas vitit 1989.

Mendimet e akademikëve Dobrica Qosiq, Dushan Kanazir dhe Mihailo Marković mbi shqiptarët dhe kërkesat e tyre janë përcjellë me aktivitete politike të pushtetit serb ndaj shqiptarëve. Këta akademikë në sajë të këtyre mendimeve dhe qëndrimeve, zunë vende

të larta në hierarkinë e pushtetit jugosllav dhe atij serb, Dobrica Qosiq, ish-Kryetar i Republikës Federative të Jugosllavisë; Dushan Kanazir, ish-nënkryeministër dhe ish-ministër për shkencë e teknologji dhe ish-anëtar i Qeverisë Serbe, Mihailo Marković, ish-anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste Serbe. Andaj, në kontekst të zhvillimit të ngjarjeve në Kosovë gjatë viteve 1981–1999 dhe hierarkisë së fituar në pushtetin politik të këtyre akademikëve, mendimet dhe qëndrimet e këtyre akademikëve shtrihen në formimin e qëndrimeve politike të përligjura në ish-Federatën Jugosllave dhe në Republikën e Serbisë, duke ndikuar në nxitjen armiqësore të urrejtjes kundër popullit shqiptar shumicë në Kosovë.

Në temën mbi çështjet demografike të shqiptarëve në tryezat shkencore të akademikëve serbë, mendimi i akademikut serb Milosh Macura, ka pasur ndikim të fuqishëm në marrjen e qëndrimeve mbi politikën demografike në Serbi dhe në formësimin e masave të veçanta shtetërore për pengimin e riprodhimit biologjik të shqiptarëve. Ky mendim i akademikut Macura përputhet me qëndrimin e ASSHA, ku “ekspansioni i shqiptarëve” është cilësuar “kërcënim real për të gjithë popujt në Jugosllavi” (Nushi, 2001, 18).

Sulmet e orkestruara ndaj shqiptarëve zhvillohen me të gjitha mjetet dhe metodat që ka në dispozicion të pushteti shtetëror serb. Gazeta “Borba” e datës 5–6.12.1987, boton artikullin me titull: “Kosova lind, Jugosllavia përkund” ku përmendet dhe atakohet shifra e lindshmërive në Kosovë (Bytyqi, Kosova dhe Shqiptarët; 2006, 10).

Në këtë mënyrë akademikët e tillë, kanë nxitur dhe ndikuar të organet politike, policore, gjyqësore dhe ushtarake të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë që të aplikojnë politika të dhunshme dhe detyruese për zhvendosjen e shqiptarëve nga vatrat e tyre dhe të sjellin serbë në trojet shqiptare. Një politikë e tillë ka qenë jashtëzakonisht e theksuar pas luftës në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, me ç’rast pushteti serb të ikurit nga këto luftëra i vendosi në Kosovë. Synimi dhe qëllimi final i politikës serbe në trajtimin e

këtyre personave nuk ishte aspak ndihma në aspektin humanitar. Por, ishte qëllimi djallëzor i mbipopullimit të Kosovës me kolonë serbo-malazez të ikur nga luftërat në ish-republikat e Jugosllavisë. Këta refugjatë të quajtur izbeglica, u vendosën në mënyrë të dhunshme në prona të shqiptarëve, nëpër të gjitha vendet e Kosovës. Tashmë, janë të faktuara krimet e kryera të këtyre igzbeglicave në popullatën e pafajshme civile shqiptare. Në fokus të veçantë për mbipopullim e Kosovës me këtë kategori ishte edhe Rrafshi i Dukagjinit, në veçanti në brezin kufitar me Republikën e Shqipërisë, ku ishin të vendosura lagje të mëdha me refugjatë-izbeglica si në Junik dhe Babaj të Lloqit etj. Kësaj politikë të ndjekur me dekada nga strukturat shtetërore të Serbisë dhe ish-Jugosllavisë, i paraprinte dhe e programonte Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë. Kjo politikë kishte për synim kryesor ndryshimin e relievit demografik duke e mbipopulluar Kosovën me refugjatë serbë të sjellë nga vendet e tjera të ish-Jugosllavisë dhe zhvendosjen e shqiptarëve etnikë nga trojet e tyre shekullore. Por, lidhur me qëndrimet e këtyre akademikëve serbë, ka pasur dhe mendime ndryshe brenda llojit sa i përket çështjes së shqiptarëve të Kosovës. Ish-kryetari i ASSHA, akademiku Vojin Despiq, ka pasur mendim të matur mbi qëndrimet politike të kolegëve të tij dhe të qarqeve politike e shtetërore serbe për shqiptarët. Despiq kërkoi botërisht marrëveshje me shqiptarët për t'u dhënë shqiptarëve atë që ju takon. Por, kërkesa e tij u refuzua nga opinion publik dhe nuk u përkrah nga kolegët e tij. Madje pas përfundimit të mandatit të kryetarit të ASSHA ai u zëvendësua nga kolegu më me “përshtatshmëri politike” nuk u shënua mendimi kritik i tij ndaj qëndrimeve politike të disa akademikëve të institucionit që udhëhoqi në kohën kritike për shqiptarët dhe as ndaj dhunës dhe terrorit të ushtruar ndaj shqiptarëve (Nushi, 2001, 21).

Andaj, me shumë të drejtë mund të konstatojmë se në rrjedhën e akteve të dhunës së ushtruar nga pushteti shtetëror serb ndaj shqiptarëve të Kosovës, kanë ndikuar shumë

faktorë në funksion të nxitjes dhe shtytjes në krim, në forma dhe mënyra të ndryshme. Prandaj, në rrjedhën e të gjitha fazave të akteve dhe të krimit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës, kanë ushtruar ndikim të veçantë mendimi arkeologjik, filologjik, filozofik, etnologjik, demografik, ekonomik, historik dhe gjeografik i disa anëtareve të ASSHA. Të gjitha këto mendime kanë hyrë në program dhe funksion të zbatimeve politike. Në funksion të këtij masiviteti të ndjekjeve penale politike, kundërvajtjeve politike, vrasjeve, plagosjeve, izolimeve, keqtrajttimeve dhe formave të tjera të dhunës së pushtetit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës, që kanë të gjitha atributet e krimit të gjenocidit, i parapriu dhe ky u përcoll nga një lloj psiko–terrorizmi kundër shqiptarëve me anë të mjeteve të informacionit publik dhe të veprave pseudo–shkencore, si formë bashkëkohore e organizimit të luftës speciale. Vetëm në periudhën 1981–1989, u botuan rreth 800.000 artikuj, deklarata, diskutime, fejtone, intervista, karikatura, komente, reportazhe etj., në gjuhën serbe, kroate, maqedonase, madje edhe në anglishte, frëngjishte e gjermanishte, në të cilat satanizohej populli shqiptar i Kosovës si kriminel, spiun, si popull pa kulturë dhe pa histori dhe atij i m’visheshin etiketime të ngjashme, me ç’rast u cënua rëndë edhe dinjiteti individual e kombëtar ((Salihu I., 1995, 43).

2.1.4. Politika si faktor nxitës në krimet e kryera nga pushteti shtetëror serb ndaj shqiptarëve të Kosovës në vitet 1981–1999

Roli i politikës serbe si faktor nxitës dhe zbatues të dhunës dhe terrorit të ushtruar nga organet shtetërore të ish–Federatës Jugosllave dhe Republikës së Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve 1981–1999 ka qenë me ndikim permanent që në gjenezë të këtij fenomeni dhe në të gjitha fazat e zhvillimit dhe aplikimit të tij. Politika nxitëse serbe e ka keqpërdor qytetarin e nacionalitetit serb në të gjitha vendet e ish–Jugosllavisë, jashtë Serbisë për konflikt me kombet tjera. Mesi dhe fundi i viteve ‘80 u

shënjua një gjallërim i dukshëm i nacionalizmit serb, sidomos në mesin e serbëve që jetonin jashtë republikës serbe. Më të zëshmit ishin serbët e Kosovës, të cilët ankoheshin për keqtrajtim nga ana e shqiptarëve etnikë. Këto ishin nxitje dhe inskenime politike të cilat realizoheshin me mjeshteri në funksion të synimeve dhe objektivave të caktuara politike, siç ishte edhe rasti i njohur PANDA në Pejë. Vrasja e 6 të rinjve serbë në kafiterinë “Panda” në Pejë, në vitin 1998, është krim, faktet e zbardhjes dhe autorët e të cilit janë fshehur rreth 15 vjet nga shteti i Serbisë, vlerësojnë përfaqësuesit e organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në Serbi. Në anën tjetër, Natasha Kandiq, e cila për shumë vjet ishte drejtoreshë e Fondit për të Drejtën Humanitare në Serbi, kishte qëndruar në Pejë, pas krimit në kafeterinë “Panda”. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ajo përshkruan atmosferën në qytetin e Pejës, në dhjetorin e vitit 1998: “Selia e ish-‘Beretave të kuqe’, gjegjësisht, njësiteve për Operacione Speciale ka qenë në pushimoret që gjendet afër Manastirit të Deçanit. Ata, me automjetet e tyre ‘hamer’ në vazhdimësi janë vozitur nëpër rrugët e Pejës. Ka qenë njësia lokale ‘Vetëtima’... Kjo ka ngjallur frikë të tmerrshme në qytet. Pas orës 16, asnjë shqiptar nuk ishte nëpër rrugë. Flitej se për këtë vepronte ‘Dora e zezë’ dhe se njerëzit zhdukeshin dhe se automjetet shëtisnin pa tabela regjistrimi”. Ajo shton se që atëherë, në mesin e shqiptarëve në Pejë, flitej se krimin nuk e kishin kryer shqiptarët. Në këtë mënyrë, sipas saj, mund të shikohej edhe porosia e prindit të Zoran Stojanivić, i vrarë nga sulmi në Pejë, i cili u kishte thënë kolegëve të tij shqiptarë me të cilët punonte, se janë të mirëseardhur në shtëpinë e tij për t’i shprehur ngushëllime dhe se ai e dinte se kush i ‘a kishte vrarë djalin. (<https://telegrafi.com>).

Montimet dhe inskenimet që i projektonte politika serbe dhe i zbatonte përmes strukturave të sigurimit sekret shtetëror dhe organeve të ndryshme të sigurisë, jepnin shkas për një ndjekje dhe persekutim masiv ndaj shqiptarëve të Kosovës. Në kontekst të

kësaj dukurie, në shtator të vitit 1986, u botua një dokument i Akademisë serbe të Shkencave dhe të Arteve, i cili trajtonte “çështjen serbe” në Jugosllavi. I njohur me emrin Memorandum, dokumenti sulmonte politikanët serbë që nuk bënë asgjë për të përballuar kërcënimet, sulmet apo edhe “gjenocidin” kundër serbëve në Kosovë. Midis pretendimeve të nxehta të Memorandumit, ata deklararin: Gjenocidi fizik, politik, ligjor e kulturor mbi popullsinë serbe në Kosovë dhe Metohi është një disfatë historike më e rëndë se sa ndonjë disfatë tjetër në luftërat për çlirim të zhvilluara nga serbët prej kryengritjes së parë serbe më 1804 deri në kryengritjen e vitit 1941. Ky viktimizim i agresorit përballë viktimave të tij potenciale, nuk ishte asgjë tjetër vetëm parapërgatitje “politiko–shkencore” për një fushatë ndjekje masive dhe sistematike ndaj shqiptarëve të Kosovës. Edhe për rastin Panda, si për shumë raste tjera policia serbe ushtroi terror mbi shqiptarët e pafajshëm, duke burgosur dhe dënuar shqiptarë pa asnjë provë.

Pas demonstrative të vitit 1981, ndonëse demonstratat ishin të drejta të garantuara me kushtetutë, dhe nuk dilnin jashtë kornizave të Kushtetutës së vitit 1974 së RFSJ, megjithatë politika ato i cilësoi me terma stigmatizues si “kundër-revolucionare”, ndërsa studentët dhe pjesëmarrësit u cilësuan “armiç. Edhe pse e vërteta ishte se në këto demonstrate nuk kërkohesh asgjë më shumë se barazi në kuadër të ish-Jugosllavisë. Por, politika serbe i shfrytëzoi si pretekst këto demonstrate nxiti dhe orkestroi një dhunë dhe terror shtetëror ndaj protestuesve, duke vrarë, plagosur, burgosur etj.

Në mozaikun e nxitjes politike të dhunës së ushtruar ndaj shqiptarëve nga pushteti shtetëror serb, gjatë viteve ‘90, Millosheviçi u kap fort pas kauzës së nacionalizmit, dhe ushqe me këtë kauzë ambicien e ngjitjes drejt pushtetit. Pra, i gjithë arsenal i politik, akademik, propagandistik i të gjitha mjeteve dhe metodave të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë që u zbraz në drejtim të stigmatizimit të shqiptarëve të Kosovës, u materializua me mjeshtëri nga kasapi i Ballkanit, Slobodan Millosheviç. Pas parullës dhe

propagandës së viktimizimit të serbëve të Kosovës se, janë të “rrezikuar dhe keqtrajtuar nga shqiptarë”, Millosheviç u kap fuqishëm dhe e shpalli vetën si shpëtimtar të tyre.

Më 24 Prill 1987, Millosheviç mbajti një fjalim para një turme të madhe serbësh në Fushë Kosovë. Ai i bëri bashkë demonstruesit me thirrjen: Askush nuk duhet të guxojë të ngrejë dorë kundër jush” (Human Rights Watch, 2002, 24–25).

Edhe pse faktet janë shumë kokë forta dhe pasqyrojnë – argumentojnë se gjatë viteve 1945–1999 ishin shqiptarët viktimë dhe të përndjekur nga organet shtetërore të ish–Jugosllavisë dhe Serbisë, kjo nuk e pengoi faktorin politik serb të propagandonte dhe të nxiste urrejtje kundër shqiptarëve. Kjo propagandë e sinkronizuar nga elementë politikë, akademikë dhe qarqeve tjera shtetërore ndaj shqiptarëve, ishte me qëllim dhe në funksion të një parapërgatitje për një ofensivë të gjerë kundër shqiptarëve. Kjo ofensivë ishte e karakterit politik, juridik, ekonomik, social dhe kulturor, ku sulmoi të gjitha poret e shoqërisë në Kosovë dhe ndodhi në mes të viteve 1989–1999.

2.1.5. Vrasjet – “Vetëvrasjet” e ushtarëve shqiptarë në Ushtrinë Jugosllave gjatë viteve 1981–1991

Manifestimi i dhunës dhe terrorit shtetëror serbo–jugosllav i ushtruar ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve 1981–1991, nuk ka lënë asnjë segment të shoqërisë pa atakuar. Një dukuri e shfaqur në fillim të viteve 1980, për të vazhduar deri në vitin 1991, ishte vrasja e shqiptarëve të Kosovës gjatë shërbimit të detyrueshëm ushtarak në Armatën Popullore Jugosllave. Një karakteristikë e cila e ka shoqëruar këtë dukuri për më shumë se një dekadë është, inskenimi dhe kryerja e këtyre vrasjeve nga organet e sigurimit shtetëror sekret të ushtrisë dhe policisë së ish–Jugosllavisë dhe manipulimi i opinionit publik, duke i paraqitur këto vrasje si vetëvrasje.

Një kapitull të veçantë të ndjekurve dhe të dënuarve politikë dhe i tragjedisë së tmerrshme individuale dhe kolektive të gjysmës së kombit shqiptar në okupimin serbo-jugosllav, e përbën numri i madh i ushtarëve shqiptarë që u vranë, ndoqën dhe u dënuan nga të gjitha gjyqet ushtarake të ish-Jugosllavisë. Procese penale politike të montuara nga gjyqet ushtarake të ish-Jugosllavisë ka pasur që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Mirëpo, intensiteti dhe shkalla e shpërfaqjes publike të këtyre proceseve në përmasa të pakrahasueshme me asnjë periudhë tjetër, ndodhi pikërisht në vitet 1980–1991. Vetëm në periudhën dhjetëvjeçare 1981–1990 janë dënuar me burgime të gjata 1.100 ushtarë shqiptarë në proceset e montuara politike. Fakti se serbët dhe malazezët në tërë popullsinë jugosllave merrnin pjesë me 36.6% dhe në komandën e ushtrisë merrnin pjesë me 80% të kuadrove komanduese, tregon gjendjen e barazisë në këtë segment të federatës.

Në fushatën më të madhe anti-shqiptare dhe të proceseve penale politike që u organizuan kundër ushtarëve shqiptarë, ishte i njohur edhe rasti famëkeq i Paraqinit. Me datën 2 Shtator 1987, shërbimi sekret i ushtrisë jugosllave planifikoi dhe kreu një masakër të madhe në kazermën e Paraqinit. Në orën 3 pas mesnatës, derisa flinin ushtarët e pafajshëm, me breshëri nga pushkët automatike u vranë në gjumë 4 ushtarë dhe 5 të tjerë u plagosën. Karakteristikë e kësaj masakre ishte fakti se, ushtarët e vrarë dhe të plagosur ishin pothuajse pjesëtarë të kombeve të ish-Jugosllavisë. Kryes i kësaj masakre, kuptohej duhej të shpallej ushtari shqiptar. Sipas shërbimit sekret të ushtrisë jugosllave, kryes i këtij krimi qe ushtari i ri shqiptar Aziz Kelmendi. Student i juridikut në Prishtinë, njeri me sjellje shembullore dhe me asnjë indikacion dhe shenjë të ndonjë sëmundje psikike. Po atë natë, sipas kumtesës zyrtare të qarqeve ushtarake të komunës së kazermës së Paraqinit, me qëllim që të mbuloheshin gjurmët e këtij krimi, “dorasi” Aziz Kelemendi bëri vetëvrasje jo larg vendit të ngjarjes. Për këtë krim “fajtori” Aziz

Kelmendi nuk mund të dënohej, ngase “bëri vetëvrasje”, por u dënuan 8 ushtarë shqiptarë me 95 vjet burg të rëndë, si kinse shtytës dhe ndihmës të Aziz Kelmendit (Salihu I., 1995, 38).

Sa i përket rastit të Paraqinit mund të konstatojmë se ishte një kurdisje politike e shërbimit sekret ushtarak, e planifikuar në detaje në funksion të pasojave që do të shkaktonte për ushtarët shqiptarë që shërbenin në armatën jugosllave. Komplexiteti i këtij rasti qëndron në atë se, duke qenë viktima të targetuara nga shërbimi sekret shtetëror, ushtarët e të gjitha kombeve në ish–Jugosllavi, do të mobilizonin turmën jugosllave kundër shqiptarëve të Kosovës. Në bazë të propagandës, e cila implikonte urrejtje shoviniste ndaj tërë kombit dhe ushtarëve shqiptarë, që sipas të dhënave jozyrtare, përbënin rreth 30% të të gjithë ushtarëve të rekrutuar në ish–armatën jugosllave, filloi fushata masive e montimeve të proceseve penale politike kundër ushtarëve shqiptarë. Politika serbe synonte që përmes akteve të tilla ta stigmatizonte popullin shqiptar në Kosovë dhe të përgatiste terrenin për legjitimimin e dhunës dhe terrorit të ushtruar shtetëror ndaj popullit shqiptar gjatë viteve 1980–1990.

Pasojat që vuajtën ushtarët shqiptarë në ish–Jugosllavi, pas montimit të këtyre rasteve ishin shumë të rënda. Shumica e këtyre ushtarëve posa kishin mbushur 18 vjet, i vinin në çeli e lokale të tjera të mbyllura dhe duke ushtruar presione psikike e maltretime fizike duke mos u dhënë ushqim dhe ujë me ditë të tëra, i detyronin të pranonin se gjoja kanë formuar grupe të ndryshme dhe përgatitur plane që të helmonim ushtarët e kombeve të tjera, madje deri të përgatitja e sulmeve për të rrëmbyer armët nëpër depo ushtarake për të sulmuar ish–Jugosllavinë. Të gjitha këto ishin kurdisje imagjinare të politikës ish–jugosllave dhe sigurimeve sekrete ushtarake të cilat bëheshin me qëllim të persekutimit të ushtarëve shqiptarë.

Krahas këtyre gjykimeve masive politike që u montuan ndaj ushtarëve shqiptarë, gjer në fund të vitit 1990, 63 ushtarë shqiptarë u kthyen në shtëpi të vrarë nga armata jugosllave, me arsyetimin e njëjtë: “Bëri vetëvrasje” (Salihu I., 1995, 39).

Edhe kjo akuzë vazhdonte modelin nga proceset penale të mëhershme para gjykatave ushtarake në tërë Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë. Grupi i ushtarëve takohet, komenton ngjarjet, krijon organizatën ilegale, i përbetohet *Enver Hoxhës*, kërkon “Kosova Republikë”... Pasi shumë prej të akuzuarve punonin në kuzhinë, ngjashëm me rastin e Splitit, janë akuzuar se dëshironin të helmonin ushtarët. Këtu ishte specifike se grupi ka komentuar vrasjen e ushtarëve në Paraqin dhe kanë komentuar “Mirë ka bërë Kelmendi”. Po të isha unë, unë do vrisja më shumë ushtarë, por në rend të parë kapitenin dhe eprorët tjerë”. Akuza e re ishte se ushtari *Gashi* thotë: “*Unë do të marr uniformën e kapitenit tim pasi i ngjaj, i njëjtë jam si ai, mandej do mbliidhemi ne shqiptarët në vendin e caktuar me armë, do të marrim municion, do të vrasim të gjithë në kazermë, do të marrim kamionë dhe tanket dhe do shkojmë në Kosovë, nga togu im do të nisemi, të gjithë shqiptarët dinë të drejtojnë kamionët dhe tanket edhe do të drejtojnë kamionin që sa më shpejtë të mbërrimë në Kosovë, djelmosha përgatituni mirë, armët i keni, municion merrni sa më tepër*”.³

Me aktgjykimin e Gjykatës Ushtarake në Shkup, IP. Nr. 108/87 datë 18 Janar 1988⁴, janë gjykuar:

1) *Naser Krasniqi*, jurist i diplomuar, nga Belaçevci i Vogël, komuna e Prishtinës, me dënim burgu në kohëzgjatje prej tetë (8) vjet;

³ Aktakuza e Prokurorisë Ushtarake e Shkup, PPU. 146/87, datë 14 Dhjetor 1987, Pika b. Akuza e njëjtë qëndronte pas disa viteve në Gjykatën Ushtarake në Beograd, në procesin e zhvilluar pas parullës politike “Është krijuar koalicioni joparimor”, e me të cilën janë përfshirë ushtarët shqiptarë, kroatë, boshnjakë dhe slloven.

⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Ushtarake në Shkup, IP. Nr. 108/87, datë 18 Janar 1988.

- 2) *Besim Gashi*, teknik i bujqësisë, nga fshati Llapushnik, me dënim burgu në kohëzgjatje prej pesë (5) vjet;
- 3) *Ramiz Ahmeti*, i papunë me shkollë tetëvjeçare, nga fshati Ristanovc, komuna e Lipjanit, me dënim burgu në kohëzgjatje prej pesë (5) vjet;
- 4) *Bajram Kelmendi*, i papunë, nga Llabjani, komuna e Pejës, me dënim burgu në kohëzgjatje prej tre (3) vjet;
- 5) *Xhemail Maroshi*, i papunë me shtatë vjet shkollë fillore, nga fshati Damjan, komuna e Gjakovës, me dënim burgu në kohëzgjatje prej pesë (5) vjet;
- 6) *Zekerija Burniku*, me shkollë të lartë ekonomike, nga fshati Runjevë, komuna e Kaçanikut, me dënim burgu në kohëzgjatje prej një (1) vjet dhe gjashtë (6) muaj;
- 7) *Zef Preni*, shkolla hoteliere, nga Prizreni, me dënim burgu në kohëzgjatje prej katër (4) vjet e gjashtë muaj;
- 8) *Ramiz Bajrami*, me shkollë fillore, nga fshati Fushticë e Epërme, komuna e Gllogovcit, me dënim burgu në kohëzgjatje prej dy (2) vjet;
- 9) *Sul Dembogaj*, elektromontues, nga fshati Bohaj, komuna e Pejës, me dënim burgu në kohëzgjatje prej një (1) vjet e gjashtë muaj.

Gjykata Supreme Ushtarake në Beograd, me aktgjykimin IIP. 129/88, datë 27 Maj 1988⁵, pjesërisht pranon ankesën dhe gjykon:

- 1) *Naser Krasniqi* me dënim burgu në kohëzgjatje prej dhjetë (10) vjet (i është shtuar dënimi për dy vjet);
- 2) *Besim Gashi* me dënim burgu në kohëzgjatje prej gjashtë (6) vjet (i është shtuar dënimi për një vit);
- 3) *Zef Preni* me dënim burgu në kohëzgjatje prej tri (3) vjet e gjashtë muaj;
- 4) *Sul Dembogaj* me dënim burgu në kohëzgjatje prej një (1) vit (ulje për gjashtë (6) muaj).

⁵ Aktgjykimi Gjykatës Supreme Ushtarake, Beograd IIP. 129/88, datë 27 Maj 1988.

Për *Ramiz Bajramin* është prish aktgjykimi dhe është ndërprerë paraburgimi.

Ngadalë, por me siguri, këto gjykime në mesin e ushtarëve krijonin mosbesim dhe frikë. Por edhe bashkim dhe shoqërim të ushtarëve sipas përkatësisë nacionale. Kështu pasoja u bë shkak – veprimtaria armiqësore shkaktoi ndarjen edhe në ushtri. Kështu u krijua fusha e gjerë për veprimtarinë e shërbimit të sigurimit për qëllime politike. Shërbimi, duke organizuar gjykime masive kundër “ushtarëve të kombësive të caktuara armiqësisht të orientuar”, krijonte prova për kulmin politik dhe shtetëror dhe nacionalizmit militant në mesin e atyre grupeve etnike. Prej këtu deri te qërimi i hesapeve të afruar me liderët politikë nga radha e “atyre kombësive të papërshtatshme”, ndante vetëm një fije e hollë.

Në vijim të kësaj teme paraqesim listën e disa prej ushtarëve shqiptarë që vdiqën, u vranë, por u paraqiten si të “vetëvrarë” nga armata e ish–Jugosllavisë (Rilindja, 1991).

Foto Nr. 1: Foto e shkëputur nga Gazeta “RILINDJA”, datë 19 Janar 1991.



Me datën 19 Janar 1991, gazeta Rilindja, boton në fejttonin e saj emrat e 52 ushtarëve të vdekur gjatë kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak në ish–Jugosllavi, nga viti 1981–1991. Kjo ishte periudha kur nuk kishin të ndalur kurdisjet dhe sulmet sistematike të organeve shtetërore kundër ushtarëve shqiptarë që shërbenin në armatën e ish–

Jugosllavisë. Planifikimi, kurdisja, montimi i proceseve penale politike dhe vrasja e ushtarëve shqiptarë në këtë periudhë kohore, i kishte objektivat e mirë të programuara nga politika shtetërore serbo-jugosllave. Duke qenë se Kosova po futej në një cikël që nuk kishte më kthim mbrapa bashkëjetesa në ish-Jugosllavi, politika serbe si objektiv dhe synim kryesor kishte largimin e gjeneratave të reja nga Kosova. Një pikë strategjike që ata zgjodhën për largimin e këtyre të rinjve, ishte terrori shtetëror serb që manifestohej me vrasje të ushtarëve shqiptarë, të cilët i deklararin si të “vetëvrarë”. Në këtë skenar të shtetit serb realizoheshin dy qëllime kryesore:

E para – duke e dituar se lufta në mes të Kosovës dhe Serbisë do të ishte e pashmangshme, Serbia përmes vrasjeve të ushtarëve shqiptarë, i detyroi të largoheshin të rinjtë shqiptarë nga shërbimi ushtarak. Me këtë, Serbia synonte nesër të kishte përballë një popull që nuk posedonte trupa ushtarakisht të përgatitur.

E dyta – duke i ndjekur të rinjtë me pretekstin që nuk po e kryenin shërbimin ushtarak, i detyronte dhe i dëbonte nga Kosova, që në të ardhmen, një luftë që pritej mos ti kishte përballë. Serbia pas viteve 1990 i thërriste të rinjtë shqiptarë në shërbim ushtarak, por në fakt ajo ishte thirrje për vdekje ose thirrje për ikje.

Represionin e ushtruar nga organet e pushtetit shtetëror serbo-jugosllav ndaj shqiptarëve të Kosovës, e përjetuan në lëkurën e tyre të rinjtë ushtarë shqiptarë, të cilët në mënyrë tinëzare dhe makabre u privuan nga jeta nga strukturat e sigurimit sekret ushtarak dhe shtetëror. Karakteristikë e këtyre skenarëve politikë dhe shtetërorë është fakti, se për të gjitha këto vrasje nuk është dënuar asnjë kryerës nga strukturat e organeve që planifikuan dhe ekzekutuan këto krime makabre ndaj ushtarëve shqiptarë, për të mos thënë se janë bërë me plan pune dhe vendime të përgatitura dhe miratuara më parë. Kjo tregon se skenarët ishin sinkronizim i të gjitha institucioneve shtetërore

federale dhe republikane, në funksion të politikave shoviniste kundër popullit shqiptarë të Kosovës dhe që realizoheshin nën fluskën e pushtetit shtetëror.

2.1.6. Dhuna e ushtruar nga organet e rendit dhe sigurisë të ish-RSFJ dhe Serbisë, ndaj demonstruesve shqiptarë në vitin 1981

Në fillim të pranverës të viti 1981, në Kosovë, shpërthyen demonstratat masive. Nisja ishte në mensën e studentëve si protestë “kundër ushqimit të keq” dhe arriti deri te parashtrimi i kërkesave politike për krijimin e “Republikës së Kosovës”. Këto ishin demonstratat e para pas vdekjes së Josip Broz–Tito. Demonstratat janë shuar me gjakderdhje, me angazhimin forcave të mëdha ushtarake dhe policore dhe me përdorimin e tankeve. Kurrë s’janë publikuar numrat e viktimave.

Pas demonstratave, së pari është kryer qërimi politik. Është shkarkuar nga detyra *Mahmut Bakalli*, i cili në atë pozitë ishte dhjetë vjet. Vendin e tij e zuri *Azem Vllasi*. Pas pastrimit politik, në Kosovë janë dërguar forca e bashkuara të policisë nga e tërë RSFJ. Në Kosovë sundonin rrethanat e jashtëzakonshme. Përforcimi i gjendjes ishte hyrje në procedura masive gjyqësore kundër “organizatorëve dhe pjesëmarrësve” në demonstrata, gjegjësisht kundër shumicës së banorëve të Kosovës, duke llogaritur lidhjet e gjakut të demonstruesve dhe të anëtarëve të familjeve të tyre.

Krahas tyre janë zhvilluar procedurat penale dhe për kundërvajtje. Në procedurën penale janë arrestuar të parët e demonstratave dhe pjesëtarët e organizatave ilegale politike, ndërsa procedura e kundërvajtjes është zhvilluar kundër të gjithë pjesëmarrësve në demonstrata, të cilët në procedurën urgjente, sipas rregullit, janë dënuar me nga dy muaj burgim dhe menjëherë janë dërguar në mbajtje të dënimit. Gjatë vuajtjes së dënimit me torturim janë marrë në pyetje nga personat e autorizuar të Shërbimit Shtetëror. Para skadimit të afatit të vuajtjes së dënimit, kundër shumicës së tyre është

iniciuar procedura penale për kryerjen e veprës penale të propagandës armiqësorë nga Neni 133 i Ligjit Penal të RSFJ ose për veprën penale rrezikim kundërrevolucionar i rregullimit shoqëror nga Neni 114 i Ligjit Penal të RSFJ, atyre u është caktuar paraburgimi.

Prej vitit 1981 deri në vitin 1999, gati më shumë se gjysma e popullit të Kosovës në forma të ndryshme ka kaluar nëpër duar të organeve të sigurimit sekret shtetëror serb dhe policisë. Përpjekjet e popullit shqiptarë për të kërkuar liri dhe barazi në kuadër të ish–Jugosllavisë, nuk kanë munguar për afro pesë dekada, ashtu siç nuk ka munguar terrori dhe dhuna shtetërore e organeve të rendit dhe sigurisë kundër shqiptarëve në përpjekje për liri. Demonstratat e 11 Marsit 1981 të organizuara nga studentët dhe të përkrahura nga masat e gjëra popullore, shpërfaqën dhunën e papërmbytshme të aparatit serbo–jugosllav ndaj shqiptarëve të Kosovës. Vetëm pas disa ditë më pas, me 1 dhe 2 Prill, me kërkesat e studentëve demonstrues u solidarizua i gjithë populli shqiptarë i Kosovës. Në këto demonstrata populli shqiptar i Kosovës u ngrit si një trup i vetëm dhe zbrazti tërë pezmin, tërë revoltën dhe tërë urrejtjen e vet kundër shtypjes, shfrytëzimit, padrejtësisë dhe represionit të përjetuar gjatë dekadave të robërisë në ish–Jugosllavi. Demonstratat e vitit 1981 zgjatën gjatë gjithë pranverës së këtij viti, duke marrë pjesë në forma të ndryshme i gjithë populli shqiptar i Kosovës. Këto demonstrata janë konsideruar si më masivet të mbajtura në Ballkan dhe në Evropën Lindore pas Luftës së Dytë Botërore.

Kundërpërgjigjja e organeve të rendit dhe sigurisë së ish–Jugosllavisë dhe Serbisë ndaj protestuesve ishte shumë e ashpër, duke e përdorur të gjithë arsenalin policor dhe ushtarak në shuarjen e këtyre demonstratave. Nga të gjitha republikat e ish–Jugosllavisë dhe në veçanti nga ajo e Serbisë, u dërguan kontigjente të mëdha me policë dhe ushtarë dhe njësi speciale me qëllim të shtypjes së demonstratës paqësore të popullit shqiptarë

në Kosovë. Kundër demonstruesve u përdorën armë zjarri, bomba me gaz lotsjellës, shkop gome, gazra helmues kimik, autoblanda, tanke, helikopterë, deri në aeroplanë luftarakë MIG-21. Edhe pse kërkesat që kishin demonstruesit ishin legjitime, të drejta dhe ishin në kuadër të kushtetutës së vitit 1974, për barazi dhe Republikës në Federatë, kundërpërgjigjja dhe ekspansioni shtetëror që ndërmori aparati serbo-jugosllav kundër demonstruesve, kishte si pasojë vrasjen, plagosjen, rrahjen dhe torturimin e shumë prej tyre. Politika shtetërore i cilësoi demonstratat si “kundërrevolucionare” dhe demonstruesit u cilësuan si “armiç”, “irredentistë shqiptarë”. Këto stigmatizime politike i hapën rrugë skenarit të ndjekjes masive që bëri sigurimi sekret shtetëror dhe organet e rendit dhe sigurisë, ndaj pjesëmarrësve në demonstratë dhe ndaj masave të gjëra popullore. Pra, vriteshin, plagoseshin, torturoheshin studentë që kishin marrë pjesë në demonstrata, dënoheshin profesorët e tyre ngase kishin përkrahur kërkesën “Kosova Republikë”. Dënoheshin qytetarë të rëndomtë pse u kishin ofruar ndihmë studentëve, dënoheshin nëna pse mbronin bijtë dhe bijat e veta, në fund dënoheshin edhe fëmijët. Me 2 Prill 1981 Beogradi zyrtar shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në KSA të Kosovës. Mbylli shkollat fillore dhe të mesme, ndërpreu mësimin në universitet, mbylli konviktet e studentëve, ndaloi qarkullimin e më shumë se dy personave së bashku në vendet publike dhe mori shumë masa tjera nëpër të gjitha komunat e Kosovës. Pavarësisht faktit se u shpall gjendja e jashtëzakonshme me 2 Prill 1981, në Prishtinë tërë ditën vazhduan demonstratat masive të shqiptarëve të Kosovës. Kosova u vendos në izolim nga pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë dhe duke bërë përpjekje të shkëpusnin çdo lidhje të saj edhe me botën në përgjithësi. Por, këto ngjarje që ndodhnin në zemër të Evropës, nuk mund të mos binin në sy edhe në shtypin e huaj. Ngjarjet e tilla patën jehonë edhe në arenën ndërkombëtare. Revista suedeze “Tempus”, veç të tjerash shkruante: “njerëz të pafajshëm qëllohen me armë. Më shumë se 300 veta janë goditur, edhe fëmijë të vegjël janë qëlluar nga forcat e armatosura serbe. Asnjëherë pas Luftës së

Dytë Botërore nuk ka ndodhur të jetë përdorur një dhunë e tillë në Jugosllavi kundër një grupi njerëzish, siç ndodhi kundër shqiptarëve. Njerëzit qëlloheshin nga helikopteri vetëm pse protestonin kundër politikës së padrejtë të regjimit të Beogradit. Me 27 Prill gazeta gjermane “Frankfurter Alemanje” shkruante: “vërtetues të informuar jugosllavë numrin e të vrarëve e çonin në minimumin, nga 30–40 veta dhe të plagosur deri në 1000 veta”, ndërsa gazeta daneze “Arbeideren” theksonte: “këto masakra ku janë vrarë me qindra veta dhe janë plagosur dhe janë burgosur mijëra të tjerë, paraqesin, pa dyshim, gjenocidin më të madh të kryer në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore (Keçmezi, 2003, 66).

Represioni dhe ndjekja politike e ushtruar nga organet e pushtetit shtetëror serbo–jugosllav ndaj shqiptarëve të Kosovës, ishte një formë e aplikimit të “drejtësisë”, që ngjante me inkuizicionin e drejtësisë mesjetare. Për kërkesat legjitime të shqiptarëve, të shtrura në demonstratat dhe manifestimet politike të viteve ’81–’89, në të cilat shqiptarët nuk përdorën dhunë, vetëm në gjyqet e rregullta dhe ushtarake, janë dënuar 3.348 shqiptarë. Këto ndjekje penale politike kundër shqiptarëve u ndërmorën me qëllim të mohimit të subjektivitetit politik, territorial kulturor të Kosovës në ish–Federatën Jugosllave, si dhe që të pengohej avancimi i autonomisë së Kosovës në statusin e republikës, si hap i politikës pragmatike të shqiptarëve, që në perspektivë të afërt të bashkohen me shtetin amë (Salihu I., 1995, 37).

Si kundërpërgjigje ndaj kërkesave të shqiptarëve për barazi dhe republikë në kuadër të Federatës dhe avancim të pozitës kushtetuese të Kosovës nga autonomia në republikë, pushteti shtetëror serb dhe jugosllav, vrau, plagosi, rrahu, burgosi, ndjekti dhe internoi shqiptarë anë e mbanë ish–Jugosllavisë. Madje, për aktivitete të tilla të shqiptarëve që kërkonin të drejtat e tyre në kuadër të Federatës, organet e sigurimit sekret shtetëror të ish–Jugosllavisë, organizuan vrasje të shqiptarëve edhe në shtetet perëndimore. Kështu,

UDB Jugosllave e udhëhequr kryesisht nga kuadro serbo-malazez, me 17 Janar 1982, vrau vëllezërit Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zekën. Ndërsa me 25 Shkurt 1990 vrau Enver Hadrin. Të gjithë këta veprimtarë dhe aktivistë për çështje kombëtare, të cilët me fakte demaskuan regjimin serb dhe jugosllav për politikën diskriminuese dhe për veprat gjenocidiale ndaj shqiptarëve. Të gjitha këto vrasje, plagosje, tortura, ndjekje, burgime të aplikuara ndaj popullit shqiptarë, nga organet e rendit dhe sigurisë të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë, kishin për qëllim shtypjen dhe dëbimin e shqiptarëve nga Kosova, duke ua mohuar të drejtën e tyre për liri dhe barazi në kuadër të Federatës.

Gjatë procedurës penale, të pandehurit janë torturuar, ndërsa mbrojtësve të tyre i'u është ndaluar shqyrtimi i shkresave të lëndës deri në plotfuqishmërinë e aktakuzës, u është ndaluar të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje të pandehurve, si edhe lirisht të kontaktojnë të mbrojturit e tyre. Veprimet hetimore, përkundër dispozitave ligjore, u besohen Shërbimit të Sigurimit Shtetëror.

Udhëheqësit e demonstratave morën qëndrim që të mos angazhojnë avokat. Organizata e tyre bënte të pandehurve tjerë që të mos angazhojnë avokat – mbrojtës, pasi “nuk pranojnë gjyqet jugosllave”. Një qëndrim i këtillë ishte i gabueshëm dhe fatal. Të pandehurit ishin lënë në vete, s’kishin informata mbi familjet, e as familjet e tyre mbi ta. Pas një kohe, të pandehurit kanë ndryshuar qëndrimin ndaj angazhimit të avokatëve, angazhonin avokatë, por vetëm nga lista të cilën kanë përpiluar “organizatat ilegale”. Nëse dikush angazhonte avokatë jashtë asaj liste, atëherë bëhej presion në familjen e të akuzuarit që të ndërrojnë avokatin. Për të njoftuar opinionin e gjerë mbi këto procese masive, u angazhuan edhe avokatët nga Beogradi, *Tanja Petovar dhe Nikolla Baroviq*

2.1.7. Dhuna e ushtruar nga organet e rendit dhe sigurisë të ish-RFJ dhe Serbisë, ndaj demonstruesve shqiptarë në vitin 1989

Pas marsit të vitit 1989, Kosova futet në dekadën e dytë të dhunës dhe agresionit policor dhe ushtarak të RFJ dhe Serbisë. Në këtë fazë të okupimit klasik, Kosovës i suprimohet Autonomia duke u atakuar çdo segment i jetës në shoqëri. Pas miratimit të amendamenteve kushtetuese me 28 Mars 1989, pushtetit serb u hap rrugë për vendosjen e pushtetit të vet të ri, absolut, në tërë territorin e Kosovës. Kjo vendosje e pushteti serb mbi Kosovën u realizuar me aparatën e ushtruar të dhunës policore dhe ushtarake kundër institucioneve autonome të Kosovës. Kosova prej vitit 1989 ka pësuar dhunë ligjore të pushtetit, organeve dhe institucioneve të Serbisë, sepse u rrënua padrejtësisht autonomia e Kosovës dhe nga kjo periudhë kohore shqiptarët e Kosovës u provuan nga të gjitha të drejtat e tyre.

Me 20 Shkurt 1989, minatorët e Trepçës u hodhën në greve për të kërkuar rikthimin në detyrat e tyre të udhëheqësve të partisë së Kosovës. Qeveria serbe dislokoi trupat policore dhe ushtarake në Kosovë dhe imponoi “masa speciale” në rajon, të cilat morën formën e ligjit të luftës. Republikat e tjera jugosllave, sidomos Sllovenia, zunë të protestonin kundër nacionalizmit agresiv serb. Asambleja kosovare e përbërë kryesisht nga shqiptarë etnikë, por që ishte nën presionin e drejtpërdrejtë të Beogradit, i pranoi ndryshimet e propozuara kushtetuese, të cilat e rikthyen autoritetin e Beogradit në Kosovë. Më 28 Mars 1989, policia serbe hapi zjarr mbi turmën e protestuesve, duke vrarë të paktën 24 shqiptarë (Human Rights Watch, 2002, 27).

Përmasat dhe format e ushtruara të dhunës nga pushteti serb ndaj shqiptarëve në Kosovë, pas vitit 1989 deri në përfundim të luftës, në Qershor 1999, ishin krime me elementë gjenocidi. Arsenali i terrorit shtetëror dhe i shkeljeve flagrante të lirive dhe të drejtave të njeriut individuale dhe kombëtare të shqiptarëve nga regjimi i Serbisë nën

fluskën e ligjit dhe të shtetit juridik, ishte i pashtershëm. Politikës serbe në Kosovë siç dukej nuk i mjaftoi vetëm vrasjet dhe keqtrajtimet e shqiptarëve, por ajo zgjodhi edhe metoda tjera të diskriminimit ndaj shqiptarëve. Në pretendimin se disa qytetarë shqiptarë të Kosovës paraqesin rrezik për rendin dhe sigurinë juridike dhe territoriale të ish-Jugosllavisë, u zbatua edhe masa e “izolimit”. Kjo masë kryesisht aplikohet ndaj intelektualëve shqiptarë si, arsimtarëve, mjekëve, profesorëve, gazetarëve etj. Kjo masë e aplikuar në vitin 1989 ndaj intelektualëve shqiptarë, në fakt ishte metodë e ngjashme me metodat e Stalinit për t’i privuar nga liria njerëzit pa asnjë bazë ligjore dhe pa kurrfarë procedure gjyqësore, të cilën e urdhëruan qarqet më të larta politike e shtetërore të Serbisë dhe e zbatuan organet e policisë serbe. Ky privim i kundërligjshëm nga liria, ishte në kundërshtim të hapur me Nenin 9 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. “Askush nuk mund të arrestohet, të burgoset ose të dëbohet arbitrarisht”.

Shqiptarëve të cilëve u aplikohet kjo masë, dërgoheshin nëpër burgje të Serbisë si në Leskovc, Vranjë, Shabac, Beograd dhe gjatë gjithë kohës sa ka zgjatur kjo masë, shqiptarët e burgosur në këtë mënyrë i’u ekspozuan maltretimeve të rënda fizike e psikike dhe atyre nuk ju lejua kurrfarë kontakti me familjet dhe avokatët e tyre, Në mozaikun e ushtrimit të terrorit të vazhdueshëm serb, ndaj shqiptarëve të Kosovës, gjatë periudhës dhjetëvjeçare, u përcollën, u mbikëqyrën, bastisën, u maltretuan u thirrën në të ashtuquajturat “biseda informative” dhe u trajtuan në ndonjë mënyrë tjetër rreth 700.000 qytetarë shqiptarë të Kosovës. Ky ishte një sulm sistematik i ushtruar nga aparati shtetëror serb ndaj çdo familje shqiptare në dy dekada robëri. Serbia e zërë ngushtë nga kundërshtimet e rrepta midis aspiratave gllabëruese për Kosovën, në njërën anë dhe kërkesave legale dhe legjitime të shqiptarëve për demokratizimin dhe avancimin e Kosovës në Republikë, në anën tjetër, filloi terrorin masiv ndaj shqiptarëve në Kosovë. Vetëm në periudhën kohore 1981–1992 pushteti serb vrau me armë 183

shqiptarë, prej të cilëve 16 të mitur dhe fëmijë. Përpos këtyre të vrarëve nga radhët e shqiptarëve civilë edhe 63 ushtarë shqiptarë u kthyen në shtëpi në arkivole hermetikisht të mbyllura, të gjithë me të njëjtin arsyetim kanë bërë “vetëvrasje”. Gjatë vitit 1990 me armë zjarri u plagosën 212 veta, ndërsa në vitet 1981–1990 u plagosën me armë zjarri 616 shqiptarë, prej të cilëve 49 të mitur dhe fëmijë. Kësisoj, vetëm gjatë vitit 1993, me pretekst të kërkimit të armëve janë keqtrajtuar fizikisht 3233 shqiptarë, prej tyre 112 femra dhe 137 fëmijë. Janë vrarë 15 shqiptarë, prej tyre 2 femra, ndërsa 3 kanë vdekur prej torturave (Salihu I., 1995, 41).

Periudha 1989 deri në Qershor 1999, është konsideruar si dekada më e rëndë nëpër të cilën ka kaluar populli shqiptarë i Kosovës, si pasojë e ushtrimit të agresionit dhe dhunës sistematike shtetërore të Serbisë ndaj qytetarëve të pambrojtur civil shqiptarë. Manifesti i dhunës dhe terrorit shtetëror të organeve shtetërore të sigurimit sekret dhe policisë serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës kishte marrë përmasa alarmante. Në vitin 1990, shërbimi sekret serb dhe ai ushtarak, helmuan mbi 7000 nxënës, studentë dhe të rinj shqiptarë nëpër shkolla shqipe me helme kimike. Madje nuk u kursyen as foshnjat në çerdhet e Kosovës, siç ishte rasti i foshnjave 3 vjeçare në entet parashkollore të Gjakovës (wikipedia, a.d.) (https://sq.wikipedia.org/wiki/Rasti_Helmimi).

Në vitet ‘90, shqiptarët e Kosovës u dëbuan nga puna në mënyrë të dhunshme dhe kolektive, u mbyllën shkollat shqipe, u mbyllën Institutet dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve, u paralizua jeta sociale, ekonomike dhe kulturore dhe u shtua represioni sistematik i dhunës së pushtetit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës. “Duke ditur rolin që luajnë punonjësit për kombin, të cilit i takojnë, pushteti okupues serb mori akte gjenocidiale mu në jetën më delikate të kombit shqiptar, duke dëbuar nga puna 120.000 punonjës shqiptarë dhe duke i lënë pa mjete për ekzistencë edhe rreth 700.000 pjesëtarë të familjeve të tyre. Kështu, më 1989, në Kosovë kishte të punësuar 164.323 shqiptarë

(çdo i dymbëdhjeti) dhe 58.806 serbo-malazes (çdo i katërti serb dhe çdo i treti malazez). Kishte të punësuar 38.900 shqiptarë (vetëm 2.39% të popullsisë shqiptare), ndërkaq 84.439 serbo-malazezë (ose 38% të popullsisë serbo-malazeze). Numri i shqiptarëve të punësuar u zvogëlua prej 164.323 në 38.900, kurse serbo-malazezët e punësuar u shtuan prej 58.816 në 84.439. Pjesëmarrja e serbo-malazezve në punësim është 15 herë më e madhe se e shqiptarëve” (Latifi, 1995, 45).

Si pasojë e veprimeve diskriminuese dhe shkeljeve të të gjitha të drejtave nga pushtetit shtetëror serb ndaj shqiptarëve të Kosovës, këta të fundit nga pas Lufta e Dytë Botërore e këndej, veçmas nga viti 1981, është shpërngulja e më së 500.000 shqiptarëve të moshës më vitale, kryesisht në shtetet e Evropës Perëndimore. Pra, mozaiku i dhunës shtetërore të organeve federative dhe republikane të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës, zgjati afër pesë dekada që karakterizoheshin me vrasje, plagosje, torturë, burgim, izolim, dhunim, dëbim, largim kolektiv nga puna, helmim dhe gjitha format e tjera të diskriminimit dhe mohimit të lirive dhe të drejtave më elementare të njeriut.

2.1.8. Krimet e pushtetit shtetëror të ish-RFJ dhe Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë viteve 1998–1999

Në pranverën e vitit 1998 në fillim rajonin e Drenicës dhe Dukagjinit filluan luftimet e drejtpërdrejta në mes të sulmit të ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve serbë dhe përballjes me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë këtyre sulmeve ushtria, policia dhe paramilitarët serbë, nuk kursyen as civilët e pafajshëm shqiptarë të cilët i masakruan anë e kënd Kosovës. Janë të njohura si masakra e Familjes Jashari në Prekaz, masakrat në Likoshan, Qirez, Meje, Reçak, Lubeniq, Qyshk të Pejës e Suharekë dhe shumë masakra të civilëve të pafajshëm shqiptarë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës u vu në mbrojtje të civilëve shqiptarë, por disproporcioni i forcave në mes të ushtarëve, policëve dhe paramilitarëve serbë dhe ushtarëve të UÇK, ishte shumë i madh dhe kështu ishte e

pamundur mbrojtja e civilëve shqiptarëve nga sulmet serbe. Si pasojë e këtyre sulmeve të aparatit shtetëror serbo–jugosllav në Kosovë ndaj shqiptarëve u vranë afër 15.000 qytetarë shqiptarë, shumica absolute civil të pambrojtur, në mesin e tyre fëmijë, gra, pleq, handicap etj. Ka dëshmi të pakontestueshme, sipas të cilave janë dhunuar varret e janë zhvendosur kufoma nga ana e trupave serbe e jugosllave, gjë që është konfirmuar në verën e vitit 2001 edhe nga qeveria serbe post–Millosheviç. Human Rights Watch dokumentoi përpjekje për të fshehur apo për të rivarrosur kufoma në Tërrnje, Gjakovë, Izbicë, Rezallë, Krushë e Madhe, Krushë e Vogël, Suharekë, Sllavinjë, Kotlinë dhe Pastasel. Përveç, kësaj forcat serbe e jugosllave tentuan dhe arritën të nxirrnin jashtë përdorimit pusët e burimet ujore në të gjithë territorin e Kosovës duke derdhur në to lëndë kimike, kafshë të ngordhura apo mbetje kufomash njerëzore. Human Rights Watch dokumentoi raste në katër fshatra, ku viktimat njerëzore ishin hedhur në burime ujore apo puse.

Agresioni i pushtetit shtetëror serb ndaj shqiptarëve nuk i kurseu as fëmijët. “Sipas të dhënave të grumbulluara për numrin e fëmijëve të vrarë dhe të pagjetur, por të rënë edhe dëshmorë në Kosovë në periudhën Janar 1998–12 Qershor 1999, janë gjithsej 1.271 fëmijë, të rinj deri në 18 vjeç. Ndërsa, deri në moshën 5 vjeçare kanë pësuar 245 fëmijë, duke mos llogaritur ata të cilët kanë vdekur menjëherë pas lindjes dhe nuk ishin pagëzuar, si dhe ata në bark të nënës së vrarë” (Osmani, 2012, 164). Në mësim e shumë viktimave të dhunës shtetërore serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, ishin dhe kategoria më e pafajshme një shoqëri siç janë fëmijët, por agresori serb nuk kurseu as jetën e tyre, duke i vrarë, çnjerëzuar dhe torturuar në forma më barbare të mundshme.

Një karakteristikë e krimeve të pushtetit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës ishte dhunimi, i cili në vitin 1998/1999 kishte marrë përmasat e një dukurie, që ushtria, policia dhe paramilitarët serbë e ushtronin ndaj shqiptarëve. Viktima e parë e përdhunimit në

Kosovën e dekadës së fundit të shekullit njëzetë është regjistruar më 1992 nga ana e hulumtuesve të kësaj dukurie pas çlirimit. Mund të thuhet se pikërisht në dy vitet e fundit të dekadës së fundit të shekullit të shekullit njëzet, sidomos gjatë gjysmës së parë, të vitit 1999, përdhunimi i femrave shqiptare ishte formë dhe mjet i krimit të organizuar, që kishte marrë përmasat e një dukurie të krimit gjithëpërfshirës. Forma më e shpeshtë e nisjes së përdhunimit ka qenë arrestimi i vajzave të moshës madhore, i nuseve dhe grave relativisht të reja dhe përdhunimi individual i tyre. Formë tjetër e organizimit të përdhunimit ka qenë ndarja e femrave të reja në grupe prej 5, 10, 20 etj. dhe përdhunimi grupor i tyre. Formë tjetër e përdhunimit ka qenë rrëmbimi me dhunë i femrave nga kolona e të dëbuarve, nga traktori, nga strehimi i familjeve në male dhe në bjeshkë, etj. U shënuan edhe raste të përdhunimit të detyrueshëm të vajzave para baballarëve, të përdhunimit të bashkëshortes në prani të bashkëshortit. Aktin e përdhunimit e kanë zbatuar ushtarët, policët dhe paramilitarët pavarësisht nga grada ushtarake e udhëheqëses së njërive dhe e njësiteve serbe. Ky karakter i përdhunimit përjashton dukurinë e përdhunimit si akt përcjellës dhe individual të luftës dhe rrjedhimisht, i jep përdhunimit tiparin e armës së luftës sistematike për shthurjen e nderit të femrës, të familjes dhe bashkësisë shqiptare (Instituti për Hulumtimin e krimeve të Luftës, 2013, 137).

Sipas Human Rights Watch, përgjithësisht, përdhunimet në Kosovë mund të grupohen në tri kategori: përdhunime në shtëpitë e grave, përdhunime të grave në rrugë e sipër për të lënë Kosovën dhe përdhunimet në lokalet e paraburgimit. Sipas formës së organizimit të dhunimeve, vlerësohet se mbi 30.000 femra janë dhunuar nga forcat serbe në Kosovë gjatë dhjetë viteve të fundit. Shumica prej dhunimeve janë bërë gjatë luftës (Ahmeti, 2001, 79).

Në fund të episodit të dhunës sistematike në dekada të ushtruara nga terrori shtetëror serb ndaj shqiptarëve, ishin targetuar edhe të burgosurit shqiptarë të cilët në maj të vitit 1999 u masakruan barbarisht në burgun e Dubravës. Më 22 Maj, forcat serbe të sigurisë rreshtuan afërsisht 1.000 të burgosur në oborr dhe qëlluan mbi ta me snajperë, mitralozë dhe granata nga muret e burgut dhe kullat për roje, duke vrarë të paktën shtatëdhjetë njerëz. Të paktën dymbëdhjetë të burgosur të tjerë u vranë gjatë njëzet e katër orëve të ardhshme pasi rojet e burgut, policia speciale dhe paramilitarët sulmuan të burgosurit që fshiheshin në ndërtesat e shkatërruara të burgut, bodrumet dhe kanalizime (wikipedia, 1999) https://sq.wikipedia.org/wiki/Masakra_e_Burgut_t%C3%AB_Dubrav.

Në burgjet që administroheshin nga organet serbo-sllave dhe që ishin të burgosur shqiptarët, rrahja, dhunimi, torturimi, izolimi, zhdukja dhe vrasja ishin dukuri. Siç është rasti edhe i Profesorit dhe aktivistit të madh të çështjes kombëtare Ukshin Hoti, i cili u zhduk në burgjet e Serbisë dhe ende edhe sot nuk dihet asgjë për fatin e tij.

Andaj, me shumë të drejtë mund të konstatojmë se, pushteti shtetëror serbo-jugosllav, për afro pesë dekada ushtroi dhunë sistematike dhe shtetërore ndaj shqiptarëve shumicë në Kosovë. Format e kësaj dhune janë: rrahje, keqtrajtim, torturim, burgosje, dëbim, dhunim, diskriminim politik, ekonomik dhe kulturor, plagosje dhe vrasje të gjitha kategorive të shoqërisë, qofshin ata, fëmijë, gra, pleq apo të rinj. Ky ishte manifestim i dhunës së ushtruar ndaj shqiptarëve, nënkupton dhunën e cila ishte sinkronizuar dhe e programuar nga të gjithë mekanizmat politikë, juridik dhe të sigurisë së organeve shtetërore të Serbisë dhe ish-Jugosllavisë.

KAPITULLI III

DHUNA JURIDIKE NË KOSOVË PAS VITIT 1989

3.1. Shqiptimi i masës së izolimit ndaj personave të papërshtatshëm politikisht

Në të gjitha ligjet mbi punët e brendshme, qëndronte dispozita për të cilin mungonin reagimet e opinionit dhe të ekspertëve juridikë. Kjo ishte dispozita me të cilën organet e punëve të brendshme autorizoheshin që, me rastin e vizitës së personave të lartë shtetëror dhe politikë ose me rastin e mbajtjes së tubimeve të rëndësishme politike e tjerë, sipas hamendjes së tyre, të izolojnë, duke i arrestuar në burgje të rregullta apo të posaçme, personat e papërshtatshëm (endacakët, personat e gjykuar, personat politikë të papërshtatshëm etj), pa status të burgosurit dhe pa të drejta komunikimi me personat tjerë. Kjo masë zgjaste sa zgjatnin rrethanat. Sipas rregullit, kjo masë përdorej me rastin e vizitës së Kryetarit të Republikës, kur endacakë arrestoheshin, kurse personave politikisht të papërshtatshëm u urdhërohej që një kohë të caktuar “të mos dalin nga shtëpia”. Por, pas demonstratave të Prillit 1981, merret vendimi politik që kjo dispozitë të zbatohet kundër personave të papërshtatshëm, kundër të cilëve s’mund të fillonin procedurat penale. Kryesia e KSA e Kosovës vlerësoi rrezikimin e rendit në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, ndërsa Këshilli Ekzekutiv Krahinor mori Vendimin Nr. 1 datë 2 Prill 1981, mbi masën e izolimit. Aktvendimi mbi shqiptimin e masës së “qëndrimit të detyrueshëm në vendin e caktuar” ose “masa e izolimit”, zbatohet ashtu që personi i caktuar privohej nga liria, mbahej një kohë në burgim ose në hapësirën tjetër të mbyllur (shkolla, ndonjë objekt i posaçëm). Familja s’dinte se ku ndodhej ky person, s’kishte kontakte dhe s’dinte asgjë mbi anëtarin e vet familjar. Kjo masë është shqiptuar kundër një numri të madh personash. Sa ishte numri i tyre, kurrë s’është shpallur. Kjo

masë në vitin 1981 ka zgjatur deri më 30 Maj 1981, pasi atë ditë Kryesia vlerësoi se rrethanat e jashtëzakonshme kanë pushuar.

Numri i madh i të izoluarve ishte në marrëdhënie pune. Të gjithë atyre u pushua marrëdhënia e punës “pasi më shumë se pesë ditë kanë munguar paarsyeshëm nga puna”. Gjykatat e Punës së Bashkuar refuzonin ankesat me arsyetim “se propozuesit kishin për detyrë që për mungesën e tyre të lajmërojnë organizatën e punës”. Kur sërish u acarua situata politike në Kosovë, veçmas në Universitetin e Prishtinës, në kushtet e keqësuar të marrëdhënieve në mes të strukturave politike të Kosovës dhe të Serbisë pas seancës së VIII^{-të} të LQ LK të Serbisë, kur *Slobodan Millosheviqi* doli si person politik numër 1, përsëriten ndjekjet penale, në baza politike, për propagandë armiqësore, kundërrevolucion. Por edhe me zbatimin masiv të dispozitave të veprës penale “përhapje e lajmeve të rrejshme”. Të gjitha këto ishin të drejtuara kundër studentëve, punëtorëve arsimorë dhe shkollarëve të mesëm.

Në procedurën penale me masivitet zbatohej masa e paraburgimit; një ditë për vërtetimin e identitetit të personit të privuar nga liria dhe tri ditë paraburgim të lejuar me ligj për përgatitjen e paraqitjes penale. Arsyeja e “vërtetimit të identitetit” ishte *non sens*, pasi policia privonte nga liria personat e identitetit të njohur. Këta persona, fillimisht policia i përcillte; ata kishin dokumentet e identifikimit me vete dhe privoheshin nga liria në shtëpitë e tyre, në vendet e punës ose në shkollat ku mësonin. Në ato katër ditë në paraburgim, të pandehurit torturoheshin dhe përgjithësisht, nënshkruanin procesverbalin policor ku pranonin “veprimtaritë armiqësore”. Mandej formalisht merreshin në pyetje te gjykatësi hetues, i cili menjëherë ua besonte sigurimit shtetëror veprimet hetimore, duke kufizuar të drejtën e të pandehurve për angazhimin e mbrojtësit nëpërmjet avokatit. Sigurimi sekret shtetëror kishte qasje në të gjitha fazat e procedurës penale ndaj të paraburgosurve edhe pse nuk ekzistonte dispozita ligjore që

autorizon gjykatësin hetues të lejojë organit të punëve të brendshme të marrë në pyetje të pandehurin i cili ndodhet në paraburgim në gjykatë.

3.2.Aktet dhe ligjet diskriminuese në Kosovë pas vitit 1989

Mund të konstatohet se legjislacioni i aplikueshëm penal në Kosovë deri në vitin 1989, të paktën në kuptimin formal–përmbajtjesor nuk kishte karakter diskriminues në raport me njësitë tjera të Federatës së ish–Jugosllavisë. Por, ky konstatim nuk mund të qëndrojë kur kemi të bëjmë me zbatimin e këtij legjislacioni në praktikë. Pas 28 Marsit 1989, ku edhe ndodhi dhunshëm rrënimi i Autonomisë së Kosovës dhe Kushtetutës së vitit 1974, në Kosovë dhe kryesisht ndaj shqiptarëve, filloi aplikimi i dhunës juridike, e cila u shoqërua me ndryshimin dhe nxjerrjen e dispozitave ligjore të cilat kishin karakter diskriminues për shqiptarët. Nën parullën e sigurimit të “unitetit të Republikës së Serbisë”, me qëllim që krahinat dhe njësitë tjera shoqërore–politike “të pastrohen prej elementeve të shtetësisë”, duke marrë parasysh se “Kosova është formuar si shtet në shtet”, janë aprovuar ndryshimet e kushtetutës më 28 Mars 1989, me të cilët “janë realizuar qëllimet e caktuara”, por, njëkohësisht, është kryer centralizimi i Serbisë. Për të aprovuar këto amendamente, është kryer kërcënimi politik dhe është rrethuar ndërtesa e Kuvendit të Kosovës. Ndryshimet në Kuvend janë aprovuar pa vullnetin e lirë të pjesëmarrësve në seancën e Kuvendit.

Aplikimi i amendamenteve në Kushtetutë të Serbisë në Kuvendin e Serbisë shkaktoi protesta masive të shqiptarëve në Kosovë. Ato janë shuar në gjak, me viktima njerëzore. Para kësaj, me 1 Mars 1989, u arrestua Azem Vllasi, disa udhëheqës dhe veprimtarë të tjerë. Me qindra kuadro shqiptarë janë vu në izolim, i cili zgjati deri në mesin e Qershorit 1989. Sipas amendamenteve, autonomia e krahinave është reduktuar në funksione të parëndësishme, janë flakur shumë funksione, ndërsa funksionet tjera

vareshin nga pëlqimi i organeve republikane. Është hapur rruga për zhveshjen e plotë të krahinave dhe të komunave, sekuestrimi i pasurisë së tyre dhe shndërrimin e pasurisë shoqërore në pasuri shtetërore në drejtimin e Republikës së Serbisë.

Në atë kohë janë kryer ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Penal të Serbisë. Ndër tjerash, janë niveluar nenet 61a, 61b dhe 61c, me të cilët duhej mbrojtur një kombësi prej sulmeve të nacionalitetit tjetër. Por, këto dispozita janë aplikuar vetëm për mbrojtjen e pjesëtarëve të serbëve dhe të malazezve, ndërsa pjesërisht edhe të goranëve, gjegjësisht ishin të drejtuar kundër pjesëtarëve të kombësisë shqiptare. Këto dispozita janë abroguar me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Penal të Serbisë më 3 Dhjetor 1990, pas shkaktimit të dëmit shumë të madh juridik dhe politik.

Popullsia shqiptare ishte e brengosur. Protestonte për shkolla dhe rrezikimin e të drejtave tjera. Ajo jetonte e ndarë prej popullatës serbe. Nëpërmjet Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Unionit të Sindikatave të Kosovës politikisht u konsolidua. U krijua sistemi shkollor: shkollat fillore, të mesme dhe të larta, punonin nëpër shtëpi private. Shëndetësia, gjithashtu, u caktua tatimi tri përqindësh për të gjitha të ardhura të qytetarëve shqiptarë për financimin e këtyre veprimtarive. Kjo u kuptua si “tatim lufte” kundër regjimit serb. Në këto rrethana, kur regjimi humbi “çdo fuqi” mbi popullatën shqiptare, u ndërmorën masa penalo–juridike për asgjësimin e sistemit paralel.

3.2.1. Programi për sendërtimin e paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit të KAS Kosovës⁶

Në fillim ceket se “ngjarjet dramatike në fillim të vitit 1990, qartë kanë treguar se marrëdhëniet ndërnacionale dhe politike në Kosovë, janë prurë deri te kufiri i durueshmërisë dhe se janë rrezikuar vlerat themelore të civilizimit”. Në vazhdim përcaktohet se kush, në të vërtetë, është i rrezikuar në Kosovë dhe se kujt i dedikohet ky

⁶ Fletorja zyrtare e RS Serbisë”, Nr. 15/90, datë 30 Mars 1990.

program. Në vazhdim ceken të gjitha llojet e presionit “që kanë organizuar dhe nxitur nacionalistët shqiptarë” (ndërsa këtë kanë kryer masat shqiptare, pasi që “numri i madh i shqiptarëve në Kosovë, jo vetëm që është mashtruar me idenë e formimit të Shqipërisë së Madhe dhe i mashtruar se sendërtimi i kësaj ideje është i mundur...”). Kjo pjesë përfundon me pohimin se forcat nacionaliste të shqiptarëve “kanë gënjyer edhe një pjesë të qytetarëve të kombësisë shqiptare se synimi kryesor i tyre është i realizueshëm. Populli serb në Serbi dhe Jugosllavi, para së gjithash, ndërsa jemi të sigurve se edhe shteti jugosllav, këtë s’do dhe s’mund të lejojë... Serbia për asnjë çmim s’do lejojë që të shkëputet pjesa e territorit të saj, atdheu i popullit serb, të cilin me shekuj ka mbrojtur prej pushtuesve, në mënyrë që aty të formohet republika – shteti i dytë, gjegjësisht që të ekzistojnë më tej elementet e vendosura të shtetësisë të ndarë prej Serbisë”.

Nga këto qëndrime s’dëgjohet melodia e paqes, por kërcënimi me vringëllim me armë. Në vazhdim saktë shënohet se kujt i premtohet paqja, liria dhe prosperiteti dhe në ç’mënyrë kjo do sendërtohet. Sipas Pikës 1, kjo paqe dhe liri, sidomos siguria personale dhe e pasurisë, do t’i sigurohet serbëve dhe malazezëve (dhe kombësive dhe kombeve të tjera të paemëruar të rrezikuar) dhe atë “me të gjitha mjetet e shtetit juridik”. Derisa, “qytetarëve të kombësisë shqiptare do tu sigurohet barazia e plotë nacionale dhe kultivimi i traditës nacionale, lirive fetare dhe i të gjitha të arriturave civilizuese”. Pas përsëritjes së frazave dhe deklaratave të përgjithshme, pason qëndrimi se nëse “nacionalistët dhe separatistët shqiptarë do vazhdojnë duke kundërshtuar politikën e aprovuar të paqes... ashtu që politika e aprovuar me këtë program të mos sendërtohet me sukses dhe plotësisht, do të pamundësohen me të gjitha mjetet, ndërsa kjo do të dëmtojë pikërisht dhe më së shumti pjesëmarrësit në shumicë – kombësisë shqiptare”.

Si pjesë përbërëse e këtij Programi është edhe Plani Operativ i realizimit të detyrave nga Programi. Si kapitull i parë janë caktuar “Detyrat për funksionimin efikas të shtetit

juridik dhe i organeve të tij në Kosovë për heqjen e shkeljeve të kushtetutës, ligjshmërisë dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve në Kosovë”. Në Pikën 1, si detyrë operative ceket “mbrojtja e plotë e sigurisë personale dhe të pasurisë së të gjithë qytetarëve në Kosovë, veçanërisht të serbëve dhe malazezëve, si i atyre që kanë ngelur në Kosovë, ashtu edhe i atyre që do kthehen dhe i atyre që do vijnë për herë të parë të punojnë në Kosovë. Poenta e kësaj pike s’është mbrojtja e të gjithë qytetarëve, veç i serbëve dhe i malazezëve, si edhe kolonizimi i Kosovës me popullatë të re serbe dhe malazeze. Kjo konkretizohet në Pikën 3 në të cilën organet kompetente republikane detyrohen që “të bashkojnë listat e të gjithë qytetarëve të paraqitur në Republikë për të shkuar në Kosovë”. Shkuarja e grupit të parë të qytetarëve të interesuar është caktuar në gjysmën e qershorit të vitit 1990”. Çfarë ngutje? Por, pasi kjo ishte detyrë e obliguar, andaj rregullohet që “dinamika e dërgimit të qytetarëve në KASK, do harmonizohet me dinamikën e ndërtimit të banesave”. Një kujdes i këtillë s’ekziston për banorët shqiptarë dhe të tjerë (përveç serbëve dhe malazezëve). Por, në Pikën 6 (gjashtë) parashihet: “organet e punëve të brendshme pikësëpari do angazhohen në zbulimin e qendrave dhe të punkteve nga të cilët nacionalistët dhe separatistët shqiptarë udhëheqin, si edhe organizatorët kryesor, ideatorët dhe bashkëpunëtorët e tyre, ndihmësit dhe nxitësit”. Për këtë detyrë caktohet afati deri në Qershor 1990. Më së largu pas dy muajve do fillojnë proceset penale të reja masive kundër shqiptarëve. Gjithashtu, në Pikën 8, jepet detyrë Ministrisë së Punëve të Brendshme që të ndërmerr “masa dhe aksione urgjente në përcaktimin e numrit të personave nga Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, të cilët s’janë shtetas të RSFJ dhe të shqyrtohen kushtet dhe kriteret nën të cilat u është dhënë shtetësia personave nga Shqipëria, si edhe të gjitha rastet e emigranteve shqiptarë që banojnë në territorin e KSA Kosovës, të cilët kanë keqpërdor mirëpritjen e vendit tonë dhe në bashkëpunim me Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme, të merren masa ligjore”. Për këtë masë të pastrimit etnik (ose të ndryshimit të strukturës së

popullatës në Kosovë) është dhënë afati – Prilli 1990. Përveç kësaj, në Pikën 12, kërkohet më shumë punë “në përcaktimin e origjinës së mjeteve enorme të mëdha materiale për blerjen e patundshmërive të serbëve dhe malazezëve me çmime enorme të larta”. Masa të këtilla nënkuptojnë sinkronizimin e caktuar të organeve të ndjekjes me ato të gjyqësisë. Në këtë kuptim, në Pikën 14, parashihet “ndihma organeve të gjyqësisë dhe organeve të administratës së KASK (dërgimi i përkohshëm në punë⁷, vizita të kohëpaskohshme, pranimi i praktikantëve për kryerjen e stazhit, pranimi i punëtorëve për përsosje profesionale e tjerë)....”. Mandej, me Pikën 15, parashihej formimi i komunave me popullatë shumicë serbe dhe atë: komuna e Sreckës në Prizren, komuna e Gorës në Dragash, komuna e Zveçanit në Mitrovicën e Titos dhe “edhe një numri i komunave në mjediset kryesisht me serbë dhe malazezë”, afati Korrik 1990. Me Pikën 17, hapen mundësitë që të mos paguhen pagat gjatë grevave, “menjëherë të kryhet ndërrimi nga funksionet në sipërmarrjet, por edhe në institucionet tjera shoqërore të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në demonstratat”. Këtu mendohet vetëm në shqiptarë, por jo edhe në pjesëmarrësit e demonstratave të organizuar nga regjimi i Beogradit. Mandej, në pjesët e ndërmarrjeve nga Serbia në Kosovë ku ishin grevat, “menjëherë të dërgohen punëtorë prej sipërmarrjeve gjegjëse nga Serbia, të cilët menjëherë do vazhdojnë procesin e prodhimit”.

Me Pikën 22 i jepet detyrë Gjykatës Kushtetuese të Serbisë të vlerësojë se cilat norma të KASK janë në kundërshtim me Kushtetutën e Serbisë, veçanërisht në këto lëmi: barazia e gjuhëve dhe e shkrimit dhe çështje e përdorimit zyrtar të gjuhës serbokroate;

⁷ Në fillim janë dërguar “gjykatës vullnetarë”, të cilëve u premtuhej se do zgjidhen për gjykatës të përhershëm në vendbanimet e tyre, se do i avancojnë në rang më të lartë, se do i zgjidhin problemin banesor etj. Pjesa më e madhe e këtyre gjykatësve pozitivisht e kuptuan detyrën e tyre dhe punonin në pajtim me betimin e dhënë. Disa prej tyre janë treguar shumë të zellshëm – zgjidhnin lëndët e grumbulluara në pajtim me ligjin. Në fillim, për shkak të propagandës politike, ishin të rezervuar ndaj shqiptarëve. Por, më vonë, sidomos prej viteve 1997–1998, vinin më së shumti “penalistë”, të cilët ishin dërguar si “xhelatë të vërtetë” – s’i përmbaheshin dispozitave të procedurës penale, nuk kujdeseshin për procedurën e provave. Ishte e mjaftueshme vetë dëshmimi i ndonjë pjesëtari të punëve të brendshme ose “dorëza të fiksuara parafinë”, që këta “ndarës të drejtësisë” të shqiptojnë dënime enorme të larta me burgim.

punësimi, marrëdhëniet e punës, qarkullimi i patundshmërive, eksproprijimi; regjimi juridik i caktimit dhe i pagesës së të ardhurave shoqërore; kushtet juridike të organizimit politik të qytetarëve, informimi publik; aktet e përgjithshme në funksionin e politikës demografike dhe regjistrimi i popullsisë; shtetësia, vendbanimi dhe banimi i personave nga Kosova; blerja dhe posedimi i armëve, regjistrimi i automjeteve, emblemat, flamujt, vulat; arsimi dhe shëndetësia, organizimi i institucioneve shëndetësore në Kosovë; kryerja e obligimeve të qytetarit në bazë të shfrytëzimit të shërbimeve komunale–banesore e tjerë”. Detyra të ngjashme janë parashtruar edhe Gjykatës Supreme, Prokurorisë Republikane dhe organeve tjera të gjyqësisë. Në Pikën 48, parashihet “zgjerimi programit të TV Prishtinës në gjuhën serbokroate, emetimi i gjithë ditshëm i programit të Radio Prishtinës në gjuhën serbokroate”. Derisa, në Pikën 49, flitet mbi kushtet e kuadrove dhe tjera “për zhvillimin e shpejtuar të Ndërmarrjes Gazetare Informative “Jedinstvo” dhe “Tan”, në mënyrë që të sendërtojnë rolin dhe ndikimin e vetë shoqëror”. Asnjë fjalë për përmirësimin e kushteve për shqiptarët.

Kapitulli i dytë mban titullin: Detyrat në sendërtimin e politikës ndërnacionale të afërsisë, jetës së përbashkët, paqes, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit për të gjithë njerëzit në Kosovë. Kur flitet për “të gjithë njerëzit”, atëherë ato janë fraza të përgjithshme, pa përcaktimi e veçantë të afateve. Konkretisht flitet vetëm mbi kategori të veçanta, të cilat favorizohen, e ato janë serbët dhe malazezët. Kështu, në Pikën 52, flitet mbi fondin e veçantë për zhvillimin e KSA Kosovës “me qëllim të ndalimit të shpërnguljeve dhe për kthimin e serbëve dhe malazezëve në Kosovë”. Afati, Prill 1990. Derisa, për shqiptarët në Pikën 57, parashihet: “Do rishqyrtohen mundësitë për punësimin e shqiptarëve në viset tjera të Jugosllavisë, në pajtim me Programin Jugosllav për Kosovën”. Afati, Tetor 1990. Kjo është edhe një mënyrë e pakësimit të territorit të Kosovës me shqiptarë. Para kësaj, gjatë demonstratave të serbëve dhe malazezëve nëpër

Serbi dhe fushatës kundër shqiptarëve, nga territori i Serbisë janë persekutuar furrтарët dhe qytetarët tjerë shqiptarë. Në Pikën 59, parashihet: “do ndërmerren masa të veçanta për përcaktimin e bazës juridike për ndarjen e tokës së pëlleshme bujqësore në shfrytëzim atyre që vinë të jetojnë dhe banojnë vijimisht në Kosovë. Gjithashtu, do sigurohen edhe kushtet e volitshme të kreditimit për ndërtimin e objekteve banesore dhe bujqësore dhe për blerjen e mekanizimit bujqësor”. Natyrisht, vetëm pjesëtarëve të kombësisë serbe dhe malazeze. Afati, deri në fund të Majit 1990. Punësimi s’vitet në funksionin e punësimit të gjithë banorëve të Kosovës, veç i kombësive të caktuara, si në Pikën 60: “...punësimit me të madhe, veçanërisht të rinjve – ndalimit të shpërnguljes dhe të popullzimit të atyre qytetarëve që dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë në Kosovë”. Në Pikën 61, parashtrihet kjo detyrë: “Gjatë vitit 1990 do të sigurohen të gjitha kushtet e nevojshme që ndërmarrjet ekonomike nga Serbia të fillojnë me ndërtimin e reparteve prodhuese në 30 vendbanime: Zubin Potok, Novo Bërdo, Shtërpce, Lipjan, Gjiilan, Obiliq dhe Ferizaj, me vendbanime dhe bashkësi lokale ku jetojnë serbët dhe malazezët, mandej Prilluzh, Graçanicë, Kamenica e Kosovës dhe tjerë”. Afati, Korrik 1990. Në Pikën 67 parashihet se në vitin 1990, do të shpejtohen veprimet që menjëherë të fillojë puna në përgatitjen urbanistike të lokacioneve për ndërtimin e 300 banesave në Prishtinë, 25 banesave në Fushë Kosovë, 150 banesave në Obiliq dhe nga 50 banesa në Novo Bërdo, Shtërpce, Lipjan, Zubin Potok dhe Kamenicë të Kosovës...”. të dedikuar për të riatdhesuarit dhe kuadrove, jo shqiptarë. Në Pikën 70, shkruan: “Duhet përcjell realizimin e ndërtimit të banesave për qytetarë të ashtuquajturës “rruga serbe” në Gjakovë dhe shfrytëzimin e kredive për këtë dedikim”.

Në pjesën e tretë: “Detyrat në përparimin e arsimit, shkencës, kulturës, marrëdhënieve me jashtë, politikës demografike, mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve dhe mbrojtjes sociale dhe luftëtare–invalidë” me konsekuencë sendërtohet politika e privilegjuar e

kombësisë serbe e malazeze, me “grimca” për grupet tjera etnike, përveç shqiptarëve, kundër të cilëve zhvillohen masa restriktive. Parashihet dërgimi i kuadrit arsimor nga Serbia në shkolla fillore dhe të mesme, si edhe në Universitetin e Prishtinës dhe atë si për mësimin në gjuhën serbishte, ashtu edhe mësimin në gjuhën shqipe. Në Pikën 78, parashihet se “veçanërisht insistohet në ndërmarrjen e masave ligjore kundër udhëheqësve të organizatave arsimore–edukative dhe mësimdhënësve, të cilët me sjelljet e tyre destruktive kanë ndikuar në nxënësit dhe studentët që të lëshojnë mësimet dhe të marrin pjesë në demonstratat dhe trazirat”. Derisa, ndaj nxënësve dhe studentëve “të ndërmerren masat ligjore, përfshirë edhe masën e përjashtimit nga shkolla e mesme dhe e lartë, gjegjësisht fakultetit”. Ky “pastrim” ka të bëjë vetëm me shqiptarët. Nënkuptohe se identifikim duhet të bëjë “Shërbimi i Sigurimit Shtetëror me ndihmën dhe denoncimin e bashkëpunëtorëve besnik të SHSSH”. Në Pikën 80, parashihet se në vitin shkollor 1889–1991 pranimi i “disa mijë studentëve të kombësisë serbe, malazeze, sllovaqe, maqedonase, kroate dhe të kombësive tjera”. Ku u humbën turqit, goranët, myslimanët e tjerë? Me Pikën 84, urdhërohet që duhet “kujdes i veçantë të kushtohet Institutit të porsaformuar për studimin e kulturës serbe, malazeze, kroate dhe myslimane”. Përfundimisht, me Pikën 91, parashihet se “në kornizën e masave për zhvillimin ekonomik dhe social të Krahinës (do ndërmerren) masa dhe veprime të nevojshme për zvogëlimin e natalitetit të shqiptarëve në Kosovë...”. Në të njëjtën kohë, në Serbi zhvillohet fushata për rritjen e natalitet të popullatës serbe.

Kjo është esenca e këtij programi, i cili për ironi u quajt, programi i paqes, lirisë, barazisë, demokracisë dhe prosperitetit, të cilin regjimi serb i dedikon Kosovës në vitin 1990. Ky program në Kosovë ka mbjell shqetësim, konflikte, jo liri, pabarazi, autokraci dhe rënien e përgjithshme ekonomike, sociale dhe shoqërore dhe ndarjen e plotë ndërmjet kombësive.

3.2.2. Ligji mbi veprimin e organeve republikane në rrethanat e posaçme⁸

Për të realizuar këtë ligj, duhej të merrej vendimi mbi ndodhjen e rrethanave të posaçme. Një vendim të këtillë mori Kuvendi i Serbisë (Dhoma e Punës së Bashkuar, Dhoma e komunave dhe Dhoma politiko–shoqërore), në seancën e datës 26 Qershor 1990. Vendimi është i shkurt (vetëm dy nene). Ai vetëm “konstaton se në territorin e KSA Kosovës kanë ndodhur rrethana të posaçme nga Neni 2 al. 1 e Ligjit mbi veprimin e organeve republikane në rrethanat e posaçme”. Qëllimi i aprovimit të këtij ligji (neni 1) ishte “sigurimi i kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, lirive demokratike, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e qytetarëve dhe barazisë së tyre në tërë territorin e RS Serbisë”. Sipas Nenit 3 të këtij Ligji, ky sigurohet: 1. Me kryerjen e kontrollit dhe formave tjera të përmbarimit të ligjit dhe dispozitave tjera. 2. Delegimin e kompetencës së gjykatave dhe të organeve tjera. 3. Vendosjen mbi çështje të caktuara nga kompetenca e organeve kompetente në atë territor. 4. Kufizimin e përkohshëm të sendërtimit të të drejtave të caktuara vetëqeverisëse dhe me ndërmarrjen e masave tjera të përkohshme nga ana Kuvendit të RS Serbisë ndaj sipërmarrjeve dhe institucioneve tjera. 5. Prishjen nëpërmjet të flakjes, gjegjësisht ndalimit të përmbarimit të dispozitave dhe akteve tjera të përgjithshme dhe të veprimeve të organeve të bashkësive shoqërore–politike, organeve, sipërmarrjeve dhe institucioneve. 6. Me marrjen e përmbarimeve të vendimeve dhe të akteve tjera individuale.

Me këtë ligj është krijuar gjendja kaotike juridike dhe pamundësuar realizimi i çfarëdo të drejte nëpërmjet organeve gjyqësore dhe administrative. Në rend të parë, u krijua kaos në procedurat gjyqësore në lëmin e procedurës së kontesteve dhe të drejtave nga puna. Në të gjithë kontestet ku njëra palë ishte e kombësisë serbe ose malazeze, në

⁸ Fletorja zyrtare e RS Serbisë, Nr. 30/90, datë 26 Qershor 1990.

kërkesë të palës, ndërpritej procedura gjyqësore, ndërsa Gjykata Supreme caktonte një gjykatë tjetër me kompetenca reale në ndonjë pjesë tjetër të Serbisë, jashtë Kosovës. Të gjitha procedurat kanë përfunduar në favor të palës së kombësisë serbo-malazeze, pikësëpari se pala e kombësisë shqiptare s'guxonte ose s'ka pasur mundësi materiale që kontestin e shtrenjtë të zhvillojë jashtë vendbanimit. Disa palë të kombësisë shqiptare propozonin për disa lëndë ku të dy palët ishin të kombësisë shqiptare, që të kryhet delegimi i gjyqit. Por, të gjithë propozimet janë refuzuar. S'duhet veçanërisht të vlerësohet se çfarë pasojash kjo kishte në marrëdhëniet ndërnacionale në Kosovë. Gjendja u keqësua për kontestet e punës në gjykatat e punës së bashkuar. Ndërmarrjet kërkonin që kontesti të zhvillohet jashtë Kosovës, ndërsa kërkesat e tyre aprovoreshin. Këto konteste, gjithashtu, përfundonin në dëm të punëtorëve, të cilët s'mundnin të merrnin pjesë në gjykime. Krejt kjo ndodhi në kushtet kur në gjykatat në Kosovë veç ishin emëruar gjykatësit nga të gjitha anët e Serbisë dhe të Vojvodinës.

Pasoja tjetër me rëndësi ishte futja e masave të përkohshme në sipërmarrje, organizata, institucione, shkolla dhe kudo ku ndodhej kuadri udhëheqës i kombësisë shqiptare dhe turke. Kuvendi i Serbisë çdo ditë binte vetëm këto masa të përkohshme. Është karakteristike se propozimet e masave mund të parashtronin individët dhe grupe të punësuarve. Individët dhe grupet e të punësuarve ishin nga radhët e kombësisë serbe dhe malazeze. Me këto vendime shkarkonin udhëheqësit e gjertanishëm të kombësisë jo serbe, si edhe organet e këshillit të punëtorëve, ndërsa në vend të tyre emërohen udhëheqës të kombësisë serbo-malazeze. Personat e emëruar merrnin rrogën e plotë. Kuadrot e njëjtë emëroheshin në organe punëdhënëse në më shumë organizata dhe pa turp, merrnin në çdonjërin prej tyre rrogat e plotë.⁹

⁹ Rrogat e këtyre personave caktoheshin me Vendimin e Dhomës së Punës së Bashkuar të Kuvendit të Serbisë mbi caktimin e të ardhurave personale dhe të kompezimeve personave të emëruar në organe të përkohshme në organizatat në territorin e KSA Kosovës e Metohisë. Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 11/90, datë 26 Nëntor 1990.

Për një kohë të shkurt deri më 1992, tërësisht janë pastruar ndërmarrjet, institucionet, përfshirë edhe çerdhet e fëmijëve, organizatat dhe organizatat tjera shoqërore prej kuadrove shqiptarë dhe janë zëvendësuar me kuadro të kombësisë serbe. Në Prizren, ngeli vetëm një drejtor i kombësisë shqiptare – drejtori gjeneral i Sipërmarrjes metalike “Famipa”, S. P. Çfarëdo procedure kundër këtyre vendimeve ishte e pasuksesshme. Njëkohësisht, në bazë të Nenit 10 të këtij ligji, i cili dukej si neutral, filloi pastrimi në organet e gjyqësisë. Kjo dispozitë ishte: “Funksionarit, punëtorit udhëheqës të cilin e zgjedh, e emëron, gjegjësisht e emëron kuvendi i bashkësisë shoqërore–politike apo organi ekzekutiv i tij, i pushojnë të drejtat sipas punës të caktuar me ligj, gjegjësisht marrëdhënia e punës, në ditën e dorëzimit të vendimit mbi shkarkimin”. Në bazë të kësaj dispozite, Kuvendi i Republikës së Serbisë më 3 Dhjetor 1990, merr Vendim mbi shkarkimin dhe zgjedhjen e kryetarit dhe gjykatësve të Gjykatës së Punës së Bashkuar, gjykatave komunale dhe të qarkut dhe kryetarëve të organeve për kundërvajtje në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë¹⁰), me të cilin shqiptarëve në ato poste dhe funksione, veç disa përjashtimeve të jashtëzakonshme – përjashtime që vërtetojnë rregullin, u pushon marrëdhënia e punës. Kështu, gjykatat u bënë një nacionale. Me vendimin e Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë, në detyra në të gjitha gjykatat komunale dhe të qarkut në Kosovë janë zgjedhur gjykatësit të kombësisë serbe, përveç në Gorë ku u zgjodh goran¹¹.

3.2.3. Ligji mbi marrëdhëniet e punës në kushtet e posaçme¹²

Ky Ligj zbatohet vetëm në territorin e KSA Kosovës. Sipas dispozitave të këtij Ligji, “vendimin mbi nevojën e lidhjes së marrëdhënies së punës me punëtorin dhe vendimin

¹⁰ Vendim mbi shkarkimin dhe zgjedhjen e kryetarit dhe gjykatësve të Gjykatës së Punës së Bashkuar, gjykatave komunale dhe të qarkut dhe kryetarëve të organeve për kundërvajtje në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë (“Fletore zyrtare e RS”, nr. 16/90 datë 3 dhjetor 1990)

¹¹ Fletore Zyrtare RS, Nr. 52/92, datë 03 Gusht 1992.

¹² Fletore Zyrtare e RS Serbisë, Nr. 40/90, datë 26 Korrik 1990.

mbi zgjedhjen e kandidatëve për punë në vendin e caktuar të punës e merr funksionari, i cili udhëheq me punën e organit” (Neni 2); “marrëdhënia e punës mund të lidhet pa konkurs publik edhe në rastet (1) kur punët në vendin e punës janë të asaj natyre që kryerja e tyre s’duron shtyrje. (2) lidhjes së marrëdhënies së punës në kohë të caktuar... (Neni 3); “gjatë punës, nëse këtë e kërkon nevoja e punës, punëtori mund të sistemohet përkohësisht në çdo vend të punës në organizatë, gjegjësisht organ që i përgjigjet dijes dhe aftësive të tij” (Neni 4); “funksionari vendos mbi përgjegjësinë disiplinore të punëtorit dhe i shqipton masat disiplinore të parapara me ligj” (Neni 6). Me dispozitat e këtij Ligji, përveç mundësisë që pa kufizime, pa kritere (vetëm duhet dije dhe aftësi, por jo edhe kualifikimi profesional), të pranohen punëtorët sipas hamendjes, paralelisht me krijimin e poltronëve dhe atmosferës psikologjike të tmerrit, gjithashtu mundësohet lirimi i lehtë prej “punëtorëve të padëgjueshëm dhe të papërshtatshëm”. Kjo e drejtë është shfrytëzuar me begati, veçanërisht ndaj pjesëtarëve të kombësisë jo serbe.

Kur përfundoi përjashtimi kuadrit shqiptar nga organizatat punuese, institucionet, organizatat shoqërore dhe tjera, filloi “lirimi” prej punëtorëve të rëndomtë të kombësisë jo serbe. Kërkohej përcaktimi i punëtorëve mbi “deklaratën e lojalitetit ndaj shtetit serb”.¹³ Këso deklarate kishin për detyrë të nënshkruajnë vetëm pjesëtarët e kombësisë jo serbe. Kush nuk nënshkruante deklaratën e lojalitetit, i pushonte marrëdhënia e punës. Shqiptarët masivisht nuk nënshkruanin deklarata të tilla, për ç’arsye u pushonte marrëdhënia e punës dhe humbnin të gjitha të drejtat.

¹³ Në deklaratën e Shërbimit të ardhurave shoqërore të Kuvendit të Komunës Prizren, 4/4 Nr. 47–5–522, datë 25 Nëntor 1991, p.sh., pas emrit dhe mbiemrit, qëndron: “Deklaron dhe me nënshkrimin e vetë vërteton se pranon Kushtetutën dhe Ligjet e Republikës së Serbisë dhe se me punën e vetë në vendin e punës do i zbatoj dhe i kryejë detyrat në tërësi. Deklaratën jap me vullnet të lirë, i vetëdijshëm se do bartë përgjegjësinë e plotë nëse s’i përmbahem deklaratës së dhënë”.

3.2.4. Ligji mbi kushtet e veçanta të qarkullimit të patundshmërive¹⁴

Ligji vlente vetëm në territorin e Serbisë, pa KSA të Vojvodinës dhe kishte të bëjë me qarkullimin e patundshmërive ndërmjet personave fizikë dhe ndërmjet personave fizikë dhe personave juridik (Neni 1). Për çdo qarkullim ishte e domosdoshme leja e Ministrisë së Financave – Drejtoria për punët pronësore–juridike. Ajo jepte pëlqimin për qarkullim “kur vlerëson se qarkullimi s’ndikon në ndryshimin e strukturës nacionale të popullsisë ose në shpërnguljen e pjesëtarëve të kombësisë së caktuar, gjegjësisht kombësisë dhe kur qarkullimi s’krijon pasiguri, gjegjësisht pasiguri ose pabarazi te popujt tjerë, gjegjësisht kombësitë” (Neni 3). Ky Ligj ishte afatizuar në 10 (dhjetë) vjet. Kontratat e lidhura pa pëlqimin e Ministrisë konsiderohen të pavlerë sipas ligjit (Neni 5). Në realitet, Ministria nuk jepte leje për kontratat mbi qarkullimin e patundshmërive ku në anën e shitësit ishte shqiptari, ndërsa më vonë edhe ata të kombësisë jo serbe. Privilegje të veçanta kishin goranët, të cilët me vërtetimin e Shoqatës së Goranëve, rregullisht merrnin pëlqim për qarkullim. Por, siç dihet, sa më shumë ndalesa, aq më shumë korrupsion. Vinte deri te “bashkëpunimi afarist” ndërmjet avokatëve në Kosovë dhe avokatëve në Beograd, të cilët kishin krijuar lidhjet në Ministri dhe për një shumë të caktuar, jepej leja për qarkullimin e patundshmërive ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Nga ky korrupsion i njerëzve udhëheqës në Ministri, gjegjësisht në Drejtori për punë

¹⁴ Fletore Zyrtare RS Serbisë, Nr. 22/91, datë 18 Prill 1991. Ky Ligj është miratuar pasi që Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë ka konstatuar se s’janë në pajtim me Kushtetutën e RSFJ dispozitat e Nenit 1 të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi qarkullimin e patundshmërive (“Fletore Zyrtare e KSA Kosovës”, Nr. 29/86), me të cilën “përkohësisht ndalohet qarkullimi i patundshmërive në të cilat qytetarët dhe personat juridik qytetar kanë të drejtën e pasurisë, nëse qarkullimi bëhet për shkak të shpërnguljes së pjesëtarëve të kombeve dhe kombësive nga territori i KASK”, si edhe dispozitat e Nenit 1 al. 1 i Ligjit mbi kufizimin e qarkullimit të patundshmërive (“Fletore zyrtare e RS Serbisë”, Nr. 30/90), me të cilën “kuvendi komunal mundet përkohësisht të ndalojë qarkullimin e patundshmërive ndërmjet qytetarëve dhe qytetarëve dhe personave juridik qytetar në territorin e komunës ose një pjese të saj, nëse vlerëson se qarkullimi kryhet në kushtet e ekzistimit të presionit, si formës së rrezikimit të barazisë kombëtare ose të lirive të njeriut dhe të qytetarit, të caktuara me kushtetutë, që kanë për qëllim shpërnguljen e pjesëtarëve të popullit të caktuar, gjegjësisht të kombësisë” (Vendimi K. Nr. 284/86 dhe K. Nr. 73/87 datë 27 Qershor 1990 dhe Vendimi IK–12/1–88, IK–101/2–89, datë 27 Qershor 1990). Arsyeimi themelor ishte se “pronarët e patundshmërive në një territor vihen në pozitë të pabarabartë në krahasim me pronarët e patundshmërive në territoret tjera... dhe kufizimi i qarkullit të patundshmërive s’i takon mënyrave të sendërtimit të lirive dhe të drejtave individuale në kuptim të dispozitës së Nenit 203 të Kushtetutës së RSFJ”.

pronësore-juridike, politika kishte dobi. Pasi, çdo vërejtje se Ligji është diskriminues për shqiptarët, pohimi demantohej me shënime statistikore se ishin lejuar qarkullimet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Për shkak të këtij Ligji. Shumë njerëz ngelën pa pasuri, ndërsa disa shitës të pandërgjegjshëm të kombësisë serbe, më vonë kërkuan lirin e banesave të shitura.

3.2.5. Rregullimi juridik i “vullnetit të qytetarëve”

Në vitin 1992 janë paraparë zgjedhjet për këshilltarë të kuvendit komunal. Për të siguruar shumicën e këshilltarëve serbë dhe malazezë në Kuvendin e Komunës së Prizrenit (ngjashëm ndodhte edhe në komunat tjera), Kuvendi Popullor i Serbisë merre Vendim mbi njësitë zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve të Kuvendit Komunal Prizren¹⁵.

Me këtë vendim janë formuar 31 njësi zgjedhore, të cilat zgjidhnin vetëm nga një këshilltar. Sipas shënimeve statistikore të vitit 1981, në Prizren kishte 134.689 banorë, ndërsa në qytet 61.990 banorë. Por, njësia e parë zgjedhore kishte gjithsej 31.000 banorë, kryesisht të kombësisë shqiptare, ndërsa zgjidhte vetëm një këshilltar. Derisa, p.sh. fshatrat Smaq dhe Sërbicë, kryesisht me popullatë serbe, numëronin gjithsejtë 427 banorë, ndërsa ishin të ndarë në tri njësi zgjedhore dhe zgjidhnin tre këshilltarë. Gjithashtu, fshati Sreçkë, i cili kishte 448 banorë serbë, zgjidhte një këshilltar. Njësoj edhe fshati Drajciq (366) serbë, Novake (462 serbë), ndërsa nga fshati Mushnikovë, si njësi e veçantë zgjedhore ndahet një pjesë për serbët (me 362 serbë)... Në të ngjashëm mënyrë janë ndarë edhe bashkësitë vendore të qytetit. Kuvendi i Komunës Prizren shkoi

¹⁵ Fletore zyrtare e RS, Nr. 24/92, datë 29 Prill 1992.

edhe një hap më tej. Ai merr vendim mbi caktimin dhe emërimin e emrave të rrugëve të Prizrenit¹⁶.

Së pari janë zëvendësuar emrat e heronjve të popullit të Luftës Nacional Çlirimtare me emra të personave nga historia serbe (mbretërit, mbretëreshat dhe vojvodët). Mandej janë hequr emrat e rrugëve me emra nga historia shqiptare, në përgjithësi dhe emrat e rrugëve në gjuhën shqipe.

3.2.6. Deklarata mbi të drejtat njerëzore të pjesëtarëve të pakicave kombëtare¹⁷

Dhuna juridike veç e kryer mbi Kosovën pati pasoja të rënda për pozitën e pakicave kombëtare, por, para së gjithash, në krijimin e mosbesimit ndërmjet pakicave kombëtare dhe popullit serbo-malazez. Janë këputur të gjitha lidhjet ndërmjet tyre, çdo bashkëpunim dhe çdo “gjë e përbashkët”. E përgjithshmja tragjike u pasqyrua edhe në martesat e përziera dhe jetën e individëve, të cilët kishin “gjakun e përzier”. Këta individë, për t’u treguar, nevojitej të bëhen ekstrem (shqiptar ose serb). Shkatërroreshin dashuritë, të cilat patën hy në legjendën e qytetit të Prizrenit, p.sh. Shqiptarët e Kosovës jetonin në geto. Formonin organe shoqërore paralele, shkollat e veta, institucione të veta të mjekësisë, si edhe partitë e veta politike nacionale. Shteti i Serbisë u bë shteti i huaj, ndërsa regjimi trajtohej si armiqësor. Djelmoshat pushuan të shkojnë në ushtri në APJ, pas shtimit enorm të funeraleve teneqesh, në të cilët binin ushtarët e rinj shqiptarë. Në këto rrethana, Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë, pasi shqyrtoi Informatën mbi gjendjen dhe problemet e sendërtimit të drejtave të njeriut në KSAK, me vështrim në sendërtimin e të drejtave të shqiptarëve, si pakicë kombëtare, merrte Deklaratën e lartpërmendur. Qysh në pikën 1 ceket se: “Republika e Serbisë, njëra prej ish

¹⁶ Fletore zyrtare e KSAK, Nr. 7, datë 9 Shtator 1992.

¹⁷ Fletore zyrtare RS”, Nr. 89/92, datë 7 Dhjetor 1992.

republikave jugosllave, është i vetmi shtet në Ballkan dhe njëri prej të rrallëve në Evropë, e cila me Kushtetutën e vet ka pranuar dhe në praktikë ka realizuar autonominë territoriale në suazat e hapësirës së vetë shtetërore”. Në pikën e radhës, konstatohet se “pjesëtarëve të pakicës kombëtare shqiptare, përveç të drejtave që garantohen edhe qytetarëve tjerë të Republikës së Serbisë, janë siguruar edhe...”, dhe numërohen shumë të drejta tjera, prej gjuhës, fesë, bashkimit, etj. Pas distancës se “disa keqpërdorime dhe mos efikasiteti në zgjidhjen e çështjeve të caktuara në lëmin e sendërtimit të drejtave qytetare dhe të njeriut, deri të cilët erdhi, s’janë shprehje e politikës shtetërore e Republikës së Serbisë”, vlerëson se “në të vërtetë s’ka lëndime masive të drejtave të njeriut të pakicës kombëtare shqiptare nga ana e Shtetit të Serbisë, përveç presionit të organizuar të separatizmit shqiptar në qytetarët e pakicës kombëtare shqiptare që të bojkotojnë shfrytëzimin e të drejtave të veta të njeriut dhe të pakicës”. Pas kësaj, gjerësisht në Pikën 4, parashtrohen shkeljet e të drejtave të serbëve: “Historia e Serbisë dhe historia e Kosovës dhe Metohisë është histori e pastrimeve të vijueshme etnike të serbëve nga këto hapësira, d.m.th. ndjekjes së serbëve nga Kosova dhe Metohia nga ana e shqiptarëve në periudhën prej 1876 deri më 1912 nga Kosova dhe Metohia janë shpërngulur afro 150.000 serbë, ndërsa kanë popullzuar shqiptarët nga Shqipëria. Gjatë okupacionit fashist 1941 deri 1944, në Kosovë e Metohi janë vrarë afro 10.000 serbë. Në Kosovë e Metohi prej 1941 deri 1944 janë popullzuar ndërmjet 80.000–100.000 shqiptarë nga Shqipëria. Ndërsa janë ndjekur 150.000 serbë dhe malazezë pa të drejtë kthimi. Lloje të ndryshme të presionit dhe terrorit të separatistëve shqiptarë (përdhunime, vrasje, sulme të vijueshme, uzurpime të tokës, kërcënime e tjerë), nga Kosova dhe Metohia prej vitit 1945 deri më 1991, sipas shënimeve zyrtare, janë shpërngulur 153.949 serbë dhe malazezë. Procesi i shqiptarizimit i Kosovës dhe Metohisë, i cili zgjatë shumë decenie paraqet pastrim etnik më të madh në Evropë...”.

Pas këtyre vlerësimeve (dhe akuzave kundër separatistëve shqiptarë) s'mund të pritej asgjë konstruktive në zgjidhjen e problemeve, përveç që të arsyetohen dispozitave e aprovuara “për disiplinimin e Kosovës” se “s’janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare” (Pika 6), se “me asnjërin e masave s’është mënjeluar asnjë e drejtë e pakicave kombëtare, por se është penguar që të drejtat e pakicave kombëtare të ngriten mbi korpusin e atyre të drejtave sipas të drejtës ndërkombëtare në një drejtë të re – në të drejtën në shtetin vetjak dhe të ndahen”. Vlerësohet se Jugosllavia “pa arsye suspendohet nga puna e organizatave ndërkombëtare dhe OSBE”, çka edhe si duket duhej të ishte funksioni i kësaj Deklarate.

3.2.7. Ligji mbi mjetet në pronësinë e Republikës së Serbisë¹⁸

Sipas Nenit 1 të këtij Ligji: “Mjetet në pronësinë e Republikës së Serbisë (në tekstin e mëtejshëm: mjetet në pronësinë shtetërore) janë:

- Pasuritë natyrore (toka, pyjet, ujërat, xehet dhe pasuritë tjera natyrore dhe të mirat në përdorimin e përgjithshëm (rrugët publike, parqet, sheshet, rrugët dhe të mirat tjera në përdorim e përgjithshëm), si edhe të interesit të përgjithshëm, për të cilat me ligj është caktuar se janë në pronësi shtetërore;
- Mjetet, të cilët, në pajtim me ligjin, janë fituar, gjegjësisht të cilët fitojnë;
- Organet shtetërore dhe organizatat;
- Organet dhe organizatat e njësive territoriale autonome dhe vetëqeverisjes lokale (në tekstin e mëtejshëm: organet e njësive territoriale);
- Shërbimet publike (ndërmarrjet publike, institucionet) dhe organizatat tjera, themeluesi i të cilave është Republika, gjegjësisht njësia territoriale;
- Sendet e ndërtuara, gjegjësisht të fituara me mjetet në pronësi shtetërore, përveç mjeteve që shfrytëzojnë organizatat e sigurimit të detyrueshëm social dhe mjeteve që

¹⁸ Fletore zyrtare e RS, Nr. 53, datë 28 Dhjetor 1993.

sipas ligjit të posaçëm janë në pronësinë e ndonjë organizate tjetër (Fletor zyrtare RS, 32/92);

- Mjetet, gjegjësisht të ardhurat e realizuara në bazë të investimeve të kapitalit shtetëror në ndërmarrje dhe organizata tjera;
- Mjetet për të cilët, në pajtim me ligjin, vërtetohet se janë pa pronarë;
- Mjetet tjera, të cilët, sipas ligjit, janë në pronësi shtetërore;

Sipas Nenit 8 të këtij Ligji “mbi fitimin dhe tjetërsimin e patundshmërive, të cilat shfrytëzojnë organet dhe organizatat shtetërore, organet e njësive territoriale dhe organizatat tjera nga Neni 1, Pika 2 e këtij Ligji, vendos Qeveria e Republikës së Serbisë”.

Me këtë Ligj është tjetërsuar edhe baza ekonomike e Krahinës së Kosovës. Por, ky Ligj ka shkarkuar edhe të gjitha njësitë territoriale në Serbi (Krahinën e Vojvodinës, Qytetin e Beogradit, komunat) dhe të gjitha sipërmarrjet punuese, institucionet, organizatat e tjerë, pasi që “në terrin e natës” pasuria shoqërore u transformua në pasuri shtetërore. Me këtë Ligj janë dëmtuar edhe punëtorët e punësuar, pasi ata me punën e tyre dhe ndarjet, me kursimin e pjesës së të ardhurave dhe të rrogave, kanë krijuar atë pasuri. U tregua normale se centralizimi i pasurisë ka shkaktuar centralizimin e pushtetit. S’ka humbur vetëm Kosova autonominë politike, forcën politike kanë humbur edhe të gjitha njësitë tjera territoriale, të cilat janë bërë bisht i pushtetit republikan. Duke u pajtuar me qërimin e hesapeve të Millosheviqit me Kosovën, ata dhanë pajtimin edhe heqjen dorë nga liria e tyre.

3.3.Llojet e veprave penale për të cilat akuzoheshin dhe dënoheshin shqiptarët gjatë viteve 1981–1999

Veprat penale të kryera në territorin e KSAK, në përgjithësi kishin një dallim substancial nga veprat penale të kryera në të gjithë pjesën tjetër të territorit të ish–Jugosllavisë, pavarësisht propagandës që përhapej për krimet e shqiptarëve ndaj serbëve. Edhe përse kishte akuza të herë pas hershme se shqiptarët si shumicë në territorin e KSAK, po ushtrojnë dhunë dhe krime ndaj popullatës serbe në Kosovë, me theks të veçantë se po dhunojnë femrat serbe, nga analiza e vetme serioze për çështjen e dhunimit të femrave serbe në Kosovë nga shqiptarët, i bërë nga një komitet i juristëve serbë dhe i ekspertëve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, më 1990, duke i analizuar të gjitha statistikat e dhunimeve dhe të përpjekjeve për dhunime të viteve ‘80, konstatuan:

- Shpeshtia e këtij krimi ishte shumë më e ulët në Kosovë se sa në pjesë të tjera të Jugosllavisë;
- Përderisa në Serbinë e ngushtë (pa dy Krahinat e Kosovës dhe Vojvodinës), mesatarja ishte 2.43 raste në vit në çdo 10 mijë banorë, shifra për Kosovën ishte 0.96;
- Në shumicën e rasteve në Kosovë (71%), sulmuesi dhe viktima ishin të po të njëjtit komb;
- Numri i përgjithshëm i rasteve, ku shqiptarët kishin bërë dhunime ose ishin përpjekur të dhunonin femra serbe, ishte vetëm 31, gjatë tërë periudhës prej vitit 1982 deri më 1989, një mesatare nga më pak se 5 raste në vit (Malcom, 2011, 424–425).


Shqiptarët në kryerjen e veprave penale të vjedhjes, vrasjes, trafikimit të lëndëve narkotike apo trafikimit të qenieve njerëzore dhe prostitucionit, ishin në minorancë në raport me pjesën tjetër të komuniteteve me të cilët bashkëjetonin në ish–Federatën Jugosllave. Shqiptarët kishin mbushur burgjet e ish–Jugosllavisë, për veprat penale të

karakterit politik, pavarësisht se në shumicën e rasteve ishin arrestuar dhe dënuar edhe masivisht pa një gjykim të drejtë, duke shkelur normat e procedurës gjyqësore, të garantuar me normimin pozitiv vendor dhe ndërkombëtar.

Në këtë kuadër, në territorin dhe periudhën objekt studimi, nga grumbullimi i të dhënave në fazën e hulumtimit, nëpërmjet qasjes në 239 aktgjykimet e të dënuarve, rezulton se në asnjë rast personi i dënuar në aktakuzë nuk ka qenë i akuzuar vetëm për një vepër penale, por minimumi për dy e më shumë vepra penale, nga pjesa e posaçme e ligjit penal të lidhura me njërin nga nenet e përgjegjësisë penale nga pjesa e përgjithshme e ligjit penal të RSFJ, e konkretisht, pasqyruar edhe në Grafikon Nr. 1, shqiptarët ishin akuzuar dhe dënuar në rastet më të shumta për veprat penale që kishin të bënin me veprimet e ndaluara nga Ligji Penal i RSFJ, 1977, Pjesa e Posaçme, Kreu XV – Veprat Penale Kundër Bazave të Rregullimit Shoqëror Socialist Vetëqeverisës dhe Sigurimit të RSFJ, e konkretisht:

- Neni 114 – Cenimi Kundër revolucionar i rregullimit Shoqëror;
- Neni 116 – Cenimi i Tërësisë Territoriale;
- Neni 123 – Dhuna nga motivet armiqësore kundër RSFJ;
- Neni 125 – Terrorizmi;
- Neni 131 – Pjesëmarrja në veprimtarinë armiqësore;
- Neni 132 – Dërgimi dhe Kalimi në Territorin e RSFJ të Grupeve të Armatosura, të Armëve, e të Municionit;
- Neni 133 – Propaganda Armiqësore;
- Neni 134 – Nxitja e Urrejtjes, të Përçarjes ose të Mos tolerancës Nacionale, Raciale ose Fetare;
- Neni 136 – Bashkimi për veprimtari armiqësore.

Grafiku Nr. 1: Numri i rasteve të aktakuzave me nenet përkatëse.




Po ashtu, në aktakuzat e të dënuarve, në shumicën e rasteve përveç dy e më shumë neneve, përkatësisht veprave penale në aktakuzë nga pjesa e posaçme për llojet e veprave penale të dyshuar, që i kanë kryer, janë bashkëlidhur edhe me veprat penale të përcaktuara nga Pjesa e Përgjithshme, Kreu II – Vepra Penale dhe Përgjegjësia Penale,

3. Bashkëpjesëmarrja në Veprën Penale Bashkë ekzekutimi, e konkretisht:

- Neni 22 – Bashkë ekzekutimi;
- Neni 24 – Të Ndihmuarit;
- Neni 26 – Përgjegjësia Penale dhe Dënueshmëria e Organizatorëve të Shoqatave Kriminale.

Grafiku Nr. 2: Nenet në bashkëlidhje.



Siç pasqyrohet edhe në grafikët më lart, institucionet jugosllave kishin marrë masat që në emër të ligjit, nëpërmjet proceseve gjyqësore, me apo pa bazë juridike, duke përfshirë dhe dhunën individuale dhe kolektive/familjare dhe torturën psiçike dhe fizike ndaj shqiptarëve të akuzuar për veprimtari armiqësore ndaj Jugosllavisë, të ruanin zonën e tyre të influencës në tokat shqiptare.

KAPITULLI IV – ANALIZA E REZULTATEVE

4.1.Diskutim dhe analizë mbi rezultatet e pyetësorit për personat e dënuar

4.1.1. Pyetësi për të dënuar dhe rezultatet e përgjigjeve

METODOLOGJIA:		
ANALIZA DESKRIPTIVE:		
DEMOGRAFIA:		
Gjinia e personave të anketuar:	Nr.	%
Femër	26	10.9
Mashkull	213	89.1
Totali	239	100

1	Në kohën kur jeni dënuar, cili ka qenë statusi juaj civil?	Nr.	%
	I/e martuar	103	43.1
	I/e pamartuar	125	52.3
	I/E ndare	4	1.7
	I/E Fejuar	7	2.9
	Totali	239	100

2	Në kohën kur jeni dënuar, cili ka qenë statusi i juaj i punësimit?	Nr.	%
	I/E punësuar	93	38.9
	I/E papunësuar	132	55.2
	Sezon	8	3.3
	I/E larguar	6	2.5
	Totali	239	100

3	Në kohën kur jeni dënuar, cila ka qenë gjendja juaj ekonomike?	Nr.	%
	Shumë e varfër	3	1.3
	E varfër	84	35.1
	E mesme	128	53.6
	E pasur	23	9.6
	Shumë e pasur	1	0.4
	Totali	239	100

4	Përshkrimi:	Min.	Max.	Mesatarja	Devijimi Standard
	Mosha sot:	41.0	87	59	8
	Mosha në kohën e dënimit:	15.0	64	29	8
	Kohëzgjatja e burgimit në vite:	0.0	20	5	4

5	A jeni dënuar në grup/a jeni gjykuar në grup?	Nr.	%
	Po	231	96.7
	Jo	8	3.3
	Totali	239	100

6	A jeni keqtrajtuar - torturuar nga organet e rendit dhe hetuesisë në paraburgim?	Nr.	%
	Pak	8	3.3
	Pjesërisht	47	19.7
	Shumë	112	46.9
	Plotësisht	72	30.1
	Totali	239	100

7	A jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit?	Nr.	%
	Pak	10	4.2
	Pjesërisht	42	17.6
	Shumë	158	66.1
	Plotësisht	29	12.1
	Totali	239	100

8	A janë keqtrajtuar të afërmit tuaj në kohën e arrestit tuaj?	Nr.	%
	Aspak	2	0.8
	Pak	56	23.4
	Pjesërisht	79	33.1
	Shumë	98	41.0
	Plotësisht	4	1.7
	Totali	239	100

9	A janë keqtrajtuar të afërmit tuaj gjatë kohës sa keni qëndruar në burg?	Nr.	%
	Aspak	8	3.3
	Pak	56	23.4
	Pjesërisht	132	55.2
	Shumë	43	18.0
	Totali	239	100

10	Nga çasti kur jeni arrestuar a ju kanë njoftuar organet e rendit se keni të drejtë për mbrojtje - për të pasur avokat?	Nr.	%
	Po	47	19.7
	Jo	192	80.3
	Totali	239	100

11	Gjatë kohës që keni qenë në hetuesi dhe paraburgim, a keni hasur në pengesa për të realizuar kontaktet me avokatin?	Nr.	%
	Pak	15	6.3
	Pjesërisht	57	23.8
	Shumë	149	62.3
	Plotësisht	18	7.5
	Totali	239	100

12	A është ushtruar torturë ndaj jush për të pranuar fajësinë?	Nr.	%
	Pjesërisht	7	2.9
	Shumë	114	47.7
	Plotësisht	118	49.4
Total		239	100

13	Gjatë kohës që keni qëndruar në paraburgim, sa herë keni pasur vizita nga organizatat joqeveritare vendore që kanë monitoruar liritë dhe të drejtat e njeriut?	Nr.	%
	Asnjëherë	145	60.7
	1 Vizitë	86	36.0
	Dy vizita	8	3.3
Totali		239	100

14	Gjatë kohës që keni qëndruar në burgim, sa herë keni pasur vizita nga organizatat joqeveritare vendore që kanë monitoruar liritë dhe të drejtat e njeriut?	Nr.	%
	Asnjëherë	62	25.9
	1 Vizitë	91	38.1
	Dy vizita	52	21.8
	3 Vizita	33	13.8
	4 Vizita	1	0.4
Totali		239	100

15	Gjatë kohës që keni qëndruar në paraburgim, sa herë keni pasur vizita nga organizatat joqeveritare ndërkombëtare që kanë monitoruar liritë dhe të drejtat e njeriut?	Nr.	%
	Asnjëherë	207	86.6
	1 Vizitë	30	12.6
	3 Vizita	2	0.8
Totali		239	100

16	Gjatë kohës që keni qëndruar në burgim, sa herë keni pasur vizita nga organizatat joqeveritare ndërkombëtare që kanë monitoruar liritë dhe të drejtat e njeriut?	Nr.	%
	Asnjëherë	142	59.4
	1 Vizitë	73	30.5
	Dy vizita	20	8.4
	3 Vizita	4	1.7
Totali		239	100

17	A mendoni se gjykimi juaj është mbështetur në prova dhe fakte, sa mendoni se ka pasur bazë juridike?	Nr.	%
	Aspak	92	38.5
	Pak	93	38.9
	Pjesërisht	49	20.5
	Shumë	4	1.7
	Plotësisht	1	0.4
Totali		239	100

18	Sa ka ndikuar dënimi (burgu) që ju keni vuajtur, në risocializimin dhe integrimin tuaj në shoqëri?	Nr.	%
	Aspak	184	77.0
	Pak	46	19.2
	Pjesërisht	8	3.3
	Shumë	1	0.4
	Totali	239	100

19	Sa ka ndikuar roli i organizatave joqeveritare të të drejtave të njeriut, lidhur me përmirësimin e kushteve në qendrat ku ju keni vuajtur dënimin me heqje lirie?	Nr.	%
	Aspak	170	71.1
	Pak	62	25.9
	Pjesërisht	6	2.5
	Shumë	1	0.4
	Totali	239	100

20	Sa keni pasur përkujdesje shëndetësore në qendrat e paraburgimit?	Nr.	%
	Aspak	125	52.3
	Pak	102	42.7
	Pjesërisht	12	5.0
	Totali	239	100

21	Sa keni pasur përkujdesje shëndetësore në qendrat e burgimit?	Nr.	%
	Aspak	5	2.1
	Pak	131	54.8
	Pjesërisht	82	34.3
	Shumë	21	8.8
	Totali	239	100

22	A keni pasur cenim të korrespondencës suaj gjatë kohës sa keni qëndruar në paraburgim?	Nr.	%
	Plotësisht	119	49.8
	Shumë	106	44.4
	Pjesërisht	13	5.4
	Pak	1	0.4
	Totali	239	100

23	A keni pasur cenim të korrespondencës suaj gjatë kohës sa keni qëndruar në burgim?	Nr.	%
	Plotësisht	54	22.6
	Shumë	120	50.2
	Pjesërisht	56	23.4
	Pak	9	3.8
	Totali	239	100

24	A mendoni se proceset gjyqësore dhe dënimet kundër jush kanë qenë procese politike me motive etnike?	Nr.	%
	Pak	2	0.8
	Pjesërisht	28	11.7
	Shumë	85	35.6
	Plotësisht	124	51.9
Totali		239	100

25	Në procesin gjyqësor kundër jush, a mendoni se janë zbatuar drejt ligjet në fuqi?	Nr.	%
	Plotësisht	1	0.4
	Pjesërisht	47	19.7
	Pak	91	38.1
	Aspak	100	41.8
Totali		239	100

26	A mendoni se vendimet e shqiptuara nga gjykatat kanë qenë meritore?	Nr.	%
	Pjesërisht	41	17.2
	Pak	88	36.8
	Aspak	110	46.0
Totali		239	100

27	Sipas mendimit tuaj, sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore?	Nr.	%
	Plotësisht	102	42.7
	Shumë	119	49.8
	Pjesërisht	13	5.4
	Pak	3	1.3
	Aspak	2	0.8
	Totali	239	100

4.1.1.1. ANALIZA E FAKTORËVE – KEQTRAJTIMI

	A jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit? Analiza gjinore		Gjinia		Totali
			Femër	Mashkull	
28	A jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit?	Pak	0%	100%	10
		Pjesërisht	5%	95%	42
		Shumë	10%	90%	158
		Plotësisht	28%	72%	29
	Totali		26	213	239

	A jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit? Analiza me moshë në dënim		Mosha ne denim					Total
			15-20	21-30	31-40	41-50	50+	
29	A jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit?	Pak	10%	90%	0%	0%	0%	10
		Pjesërisht	17%	45%	24%	14%	0%	42
		Shumë	14%	54%	23%	8%	1%	158
		Plotësisht	21%	38%	31%	10%	0%	29
	Totali		36	124	56	22	1	239

	A jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit? Analiza e punësimit në kohën e dënimit		Në kohën kur jeni dënuar, cili ka qenë statusi i juaj i punësimit?				Total
			I/E punësuar	I/E papunësuar	Sezonal	I/E larguar	
30	A jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit?	Pak	0%	90%	10%	0%	10
		Pjesërisht	45%	48%	7%	0%	42
		Shumë	39%	54%	3%	4%	158
		Plotësisht	41%	59%	0%	0%	29
	Totali		93	132	8	6	239

	A jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit? Analiza e statusit socio-ekonomik		Në kohën kur jeni dënuar, cila ka qenë gjendja juaj ekonomike?					Totali
			Shumë e varfër	E varfër	E mesme	E pasur	Shumë e pasur	
31	A jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit?	Pak	0%	50%	40%	10%	0%	10
		Pjesërisht	5%	40%	43%	12%	0%	42
		Shumë	1%	32%	58%	9%	1%	158
		Plotësisht	0%	41%	48%	10%	0%	29
	Totali		3	84	128	23	1	239

Në anketimin e bërë me 239 persona të dënuar, nga pyetësi i cili përmbante 25 pyetje drejtuar personave të hetuar, gjykuar dhe dënuar në Kosovë , në intervalin kohor 1981 deri në 1999, kemi arritur të pranojmë rezultate me interes për disertacionin doktoral.

Që në fillim mund të konstatoj se, kemi të bëjmë me një kategori të të anketuarve “*sui generis*”, nisur nga fakti se ndaj tyre janë aplikuar tre lloje të të drejtave pozitive të subjekteve të ndryshme juridike, pra, në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, karshi legjislacionit të saj të aplikueshëm penal, është aplikuar edhe legjislacioni penal i Federatës Jugosllave dhe legjislacioni penal i Republikës Socialiste të Serbisë. Pra, këtu kemi të bëj me një sistem hibrid penal, i cili në intervalin kohor 1981-1999, kalon nëpër disa faza të aplikimit.

Në fazën e parë, e cila përfshinë intervalin kohor 1981 deri në mars të vitit 1989, në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, përveç legjislacionit të KSAK-së, janë aplikuar edhe ligjet penale të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, dhe ligjet penale të Republikës Socialiste të Serbisë.

Në fazën e dytë, e cila përfshinë periudhën kohore pas marsit të vitit 1989, krijohet një situatë komplet tjetër politik dhe juridik. Suprimimi i dhunshëm që i bëhet Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1974, nga aparati i dhunshëm shtetëror i organeve të Federatës Jugosllave, dhe në mënyrë të veçantë nga organet e Republikës Socialiste të Serbisë, krijon një momentum të ri politik dhe juridik. Pra, de fakto dhe de jure, pushuan së vepruari në mënyrë të dhunshme ligjet e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, dhe aplikohen me dhunë vetëm ligjet e RSFJ-së dhe Republikës Socialiste të Serbisë. Pra, nisur nga fakti se personat e anketimit tonë, kanë kaluar dhe janë përballur me këto rrethana dhe faktorë, e bëjnë me interes rezultatin e këtij pyetësi për disertacionin e punimit tonë. Në diskutimin dhe analizimin e rezultateve të këtij pyetësi, do bëj përpjekje serioze që të analizoj faktorët objektivë dhe subjektivë të rezultateve të arritura në këtë pyetësor.

4.1.2. Gjinia e personave të dënuar

Nga 239 ish të dënuar të anketuar 89.1% janë meshkuj dhe 10.9% janë femra. Ky rezultat nuk pasqyron gjendjen e përgjithshme të personave të dënuar në intervalin kohor 1981-1999, por ky rezultat mund të justifikohet duke u bazuar në zhvillimet e ndodhura në KSA të Kosovës gjatë harkut kohor 1981-1999, sepse në rrafshin e ndjekjes dhe persekutimit që bëri pushteti shtetërorë i ish-Jugosllavisë femrën Shqiptare e kishte në fokus, sidomos për vepra penale të natyrës politike. Në pyetjen se a mendoni se proceset gjyqësore kundër jush kanë qenë procese politike me motive etnike? Në përgjigje të kësaj 99.2% deklarojnë se dënimet kundër tyre kanë qenë të motivuara dhe ndikuara nga elemente politikë dhe etnikë. Pra, kjo përgjigje e justifikon numrin e lartë gjinisë femërore në këtë rezultat, edhe nisur nga fakti se femra Shqiptare çdo herë ka qenë pjesë qenësore e përpjekjeve për liri dhe asnjëherë nuk është kursyer në përpjekje të tilla. Pra, duke qenë si e tillë, bëhet edhe cak sulmi dhe vetëm në këtë mënyrë justifikohet ky rezultat. Në të kundërtën, ky rezultat nuk do të kishte kuptim, sepse asnjëherë në rrethana të zakonshme në dënime që nuk kanë element politik dhe etnik, femra shqiptare nuk ka arritur në përmasa të tilla të jetë subjekt i konfliktit me ligjin.

Femra shqiptare dhe në veçanti ato të shkolluarat ishin target i ndjekjeve politike në procedurat e montuara penale. Rasti i tillë ishte edhe i mësueses Myibe Kabashi, nga Prizreni, mësuese, nënë e tre fëmijëve. Ajo më 21 Shkurt 1990, para shkollës së vet sheh se si polici prej njësisë së bashkuar të policisë me këmbë shkelmon të miturin në këmbë. Duke menduar se ky djalë është i shkollës së saj, u afrohet policëve që të pyes mbi problemin, andaj e pyet se “pse e rrah djalin”. Kjo pyetje te polici dhe organet e gjyqësisë shkaktoi sjellje të çuditshme. Në të vërtetë, në Kosovë, çdo fëmijë mbi 14 vjet ishte i detyruar të kishte lejen e njoftimi, ndërsa nën 14 vjeç librezën e nxënësve me

fotografi të vërtetuar me vulën e shkollës. Nga ky rast naiv, kundër Myibes u iniciua procedura për kundërvajtje, ndërsa pas kësaj edhe procedura penale. Me aktvendimin e gjykatësit për kundërvajtje në Prizren, Myibe shpallet përgjegjëse “se me datë 21.02.1990, afër orës 12:00, në afërsi të dyerve të hyrjes në Shkollën Fillore “Ortakoll” në Prizren, ka prishur rendin dhe qetësinë publike ashtu që ka penguar Policin Bajiq Miloradin në kryerjen e detyrës zyrtare, kur ai legjitimonte dy persona, duke i ‘u drejtuar “Pse prekni fëmijët tanë, marre ju qoftë”, ndërsa mandej vazhdon rrugën për në shkollë, andaj gjykatësi e dënon me 10 ditë burgim, ndërsa për kundërvajtjet tjera pezullon procedurën. Gjykatësi ka vlerësuar se s’ka prova për sjelljen nacionaliste të pandehurës, por “vetëm” prishje e rendit dhe qetësisë publike.¹⁹

Por, pasi që Myibe pati “guxim” t’i tërheq vërejtjen policit për shkak të rrahjes së fëmijës, çfarë në atë kohë ishte gjë e rëndomtë në sjelljet e policëve, zëvendësi i prokurorit publik i komunës, mbanë konferencën për shtyp ku, përveç tjerash, deklaroi: “S’është aspak për t’u çuditur pse në shkollën fillore ku kjo punëto e arsimit edukon gjeneratat e reja, bojkoti i mësimit dhe demonstratat e nxënësve të kombësisë shqiptare është më e shprehur... Përndryshe, në këtë kolektiv shkollor, ajo ka edhe një mendimtar, të cilët kanë nxitur fëmijët në demonstrata, ndërsa numri jo i vogël prej tyre ka kthyer librezat partiake”. Duke mos pritur përfundimin e procedurës për kundërvajtje, ndërsa për të mbuluar sjelljen joligjore të policit, prokuroria ngrit propozim akuzë, PP. Nr. 218/90, datë 16 Gusht 1990, me të cilin të pandehurën Myibe Kabashi akuzon “se me datë 21 shkurt 1990, në ora 11:50, para Shkollës Fillore “Ortakoll” ka ofenduar pjesëtarët e njësisë së bashkuar të milicisë²⁰ Milorad Bajiqin dhe Millan Antoniqin²¹ që

¹⁹ Aktvendimi Nr. 129/01–90, datë 18 Prill 1990.

²⁰ Pas marrëveshjes politike se problemi i Kosovës është “çështje e brendshme e Serbisë”, ndërsa për shkak të sigurisë së RSFJ, është marrë vendimi politik që për sigurinë në Kosovë të kujdeset Njësia e Bashkuar e Milicisë, e përbërë prej njësive të veçanta nga të gjitha republikat dhe nga Krahina e Vojvodinës. Sjellja e tyre ishte tejet rigoroze ndaj qytetarëve të kombësisë shqiptare. Në këtë drejtim prinin njësitet nga Serbia dhe Mali i Zi. Milicët shpesh legjitimonin qytetarët. Pasi që këta letërnjoftimin e

kryenin detyrën zyrtare të sigurisë publike në cilësi të personave zyrtarë, me fjalë: “Marre ju qoftë, pse keqtrajtoni djelmoshat tonë dhe u vini pas, ndërsa fëmijët tuaj i mbron”, “Marre ju qoftë, plehra serb...”, meqë kryen veprën penale të nxitjes së urrejtjes nacionale... nga Neni 134, al. 2, i LP RSFJ”.²²

Duke krahasuar akuzat nga procedura për kundërvajtje dhe nga kjo procedurë penale, shihet një neglizhencë dhe arrogancë në zhvillimin e procedurës. Prej fëmijëve, u krijuan “djelmoshat”, shtohet personi i ri, ndërsa dëshmitarja e drejtpërdrejtë dhe drejtori i shkollës, eliminohen si të papërshtatshëm për këtë procedurë. Ndërkohë, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, duke aprovuar ankesën, ndryshon aktvendimin e shkallës së parë dhe të pandehurën Myibe e dënon me gjobë²³. Ndërsa Gjykata Komunale në Prizren, me aktgjykim, Myiben e shpallë fajtores dhe e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej tre muaj²⁴. Gjykata e qarkut, në procedurë të apelit, duke shqyrtuar ankesën, me aktgjykim, shqipton gjykimin me kusht në dënimin e caktuar.²⁵

4.1.3. Statusi civil i personave të dënuar

Në përgjigjen e pyetjes, në kohën kur jeni dënuar, cili ka qenë statusi juaj civil? Nga 239 persona të anketuar nga ta 43.1% kanë deklaruar të martuar, 52.3% të pamartuar, 1.7% të ndarë dhe 2.9% të fejuar. Nëse shtroj pyetjen se për çfarë arsye dominon përqindja më e lartë e personave të dënuar të pamartuar, kjo justifikohet me faktin se një pjesë jo e vogël e tyre ishin studentë. Duke qenë i pakontestueshëm fakti se dy valë të mëdha arrestimesh ndodhën pikërisht pas demonstrative studentore të vitit 1981 dhe

mbanin në kuletë, atëherë kontrollonin edhe kuletat dhe çdo herë u merrnin paratë “pasi mbanin para kundër ligjit”. Shpesh këto para i përvetësonin dhe ndanin mes veti. Gjithashtu, hynin në dyqane, merrnin mallra dhe nuk pagunin. Më së shumti “kontrollonin” dyqanet e argjendarëve.

²¹ Si në rastin e Krasniqit, shtonin persona të tjerë që s’ishin të pranishëm në ngjarjen, vetëm e vetëm për të vërtetuar akuzat. Këtu Antoniqi zëvendëson Millosh Deniqin

²² Alineja 2 përndryshe ishte flakur me ndryshimet dhe plotësimet, çka dëshmon se prokurorët ishin të liruar “nga kokë dhembjet juridike”, por me rëndësi ishte “qëndrimi politik dhe orientimi ideologjik”.

²³ Aktvendim, II Nr. 2049/90, datë 7 Dhjetor 1990.

²⁴ Aktgjykim, P. Nr. 169/90, datë 21 Mars 1991.

²⁵ AP. 170/91, datë 21 Mars 1991.

1989, në mendimin tonë analitikë e nxjerrim këtë konstatim se shifra prej 52.3% e të pamartuarve rrjedhë nga këta faktorë. Pra ky rezultat mund të pasqyron relativisht një pasqyrë objektive të numrit të përgjithshëm, bile ne mendojmë se personat e privuar nga liria përbëjnë një numër edhe më të lartë të dënuarve politikë të pamartuar. Këtë e bazojmë në faktin se në të gjitha valët e arrestimeve në fokus të veçantë ishin gjeneratat e reja e në veçanti kategoritë universitare, siç ishin studentë, profesorë, mësues etj., duke mos e përjashtuar asnjë shtresë të shoqërisë.

4.1.4. Statusi i punësimit i personave të dënuar

Nga 239 persona të anketuar 38.9% janë deklaruar se kanë qenë të punësuar, 55.2% të papunësuar, 3.3% punësim sezonal, 2.5% të larguar. Konsideroj se është shumë me rëndësi të konstatoj faktin se personat e anketuar janë te periudhës kohore 1981 deri 1999, dhe me gjasë këtu kanë dominuar dy faktorë në këtë rezultat. Fakti se një numër goxha i madh i të anketuarve me gjasë në kohën e arrestimit kanë qenë studentë dhe faktori tjetër ka të bëjë me faktin se arrestimi i shumicës prej tyre ka ndodhur para dëbimit kolektiv nga puna, sepse pas vitit 1989 shumica absolute e shqiptarëve u përzunë nga vendet e tyre të punës dhe një rezultat i tillë nuk do të kishte justifikim. Andaj, po të ishte në fokus kategoria e dënuar pas marsit të vitit 1989, ky rezultatet do të përmysej dhe nuk do të kishte fare kuptim, sepse pas vitit të lartcekur populli Shqiptarë u dëbua dhunshëm nga puna, dhe atë në formë kolektive nga të gjitha institucionet shtetërore dhe publike.

4.1.5. Gjendja ekonomike e personave të dënuar

Nga personat e anketuar 1.3% kanë deklaruar gjendje shumë të varfër, 35.1% kanë deklaruar gjendje të varfër, 53.6 kanë deklaruar gjendje të mesme ekonomike, 9.6% kanë deklaruar gjendje të pasur ekonomike dhe 0.4% të anketuarve kanë deklaruar

gjendje shumë të pasur ekonomike. Referuar gjetjes së këtij rezultati ku mbi 36% të anketuarve të dënuar deklarojnë gjendje të varfër ekonomike, me të drejtë mund të konstatoj edhe ekzistencën e dukshme të pabarazisë sociale që ishte krijuar në mes të njësive të federatës, pra lufta dhe persekutimi zhvillohej në shumë fronte kundër Shqiptarëve. Persekutimi i Shqiptarëve zhvillohej në shumë fronte, si në atë politik, juridik dhe ekonomik. Por, nuk mund të anashkalohet fakti se të anketuarit e këtij pyetësoi përbëjnë edhe periudhën e vitit 1981 deri 1989 ku Shqiptarët ende ishin aktive në vendet e tyre të punës, sepse po të bëhej ndarja e të anketuarve në dy periudha kohore 1981 deri 1989, dhe pas 1989 deri 1999, ky rezultat nuk mund të qëndronte, sepse pas vitit 1990 të gjithë shqiptarët janë larguar nga vendet e tyre të punës. Periudha pas suspendimit me dhunë të subjektivitetit politik të Kosovës nga Serbia është periudha më e rëndë për nga pasojat socio-ekonomike të Kosovës në tërë historinë e zhvillimit të saj ekonomik e social. Ishin dy qëllime esenciale të veprimit të këtillë të shtetit serb në Kosovë: së pari eksploatimi maksimal i resurseve të saj dhe plaçkitja e pasurisë së krijuar dhe së dyti, varfërimi dhe degradimi material i familjeve shqiptare të Kosovës si metodë që drejtpërdrejt nxitë shpërnguljen dhe ndihmon veprimet e tjera për pastrimin etnik të Kosovës (Shatri H. 2001, 109).

Pas rrënimit të Autonomisë së KSA të Kosovës, në Kosovë në formë të dhunshme u larguan nga puna 120.000 punonjës shqiptarë (Rexhepi, 2001, 48). Pra, largimi i shqiptarëve nga puna, ishte bërë me qëllim të rrënimit të ekzistencës së tyre ekonomike, duke i qar në prag të mbijetesës, me synimin final që t'i detyron në të gjitha llojet e mjeteve dhe metodave për t'i shpërngulur nga Kosova.

4.1.6. Mosha e personave të dënuar dhe lartësia e dënimit

Kur bëhet fjalë për aplikimin e politikave penale në KSA të Kosovës gjatë viteve 1981–1999, pothuajse asnjë moshë nuk kishte përjashtim, sidomos kur kishim të bënim me

vepra penale me karakter politikë. Prej 239 personave të dënuar minimum i moshës në kohën e dënimit ka rezultuar 15 vjeç, maksimumi 64 vjeç, dhe mesatarja ka rezultuar në 29 vjeç. Nga burimet e konsultuara dhe nga të dhënat e ndryshme statistikore na rezulton se, pushteti shtetërorë e kishte targetuar moshën e re. Ndërsa lidhur me lartësinë e dënimit të të anketuarve na rezulton se, mesatarja e dënimit ishte 5 vite, ndërsa maksimumi ishte 20 vite burgim. Nga të dhënat e ndryshme dhe burimet që i referohen kësaj dukurie kemi hasur në shifra që tregojnë në vrazhdësi më të madhe të dënimeve, sa i përket moshës së re dhe lartësisë së dënimit. Sipas të dhënave të siguruara nga institucionet përkatëse të gjyqësisë, del se vetëm nga viti 1945 e deri më 1989 kundër shqiptarëve janë shqiptuar hiç më pak se 66.672 vjet e 7 muaj burg, ose 666 shekuj, 72 vjet e 7 muaj. Sipas të dhënave, mesatarja e dënimeve me burg që u janë shqiptuar të dënuarve politikë shqiptarë, del se ishte 7 vjet e 1 muaj. Pjesa dërmuese e të burgosurve politikë (21%) ishin persona të moshës 21-24 vjeçare. Gjyqet serbe gjatë proceseve nuk kursenin që në bankën e të akuzuarve të ulnin edhe fëmijët e moshës 14-15 vjeçe (3.9%), ndërsa të miturit e moshës 16-18 vjeçe përbënin 15.6%. (Keçmezi, 2009, 480).

Rastet kur të miturit shqiptarë akuzoheshin me akuza banale me motivacion politik, nuk ishin aspak të rralla në periudhën kohore 1981–1999, siç ishte rasti me të miturin, *Tom Çettaj* jetonte në fshatin shumë nacional Smaq, komuna e Prizrenit. Në një ditë të bukur pranverore vendosi “të tregohej” duke vrapuar në të katra mbi kalin në rrugicat plot pluhur të fshatit. Me shpejtësi arriti deri te qeshma e fshatit për t’i dhënë ujë, por i pakujdesshëm ndaj një vogëlushe serbe që mbushte ujë në qeshme. Ajo u frikësua, la enën dhe vrapoi kah shtëpia duke vajtuar. Toma vrapoi pas saj. Ajo ra e Toma, i frikësuar, largohet në shtëpi. Vogëlushja e përgjakur familjarëve u ankua në Tomën. Xhaxhai këshillon që rasti të paraqitet në polici, pasi Toma këtë e ka kryer “për arsye

politike”. Vet e merr përsipër që të lajmërojë policinë. Në qytet e këshillojnë që rasti të paraqet si “dhunim ndaj vogëlushes serbe prej shqiptarit irredentist”. Në atë kohë gazetat shkruanin mbi rastet e dhunimeve masive të serbeve në Kosovë. Patrulla policore menjëherë Tomën e privon nga liria, ndërsa rasti paraqitet si “dhunim”. Vogëlushja dërgohet në ekzaminim gjinekologjik. Akuza ishte se Toma në kalë erdhi në qeshmë për ti dhënë ujë kalit. Kur Toma vëren vogëlushen, i afrohet, ia çon fustanin, ia shqyen brekët dhe e dhunon. Edhe e rrahin, Toma në polici s’pranon veprën. Ai s’ka pasur kurrfarë përvoja seksuale. Ekzaminimi gjinekologjik mohon dhunimin dhe s’gjen asnjë shenjë të dhunës në organet seksuale, përveç gërvishtjeve në gjunjë dhe kofshë, duar dhe fytyrë, por këto lëndime prokuroria kualifikon si “dhunim në tentativë” nga Neni 74 i Ligjit Penal të Kosovës. Vogëlushen viktimë e përfaqësonte avokati më i njohur serb i Prizrenit dhe deputet popullor i Kuvendit Popullor të Serbisë, *Kërsta Tanasković*.

Në gjykim u tregua se akuza është “boshe” dhe pa asnjë provë. Për më tepër, rasti është keqpërdorur për qëllime politike dhe pa pëlqimin e prindërve të vogëlushes, të cilët flisnin se janë në marrëdhënie të mira me familjen e të miturit të akuzuar. Gjykatësi e liron të miturin nga akuza²⁶). Gjykata supreme e Kosovës e kthen lëndën në rigjykim²⁷). Gjykata e Qarkut sërish të miturin e liron nga akuza²⁸). Gjykata Supreme e Kosovës vërteton këtë aktgjykim²⁹), por kundër gjykatësit shqiptar, *Safet Gorani* zhvillohet fushata politike dhe kërkohet shkarkimi i tij. Kjo kërkesë realizohet tek më 1990 kur bëhet shkarkimi masiv i gjykatësve shqiptarë. Si arsye për shkarkimin e këtij gjykatësi ishte mu kjo lëndë penale. Autor i fushatës ishte avokati *Kërsta Tanasković*.

²⁶ PM Nr. 2/82, datë 4 Mars 1982, Prizren.

²⁷ APM Nr. 24/82, datë 13 Korrik 1982, Prishtinë.

²⁸ PM Nr. 2/82, datë 7 Janar 1983, Prizren.

²⁹ APM Nr. 3/83, datë 9 Qershor 1983, Prishtinë.

4.1.7. Gjykime dhe dënime në grup

Nga përgjigjja e 239 personave të anketuar ka rezultuar një përgjigje mjaft karakteristike. Shumica absolute kanë deklaruar se janë gjykuar dhe dënuar në grup, pra, 96.7% janë gjykuar dhe dënuar në grup dhe vetëm 3.3% janë gjykuar dhe dënuar në mënyrë individuale. Ky rezultat i kësaj përgjigje krijon shumë hapësirë dyshimi në sistemin e drejtësisë të asaj periudhe kohore. Pra, gjyqi në turma lë shumë për të dëshiruar dhe një rezultat i tillë e përforcon mendimin tonë se shumica e gjyqtarëve të asaj periudhe kohore ishin të ndikuar nga motive politike dhe si pasojë në masë të gjerë kërkonin fajësi kolektive. Ndjekjet e shqiptarëve për bindje politike nuk kishin të ndalur me theks të veçantë nga viti 1945 e këndej. Mirëpo, demonstratat e vitit 1981 shfrytëzohen si alibi për të hedhur në burg gati një të tretën e popullatës shqiptare që jetonte në ish-Jugosllavi. Një shpërthim gjithë popullor që ndodhi në vitin 81 dhe i cili u manifestu me demonstratat e marsit të këtij viti, ishte pasojë logjike e plotësimit të pjesërishëm të kërkesave të studentëve nga ngjarjet e vitit 1968, kur organet e Federatës Jugosllave dhe të Republikës së Serbisë, me dinakëri i kishin ikur kërkesës së tyre kryesore, për avancimin politiko-juridik të statusit të Kosovës në Republikë, në kuadër të Federatës. Dy ditë pas demonstratave të 26 Marsit 1981, pikërisht më 28 Mars, në kompetencat e Sekretariatit të punëve të brendshme të Kosovës, padrejtësisht ndërhyne Federata dhe Serbia, ndonëse me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974 Kosova e kishte “siguruar autonominë”. Me këtë rast u burgosën deri në 70 mijë shqiptarë me kundërvajtje dhe me burgim të rëndë deri më 15–20 vjet, ndërsa nëpër duar të policisë kaluan mbi 700 mijë veta. Nga kjo mund të konkludohet se çdo i treti shqiptar përjetoi “kontaktin” e afërt me policinë, qoftë nëpërmjet hetimeve, qoftë nëpërmjet para burgosjeve e dënimeve për vepra penale apo edhe për kundërvajtje të karakterit politik (Keçmezi, 2003, 39).

Kultura e aktakuzave dhe dënimeve politike ishte vazhdimësi e kultivuar për dekada në Kosovë. Por, intensifikimi i këtyre rasteve u shpërfaq në formë shumë më të vrazhde sidomos pas demonstrative të vitit 1981. Procesi i parë gjyqësor i grupit të studentëve që morën pjesë në demonstratat studentore të vitit 1981 për nga numri i të akuzuarve ishte i përbërë nga 21 persona. Sipas aktakuzës PP. nr. 58/81 datë 14 gusht 1981, këta persona dënohen me 238 vjet burg (Keçmezi, 2003, 67). Pra, kultura e akuzave dhe dënimeve në grupe vazhdoi nga viti 1981 deri në vitin 1999, derisa Kosova e fitoi lirinë. Kështu, kemi rastin e dënimit kolektiv të grupit të Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe 14 bashkëveprimtarëve të tjerë, të cilët i kishte gjykuar dhe dënuar në mungesë me burg të rëndë Gjykata e Qarkut në Prishtinë³⁰. Grupi i përbërë prej pesëmbëdhjetë të akuzuarve, ishin dënuar në mungesë dhe atë me dënime drakonike, në shumicën e rasteve me nga njëzet vjet burgim për secilin të akuzuar.

4.1.8. Trajtimi në hetuesi dhe paraburgim

Të gjeturat e rezultatit për trajtimin e të dënuarve në fazën e hetimit dhe paraburgimit janë mjaftë alarmante. Nga 239 të dënuar, në pyetjen a jeni keqtrajtuar-torturuar nga organet e rendit dhe hetuesisë në paraburgim? Prej tyre 3.3% janë deklaruar se kanë keqtrajtuar pak, 19.7% janë deklaruar se janë keqtrajtuar pjesërisht, 46.9% janë deklaruar se janë keqtrajtuar dhe torturuar shumë dhe 30.1% janë deklaruar se janë torturuar plotësisht. Pas një analize të këtij rezultati, mund të konstatoj se këtu kemi të bëjmë me një dhunim sistematik të lirive dhe të drejtave të njeriut nga një aparat shtetëror kundër një nacionaliteti të caktuar. Këtë rezultat deri në njëfarë shkalle e vërteton edhe rezultati që ka rrjedhur nga pyetjet e gjyqtarëve të anketuar. Në pyetjen drejtuar gjyqtarëve se, a keni pasur ankesa nga të akuzuarit me pretendimin se janë keqtrajtuar dhe torturuar nga policët dhe hetuesit gjatë fazës së hetuesisë? Prej 33

³⁰ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.37/97, datë 23 Korrik 1997.

gjyqtarëve të anketuar janë përgjigjur kështu, 3.0% plotësisht, 51% shumë, 27.3% pjesërisht, 12.1% dhe 6.1% aspak. Nëse nisemi nga fakti se tortura ishte e ndalur me ligjet e aplikueshme penale në periudhën 1981–1999, dhe me akte ndërkombëtare, aplikimi i torturës në përmasa të tilla nuk mund të konsiderohet se ishte asgjë më pak se një instrument në duart e pushtetit për të ushtruar agresion kundër një etnie të caktuar që në këtë rast ishte populli Shqiptar i Kosovës. Dhuna dhe terrori masiv i pushtetit serb, si dhe proceset penale politike ndaj mijëra shqiptarëve erdhën në shprehje sidomos pas viteve 1990, ku si pretekst u morën demonstratat dhe manifestimet politike të këtyre viteve, ku populli shqiptar, përdorë kurrfarë dhune, shtruan kërkesën që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës në ish Federatën Jugosllave. Ndaj këtyre kërkesave legale dhe legjitime, regjimi i Serbisë dhe Jugosllavisë reagoi me dhunë të paprecedentë. Nga dhuna që ushtruan policët, hetuesit dhe udbashët në qendra të ndalimit dhe burgimit, shumë persona e pësuan rëndë, disa prej tyre as nuk arritën të dalin gjallë. Me qindra kanë mbetur invalidë të përjetshëm, ndërsa me qindra familje janë bërë qytetarë inferior, sepse përmes torturës shpirtërore mbi ta, bëheshin edhe trajtime makabre deri në shkallë vdekjeje ose të gjymtimit fizik. Udbashët udhëhiqeshin e njohur “Qëllimi e arsyeton mjetin”, (Kekezi & Hida, 1990, 139).

Vrazhdësia e sjelljes së pushtetit ushtarako-policor e Federatës dhe Serbisë kundër popullit shumicë në Kosovë, pas vitit 1981-deri 1999, nuk i kishte njohur përmasat e dhunës së tillë, që prej Luftës së Dytë Botërore. Veprimet dhe sjelljet gjenocidiale, në mënyrë sistematike vihen në zbatim pas demonstrative të vitit 1981 kur nxënësve, studentëve dhe arsimtarëve shqiptarë u shkaktohen plagë të rënda fizike dhe psikike, kur nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë hedhen të gjallë nga ndërtesat e stacioneve të policisë. Kështu më 1982 nga kati IV i Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Ferizaj hidhet nxënësi i klasës IV të Shkollës “N. Tesla” në Ferizaj, Afrim Abazi. Në vitin 1987–1989

në Kosovë organizohet nga helmimi serb helmimi masiv i nxënësve dhe i qytetarëve shqiptarë me helmin e luftës SARIN. Me këtë helm janë helmuar 7.421 fëmijë, nxënës dhe qytetarë shqiptarë. Nga pasojat e helmimit kanë vdekur 3 persona. Sjelljet dhe veprimet gjenocidare serbe morën karakter shqetësues pas vitit 1990 kur filloi vrasja e nxënësve dhe arsimtarëve shqiptarë në mënyrë të sinkronizuar dhe të programuar. Në këtë periudhë në zyrat e policisë vriten drejtori Haki Pavataj, Mikel Marku (avokat), Tahir Berisha etj. Po në këtë periudhë filloi vrasja e organizuar e prindërve shqiptarë: Bajram Hysenjat, Muharrem Hysenajt dhe Hasan Hysenajt nga Uça e Istogut. Mentaliteti gjenocidar serb u manifestua me anë të shkeljes së dinjitetit kombëtar të shqiptarëve kur në trupat e mbytur të shqiptarëve vizatoheshin me bajoneta kryqet ortodokse serbe dhe katër C si simbol të tyre të çmendurisë. P.sh. në kufomën e Arin Currit nga Deçani, të cilit pas keqtrajtimit të rëndë fizik, në gjoks dhe duar i ishin vizatuar me thikë kryqet serbe dhe pocilët (Shatri & Hyseni, 2001, 63).

4.1.9. Trajtimi i personave në burgim

Nisur nga analizimi i situatës nëpër të cilën kanë kaluar personat e paraburgosur, pothuajse kemi situatë shumë ngjashme edhe në institucionin e burgimit. Këtë e konstatim e bazojë në përgjigjën e 239 personave të burgosur të cilët kanë arritur t'i mbijetojnë torturës së burgimit. Në pyetjen a jeni keqtrajtuar-torturuar gjatë kohës së burgimit, përgjigjja e tyre ishte, 4.2% pak, 17.6% pjesërisht, 66.1% shumë, 12.1% plotësisht. Ky rezultat tregon një kulturë të sjelljes institucionale të periudhës kohore 1981–1999. Derisa bota bashkëkohore në qendrat e paraburgimit dhe burgimit investon mjete dhe metoda në funksion të së ardhmes që personat e dënuar pas vuajtjes dënimit të kthehen si persona të shëndosh të dobishëm për shoqërinë, pra të ri-socializohen dhe ri-integrohen në shoqëri. Mjetet dhe metodat e përdorura në qendrat e burgimit në periudhën kohore 1981–1999, kanë qenë në funksion të shkatërrimit të qenies njerëzore

të burgosur, dhe një agresion shtetëror kundër një etnie të caktuar. Pushtuesi serb ndër shumë strategjitë që përdori për të dëmtuar popullin shqiptar të Kosovës, ishte edhe keqtrajtimi, tortura, fizike dhe psikike që u shkaktoi të burgosurve politikë shqiptar dhe familjarëve të tyre.

Duke filluar nga Sllovenia, Stara Gradishka, Zenica, Sremska Mitrovica, Beogradi, Nishi, Pozharevci, Idrizova e shumë vende tjera në të gjithë ish-Jugosllavinë, shqiptarët, të dënuar politikë burgun e vuanin në burgjet më famëkeqe dhe më të largëta. Kjo ishte forma më barbare që ndikonte edhe te të burgosurit edhe te familjarët e tyre, si në aspektin e shpenzimeve material, ashtu edhe në atë psikik dhe fizik të burgosurve dhe vizitorëve. Ndodhte që, mu për shkak të largësisë të burgosurin me mua (ndonjëher edhe me vite) të mos e vizitonte askush. Binak Ulajn, për pesë vjet sa kishte vuajtur burgim vetëm njëherë e kishte vizituar nëna plakë (Deklaratë, Binak Ulaj; 1993).

Të burgosurit politikë shqiptarë gjatë këtij harku kohor 81/99 i kanë përjetuar të gjitha format e krimit, duke filluar, nga fyerjet, nënçmimi, cenimi i integritetit psiko-fizik, dhe deri të humbja e jetës në qelitë e burgimit. Të burgosurit shqiptarë, sapo vinin nëpër kazermat jugosllave, menjëherë i nënshtroheshin trajtimit të mbyllur, fare nuk kalonin në sektorin e pranimi (karantina). Kështu shkelej neni 97 i LESP. E tërë kjo kishte për qëllim presionin e vazhdueshëm kundër bindjeve të tyre politike. Ndodhte që i burgosuri të ishte i sëmurë rëndë, por kjo nuk luante rol, dhe ai në këtë gjendje shëndetësore mbahej në vetmi, ku mungonte ndihma mjekësore. Si rast tipik i këtij presioni është ai i Ibrahim Krasniqit, të cilin pas një kohe nga burgu e nxorën të vdekur. Të ndjerin deri në fund e kishin mbajtur në këtë trajtim pa i ofruar as ndihmën më të vogël mjekësore. Akti tjetër i keqtrajtimit të të burgosurve shqiptarë ishte vendosja e tyre nëpër qelitë e burgut me persona problematikë, që në të shumtën e rasteve ishin të sëmurë patologjikë, kriminel dhe vegla të personelit të burgut. (Keçmezi, 2003, 51–52).

Dhuna dhe presioni që ushtrohej kundër të burgosurve politikë shqiptarë, ishte e sinkronizuar në mënyrë sistematike nga aparati shtetëror i organeve të Federatës dhe Serbisë. Kjo dhunë ushtrohej në shumë dimensione duke filluar nga transferimi i të burgosurve politikë jashtë Kosovës, trajtimi i mbyllur, mohimi i të drejtës për tu ngritur në profesion, punët e rënda nëpër burgje që ndaheshin për të burgosurit shqiptarë politikë, mohimi për ajrosje të qelisë, aplikimi masiv i dënimeve në vetmi, distancimi i familjes dhe shoqërisë nga të burgosurit politikë, tortura e drejtpërdrejt fizike dhe psike, deri në kushtet e përshtatshme për “vetëvrasje”. Pra, mozaiku i akteve të terrorit që ushtronte pushteti shtetëror kundër të burgosurve politikë shqiptarë, nuk ka të njohur pas Luftës së Dytë Botërore.

4.1.10. Trajtimi i familjarëve të personave që kanë qëndruar në paraburgim dhe burgim

Nga analiza e përgjigjes së 239 personave të anketuar në pyetjen se, a janë keqtrajtuar të afërmit tuaj në kohën e arrestimit tuaj? Përgjigja e dhënë në këtë pyetje tregon se organet e rendit-hetuesisë dhe gjyqësorit të periudhës 1981-1999, fajin nuk e shohin si kategori individuale, por si kategori kolektive, këtë më së miri e dëshmon rezultati i këtij pyetësi. Nga pyetja e lartë cekur se a janë keqtrajtuar të afërmit tuaj në kohën e arrestimit tuaj, 0.8% janë përgjigjur aspak, 23.4% pak, 33.1% pjesërisht, 41.0% shumë dhe 1.7% plotësisht. Nëse i referohemi këtij rezultati mund të konstatojmë me objektivitet se këtu nuk kemi të bëjmë me procese të rregullta gjyqësore, në funksion të së drejtës, por me persekutime të mirë organizuara me qëllim të frikësimit të masave për objektiva të caktuara politike. Pra, një politikë penale e aplikuar si kjo, nuk ka bazë në frymën e ligjit, por baza e saj është forca dhe mundësia, e cila shfrytëzohet në funksion të një qëllimi të caktuar politikë, pra e drejta bëhet instrument i politikës.

Duke i bërë një analizë qoftë edhe sipërfaqësore këtij rezultati e vëren se këtu kemi të bëjmë një sjellje të mirë organizuar të organeve të rendit, hetuesisë dhe gjyqësisë, në drejtim të shkeljeve dhe lirive të të drejtave të njeriut, pra duke atakuar rëndë edhe personat të cilët nuk janë subjekt i shkeljes së ligjit, por janë të afërm me personat të cilët përballen me procedura gjyqësore. Nga 239 persona të pyetur se a janë keqtrajtuar-maltretuar personat e afërm të juaj derisa ju keni qëndruar në vuajtje të dënimit, përgjigja është, 3.3% aspak, 23.4 % pak, 55.2 % pjesërisht, 18.0% shumë. Nëse iu referohemi shifrave të personave të afërm të keqtrajtuar, derisa personat e privuar nga liria kanë qëndruar në paraburgim dhe burgim, ka një dallim me nuancë të lehtë drejtë përmirësimit apo zbritjes së lakores të personave të afërm të keqtrajtuar. Por, kjo sipas mendimit tonë analitik e ka një shpjegim mjaftueshëm të besueshëm, nisur nga fakti se paraburgosurit në fazën e hetuesisë i janë nënshtruar një torture dhe presioni për të pranuar fajësinë, metodë e cila është aplikuar si formë presioni edhe kundër familjarëve të tyre. Pra, sipas rezultatit të përgjigjeve të këtij pyetësi rezulton se, pozita e personave të hetuar, paraburgosur dhe e familjarëve të tyre rezulton të jetë më e vështirësuar, me përjashtim të rasteve të caktuara edhe gjatë fazës së burgimit. Gama e vuajtjeve dhe e maltretimeve të familjarëve të burgosur politikë fillonte nga çasti i arrestimit, paraburgimit, burgimit, dhe vazhdonte në forma të ndryshme të persekutimit edhe pas vuajtjes së dënimit, duke përfshirë forma të ndryshme linçimi dhe diferencimi në shoqëri. Vizitorët ishin të detyruar të flisnin në gjuhën serbe, kurse shumë nga ta nuk e dinin këtë gjuhë, andaj detyroheshin që të ktheheshin pa e parë të burgosurin. Rasti më flagrant ishte kur Adem Demaçit (i njohur si Mandela i Ballkanit) i kishte shkuar për vizitë nëna. Ajo për shkak se nuk e dinte gjuhën serbe ishte detyruar të kthehej në shtëpi pa e parë kurrë të birin. Pas një kohe të shkurtër kishte vdekur, duke i thënë të bijës-Ajshes “ç’më vyen më jeta kur nuk më lanë ta shoh djalin tim. Rasti tjetër i vajzës së vogël të burgosurit politik Hydajet Hysenit, e cila e kishte vizituar babanë në burgun e

Beogradit. Këtyre u ishte lejuar vizita, por vetëm përmes grilave, kur ai kishte qenë në gjendje shumë të rëndë shëndetësore, si pasojë e torturave. Ai deklaroi se fare nuk i kujtohet të ketë pasur vizitë. Vajza e vogël ishte tmerruar. I burgosuri më vonë kishte bërë dhe kërkesë “që vizitat”, së paku kur vijnë fëmijët, të bëheshin në kushte normale, në dhomën e vizitave të rregullta. Mirëpo kërkesa nuk ishte miratuar (Keçmezi, 2003, 51). Qëllimi i maltretimeve të tilla kishte për objektiv final, shkatërrimin, thyerjen fizike dhe psikike, jo vetëm për të burgosurit, por edhe për familjarët e tyre. Këto metoda dhune dhe represioni sistematik kundër të burgosurve politikë shqiptarë, dhe familjarëve të tyre, pushteti shtetërorë i Federatës jugosllave dhe i Serbisë, i ushtroi afër gjysmë shekulli në Kosovë. Pra, ndëshkimi kolektiv dhe pretendimi për gjetjen e fajësisë kolektive, ishin karakteristika të theksuara të sistemit gjyqësor në KSA të Kosovës në harkun kohor 1981–1999.

4.1.11. Shkelja e të drejtës në mbrojtje gjatë fazës së arrestimit, hetimit dhe paraburgimit

Personat e anketuar në pyetjen se, nga çasti kur jeni arrestuar a ju kanë njoftuar organet e rendit se keni të drejtë për mbrojtje-për të pasur avokat? Prej 239 personave të anketuar të pyetur, 19.7% deklarohen se janë njoftuar, përderisa 80.3 % deklarohen se nuk janë njoftuar fare. Kjo është një shkelje elementare dhe substanciale në procedure penale dhe cenon rëndë integritetin e një gjykimi të drejtë dhe objektiv.

Organet e ndjekjes dhe gjyqësisë me të njëjtin ritëm vazhdojnë cenimin e të drejtave të njohura me ligj personave në fazën e hetuesisë dhe në paraburgim. Nga 239 persona të pyetur a kanë hasur në pengesa për kontakt me avokat në fazën e hetuesisë dhe paraburgimit, 6.3% janë përgjigjur pak, 23.8% janë përgjigjur pjesërisht, 62.3% janë përgjigjur shumë, 7.5% janë përgjigjur plotësisht. Pra, këtu kemi të bëjmë me një mohim sistematik të së drejtës në mbrojtje, nëpër të gjitha fazat e procedurës penale. E

drejtë kjo e garantuar edhe me ligjin e procedurës penale të ish-Jugosllavisë, saktësisht në nenin 11 të atij ligji i cili parasheh: 1) I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën profesionale të mbrojtësit të cilin e zgjedh vetë nga radha e avokatëve. 2) Në qoftë se i pandehuri nuk e angazhon vetë mbrojtësin kur kjo gjë është e caktuar me këtë ligj. 3) Për të pandehurin duhet të sigurohet mjaft kohë për përgatitjen e mbrojtjes (Ligji Mbi Procedurën Penale; 1977, Neni 11).

Mohimi i të drejtës së garantuar me ligj për kontakt me avokatin, për të drejtën për të ushtruar mbrojtje efektive në të gjitha fazat e procedurës penale, është shkelje flagrante e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara në procedurë penale, dhe me një shkelje të tillë as që mund të bëhet fjalë për një proces transparent. Rasti i të riut, Nuri Pulaj, është shembull negativ që pasqyron politikën penale të aplikuar në Kosovë, duke iu kufizuar të drejtën në mbrojtje personave të privuar nga liria.

Rasti i *Nuri Pulaj*³¹. – i mituri *Nuri Pulaj*, nga fshati Vërmicë, komuna e Prizrenit, i lindur më 12 Prill 1965, nxënës i shkollës së mesme, arrestohet më 25 Mars 1982, për shkak të shkruarjes së parullave: “Kosova Republikë”, “Rroftë Adem Demaçi” dhe “Rroftë Republika e Kosovës” (26 Qershor 1981); “Pa liri s’ka barazi”, “Rroftë Republika e Kosovës”, “Populli s’ka bukë”, “Pa republikë s’ka barazi”, “VSHLP”, “Vdekje shovinizmit, liri popullit” dhe “Spiunët paguajnë me gjak” (23 Shtator 1981). “Kosova Republikë”, “Rroftë Enver Hoxha” dhe “Fshatarët lypin bukë” (12 Shkurt 1982). Në kohën e kryerjes së veprës ishte 15 vjeç e 2 muaj dhe 14 ditë. Në

³¹ Lënda e të miturit PM 17/82. Propozimi për dënim i PPQ Prizren, PPM. 27/82, datë 8 Korrik 1982. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, PM 17/82, datë 14 Korrik 1982 me të cilën i mituri Nuri Pulaj dënohet me burgim në kohëzgjatje prej një viti. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i Kosovës, APM. 31/82, datë 9 Nëntor 1982, refuzon ankesën e mbrojtësit. Aktgjykimi i Gjykatës Federative, PSHF. 8/83, datë 15 Mars 1983, i prish aktgjykimet gjyquese dhe lëndën i’a kthen Gjykatës së Qarkut në Prizren në rigjykim. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, PM. 17/82, datë 26 Maj 1983, sërish vendos njësoj. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i Kosovës, APM 15/83, datë 24 Qershor 1984, sërish refuzon ankesën e mbrojtësit. *I akuzuari veç e ka vuajtur dënimin*. Aktgjykimi i Gjykatës Federative, PSHF. 10/85, datë 23 Prill 1984, sërish prish aktgjykimet dënuuese dhe lëndën e kthen në Gjykatë të Qarkut në Prizren në rigjykim. Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, PM 24/85, datë 3 Korrik 1985, pezullon procedurën penale kundër Nuri Pulaj. Gjykatësi që dënoi Nuri Pulajn ishte *Safet Gorani*.

procedurën për kundërvajtje është dënuar me 15 ditë burg. Gjatë vuajtjes së dënimit, pa dijeni dhe leje të gjykatësit për kundërvajtje, nga organet e sigurimit merret në pyetje. Me dorë të vetë ka shkruar dhe nënshkruar deklaratën sipas diktatit të personave zyrtar të Shërbimit Shtetëror. Pas vuajtjes së dënimit, me 8 Prill 1982, fillon procedura penale për vepër të propagandës armiqësore nga Neni 133 i LP të RSFJ. Gjykatësi për të mitur në Gjykatën e Qarkut në Prizren, Safet Gorani, hetimet i beson Shërbimit të Sigurimit Shtetëror. Hetimet reduktohen vetëm në marrjen në pyetje të të miturit. Kolegji gjyqësor dy herë vazhdon paraburgimin me nga një muaj, “pasi Shërbimi i Sigurimit Shtetëror ende s’ka marrë në pyetje të miturin”.

Nuk ishin aspak të rralla rastet kur një person ndiqej penalisht në mënyrë sistematike. Një fat të tillë e kishte edhe i riu, Nuri Pulaj, i cili në vitin 1981 dënohet në procedurë kundërvajtëse dhe penale, për të vazhduar pastaj ndjekja edhe në vitin 1989. Nuri Pulaj, student i Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë, për shkak të veprës penale propagandë armiqësore nga Neni 133 të Kodit Penal të RFSJ, në këtë proces gjyqësor i cenohet dhe i kufizohet e drejta për mbrojtje nga avokati³² edhe pse me Ligjin Federativ Për Procedurën Penale në Jugosllavi, lejohet e drejta e ankesës³³.

4.1.12. Ushtrimi i torturës nga organet e rendit dhe hetuesisë për të pranuar fajësinë

Lidhur me torturën është shkruar e folur me shekuj dhe në etapa të ndryshme të historisë janë nda mendime të ndryshme për aplikimin e torturës si mjetë dhe metodë për pranimin e fajësisë. Por, në të drejtën penale bashkëkohore të gjitha sistemet demokratike bashkëkohore ndajnë mendimin se tortura është vepër penale dhe i tillë është inkorporuar në legjislacionin penal të kohës së sotme. Edhe në legjislacionin e

³² Aktvendimi Hep. Nr. 10/89 datë 16 Janar 1989.

³³ LPP, 1. Procedura me Mjetet Juridike, Kreu XXIII – Mjetet e Zakonshme Juridike, 4. – Ankimi Kundër Akvendimit, Neni 394.

aplikueshëm penal në Kosovë gjatë viteve 1981–1999 në aspektin formal tortura ishte e ndaluar si mjet dhe metodë për pranimin e fajësisë. Është e ndaluar dhe e dënueshme nga i pandehuri ose personi tjetër i cili merr pjesë në procedurë të nxirret me shtrëngesë pohimi, respektivisht çfarëdo deklarate tjetër (Ligji mbi Procedurës Penale;1977, Neni 10).

Praktika e tregon të kundërtën e saj. Prej 239 personave të anketuar dhe të pyetur se, a është ushtruar torturë kundër juve për të pranuar fajësinë, përgjigja është, 2.9% pjesërisht, 47.7% shumë dhe 49.4 % plotësisht. Ky rezultat paraqet një pasqyrë serioze të aplikimit të politikës diskriminuese penale kundër personave të privuar nga liria. Në situatë kur pranimi i fajësisë bëhet nën ushtrimin e presionit dhe torturës, nuk mund të flasim për një procedurë gjyqësore me kredibilitet. Pra, në situatë si këto, sistemi drejtësisë vihet në funksion të politikës dhe instrumentalizohet prej saj, duke targetuar për ndjekje dhe persekutim politikë të një kategorie të caktuar, etnike në këtë rast. Nga gjetjet e rezultatit të këtij pyetësi, rezulton se, tortura e ushtruar nga organet e ndjekjes është përdorur si mjet dhe metodë për t'i detyruar personat në procedure penale ta pranojnë fajësinë. Se dyshimi pa arsye, marrja në pyetje dhe rrahja e shqiptarëve është varianti më i butë i dhunës policore tregon rasti i Zeqir Ademit nga Brovina e Gjakovës i cili si i burgosur u rrah dhe torturua për vdekje. Në raportin mbi shkaqet e vdekjes së të burgosurit (numri i amzës 1970) të cilin e nënshkroi doktoreshë Suzana Razhoviq në Institutin e mjekësisë ligjore në Prishtinë, thuhet se vdekja filloi më 16 Shkurt 1993 si pasojë e shokut të shkaktuar nga numri i madh i hematomave prej gjakut nëpër trup (KMLDNJ, 2010, 15).

Nga viti 1981–1999, tortura e ushtruar nga aparati shtetëror kundër mbi 700 mijë qytetarëve shqiptarë të Kosovës, ishte mirë e sinkronizuar dhe programuar nga të gjithë segmentet e pushtetit shtetëror të organeve të Federatës dhe të Serbisë.

4.1.13. Vizitat e organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare në institucionet e paraburgimit dhe burgimit

Roli i organizatave joqeveritare është shumë i rëndësishëm në monitorimin dhe korrektimin e pushtetit gjyqësor dhe më gjerë, dhe në veçanti në vëzhgimin e gjendjes të personave të privuar nga liria. Ky rol i këtyre mekanizmave bëhet edhe më i rëndësishëm, sidomos kur kemi të bëjmë me sisteme totalitare, ngjashëm siç ishte sistemi në Kosovë gjatë kësaj periudhe kohore në mënyrë më specifike pas Marsit 1981 deri në 1999. Nga 239 persona të anketuar të pyetur sa herë keni pas vizita nga organizatat joqeveritare vendore që kanë monitoruar Liritë dhe të Drejtat e Njeriut? Përgjigja ishte, 60.7% asnjëherë, 36.0% e kanë deklaruar një vizitë dhe vetëm 3.3% kanë deklaruar dy vizita. Nga ky rezultat mund të nxjerrim dy konkluzione, e para këtu kemi të bëjë me një sistem i cili lë shumë për të dëshiruar sa i përket nivelit të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe vetë mungesa dhe mos mundësia e këtyre vizitave ka dhënë indice se këtu kemi të bëjmë me një gjendje të rënduar të personave të privuar nga liria.

Kontributi i organizatave joqeveritare është mjaft i çmuar në drejtim të monitorimit, vëzhgimit dhe pasqyrimin të gjendjes dhe kushteve të personave të cilat janë në vuajtje të dënimit. Ky kontribut bëhet duke dhënë vërejtje, rekomandime dhe sugjerime drejtë përmirësimit të kushteve të personave të privuar nga liria. Në analizën e rezultatit të gjetjeve të këtij pyetësi, kemi një dallim me nuanca të lehta sa i përket rolit të këtyre organizatave dhe numrit të vizitave të tyre në qendra e burgimit. Pra, për dallim prej paraburgimit në institucionin e burgimit vizitat rezultojnë me të shpeshta. Nga 239% anketuar ish të burgosur 25.9% janë deklaruar se nuk janë vizituar asnjëherë nga organizata joqeveritare, 38.1% janë deklaruar se kanë pranuar një vizitë, 21.8% janë deklaruar se kanë pranuar dy vizita, 13.8% janë deklaruar se kanë pranuar tri vizita dhe

0.4% janë deklaruar se kanë pranuar katër vizita. Dallimin numerik në mes të paraburgimit dhe burgimit këtu e bënë elementi kohë, sepse vetë fakti se personat e burgosur kanë qëndruar më gjatë në institucionin e burgimit edhe kanë pasur mundësi më shumë të pranojnë vizita. Një element tjetër që vlen për t'u theksuar është se organet e ndjekjes kanë hezituuar të pranojnë vizita në kohën e hetuesisë dhe paraburgimit, duke mos dashur të pasqyrojnë gjendjen e vërtetë nëpër të cilën kanë kaluar personat e privuar nga liria.

Roli i organizatave ndërkombëtare është shumëfish më i rëndësishëm se i atyre vendore sa i përket monitorimit dhe respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në qendrat paraburgimit. Ky rol bëhet shumë herë më i rëndësishëm kur kemi të bëjmë me persona të privuar nga liria, sepse prestigji dhe mundësia e publicitetit që kanë këto mekanizma ndërkombëtar për t'i pasqyruar shkeljet e lirive dhe të drejtat e njeriut në qendrat e paraburgimit janë shumëfish më të mëdha. Rezultati që ka rrjedhë nga ky pyetësor sa i përket numrit të vizitave në qendrat e burgimit nga organizatat vendore dhe ato ndërkombëtare nuk bën ndonjë dallim të madh numerik. Nga 239 persona të anketuar 86.6% kanë deklaruar se nuk janë vizituar asnjëherë nga organizatat ndërkombëtare, 12.6% kanë deklaruar se kanë pranuar një vizitë dhe 0.8% kanë pranuar se kanë pranuar tri vizita.

Sa i përket vizitave të organizatave ndërkombëtare në institucionin e burgimit, këtu kemi një rritje të lehtë në krahasim me institucionin e paraburgimit. Nga 239 të anketuar 59.4% kanë deklaruar se nuk janë vizituar asnjëherë nga organizatat ndërkombëtare që monitorojnë respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në qendrat e burgimit, 30.5% kanë deklaruar se kanë pranuar një vizitë, 8.4% janë deklaruar se kanë pranuar nga dy vizita, dhe, 1.7% janë deklaruar se kanë pranuar nga tri vizita. Fakti se këtu kemi një rritje të lehtë të vizitave në krahasim me qendrat e paraburgimit, ne mendoj se lidhet me

dy faktorë. Faktori i parë konsideroj se ka të bëjë me hezitimin e organeve të ndjekjes dhe gjyqësisë për të pranuar vizita në qendrat e ndalimit dhe paraburgimit, nisur nga fakti dhe gjendja e rëndë e personave të privuar lirie në këtë institucion. Ndërsa faktori i dytë konsideroj se ka të bëjë me elementin kohor, duke u nisur nga fakti se një person qëndrueshmërinë kohore e ka shumë më madhe në institucionin e burgimit, me ç'rast edhe mundësia dhe mundësi për të pranuar një vizitë të tillë ka qenë më e madhe. Por, pavarësisht mundësisë së kufizuar që kanë pasur këto organizata, për t'iu qasur institucioneve të paraburgimit dhe burgimit, ne konsideroj se roli dhe kontributi i tyre mbetet me peshë të veçantë në sensibilizimin e opinionit ndërkombëtarë dhe vendor për të pasqyruar gjendjen e rëndë të personave të privuar nga liria në periudhën 1981–1999.

4.1.14. Baza juridike e vendimeve të gjyqësorit 1981–1999

Dihet mirëfilli se një gjyq për t'u quajtur objektiv dhe i pranueshëm duhet të ketë bazë ligjore të mbështetët në prova dhe fakte, e kundërta e kësaj, pastaj nuk kemi të bëjmë me një gjykim të drejtë, por më shumë një ndjekje apo persekutim për çfarëdo qëllimi qoftë ai. Në analizën e rezultateve të anketuarve të përgjigjur, në pyetjen e parashtruar se, a mendoni se gjykimi juaj është mbështetur në prova dhe fakte dhe sa ka pasur bazë juridike gjykimi juaj? Nga përgjigjet e pranura në bazë të analizës tonë mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me një situatë mjaftë shqetësuese sa i përket mendimit të personave të dënuar, sepse shumica absolute kanë deklaruar se janë dënuar në mungesë provash. Këtë konstatim më së miri e pohon fakti se nga 239 persona të dënuar, 38.5% janë përgjigjur se gjykimi i tyre nuk është mbështetur aspak në prova dhe nuk ka pasur bazë juridike. Ndërsa, 38.9% janë përgjigjur se ka pasur pak prova dhe bazë juridike, 20.5% janë përgjigjur pjesërisht dhe vetëm 0.4% janë të mendimit se ka pasur plotësisht prova dhe bazë juridike. Duke ju bërë analize përgjigjeve të këtyre pyetjeve mund të vijmë në konkluzionin se shumica e të dënuarve nuk ndihen fajtorë dhe janë gjykuar dhe

dënuar pa të drejtë. Po ashtu, mund të konkludoj se në dënimet në mungesë provash dhe fakteve, më shumë i japin një karakter ndjekës-persekutimi procesit, se sa një gjykimi të drejtë, objektiv dhe të paanshëm. Situata të tilla në sistemin e drejtësisë krijohen, kur sistemi i drejtësisë instrumentalizohet në dorë të politikës dhe për qëllime politike, për t'i arritur politika qëllimet e caktuara. Në sistemin e gjyqësorit në harkun kohor 1981/199 nuk ka qenë aspak risi ngjyrimi dhe gërshetimi i proceseve gjyqësore me interesa politike të pushtetit. Dënimet në atë kohë ishin drastike, ato ishin të porositura dhe caktoheshin para fillimit të seancës. Porotët i posedonin listat me dënime dhe vendimi merrej me mbivotimin e porotëve. Dënimet i caktonte (SHSSH) Sigurimi Sekret Shtetëror, ndërsa nga bashkësia lokale deri në nivelet më të larta, përgatitjen e masave, që duhej të merreshin kundër të pandehurve për dënime drastike e bënte partia (Pasqyra;2001,nr.4). Me një sistem gjyqësor ku listat e dënimeve përgatitën nga organet e sigurimit shtetëror dhe zyrat e partive politike në pushtet, nuk mund të flasim për vendime dhe dënime të bazuara në ligj.

4.1.15. Efekti i vuajtjes së dënimit, ndëshkimi apo risocializimi

Një ndër postulatet e të drejtës penale bashkëkohore është risocializimi dhe integrimi i personave pas vuajtjes së dënimit, pra, kthimi i këtyre personave si të shëndosh në shoqëri për të dhënë kontributin e tyre. Pyetjes së parashtruar, sa ka ndikuar dënimi, burgu që ju keni vuajtur, në risocializimin dhe integrimin tuaj në shoqëri? Nga 239 të dënuar 77.0% janë përgjigjur aspak, 19.2% janë përgjigjur pak, 3.3% janë përgjigjur pjesërisht dhe vetëm 0.4% janë përgjigjur plotësisht. Duke analizuar në hollësi këtë rezultat, në kushte normale një sistem i drejtësisë duhej të alarmohej, sepse bazuar në këtë rezultat, efekti i dënimit del të jetë i kundërt me qëllimin e tij. Por, ne mendojmë se ky rezultat duhet parë nga një këndvështrim tjetër, dhe ai është: së pari shumica e të dënuarve janë deklaruar se janë dënuar në mungesë provash dhe faktesh, dhe së dyti ata

nuk ndihen fajtorë për një vepër të tillë, dhe krejt në fund një ndër elementët më të rëndësishëm se përse kemi arritur të marrim një përgjigje të tillë është faktori politikë. Sepse shumica absolute nga ata mendojnë se janë trajtuar dhe dënuar për një bindje politike dhe ata me të drejtë konsideroj se nuk kanë pasur përse të ri socializohen ose integrohen, përderisa ata nuk e kanë pranuar atë sistem dhe gjykimin e tyre e kanë parë nga këndvështrimi i një persekutimi. Konkluzioni i këtij rezultati është se ata me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë qenë të bindur se kanë punuar për interes të shoqërisë, pra të bindur në të drejtën e tyre. Po të jepej sot në një sistem demokratik një rezultat i tillë, ai sistem drejtësie do të quhet totalisht i dështuar. Ky rezultat e ka shpjegimin e tij, duke marrë parasysh, kohën kur këta persona janë dënuar, sistemin e cili ka operuar dhe mjetet-metodat të cilat i ka shfrytëzuar ai sistem. Nga rezultatet dhe konkluzionet e analizës tonë rezulton se sistemi i politikave të aplikuara penale nuk ishte në funksion të qëllimit të dënimit, por të persekutimit të personave të privuar nga liria. Të burgosurit shqiptarë politikë, i përjetuan të gjitha format e torturës, duke filluar nga keqtrajtimi fizik dhe psikik, rrahja në mënyrë sistematike, gjymtimi fizik, dhe deri te humbja në qelitë e burgimit. Si pasojë e këtyre faktorëve gjatë vuajtjes së dënimit shumë prej tyre u bënë të paaftë për jetën. Në përfundim të kësaj rezulton se qëllimi i dënimit për të burgosurit politikë shqiptarë në sistemin gjyqësor nga viti 1981 deri 1999 ishte ndëshkimi, persekutimi, ndjekja dhe diskriminimi.

4.1.16. Ndikimi dhe roli i organizatave joqeveritare në përmirësimin e kushteve në qendrat e paraburgimit dhe burgimit gjatë viteve 1981–1999

Roli dhe rëndësia e këtyre organizatave është i pazëvendësueshëm në drejtim që bëhet sensibilizimit të opinionit vendor dhe ndërkombëtarë për kushtet dhe gjendjen e personave të privuar nga liria. Organizata e tilla kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm, edhe pse me mundësi operimi të kufizuar, për arsye se pushteti i asaj kohë

nuk kishte dhënë hapësirë në drejtim të bashkëpunimit me këto organizata. Këtë e dëshmon fakti se shumica e personave të privuar nga liria kanë deklaruar se nuk kanë pranuar asnjëherë vizitë nga këtë organizata. Në pyetjen drejtuar të dënuarve, sa ka ndikuar roli i organizatave joqeveritare që merren me liritë dhe të drejtat e Njeriut në drejtim të përmirësimit të kushteve në qendrat ku ju keni vuajtur dënimin me heqje lirie? Prej 239 personave të anketuar 71.1% janë përgjigjur aspak, 25.9% janë përgjigjur pak, 2.5% janë përgjigjur pjesërisht, dhe vetëm 0.4% janë përgjigjur shumë. Nga këndvështrimin ynë analitikë i këtij rezultati, konsiderojë se personat e dënuar me objektivitet janë përgjigjur, sidomos kur kemi të bëjmë në drejtim të përmirësimit të kushteve të tyre fizike dhe trajtimit nga organet e rendit. Por nuk mund të mohohet kontributi i këtyre organizatave, në veçanti në drejtim të sensibilizimit dhe vetëdijesimit të opinionit, për kushtet dhe trajtimin e personave të privuar nga liria. Roli i Kryqit të Kuq, Këshillit për Liritë dhe Mbrojtën e të Drejtave të Njeriut, Amnesty International etj, ka qenë me peshë të veçantë në drejtim të sensibilizimit të opinionit për gjendjen e personave të privuar nga liria.

4.1.17. Përkujdesja shëndetësore në qendrat e paraburgimit dhe burgimit për personat e privuar nga liria

E drejta për përkujdesje shëndetësore është një e drejtë garantuar në të gjitha fazat e zhvillimit të shoqërisë, pra është e drejtë elementare e cila garantohet me ligje nacionale dhe akte dhe konventa ndërkombëtare. Natyrisht, dhe mbi të gjitha e drejta në shëndet dhe përkujdesje shëndetësore, janë të drejta humanitare. Natyrisht, se edhe në periudhën kohore 1981–1999 në legjislacionin e aplikuar të asaj periudhe e drejta në përkujdesje shëndetësore ka qenë e garantuar. Por, cila ka qenë praktika e shfrytëzimit të kësaj të drejte elementare. Prej 239 personave të pyetur, sa keni pasur përkujdesje shëndetësore në qendrat e paraburgimit? 52.3% janë përgjigjur aspak, 42.7% janë përgjigjur pak, dhe 5.0% janë përgjigjur pjesërisht. Në analizë të këtij rezultati del se kemi të bëjmë me një

shkelje shumë elementare e cila e drejtë është e garantuar me ligj dhe me akte ndërkombëtare, por mbi të gjitha e drejta për përkujdesje shëndetësore është një e drejtë humane.

Nëse i krahasojmë rezultatet e pyetësorit se cili ka qenë niveli i përkujdesjes shëndetësore në kushtet e paraburgimit dhe burgimit, te institucioni i fundit kemi një lëvizje të lakores në drejtim pozitive. Prej 239 të anketuar në pyetjen, sa keni pasur përkujdesje shëndetësore në qendrat e burgimit? 2.1% janë përgjigjur aspak, 54.8% janë përgjigjur pak, 34.3% janë përgjigjur pjesërisht, 8.8% janë përgjigjur shumë. Në mendimin tone analitikë dallimin në përkujdesje shëndetësore në mes të institucionit të paraburgimit dhe burgimit janë dy faktorë që e kanë bërë. Faktori i parë është koha, sepse një person i privuar nga liria në burgim për arsye se aty ka qëndruar me vite edhe ka pasur mundësi me marrë përkujdesje shëndetësore gjatë këtij intervali kohor. Ndërsa faktori i dytë është keqtrajtimi dhe tortura që kanë kaluar personat e paraburgosur në veçanti në hetuesi për të pranuar fajësinë dhe kjo rezultuar me një mbyllje të sistemit të drejtësisë në drejtim të ofrimit të përkujdesjes shëndetësore, për arsye që mos të evidentohet shkeljet e lirive dhe të drejtave të njeriut në këtë fazë të procedurës penale. Gjatë hulumtimit tonë kemi hasur në materiale që pasqyrojnë një gjendje të rëndë në aspektin e përkujdesjes shëndetësore në qendrat e paraburgimit dhe veçanërisht ndaj të burgosurve politikë shqiptarë. Ndodhte që i burgosuri ishte i sëmurë rëndë, por kjo nuk luante rol, ai edhe në këtë gjendje shëndetësore mbahej në vetmi ku mungonte ndihma mjekësore. Këtë mënyrë të vuajtjes së burgut e kanë kaluar të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë, prandaj shumë nga ta kanë pësuar trauma psikike. Shumë të burgosur të tjerë janë operuar për shkak të sëmundjeve që i pësonin në këto biruca. Për sëmundjet e lehta e të zakonshme, as mos të flitet, ngase është vështirë të gjesësh ndonjë të burgosur politik shqiptar që nuk ka vuajtur nga reuma, nga dëmtimi i të parit, nga sëmundjet e organeve të tretjes, frymëmarrjes etj.

4.1.18. Cenimi i korrespondencës gjatë kohës së qëndrimit në institucionet e paraburgimit–burgimit

E drejta e korrespondencës e personave të privuar nga liria është një e drejtë e garantuar me ligj. Prej 239 personave të dënuar në pyetjen a keni pasur cenim të korrespondencës gjatë kohës sa keni qëndruar në paraburgim? 49.8 % janë përgjigjur plotësisht, 44.4% janë përgjigjur shumë, 5.4% janë pjesërisht, dhe vetëm 0.4% janë përgjigjur pak. Nga përgjigjet e pyetësorit rezulton se shumica absolute e të anketuarve janë përballur me cenim të privatësisë gjatë kohës sa ata kanë qëndruar në paraburgim. Shkelja e të drejtës së garantuar me ligj për korrespondencë, duke i bërë një analizë kronologjike përgjigjes së të anketuarve, pikërisht në fazën e hetimit dhe paraburgimit, na jep indice serioze se kemi të bëjmë me presion sistematik për të detyruar personat e privuar nga liria të pranojnë fajësinë. Pra, krahas mjeteve dhe metodave tjera si tortura, keqtrajtimi, edhe cenimi i korrespondencës është shfrytëzuar si instrument presioni kundër personave të privuar nga liria. Ky mohim dhe cenim i korrespondencës të personave të privuar nga liria bëhej në kundërshtim me të gjitha normat e aplikueshme pozitive. Ligji i procedurës penale të RSFJ nuk e ndalonte korrespondencën, përveç në raste të caktuara të parashikuara me ligj (Ligji mbi Procedurën Penale; 1977, Neni 203).

Bazuar në përgjigjet e të anketuarve, avazi i cenimit të korrespondencës pothuajse vazhdon me të njëjtin ritëm edhe në fazën e burgimit, edhe pse me një lakore të lehtë drejtë përmirësimit në favor të personave të burgosur, prapëseprapë rezultatet tregun një gjendje të rëndë. Prej 239 personave të pyetur se, a keni pasur cenim të korrespondencës tuaj gjatë kohës sa keni qëndruar në burgim? 22.6% janë plotësisht, 50.2% janë përgjigjur shumë, 23.4% janë përgjigjur pjesërisht, dhe vetëm 3.8% janë përgjigjur pak. Pra, ky rezultat tregon se janë shkelur në formë sistematike të drejta të garantuar edhe me ligjin e aplikueshëm penal të kohës, shkelje të cilat cenojnë rëndë privatësinë e

personave të privuar nga liria dhe të familjarëve të tyre. Monitorimi, surveimi, vëzhgimi që policët dhe gardianët u kanë bërë personave të privuar nga liria dhe familjarëve të tyre, ka cenuar rëndë të drejtën e tyre në korrespondencë. Në shumë burgje të Serbisë nuk lejohej as lapsi për shqiptarët, as libri as fletorja. Këtë e dëshmon edhe një i burgosur shqiptarë, kur bën ankesë dhe kërkesë në burgun e Beogradit, ai shkruan: “Ndoshta është cikërrimë. Kam kërkuar nga familja që të më sjellin një laps të thjeshtë, duke menduar se kjo është e lejueshme, por këtë këtu nuk ma kanë lejuar. Kjo nuk ju duket e çuditshme dhe e padrejtë. Lapsi nuk është as i rrezikshëm, as i ndaluar “ (Myrtaj, Prill, 1999). Në situatat kur nuk lejohet një laps për të shkruar një letër, kjo tregon se ai sistem gjyqësor ka qenë i minuar në shumë dimensione, dhe ka lënguar nga padrejtësitë e shumta që u është personave që janë privuar nga liria.

4.1.19. Proceset gjyqësore me motivacion politiko-etnik

Një prej pyetjeve çelës që iu është parashtruar të dënuarve dhe me një interes të jashtëzakonshëm për trajtesën e studimit është pyetja se, a mendoni se proceset gjyqësore kundër jush kanë qenë procese politike me motive etnike? Prej 239 të anketuarve 0.8 % janë përgjigjur pak, 11.7% janë përgjigjur pjesërisht, 35.6% janë përgjigjur shumë, dhe 51.9% janë përgjigjur plotësisht. Ky rezultat rrënon në themel dhe cenon rëndë pretendimin e kujtdo qoftë se ndaj kësaj kategorie personash është zhvilluar një proces i drejtë dhe transparent penal. Në një situatë kur mbi 99% të anketuarve përgjigjën se janë gjykuar dhe dënuar me motivacion politik dhe etnik, pra vetëm se janë shqiptarë, madje banaliteti ka shkuar aq larg sa janë dënuar shqiptar për ngjyrën e lopëve që kanë kultivuar. Pra, është dënuar qytetari shqiptar i Kosovës ,sepse ka pasur një lopë të kuqe dhe një të zezë. Me pretekstin se kjo simbolizon ngjyrat e flamurit kombëtar shqiptar (Kryeziu, TV Klan/Opinion, 20.10.2016).

Një rast tipik me motivacion etnik, ishte edhe rasti i Vehbi Sylejmanit, banor i fshatit Lubizhdë, afër Prizrenit. Fshati ishte i madh ku banonin shqiptarë, serbë dhe myslimanë. Paraqiste qendër administrative për më shumë fshatra. Për shkak të afërsisë me qytetin, nga ky fshat në qytet shkolloheshin shumë nxënës, ndërsa në fshat punonin punëtorë arsimit, shëndetësi e tjerë nga qyteti. Andaj, Lubizhda konsiderohej si “fshat përparimtar”. Dallimet sociale dhe politike gradualisht ndanin njerëzit, veçanërisht në baza nacionale, për të arritur, fal mjeteve propagandistike informative zyrtare dhe veprimit politik “nga anash”, deri te ekseset dhe mos durimi nacional dhe urrejtja. Andaj, çdo ngjarje “larg dëgjohej”.

Në fillim të vitit 1960, Vehbi Sylejmani (atëbotë njëzetedyvjeçar), bëhet aktivist i rinisë (anëtar i Komitetit komunal të rinisë) dhe anëtar i Lidhjes së komunistëve. Së shpejti kryen shkollën për mësues dhe bëhet mësues në Shkollën fillore në Lubizhdë. Ishte anëtar i të gjitha forumeve partiake në fshat dhe në Prizren. Është konsideruar “shqiptar i ndershëm dhe intelektual”. Por, një ngjarje e rastit kah fundi i vitit 1986 e rendon në radhë të “irredentistëve, gjegjësisht separatistëve, nacionalistëve, shovinistëve dhe personave ideo-politikisht të papërshtatshmëve”. Në të vërtetë, derisa shoqëronte bashkëshorten në ambulancë, në rrugë janë rrahur dy fëmijë. Ai i ndan, por njëri prej tyre e ofendon dhe mundohet ta godit, ndërsa ky i plas një shuplakë. Sylejmani s’ka ditur se, si arsimtar shqiptar, ka plas shuplakë fëmijë serb. Mbi këtë shkruan shtypi (sulmi i pandërprerë i shqiptarëve kundër serbëve), janë mbajtur diskutime politike (atak shovinist i punëtorit të arsimit si atak në bashkim-vëllazërim. E gjitha kjo s’mjaftonte. Është iniciuar procedura penale me propozim akuzën e prokurorit publik komunal, PP. 148/86, datë 9 Mars 1987, për shkak të veprës penale të keqtrajtimit me rastin e kryerjes së shërbimit nga Neni 66 i Ligjit Penal të Serbisë.³⁴

³⁴ Akuzë ishte se “Vehbi Sylejmani, në cilësi të personit zyrtar arsimtar në Shkollën fillore “Vëllazërim-Bashkim” në Lubizhdë, me datë 11.10.1986, afër orës 11:00, pranë ambulancës shëndetësore të fshatit Lubizhdë, e cila gjendet në afro 50 metra prej shkolle, ka keqtrajtuar të dëmtuarin *Dragolub Jeftiq*, i cili

Gjykata Komunale në Prizren, me aktgjykimin P. Nr. 54/87, datë 27 Maj 1987, gjykon Sylejmanin me dënim burgu në kohëzgjatje prej tri (3) muaj. Gjykatësi Fillim Skoro, shqiptar, s'deshi të shqyrtojë asnjë arsye të mbrojtjes dhe arsyet elementare juridike në nivelin e fillestarit student të drejtësisë, pasi gjykimin konsideronte si detyrë të veten partiake. Gjykata e Qarkut në Prizren e prishë aktgjykimin e shkallës së parë³⁵. Gjykata e shkallës së parë, në gjykimin e ri, konstaton se “ka marrë parasysh të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e gjykatës më të lartë”, por merr vendimin identik edhe pse shkolla ka vërtetuar se atë ditë Sylejmani s'ka pasur orë mësimore, se rrahja ka ndodhur jashtë orëve dhe jashtë hapësirës së shkollës. Por, Këshilli për vetëmbrojtje dhe mbrojtjen gjithë popullore i shkollës konsideronte se “arsimtarin duhet gjykuar”.³⁶ Duke aprovuar ankesën e mbrojtësit, Gjykata e Qarkut në Prizren, ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë dhe Sylejmanin e liron nga akuza, pasi “vepra për të cilën akuzohet, sipas ligjit s'është vepër penale”.³⁷ Është për t'u çuditur se të gjitha këto ishin të njohur edhe prokurorit publik të qarku S. M., i cili ka përkrahur aktgjykimin dhe akuzën edhe pse ka ditur se ajo s'mund të qëndrojë. Si shqiptar s'ka dashur që t'i thonë se “s'ka qenë politikisht i syhapur”. Prapëseprapë edhe ky rast u shënua si provë e “njëanshmërisë politike të gjykatave në Kosovë në lëndët në të cilat të dëmtuar ishin serbët”.

Edhe rasti i vrasjes së zëvendësit të prokurorit publik në Pejë, *Mirolub Popoviqit*, të cilin në banesën e nënës së tij e vret shqiptarja *Iliriana Jaha*, me revolen e viktimës,

rrihej me *Latif Elshanin*, pasi në atë çast i pandehuri Vehbi hyri në mes të tyre për t'i ndarë dhe pa paralajmërua rrëzon në tokë të dëmtuarin Dragolub, duke i mëshuar me shuplakë në pjesët e shpinës dhe me këmbë në prapnicë, meqë kryen veprën penale të keqtrajtimit me rastin e kryerjes së detyrës nga Neni 66 i LPS.

³⁵ Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, AP Nr. 367/87, datë 29 Dhjetor 1987, konstaton në arsyetim se aktgjykimi i shkallës së parë është në kundërtënie, pasi “në ditën kritike, i akuzuari s'ishte në detyrë, pasi shoqëronte bashkëshorten te mjeku”. Mandej, “i akuzuari është munduar që të ndajë dy fëmijë në rrahje, të cilët s'ishin nxënësit e tij”. Gjykatës i vihet në detyrë që në gjykimin e ri të vërtetojë (1) se i pandehuri në kohën kritike kryente detyrën e vetë, (2) deri te rrahja e nxënësve a ka ardhur gjatë orëve të mësimit dhe (3) i pandehuri a ka njohur edhe më parë këta nxënës.

³⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren P. Nr. 32/88, datë 25 Maj 1988. Aktgjykimin e merr i njëjti gjykatës.

³⁷ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, AP Nr. 484/99, datë 9 Mars 1990, me arsyetim se veprimet e të akuzuarit s'përmbajnë elementet qenësore të veprës penale (1) i akuzuari s'ka pasur cilësinë e personit zyrtar dhe (2) veprimet s'ka ndërmarrë në kryerjen e detyrës. Këtë aktgjykim ka marr gjykatësi i kombësisë serbe – Nikolla Vazura.

trajtohet si akt terrorist edhe pse kishte të bëjë me mosmarrëveshje dashurie. Pohohej se kjo shqiptare 20 vjeçare ishte “terroriste e stërvitur”.

Pra këtu rezulton që kemi pasur të bëjmë me një sistem gjyqësor të instrumentalizuar nga politika dhe të imponuar me gjuhën e dhunës kundër një etnie të caktuar, duke i shkelur edhe ligjet e aplikueshme, konventat dhe aktet e ndryshme që garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut. Periudha pas vitit 1981 deri në vitin 1999 në Kosovë do të mbetet e gdhendur si periudhë e gjyqësisë së çeliktë apo si kohë e sundimit të ashpër të politikës mbi drejtësinë.

4.1.20. Zbatimi i ligjit në procedurë penale 1981–1999

Zbatimi i drejtë i ligjit të aplikueshëm penal është imperativ për të garantuar një procedurë objektive, të drejtë dhe transparente, duke ju dhënë mundësi të barabarta ligjore palëve në procedurë penale. Çdo devijim nga ky parim është shmangie nga sistemi i drejtësisë dhe nuk garanton as minimumin e respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut. Bazuar në rezultatin e pyetësorit të 239 anketuarve, duket haptazi se kemi pasur devijime të tilla të zbatimit të ligjit në periudhën kohore 1981/1999. Prej 239 personave të anketuar në pyetjen se, në procesin gjyqësor kundër jush a mendoni se janë zbatuar drejtë ligjet në fuqi? Vetëm 0.4% janë përgjigjur plotësisht, 19.7 % janë deklaruar pjesërisht, 38.1% janë përgjigjur pak, dhe, 41.8% janë përgjigjur aspak.

Ky rezultat pasqyron shkarjen e ndodhur në sistemin e drejtësisë të asaj periudhe kohore dhe rrëshqitjen drejtë një arbitrariteti me elementë kriminal brenda institucioneve shtetërore të sistemit të drejtësisë. Pra, nëse organet e rendit dhe drejtësisë vendimet e tyre nuk i kanë mbështetur në frymën dhe forcën e ligjit, atëherë mund të konkludoj se këto vendime janë mbështetur në forcën e individit, politikës dhe keqpërdorimit të gjyqësorit në shërbim të politikës. Me rastin e bastisjeve dhe arrestimeve, nëse nuk gjenin personin e kërkuar, policia merrte “për peng” ndonjë anëtar të familjes dhe s’e

lironin nga burg, derisa të mos lajmërohet në polici personi i kërkuar. Ky ishte shpikja e re e policisë, e huazuar nga përvoja kriminele e grupeve kriminele.

4.1.21. Meritokracia e vendimeve të gjykatës dhe ndikimi i politikës mbi këto vendime

Një sfidë e vërtetë e sistemit të drejtësisë ka qenë dhe mbetet ndër shekuj, çështja se një vendim, është apo nuk është meritator dhe kjo sfidë vazhdon edhe sot në sistemet penale bashkëkohore. Sepse, në fund të fundit e gjithë procedura penale në fund përmbyllet me një vendim gjykate, dhe nëse ai vendim nuk është meritator, ajo procedurë në substancë nuk ka asnjë kuptim. Prej 239 personave të pyetur se, a mendoni se vendimet e shqiptuar nga gjykata kanë qenë meritore? Nga të anketuarit e përgjigjur rezulton se, 17.2% kanë deklaruar pjesërisht, 36.8% kanë deklaruar pak dhe 46.0% kanë deklaruar aspak. Edhe këto përgjigje ndjekin vazhden e rezultatit të përgjigjeve tjera në këtë pyetësor, ku të anketuarit në një linjë përgjigjesh, në një formë ose një tjetër e deklarojnë se organet e rendit dhe drejtësisë kanë shfaqur nihilizëm karshi të drejtave të tyre ligjore. Pra, kemi të bëjmë me një nihilizëm sistematik që aplikon aparati shtetëror kundër personave të privuar nga liria, nga momenti i këtij privimi, deri të dhënia e një vendimi jo meritator.

Në shoqëritë bashkëkohore me sistem demokratik pushtete janë të ndara dhe secili pushtet e mbështet veprimtarinë e vetë në kushtetutë dhe ligje të atij shteti. Pra, legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori, janë tri pushtete të ndara njëra nga tjetra, të cilat një një mënyrë apo tjetër e korrektojnë-kontrollojnë njëri tjetrin, por as sesi të dirigjojnë njëri tjetrin. Në situatat kur njëri pushtet kontrollon dhe dirigjon pushtetin tjetër, atëherë rrëshqasim drejtë arbitraritetit shtetëror, ku ligji dhe e humb kuptimin e ekzistencës së tij. Situata të tilla duket hapur që janë krijuar në aplikimin e politikave penale në

Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës nga ish–RSFJ dhe Republika e Serbisë, gjatë viteve 1981–1999, duke instrumentalizuar funksionin e gjyqësorit në shërbim të interesave politike. Këtë konstatim e mbështetës edhe në analizën e rezultateve të personave të anketuar, të cilët në pyetjen, sa kanë ndikuar rrethanat politike në vendimet gjyqësore? 42.7% prej tyre janë përgjigjur plotësisht, 49.8% janë përgjigjur shumë, 5.4% janë përgjigjur pjesërisht, 1.3% janë përgjigjur pak, dhe, vetëm 0.8% janë përgjigjur aspak. Duke e marrë si të mirëqenë faktin se këta të anketuar janë përgjigjur me objektivitet, një rezultat i tillë i jep zero kredibilitet moral dhe profesional çdo sistemi të drejtësisë, i cili pretendon se ka zhvilluar një procedurë penale të mbështetur në ligj. Se dënimet kanë qenë të motivuara nga politika kemi mjaftueshëm argumente që rezultojnë nga burime të sakta informacioni. Në intervistën e një gjyqtari të dhënë në një revistë, midis tjerash thotë: Dënimet i caktonte Sigurimi Sekret i Shtetit, ndërsa nga bashkësia lokale deri në nivelet më të larta, përgatitjen e masave, që duhej të merreshin kundër të pandehurve e bënte partia. Ndërkaq, për hetuesi dhe për deklaratat që i jepnin të akuzuarit ai shton: “Ato nxirreshin me dhunë dhe ata kërcënoheshin që të mos i ndryshonin ato as në gjyq. Për aktin e dorëheqjes thotë: Dorëheqja kishte pasoja të rrezikshme, ne s’kishim tjetër mundësi përveç, heshtjes (Revista Pasqyra, 2001, Nr.4). Pra kjo tregon se metastaza politike e kishte kapluar sistemin gjyqësor dhe çdo organ tjetër, duke e instrumentalizuar sistemin gjyqësor në funksion dhe interesat e politikave të caktuara ditore.

4.2.Diskutim dhe analizë mbi rezultatet e pyetësorit me avokatë

	Gjinia	Nr.	%
	Femër	4	8.5
	Mashkull	43	91.5
	Totali	47	100

1	Në periudhën kohore 1981–1999, e keni ushtruar profesionin e:	Nr.	%
	Avokatit	43	91.5
	Avokates	4	8.5
	Totali	47	100

2	Gjatë kësaj periudhe kohore që keni ushtruar profesionin e avokatit, sa e keni ndier veten të lirë dhe të sigurt në ushtrimin e profesionit tuaj?	Nr.	%
	Aspak	3	6.4
	Pak	10	21.3
	Pjesërisht	26	55.3
	Shumë	5	10.6
	Plotësisht	3	6.4
	Totali	47	100

3	Sipas përvojës tuaj, gjatë viteve 1981 - 1999, sa ka pasur mundësi një avokat të ushtrojë profesionin e tij në mënyrë të pavarur?	Nr.	%
	Aspak	1	2.1
	Pak	13	27.7
	Pjesërisht	27	57.4
	Shumë	3	6.4
	Plotësisht	3	6.4
	Totali	47	100

4	Gjatë viteve 1981 - 1999, personat që keni mbrojtur, për cilin lloj të veprës kanë qenë akuzuar më shumë?	Nr.	%
	Vepra penale me karakter politik	29	61.7
	Vepra penale me karakter ekonomik	4	8.5
	Vepra penale apo krime të rëndomta	11	23.4
	Kundërvajtje	2	4.3
	Tjetër	1	2.1
	Totali	47	100

5	Bazuar në eksperiencën tuaj, gjatë fazës së hetuesisë, sa respektoheshin liritë dhe të drejtat e njeriut?	Nr.	%
	Plotësisht	1	2.1
	Shumë	2	4.3
	Pjesërisht	9	19.1
	Pak	18	38.3
	Aspak	17	36.2
	Totali	47	100

6	A ka qenë tortura mjet për të marrë pohimin apo deklaratën e të akuzuarit?	Nr.	%
	Po	45	95.7
	Jo	2	4.3
	Totali	47	100
7	Ju keni pasur kontakt me klientët tuaj, pra me të dyshuarit/akuzuarit, a kanë qenë të keqtrajtuar - torturuar ata nga organet e rendit dhe hetuesisë	Nr.	%
	Aspak	1	2.1
	Pak	2	4.3
	Pjesërisht	6	12.8
	Shumë	30	63.8
	Plotësisht	8	17.0
	Totali	47	100

8	Sipas eksperiencës tuaj, a ju ka trajtuar gjykata drejtë dhe në mënyrë të barabartë në raport me institucionin e akuzës?	Nr.	%
	Plotësisht	3	6.4
	Pjesërisht	5	10.6
	Pak	11	23.4
	Aspak	28	59.6
	Totali	47	100

9	A keni hasur në pengesa të qëllimshme procedurale gjatë procedurës për mbrojtjen e klientëve tuaj?	Nr.	%
	Aspak	1	2.1
	Pak	4	8.5
	Pjesërisht	10	21.3
	Shumë	30	63.8
	Plotësisht	2	4.3
	Totali	47	100

10	Ju jeni profesionist i fushës tuaj, çfarë mendoni, cili ka qenë qëllimi i dënimit për veprat penale me karakter politik?	Nr.	%
	Ndëshkimi	39	83.0
	Risocializimi	3	6.4
	Ndëshkimi dhe risocializimi	5	10.6
	Totali	47	100

11	Si njohës i ligjeve dhe ekspert i fushës që jeni, a mendoni ju se janë akuzuar dhe dënuar klientët tuaj në mungesë të fakteve?	Nr.	%
	Aspak	1	2.1
	Pak	2	4.3
	Pjesërisht	18	38.3
	Shumë	24	51.1
	Plotësisht	2	4.3
	Totali	47	100

12	A mendoni se vendimet e shqiptuara nga gjykatat kanë qenë meritore?	Nr.	%
	Pjesërisht	18	38.3
	Pak	25	53.2
	Aspak	4	8.5
	Totali	47	100

13	Sipas mendimit tuaj, sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore?	Nr.	%
	Plotësisht	10	21.3
	Shumë	30	63.8
	Pjesërisht	3	6.4
	Pak	2	4.3
	Aspak	2	4.3
	Totali	47	100

14	A mendoni se ka pasur procese të montuara politikisht, për vepra penale me karakter politik?	Nr.	%
	Po	46	97.9
	Jo	1	2.1
	Totali	47	100

15	Në bazë të eksperiencës tuaj, a mendoni se personat e akuzuar për vepra penale me karakter politik, janë trajtuar më ashpër se personat e akuzuar për vepra të rëndomta penale?	Nr.	%
	Plotësisht	15	31.9
	Shumë	29	61.7
	Pjesërisht	3	6.4
	Totali	47	100

16	Sa keni pasur mundësi që t'i realizoni të drejtat ligjore avokat - klient?	Nr.	%
	Shume	1	2.1
	Pjesërisht	25	53.2
	Pak	21	44.7
	Totali	47	100

17	Sipas ligjit, ju i keni vizituar klientët tuaj në polici, hetuesi apo paraburgim, si mund t'i përshkruani kushtet ku ata janë mbajtur?	Nr.	%
	Të mira	1	2.1
	Të rënda	23	48.9
	Shumë të rënda	23	48.9
	Totali	47	100

18	Vendimet e shqiptuara nga gjykatat sa i kanë marrë për bazë konventat dhe aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut?	Nr.	%
	Pjesërisht	1	2.1
	Pak	7	14.9
	Aspak	39	83.0
	Totali	47	100

19	Sa kanë pasur mundësi organizatat vendore që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?	Nr.	%
	Plotësisht	1	2.1
	Pjesërisht	7	14.9
	Pak	34	72.3
	Aspak	5	10.6
Totali		47	100

20	Sa kanë pasur mundësi organizatat ndërkombëtare që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?	Nr.	%
	Plotësisht	1	2.1
	Pjesërisht	8	17.0
	Pak	33	70.2
	Aspak	5	10.6
Totali		47	100

21	A ju kujtohet të keni mbrojtur ndonjë klient që ka qenë polic apo hetues që është akuzuar për keqtrajtim apo torturim të të akuzuarve për vepra penale me karakter politik?	Nr.	%
	Po	5	10.6
	Jo	27	57.4
	Nuk më kujtohet	15	31.9
	Totali	47	100

21.1	Nëse po, sa klientë?	Nr.	%
	1	4	80.0
	2	1	20.0
		5	100
	999	42	
Totali		47	

22	A mund ta kujtoni nga eksperiencia apo të keni dëgjuar nga kolegët tuaj, se është dënuar ndonjë polic apo hetues për vepër penale të torturës ndaj të akuzuarve?	Nr.	%
	Po	1	2.1
	Jo	13	27.7
	Nuk më kujtohet	33	70.2
	Totali	47	100

23	Sipas eksperiencës tuaj, të akuzuarit për vepra penale me karakter politik a janë akuzuar në grupe?	Nr.	%
	Po	47	100
	Jo	0	0
Totali		47	100

23.1	Nëse PO, sa?	Nr.	%
	2	1	2.1
	5	2	4.3
	6	1	2.1
	8	1	2.1
	shumica e rasteve	25	53.2
	të gjitha rastet	17	36.2
	Totali	47	100

24	Sa kanë pasur mediat qasje në monitorimin e proceseve gjyqësore për vepra penale me karakter politik, duke filluar nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procesit gjyqësor?	Nr.	%
	Plotësisht	1	2.1
	Shumë	1	2.1
	Pjesërisht	14	29.8
	Pak	31	66.0
	Totali	47	100

25	A mendoni se pas këtyre vendimeve juridike, janë fshehur qëllimet politike me motive etnike	Nr.	%
	Po	44	93.6
	Jo	3	6.4
	Totali	47	100

26	Sipas mendimit tuaj profesional, a mendoni se është shkel ligji gjatë procedurës penale së zhvilluar kundër personave të dënuar për këto vepra penale?	Nr.	%
	Po	44	93.6
	Jo	3	6.4
	Totali	47	100

Në pyetësin e disertacionit tonë kemi arritur të anketojmë 47 avokatë, të cilët në intervale të ndryshme kohore nga viti 1981 deri në vitin 1999 e kanë ushtruar profesionin e avokatit. Nga 47 avokatë të anketuar, 91.5 % janë meshkuj dhe vetëm 8.5% janë femra. Pyetjet të cilat u janë parashtruar në pyetësor personave të dënuar, avokatëve-mbrojtës, prokurorëve dhe gjymëtarëve, kanë një gërshetim taktik dhe ky gërshetim është bërë në funksion të vërtetimit ose mohimit të hipotezës së studimit. Duke qenë se kjo kategori e të anketuarve janë persona të cilët në ngjarjet e zhvilluara në sistemin e gjyqësisë penale 1981/1999 kanë qenë protagonistë direkt ose indirekt të

ngjarjeve, përgjigjet e këtyre kategorive të anketuarve e konsiderojmë me peshë të veçantë për studimin.

4.2.1. Sa kanë pasur liri, siguri dhe pavarësi avokatët në ushtrimin e profesionit të tyre

Në pyetjen drejtuar avokatëve se, sa e keni ndier vetën të lirë dhe të sigurt në ushtrimin e profesionit të avokatit, gjatë periudhës kohore 1981–1999? Prej tyre 6.4% janë deklaruar aspak, 21.3% janë deklaruar pak, 55.3% janë deklaruar pjesërisht, 10.6 janë deklaruar shumë, dhe, vetëm 6.4% janë deklaruar plotësisht. Duke iu referuar kësaj përqindje rezulton se pozicioni i avokatit ka qenë në pozitë të pa lakmueshme në ushtrimin e profesionit të garantuar me ligj. Këtë konstatim e vërteton edhe përgjigja e personave të dënuar të cilët në shumicë absolute kanë deklaruar se kanë hasur vështirësi për ta realizuar mbrojtën e tyre në të gjitha fazat e procedurës penale, dhe në veçanti në institucionin e paraburgimit. Në pyetjen e parashtruar avokatëve se, sipas përvojës tuaj, gjatë viteve 1981/1999 sa ka pasur mundësi një avokat ta ushtroj profesionin e tij në mënyrë të pavarur? Prej 47 të anketuar 2.1% janë deklaruar aspak, 27.7% janë deklaruar pak, 57.4% janë deklaruar pjesërisht, 6.4% janë deklaruar shumë dhe 6.4% janë deklaruar plotësisht. Analiza e këtyre rezultateve konstaton se gama e shkeljeve në procedurë nuk përfshinë vetëm personat e privuar nga liria, por edhe mbrojtësit e tyre ligjor. Pra, nëse një avokat nuk ndihet i lirë, i sigurt dhe i pavarur në ushtrimin e profesionit të tij, natyrshëm se ai nuk mund të ofrojë mbrojtje efektive në procedurë penale dhe kjo e dëmton në substancë një proces të tillë. Pra, kur diskutojmë për sistemin gjyqësor dhe sistemin e drejtësisë penale në Kosovë gjatë viteve 1981/1999, nuk mund të anashkalohet fakti se, përveç pozitës së vështirë së krijuar për personat e privuar nga liria në procedurë penale, aspak nuk ishte imun edhe e drejta e avokatit për të ushtruar profesionin e tij sipas ligjit.

4.2.2. Personat që ju keni mbrojtur në periudhën 1981–1999 për cilat lloji të veprave penale kanë qenë të gjykuar dhe dënuar

Në pyetjen drejtuar avokatëve se në këtë periudhë kohore klientët e mbrojtur për çfarë veprash penale janë akuzuar? Sipas përgjigjes së tyre 61.7% për vepra penale me karakter politikë, 8.5% vepra penale të natyrës ekonomike, 2.4% vepra penale apo krime të rëndomta, 4.3% kundërvajtje dhe 2.1% tjera. Pra, dukshëm në këtë periudhë kohore dominojnë veprat penale me karakter politik. Ky fakt ndërlidhet edhe me përpjekjet e popullit Shqiptarë për liri që u manifestua pikërisht në demonstratat e vitit 1981 dhe 1989 ku dhe vala e arrestimeve dhe dënimeve ishte shumë e theksuar në këtë periudhë kohore. Dyndjet masive të organeve të rendit dhe drejtësisë të Federatës Jugosllave dhe të Republikës së Serbisë kundër popullit shumicë në Kosovë, bën që 1/3 e popullit shqiptarë të Kosovës të kalojnë nëpër dyert e organeve të policisë, hetuesisë dhe gjyqësisë. Pra, nga viti 1981 deri në vitin 1999 ishte ndjekja më masive që kishte ndodhur në Evropë nga pas Lufta e Dytë Botërore. Fakti se populli shqiptar i Kosovës në numrin e përgjithshëm të popullsisë në ish-Jugosllavi merrnin pjesë me afro 12%, kurse ë numrin e gjithmbarshëm të të dënuarve politikë me mbi 90% (Basha–Kecmezi; 2009, 482). Kjo statistikë tregon dhe mbyllë çdo dilemë se cili ishte populli i përndjekur dhe persekutuar politikisht në periudhën kohore 1981/1999 në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

4.2.3. Bazuar në eksperiencën tuaj, cila ishte pozita e klientëve tuaj në fazën e hetuesisë

Në pyetjen sa janë respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut gjatë fazës së hetuesisë? Prej 47 të anketuarve avokatë, prej tyre 2.1% janë deklaruar plotësisht, 4.3% janë deklaruar shumë, 19.1% janë deklaruar pjesërisht, 38.3% janë deklaruar pak, dhe, 36.2% janë

deklaruar aspak. Nga ky rezultat mund të konkludojë se gjendja e personave të privuar, sidomos në fazën e hetuesisë është shoqëruar me probleme serioze me cenim të rëndë të lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo përgjigje ndërlidhet edhe me pohimet e të anketuar me status të dënuar, të cilët kanë deklaruar në masë të gjerë se kundër tyre është ushtruar torturë.

Në pyetjen drejtuar avokatëve, ju keni pasur takime me klientët tuaj, a kanë qenë ata të torturuar nga organet e rendit dhe hetuesisë? Prej tyre janë përgjigjur kështu, 2.1% janë deklaruar aspak, 4.3% janë deklaruar pak, 12.8% janë deklaruar pjesërisht, 63.8% janë deklaruar shumë dhe 17.0% janë deklaruar plotësisht. Këto rezultate deri në njëfarë mase korrespondojnë me përgjigjet e personave të privuar nga liria të cilët janë deklaruar se kanë kaluar në procedura torturimi për të pranuar fajësinë gjatë fazës së hetuesisë. Tortura në fazën e hetuesisë ishte projekt i sinkronizuar në mes të organeve të sigurimit shtetëror, policor, të koordinuar mirë me organet e gjyqësorit dhe nën urdhrat e politikës.

4.2.4. A ka qenë tortura metodë për të marrë pohimin apo deklaratën e të akuzuarit

Në pyetjen drejtuar avokatëve të anketuar se, a ka qenë tortura mjet-metodë për ta marrë pohimin apo deklaratën e të akuzuarit? Prej 47 avokatëve të anketuar, 2.1% janë deklaruar aspak, 2.1 % janë deklaruar pak, 10.6% janë deklaruar pjesërisht, 53.2% janë deklaruar shumë, dhe, 31.9% janë deklaruar plotësisht. Nëse ju referohemi rezultateve të pranuar nga pyetësi me persona ish të privuar nga liria dhe të anketuarve avokatë, duke i trajtuar në aspektin komperativ, na rezulton se keqtrajtimi dhe tortura kanë qenë mjete dhe metoda të aplikuara në masë të gjerë për t'i detyruar personat e privuar nga liria të pranojnë fajësinë. Pra, kjo metodë e përdorur ka qenë në kundërshtim flagrante me ligjet e aplikueshme në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, dhe me

Konventa Ndërkombëtare referuar lirive dhe të drejtave të njeriut. Në analizën tonë mund të konstatojmë se në aplikimin e politikës penale dhe gjatë fazave të zhvillimit të procedurës penale, kemi pasur një abuzim të gjere me ligjet në fuqi nga organet e ndjekjes dhe drejtësisë. Ky abuzim i pushtetit është manifestuar në veçanti kundër një kategorie të caktuar dhe kryesisht, target sulmi kanë qenë personat e ndjekur, gjykuar dhe dënuar për vepra penale me karakter politikë. Format e represive të Federatës dhe Serbisë në Kosovë ishin prej më të ndryshmeve. Tridhjetë ditë zgjati drama e pasigurisë në lidhje me fatin e Nait Hasanit, i cili në kohën e fundit u pa në kohën e arrestimit në rrugë në Prishtinë me 28 janar 1997. Fondi për të drejtën humanitare kërkoi nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Serbisë të njoftoi për vendin e arrestit të Nait Hasanit. Në përgjigjen e ministres u njoftua se ky institucion menjëherë verifikoi dhe vërtetoi se “personi në fjalë nuk gjendet, dhe as nuk gjendej në Burgun e qarkut në Prishtinë”. Po këtë informatë e konfirmuan edhe prokurori i qarkut dhe gjykatësi hetues i qarkut në Prishtinë, duke e njoftuar Fondin se kundër Hasanit nuk është ngritur aktpadia dhe se ata nuk kanë informatë në lidhje me arrestimin e tij. Me rastin e zhdukjes së Nait Hasanit vetëm Shërbimi i sigurimit të shtetit në Prishtinë refuzoi të japë çfarëdo informate. Me 28 shkurt 1997 Nait Hasani, pa njoftim paraprak dhe lajmërim të familjes, u nxor përpara gjykatësit hetues në Gjykatën e qarkut në Prishtinë. Hasani ia doli me këtë rast që të përmend ngjarjet të cilat vijuan pas janarit të vitit 1997. Sipas fjalëve të Hasanit të cilat i transmeton avokati Fazli Balaj, pas heqjes së lirisë, u çua në spitalin e Prishtinës për shkak të plagëve të rënda të cilat iu shkaktuan gjatë hetimit. Ishte i vetëdijshëm se dergjej në krevat dhe se duart i ka të lidhura në të. Ai nuk e din se a është mbajtur në spital dy apo tre ditë si dhe ku u çua prej spitalit. Me rastin e kësaj ngjarjeje, Fondi për të drejtën humanitare, tregon për përgjegjësinë e institucioneve shtetërore të Serbisë, për veprimet anti juridike dhe shkeljet e të drejtave të personave që u është hequr liria (E Drejta në Kosovë; 1998, 97).

4.2.5. Si avokat a jeni trajtuar drejtë në raport institucionin e akuzës

Barazia e palëve në procedurë penale është një ndër parimet themeltare të procedurës penale bashkëkohore. Pra, me një proces gjyqësor ku mohohet ky parim, atëherë një proces i tillë nuk mund të quhet objektiv dhe i paanshëm. Në pyetjen e parashtruar avokatëve të anketuar se, duke u bazuar në eksperiencën tuaj, a ju ka trajtuar gjykata drejtë në raport me institucionin e akuzës? Prej 47 avokatëve të anketuar, 6.4% janë deklaruar shumë, 10.6% janë deklaruar pjesërisht, 23.4% janë deklaruar pak, dhe, 59.6% janë deklaruar aspak. Pasqyra e këtij rezultati na dëshmon se institucioni i avokatit-mbrojtësit në procedurë penale është vu në pozitë të pabarabartë përballë institucionit të akuzës. Nëse e shikojmë nga një këndvështrim më të gjere, marrja anë e gjykatës në procedurë penale në fakt nuk e dëmton vetëm pozicionin e mbrojtësit, por dëmin e madh ia bën të mbrojturit. Sepse, në fund të fundit procedura gjyqësore penale fillon, zhvillohet dhe përfundon në raport për të mbrojturin.

Me një analizë kronologjike referuar përgjigjeve që kanë rezultuar nga ky pyetësor, nuk është e vështirë të vërtetojmë dhe konstatojmë se, gama e shkeljeve në procedurë penale rezulton të jetë mirë e organizuar dhe me qëllime të caktuara për t'i vendosur palët në pozita të pabarabarta në procedurë penale. Këtë konstatim e vërteton rezultati i nxjerrë edhe nga kjo pyetje e parashtruar avokatëve të anketuar: A keni hasur në pengesa të qëllimshme procedurale gjatë zhvillimit të procedurës për mbrojtën e klientëve tuaj? Prej 47 avokatëve të anketuar, 2.1% janë përgjigjur aspak, 8.5% janë përgjigjur shumë, 21.3% janë përgjigjur pjesërisht, 63.8% janë përgjigjur shumë, dhe, vetëm 4.3% janë përgjigjur plotësisht. Në analizën tonë kronologjike të gjendjes së paraqitur në gjyqësorin e harkut kohor 81/99, rezulton të jetë gjithçka sistem dhe asgjë rastësi, pra çdo pengesë dhe shkelje është bërë në funksion të qëllimeve të caktuara politike.

4.2.6. Qëllimi i dënimit sipas mendimit dhe eksperiencës së avokatëve

E drejta penale bashkëkohore i kushton shumë rëndësi qëllimit të dënimit, sepse një dënim pa qëllim, nuk është asgjë më shumë se një procedurë e thatë, duke e marrë për bazë efektin e dënimit final. Prandaj e drejta penale bashkëkohore sot nuk e sheh qëllimin e dënimit vetëm si kategori ndëshkimi kundër kryerësit të veprës penale, por i kushton rëndësi të posaçme risocializimit dhe ri-integrimit të personit të dënuar. Përgjigja që kanë ofruar avokatët e anketuar lidhur me qëllimin e dënimit, i cili është shqiptuar në harkun kohor 1981–1999, lë shumë për të dëshiruar për aplikimin e politikave penale gjatë vitit 1981–1999. Në pyetjen drejtuar avokatëve të anketuar se, çka mendoni ju, cili ka qenë qëllimi i dënimit për vepra penale me karakter politikë? 83.0% janë përgjigjur ndëshkimi, 6.4% janë përgjigjur risocializimi, dhe, vetëm 10.6% janë përgjigjur ndëshkimi dhe risocializimi. Një rezultat si ky është në dispropocion të plotë me qëllimin e dënimit në të drejtën penale bashkëkohore. Pra, kjo formë e tillë e aplikimit e të drejtës penale në kuptimin e gjerë, më shumë është në funksion të shërbimit të një politike të caktuar, dhe, aspak nuk është në funksion final të qëllimit të dënimit për të cilin është përcaktuar e drejta penale bashkëkohore.

4.2.7. Dënime në mungesë provash, ndikimi dhe montimi politik i proceseve gjyqësore

Është kusht themelor i së drejtës penale bashkëkohore në kuptimin e gjerë që, një vendim gjykate duhet të mbështetet në prova dhe fakte të provuara. Një aktgjykim i cili bazën nuk e ka në prova dhe fakte të provuara me objektivitet të plotë, nuk i plotëson kushtet për t'u quajtur i drejtë, i paanshëm dhe objektiv në të drejtën penale bashkëkohore, dhe si rrjedhojë nuk mund të jetë i besueshëm.

Në pyetjen drejtuar avokatëve se, a mendoni ju që klientët tuaj janë akuzuar dhe dënuar në mungesë fakteve të provuara? 2.1% janë deklaruar aspak, 4.3% janë deklaruar pak, 38.3% janë deklaruar pjesërisht, 51.1% janë deklaruar shumë, dhe, 4.3% janë deklaruar plotësisht. Në pyetjen e ngjashme me përmbajtjeje të njëjtte që ju kemi parashtruar personave të privuar nga liria, dhe si rrjedhojë shumica absolute kanë deklaruar se janë dënuar në mungesë faktesh të provuara, natyrisht këtë rezultat e pranojmë si të tillë me një rezervë objektive, duke u nisur nga fakti se shumica e personave të gjykuar dhe dënuar mund të jenë laik në raport me procedurat gjyqësore. Por, në anën tjetër duke e përdorur një metodë krahasuese në mes të përgjigjeve të personave të dënuar dhe përgjigjeve që i kanë dhënë avokatët si profesionistë të fushës, na rezulton se kemi të bëjmë me një situatë ku kemi përafrim mendimesh dhe qëndrimesh, si nga laikët e fushës edhe nga profesionistët. Andaj, si rrjedhojë e këtij rezultati dhe faktorëve të tjerë mund të konkludoj se, procedura penale e zhvilluar kundër personave të privuar nga liria për vepra penale kryesisht të natyrës politike, është shoqëruar me defekte serioze në aplikimin e dispozitave ligjore, në harkun kohor 1981–1999. Edhe në pyetjen tjetër parashtruar avokatëve se, a mendoni se vendimet e shqiptuara nga gjykata kanë qenë meritore? 38.3% janë deklaruar pjesërisht, 53.2% janë deklaruar pak, dhe, 8.5% janë deklaruar aspak. Nëse e krahasojmë përgjigjen e pyetjes së njëjtë që ju kemi parashtruar personave të dënuar, me përgjigjen e avokatëve të anketuar, pavarësisht se rezultati statistikor ka dallim, lakorja e dy kategorive qon në drejtimin se vendimet nuk ishin meritore në harkun kohor, 1981–1999.

Pavarësia e gjyqësorit nga politika ka qenë dhe mbetet sfidë në të gjitha fazat e zhvillimit të shoqërisë, dhe në veçanti në zhvillimin e shoqërive bashkëkohore. Pra, pavarësisht se në aspektin formal – juridik kemi ndarje të pushteteve si legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori, prapëseprapë koha ka dëshmuar se asnjëri nga këto tri

pushtete nuk ngelet imun nga ndikimi. Por, duhet potencuar se ndikimi politikë historikisht ka qenë më i theksuar në drejtim të gjyqësorit, për t'i realizuar objektivat e tij politike. Në harkun kohor 1981–199, në Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës duke i pasur parasysh edhe rrethanat e asaj kohe, gjetjet tona gjatë hulumtimit, na japin një pasqyrë se kemi një sistem gjyqësori shumë të brishtë, dhe që nuk është aspak imun ndaj ndërhyrjeve politike. Në pyetjen e parashtruar avokatëve të anketuar se, sipas mendimit tuaj, sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore? Prej tyre, 21.3% janë përgjigjur plotësisht, 63.8% janë përgjigjur shumë, 6.4% pjesërisht, 4.3% pak, dhe, 4.3% kanë deklaruar aspak. Mbi përgjigjen e këtyre pyetjeve, mund të analizojmë, diskutojmë dhe ngremë dilema nga këndvështrime të ndryshme, por një fakt relativisht të rëndësishëm nuk mund ta anashkalojmë. Dhe, ky fakt ka të bëjë me avokatët e përgjigjur të cilët janë edhe profesionistë fushës, dhe po ashtu, në shumicën e rasteve janë përjetues të ngjarjeve reale.

Nga shumë pyetje të parashtruara në katër fokus grupe të pyetësorit në funksion të studimi, pyetja se, a mendoni se ka pasur procese penale të montuara politikisht për vepra penale me karakter politikë? Përgjigja e kësaj pyetje është me një interes të veçantë për punimin tonë. Prej 47 avokatëve të anketuar, në këtë pyetje janë përgjigjur kështu, 97.9% janë deklaruar po, dhe, vetëm 2.1% janë deklaruar jo. Një prej shumë defekteve serioze që e kanë shoqëruar sistemin gjyqësorë të hakt kohore 1981–1999 në KSKA, janë proceset e montuara gjyqësore me motivacion politik, kundër një kategorie të caktuar, që në këtë rast, target sulmi dhe objektiv kanë qenë populli Shqiptarë. Ligji është i qartë sa i përket përcaktimit të kushteve për marrjen e një vendimi të drejtë. Neni 15 i Ligjit mbi Procedurën Penale parasheh: 1) *“Gjykata dhe organet shtetërore që marrin pjesë në procedurë penale kanë për detyrë të konstatojnë në mënyrë të vërtetë*

dhe të plot faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit të ligjshëm” (Ligji mbi Procedurën Penale;1977, Neni 15).

Sipas një analize të Fondit për të drejtë humanitare, Gjykata e qarkut të Prishtinës dënoi me 30 Maj 1997, njëzet shqiptarë, në mesin e tyre edhe dy vajza, me dënime të renda burgimi, dhe se gjatë kësaj nuk paraqiti prova relevante për të ndriçuar gjendjen faktike dhe për të vendosur lidhur me përgjegjësinë penale të të akuzuarve. Në veprimin penal nuk u dëgjua asnjë dëshmitar (E Drejta në Kosovë; 1998, 99).

Rasti i policit Ukë Qerreti, që ishte polic i Sekretariatit të Punëve të Brendshme Federative, në sigurimin e objekteve të rëndësishme federative. Në polici punonte afro 17 vjet. Ishte anëtar i Lidhjes së Komunistëve dhe anëtar i sekretariatit të Organizatës Themelore. Konsideronin si të vyeshëm, të ndershëm dhe ideopolitikisht të përshtatshëm. Por, pas demonstratave të shqiptarëve në Kosovë, në Prill 1981, raporti ndaj rrethit ndryshon. Uka me 17 Prill 1981, për vikend, shkon në vizitë miqve në rrethin e Pejës. Në kthim, në autobus dëgjon komentin e një pasagjeri mbi demonstratat. Menjëherë filluan të thënat se Qerreti ka shkuar ilegalisht në Kosovë. Fushata kundër tij u kanalizua në tri procedura: (1) iniciohet procedura për vërtetimin e përgjegjësisë ideopolitike të Qerretit në bazë të deklaratave me shkrim të një numri të policëve që punonin me të. Në mbledhjen e OTH të LK formohet kolegji shoqëror. Pas kësaj, 12 policë detyrohen që të shkruajnë deklarata se ç’kanë folur me Qerretin. Të gjitha deklaratat janë shkruar me të njëjtin makinë shkrimi gjatë muajit Nëntor 1983. Qerreti përjashtohet prej Lidhjes së Komunistëve. Por, Komisioni i Statutit konstaton se vendimi i organizatës bazë është kundër statutit, kështu që përfundimisht Qerretit i shqiptohet vërejtja. Prokuroria e Dytë Publike në Beograd, pas dy vjetëve prej kësaj ngjarje, ngrit propozim akuzën,³⁸, me nënshkrimin e zëvendësës së prokurorit publik Bozhidarka

³⁸ Propozim Akuza PP. Nr. 975/83, datë 16 Qershor 1983, Beograd.

Bajiq, me të cilin Qerreti akuzohet “se gjatë vitit 1981 disa herë ka shprehur lajme dhe pohime të rrejshme mbi ngjarjet dhe situatën shoqërore/politike në KSA të Kosovës, ndërsa me qëllim që të shkaktojë revoltë dhe tronditje të qytetarëve dhe zvogëlimin e besimit të qytetarëve në vendimet dhe masat e organeve shtetërore, ashtu që pas kthimit nga Kosova, ku ndodhej më 17 Prill 1981, ku ishte në vizitë te miqtë e vet, në bisedë me N.A., M.P., M.T. dhe D.M., pohonte: (1) se s’është e drejtë që në Kosovë kanë ardhur serbët dhe malaziasit, pasi ajo është tokë shqiptare dhe e njëjta duhet t’i takojë shqiptarëve; (2) se tani shqiptarët, pas shpërnguljes së serbëve dhe të malaziasve tokën e vetë blejnë për së dyti; (3) se ata vetëm kërkojnë të drejtat e veta; (4) se malaziasë ka më pakë se shqiptarë dhe kanë republikën e vetë, andaj pse edhe shqiptarët të mos kenë Republikën; (5) se ai s’beson informatave që jep Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, shtypi dhe mjetet tjera informative, por beson se çka dëgjon prej njerëzve të vetë nga Kosova; (6) se Pilicin Abazi e kanë vra policët nga Brigada e policisë, të cilët të gjithë janë “të Rankoviqit” dhe të cilët në Kosovë kanë vepruar ashpër, veçanërisht ndaj femrave shqiptare, për ç’arsye pjesëtarët e forcave të sigurisë prej republikave tjera janë turpëruar nga këto sjellje.

Gjykimi i parë në Gjykatën e Dytë Komunale në Beograd është mbajtur më 15 Dhjetor 1983. Ukë Qerreti në mbrojtjen e vetë tha se ngjarja është vendosur në prill-qershor 1981, biseda me kolegët është vendosur në hapësirat e organeve federative me rastin e mbajtjes së rojës, procedura disiplinore është iniciuar në korrik 1982, pas ankesës kundër eprorit, ndërsa paraqitja penale është iniciuar në Mars–Prill 1983. Kur iu është shqiptuar dënimi në LKJ, ai s’është njoftuar me deklaratat e kolegëve, por për ta është njoftuar në seancën e Komisionit për Statut. Tha se tregimi i tij nga autobusi “është copëtuar dhe pjesët iu janë dhënë dëshmitarëve sikur se gjoja i akuzuari me ta paska biseduar”.

Dëshmitari M.I., punëtor i SFPB, luti gjykatësin që ta përkujtoj se çka ka deklaruar në procedurën paraprake”, dëshmitari deklaroi se i akuzuari s’ka folur për rrugën e vetë në Kosovë. Gjykatësi i jep që të lexojë deklaratën. Pas kësaj, dëshmitari deklaroi: “Përfundimi im ishte se i akuzuari desh të thoshte se milicia është fajtores për demonstratat në Kosovë. S’mund të them se Uka pajtohej me demonstratat. Por, dëgjova se dikush ka spiunuar se Uka pajtohet me demonstratat, por ai mendonte se unë kam spiunuar..”. Dëshmitari konstaton se asnjëherë s’kanë punuar në ndërrimin e njëjtë. Me aktgjykim³⁹, Ukë Qerretin e shpallin fajtor për të gjitha inkriminimet nga propozimi akuza dhe e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Në arsyetim të aktgjykimit shkruan edhe atë që s’ishte lëndë e shqyrtimit, e as që u paraqit si provë, dhe duke shtrembëruar faktet.

Kolegji i Gjykatës së Qarkut në Beograd, në përbërje: Bosilka Subotin, kryetare e kolegjit, Slobodan Todoroviq dhe Milica Petrovich, anëtarë të kolegjit, me vendimin PA. Nr. 2793/94 më 27 dhjetor 1984, e prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën ia kthen në rigjykim.⁴⁰

³⁹ Aktgjykim, P. Nr. 1231/83 datë 24 Prill 1984, Beograd.

⁴⁰ Në arsyetimin e aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, ndërmjet tjerash, qëndron:

“...nga dispozita e aktgjykimit të shkallës së parë shihet se i pandehuri është shpallur fajtor se, ndërmjet tjerash – para *Nikolla Arsiqit* ka folur lajme dhe konstatime të rrejshme mbi ngjarjet në Kosovë, e të cilat janë përcaktuar në aktgjykim. Por, në arsyet e aktgjykimit s’janë përmendur provat. Në bazë të cilave vërtetohet se i pandehuri para personit të përmendur ka folur inkriminimet, ndërsa nga procesverbali i shqyrtimit kryesor nuk shihet se në atë drejtim janë nxjerrë provat.

“Përveç kësaj, i pandehuri është shpallur fajtores, përveç tjerash, folur konstatime të rrejshme “se s’është e drejtë që në Kosovë kanë ardhur serbët dhe malaziasit, pasi ajo është toka shqiptare, dhe se e njëjta t’i takojë shqiptarëve, se tani Shqiptarët, me rastin e shpërnguljes së serbëve dhe të malaziasve, tokën e vetë për herë të dytë blejnë”. Por, në arsyetimin e aktgjykimit s’janë cekur se në bazë të cilave prova është vërtetuar se i pandehuri ka folur këto inkriminime, ndërsa nga dëshmia e dëshmitarë ë dëgjuar *Velkoviçit*, *Timotijeviqit* dhe *Milovanoviqit* në shqyrtimin kryesor nuk rrjedhë një përfundim i tillë. Vërtet, dëshmitari Milovanoviq në procedurën paraprake sqarohet lidhur me një pjesë të inkriminimit të përmendur, por gjykata e shkallës së parë, në shqyrtimin kryesor nuk i ka parashtruar dëshminë nga procedura paraprake, e as që dëshmitarit i ka bërë pyetje lidhur me këtë në shqyrtimin kryesor.

“Gjithashtu, i akuzuari është shpallur fajtor se, përveç tjerash, ka folur “se malaziasë ka shumë më pakë se shqiptarë, ndërsa kanë republikën, e pse atëherë edhe shqiptarët s’mund të kenë republikën?”. Lidhur me këto inkriminime, gjykata e shkallës së parë s’ka dhënë arsye se këto inkriminime a mund të paraqesin veprimet e kryera të veprës penale për të cilën i pandehuri është akuzuar. Arsyet mbi faktet e cekura janë me rëndësi, për shkak se është e ditur se shqiptarë ka më shumë se malazias, ndërsa mendimi i të pandehurit se shqiptarët për shkak të numrit të banorëve në Kosovë duhet të kenë republikën, paraqet qëndrim politik, andaj ky inkriminim s’mund të hyjë në veprimin e kryerjes së veprës penale. “Gjithashtu,

Përfundimisht, gjykatësi i Gjykatës së Dytë Komunale në Beograd, pa mbajtjen e seancës, bien aktvendim K. Nr. 90/85 datë 12 korrik 1986, me të cilin pezullon procedurën penale kundër Ukë Qerretit për shkak të heqjes dorë prokurorit publik komunal. Pra, katër vjet ka zgjatur maltretimi i këtij milici nga ana e kolegëve të tij, drejtuesve të Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme në krye me Stane Dollancin, LK...Fajtorët s'janë marrë në përgjegjësi. Përkundër zvarritjes gjyqësore iu janë paguar të ardhurat personale.

4.2.8. Trajtimi i ligjit me dy standarde

Një ndër postulatet bazë të së drejtës penale bashkëkohore është parimi i barazisë para ligjit, pra, para ligjit të gjithë të barabartë. Trajtimi dhe zbatimit i ligjit me dy standarde nuk është i panjohur as risi, sidomos kur kemi të bëjmë me pushtete të cilat sistemin gjyqësorë nuk e kanë aspak imun ndaj ndërhyrjeve nga jashtë. Politikat dhe procedurat penale të aplikuara në Kosovë në harkun kohor 81/99, janë shoqëruar me zbatimin e ligjit me standarde të dyfishta. Në pyetjen drejtuar avokatëve të anketuar se, në bazë të eksperiencës tuaj, a mendoni se personat e akuzuar për vepra penale të natyrës politike,

i pandehuri shpallet fajtor, përveç tjerash, se ka thanë “se s’beson informatave që jepe Komiteti Qendror i LKJ, shtypi dhe mjetet tjera informative”, ndërsa në arsyet në faqen e pestë, alineja katër, përmendet se, duke shfaqur inkriminimet e cekura, i pandehuri ka pasur për qëllim që të krijojë pabesim të qytetarëve ndaj vendimeve të organeve kompetente shtetërore dhe politike. Qëndrimi i këtillë i gjykatës së shkallës së parë është në kundërtënie me faktet përgjithësisht të njohura, e në të vërtetë se KQ I LKJ, mjetet e informimit s’janë organe dhe institute shtetërore, çka kërkohet për ekzistimin e veprës penale të përmendur, andaj këto pjesë të dispozitës s’mund të hyjnë në veprimin e kryerjes së veprës penale, për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. “Përveç kësaj, në aktgjykimin e shkallës së parë është cekur se i pandehuri para personave të përmendur ka paraqitur lajme dhe pohime të rrejshme lidhur me vrasjen e milicist Abazi, duke thënë se atë e kanë vra milicët nga brigada e milicisë, të cilët janë të rankoviqit. Por, Nikolla Arsiqi s’është dëgjuar si dëshmitar, ndërsa nga dëshmia e dëshmitarëve tjerë nuk mund të rrjedhë përfundimi i atillë i gjykatës së shkallës së parë. Mu dëshmitari **Dragan Milovanović** s’është deklaruar në këto rrethana, derisa nga dëshmia e dëshmitarit **Millutin Velković** shihet se i pandehuri paska thënë se gjoja studentin në demonstratë ka vra i rankoviqit. Në dallim prej tij, nga dëshmia e dëshmitarit Millan Timotijević rrjedhë se i pandehuri i ka thënë se milicin Abazi e ka vra i rankoviqit, çka është përshkrim tjetër i faktit në aktgjykim.

“Në fund, aktgjykimin e shkallës së parë s’mban arsye të mjaftueshme dhe të qarta mbi qëllimin e të pandehurit si elementit qenësor të veprës penale. Në të vërtetë, nga dëshmia e dëshmitarëve mund të përfundohet se ata kanë iniciuar bisedat. Nëse kemi parasysh vendimin e komisionit për statut të organizatës së LK në organet federative, i cili është provë në shqyrtimin kryesor, i cili është në kundërshtim me faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë, atëherë gjykata e shkallës së parë...”

janë trajtuar më ashpër se personat e akuzuar për vepra penale të rëndomta? 31.9% janë deklaruar plotësisht, 61.7% janë deklaruar shumë, dhe, vetëm 6.4% janë deklaruar pjesërisht. Ky rezultat tregon se zbatimi i ligjit me dy standarde në periudhën kohore 1981/1999, ka qenë normë e pashkruar e sistemit gjyqësorë. Nga kjo rezulton se në Kosovës pas vitit 1981 dhe deri në qershor të vitit 1999, për sistemin e drejtësisë dhe gjyqësorit në fokus specifik ka qenë ndjekja e një etnie të caktuar me motivacion politik. Por, ç'është e vërteta gjithë kjo ndjekje e cila ka qenë në funksion të politikës, në fakt ka ndodhur në fluskën e pushtetit juridik.

4.2.9. Pengesa në realizim i të drejtës ligjore avokat–klient

E drejta e të akuzuarit për të pasur të pasur mbrojtës në të gjitha fazat e procedurës është e drejtë e garantuar me ligj, ashtu siç është e garantuar me ligj edhe e drejta e mbrojtësit për të pasur qasje me klientin e tij në të gjitha fazat e procedurës penale. Gjetjet të cilat rezultojnë nga përgjigjet e pyetësorit, konstatojnë se kjo e drejtë është cenuar në mënyrë sistematike nga organet e rendit dhe të drejtësisë. Në pyetjen e parashtruar avokatëve të anketuar se, sa keni pasur mundësi t'i realizoni të drejtat ligjore avokat-klient? 2.1% janë deklaruar shumë, 53.2% janë deklaruar pjesërisht, dhe, 44.7% janë deklaruar pak. Në analizën tonë konstatojmë se edhe ky rezultat është në frymën e përgjigjeve tjera, nga të cilat përgjigje ka rezultuar shkelja permanente e lirive dhe të drejtave të njeriut në procedurë penale në KSAK, në harkun kohor, 1981–1999. Mohimi, pengesa, dhe kufizimi që iu është mbrojtësve dhe klientëve në funksion të mbrojtjes së tyre përballë organit të akuzës, ka rezultuar edhe me shkelje të dispozitave ligjore në Kosovë gjatë vitit 1981–1999. Me ç'rast është shkelur ligji mbi Ligji mbi Procedurën Penale i RSFJ, konkretisht dispozitat të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e mbrojtësit dhe klientit. Pra, konkretisht është cenuar neni 11 dhe kreu VI i këtij ligji, i cili parasheh pozitën e mbrojtësit në procedurë penale (Ligji mbi Procedurën Penale; 1977).

4.2.10. Kushtet në qendrat e paraburgimit

Për kushtet e paraburgimit është debatuar gjatë në të drejtën penale bashkëkohore në kuptimin e gjerë, gjithmonë në kontekst të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në qendrat e paraburgimit. Një ndër defektet serioze me të cilat është shoqëruar sistemi gjyqësorë në KSAK, gjatë viteve 1981–1999, janë kushtet e vështira në qendrat e ndalimit dhe paraburgimit. Në pyetjen e parashtruar në drejtim të avokatëve të anketuar, kur ju i keni vizituar klientët tuaj në polici, hetuesi apo paraburgim, si mund t’i përshkruani kushtet ku ata kanë qëndruar? 2.1% janë deklaruar të mira, 48.9% janë deklaruar të rënda, dhe, 48.9% janë deklaruar shumë të rënda. Ky pohim mbështetet edhe në burime tjera, në organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që arritur të monitorojnë kushtet e personave të privuar nga liria në harkun kohor, 1981–1999. Si pasojë e kushteve dhe torturave në qendrat e paraburgimit dhe burgimit, me qindra kanë mbetur invalidë të përjetshëm, ndërsa mbi qindra familje janë bërë inferior, sepse përmes torturës shpirtërore mbi ta, bëheshin edhe trajtime makabre, deri në shkallë vdekje ose të gjymtimit fizik. Keqtrajtimet fillonin e aktin e arrestit, hetuesisë dhe paraburgimit dhe vazhdonin në të gjitha fazat e procedurës penale, pra edhe gjatë vuajtjes së dënimit. Pesë dekada të ish-Jugosllavisë socialiste, ishin vite ndjekje dhe gjahu për shqiptarë.

4.2.11. Vendimet e shqiptuara nga gjykatat në raport me aktet ndërkombëtare referuar lirive dhe të drejtave të njeriut

Tani është fakt njohur se shumica absolute e shteteve përveç legjislacionit të tyre me rastin e shqiptimit të dënimeve në procedurë penale i inkorporojnë edhe aktet dhe konventat e ndryshme ndërkombëtare, të cilat me rastin e zhvillimit të procedurës

penale dhe shqiptimit të vendimeve gjyqësore i obligojnë shtetet në respektimin e tyre. Të drejtat e njeriut po marrin karakter universal, gjë që mund të shihet edhe nga aktivitetet e Kombeve të Bashkuara në nxjerrjen e shumë dokumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat i miratojnë shumë anëtarë të organizatës botërore. Ndër të drejta të shumta dhe të llojllojshme të njeriut, kujdes i veçantë u kushtohet atyre të drejtave që janë të lidhura ngushtë me procedurën penale. Pikërisht në procedurën penale shpesh vjen e bëhet cenimi i të drejtave të individëve. Prandaj lufta për të drejtat e njeriut ka qenë gjithmonë e orientuar në drejtim të fitimit të garancive kundër arbitraritetit të organeve shtetërore, por edhe i ofrimit të mbrojtjes nga cenimi i këtyre të drejtave. Historia moderne e të drejtave të njeriut fillon me Deklaratën për të drejtat e njeriut dhe gjyqtarit të cilën e ka miratuar Kuvendi Popullor i Francës me 26 Gusht 1879, me të cilën janë hequr pushteti absolut privilegjet e aristokracisë, ndërsa janë proklamuar liria, barazia dhe një varg të drejtash të njeriut (E Drejta; Prishtinë, 1989, 134).

Rëndësi të veçantë promovimin dhe afirmimin e të drejtave të njeriut ka, Deklarata e përgjithshme për të drejtat e njeriut e vitit 1948, traktate të ndryshme ndërkombëtare si Traktati për të drejtat civile dhe politike, sepse në to caktohet, sepse në to caktohet pozita e njeriut dhe të drejtat e tij lidhur me gjyqësinë penale. Por, pavarësisht faktit se në harkun kohor 1981/199, në ish Jugosllavi ishin të proklamuar një sërë aktesh dhe burimesh ndërkombëtare referuar lirive dhe të drejtave të njeriut, duke u bazuar në burime të besueshme rezulton se respektimi i tyre nuk përfillej në praktikë. Rezultati i pyetësorit drejtuar avokatëve na jep një pasqyrë relativisht negative në këtë drejtim. Pra, në pyetjen, vendimet e shqiptuara nga gjykata sa i kanë për bazë konventat dhe aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut? 2.1% janë përgjigjur pjesërisht, 14.9% janë përgjigjur pak, dhe, 83.0% janë përgjigjur aspak.

Pavarësisht se në bazë të dokumenteve të ndryshme nën patronatin e Kombeve të Bashkuara janë nxjerrë një varg instrumentesh, konventash, deklaratash dhe protokolle ndërkombëtare me të cilat trajtohen të drejtat e njeriut në lëmin e gjyqësisë penale siç janë: Deklarata për mbrojtjen e të gjithë individëve nga tortura dhe veprimet e tjera johumane dhe poshtëruese përkatësisht nga dënimet (1975), Konventa kundër torturës dhe veprimeve të tjera mizore johumane dhe poshtëruese ose dënimet (1984), Garancinë për të mbrojtjen e personave të cilëve u kanoset dënimi me vdekje (1984), Deklarata mbi parimet themelore të jurisprudencës për viktimat e krimeve dhe keqpërdorimit të forcës (1985), Parimet themelore për pavarësinë e gjyqeve (1985), Rregullat standard minimale të gjyqeve penale për të mitur (të ashtuquajturat rregullat e Pekinit) etj. Pra, me gjithë mozaikun ekzistues të akteve dhe konventave ndërkombëtare që proklamojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, sistemi gjyqësor në Federatën jugosllave vazhdoi me shkelje sistematike të lirive dhe të drejtave të njeriut, në veçanti ndaj individëve që ishin subjekt i ndjekjes penale.

4.2.12. Monitorimi i proceseve gjyqësore nga organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare

Roli monitorues i organizatave vendore dhe ndërkombëtare është mjaftë i rëndësishëm për të pasqyruar nivelin e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në procedurë penale, duke dhënë rekomandime, vërejtje dhe sugjerime në drejtim përmirësimit të sistemit gjyqësorë. Ky rol i këtyre organizatave bëhet edhe më i rëndësishëm kur kemi të bëjmë me sisteme të brishta gjyqësore, siç ishte sistemi gjyqësor në KSAK, gjatë viteve 1981–1999.

Në pyetjen drejtuar avokatëve të anketuar se, sa kanë pasur mundësi organizatat vendore dhe ndërkombëtare që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i

monitoruar proceset gjyqësore nga faza e hetuesisë deri në përfundim të procedurës gjyqësore? 2.1% janë përgjigjur plotësisht, 17.0% janë përgjigjur plotësisht, 70.2% janë përgjigjur pak, dhe, 10.6% janë përgjigjur aspak. nëse i referohemi vetëm këtij rezultati, këtu kemi të bëjmë me mundësi të kufizuar që u është dhënë këtyre organizatave. por, puna dhe kontributi i këtyre organizatave ka qenë jashtëzakonisht e çmueshme, në mënyrë të veçantë në sensibilizimin e opinionit vendor dhe atij ndërkombëtarë, për shkeljet e lirive dhe të drejtave të njeriut nga organet e rendit dhe drejtësisë gjatë gjitha fazave të zhvillimit të procedurës penale. në mesin e këtyre organizatave të cilat kanë dhënë kontribut të çmueshëm janë: Amnesty International, Kryçi Kuq, Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KLMDNJ), *“Këshilli i Helsinkit për të drejtat e njeriut, “IZBOR” – organizata joqeveritare për mbrojtjen e viktimave të pastrimit etnik. – kjo organizatë joqeveritare u formua në Paris, në Janar 1991, nga aktivistët për të drejtat e njeriut nga tërë hapësira e RSFJ dhe aktivistëve francezë për të drejtat e njeriut. Ky asociacion kishte përkrahjen dhe ndihmën materiale të unionit evropian. “IZBOR” ishte iniciator i formimit të SOS telefonit – SOS viktimave.. “IZBOR” kishte moton: “nëse Evropën s’mundemi të kthejmë në parajsë, mos të lejojmë që të jetë ferr”.*

4.2.13. Kultura e mos ndëshkueshmërisë së abuzuesve të pushtetit

Në procedurën e zhvilluar penale gjatë viteve 1981–1999, kundër personave të privuar nga liria ka ndodhur një dhunim sistematik nga organet e ndjekjes, hetuesisë dhe policisë kundër personave të privuar nga liria të ndjekur kryesisht për vepra penale me karakter politikë. Ky privim i të drejtave fillon nga ajo më elementare deri të privimi nga jeta. Këto pohime i mbështesim në shumë fakte dhe burime të cilat u inkorporuan në studim. Por, cila ishte përgjegjësia penale e këtyre zyrtarëve shtetërorë që u përfshinë

në këto krime kundër popullit shumicë në Kosovë gjatë viteve 1981–1999. Në pyetjen drejtuar avokatëve, a ju kujtohet të keni mbrojtur ju ndonjë klientë që ka qenë polic apo hetues dhe që është akuzuar për keqtrajtim apo torturim të personave të privuar nga liria? 10.6% janë deklaruar po, 57.4% janë deklaruar jo, dhe, 31.9% janë deklaruar nuk me kujtohet. Nëse e tërheqim një paralele krahasimi në mes të deklarimit të personave të privuar nga liria të cilët kanë deklaruar në përqindje absolute se kanë subjekt torture, dhe rezultatit të kësaj përgjigje, mund të konstatojmë se kemi një shmangie nga përgjegjësia penale të kryerësve të këtyre veprave, por të cilët kanë të veshur me pushtetin shtetëror. Pra, thjeshtë kemi një diskrepancë të madhe në mes të krimit dhe ndëshkimit, e cila kthehet si një normë e heshtur e pa ndëshkueshmërisë. Në pyetjen pasuese drejtuar avokatëve, a mund ta kujtoni nga eksperiencia e juaj, apo që keni dëgjuar nga kolegët tuaj se është dënuar ndonjë polic apo hetues për vepra penale të torturës? Prej tyre janë përgjigjur kështu, 2.1% janë deklaruar po, 27.7% janë deklaruar jo, dhe, 70.2 janë deklaruar nuk me kujtohet.

4.2.14. Fenomeni i akuzave dhe dënimeve në grup

Sistemin e gjyqësor të viteve 1981–199 në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, e karakterizon një fenomen jashtëzakonisht i theksuar ai fenomen është ndjekja, arrestimi, akuzimi dhe dënimi në grupe, për personat e privuar të akuzuar për vepra penale të natyrës politike. Në pyetjen drejtuar avokatëve të anketuar se, sipas eksperiencës tuaj të akuzuarit për vepra penale me karakter politikë a janë akuzuar në grupe? Prej 47 avokatëve të anketuar, 100% janë deklaruar po! Pra, fenomeni i akuzës në grup e ka shoqëruar sistemin e aplikimit të politikave penale në harkun kohor 81/99, dhe sikur sistemi gjyqësor i asaj kohe ka pretenduar në një fajësi kolektive, kryesisht kundër një kategorie të targetuar mbi baza etnike. Këtë rezultat e përforcon fakti se prej vitit 1981 deri në vitin 1990 nëpër zyrat e policisë, hetuesisë dhe organet e drejtësisë, kaloi 1/3 e

popullit shqiptar të Kosovës. Gjatë punës hulumtuese dhe materialeve të shqyrtuara në funksion të këtij studimi, kemi hasur në një fenomen që ka të bëjë me aktakuza dhe dënime kolektive.

4.2.15. Prapavija e vendimeve juridike

E drejta penale bashkëkohore në kuptimin e gjerë i kushton një rëndësi të veçantë qëllimit të dënimit. Pra, dënimi në vetën e tij nuk mund të bartë si qëllim vetëm shpagimin. E drejta penale bashkëkohore në qëllimin e dënimit i parasheh elementet përbërës që e kompletojnë qëllimin e dënimit, siç janë përveç shpagimit, risocializimi dhe ri-integrimi i personit të dënuar në shoqëri pas vuajtjes së dënimit. Thënë ndryshe nga kjo, qëllimi i dënimit nuk do të kishte asnjë kuptim nëse brenda tij nuk i përmban të gjitha këto elemente së bashku. Por, cili do të ishte qëllimi i dënimit nëse prapa vendimeve juridike fshihen qëllime të caktuara politike. Atëherë, në analizën tonë me të drejtë mund të konstatohet se qëllimi i dënimit në këto raste nuk mund të jetë asgjë më pak se ndjekja, stigmatizimi dhe persekutimi kundër një kategorie të caktuar në shoqëri. Në pyetjen drejtuar avokatëve të anketuar se, a mendoni se pas këtyre vendimeve juridike janë fshehur qëllimet politike me motive etnike? Prej 47 avokatëve të anketuar, 93.6% janë deklaruar po, dhe, vetëm 6.4% janë deklaruar jo! Në kushte normale një rezultat si ky do të ishte alarm për çdo sistem drejtësie. Por tani më duke qenë të njohura faktet se sistemi gjyqësor i periudhës kohore në KSAK, nuk ka qenë imun aspak ndaj instrumentalizimit për qëllime politike, atëherë, nëse e shikojmë në kontekstin kohor, mënyrën si ka vepruar ai sistem, këto shkelje kanë që të aplikueshme si normë e pashkruar. Devijimi dhe keqpërdorimi i sistemit të drejtësisë nga politika e asaj kohe, mund të konsiderohet shkarja serioze e atij sistemi gjyqësorë. Sipas një raporti që u publikua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, del se në asnjë vend të Evropës nuk ka

pasur numër aq të madh të proceseve politike dhe të të dënuarve politikë, për krye të banorëve sa ka pasur në Kosovë (Gazeta Bujku; 1993)

Republika Federative Socialiste e Jugosllavisë dhe Republika e Serbisë, të gjitha këto arrestime, ndjekje, tortura, akuza, gjyqe, dënime dhe vrasje, kundër popullit shqiptar i bënte të mbështjellë nën fluskën e pushtetit juridik. Pra, thënte troç dhe thjeshtë, vendimet ishin me ngjyrë juridike, por me substancë politike. Raste kur turma njerëzish akuzoheshin dhe persekutoheshin politikisht, ishin edhe rastet e grupit të Prizrenit me 44 persona të akuzuar dhe grupi i Prishtinës me 77 persona të akuzuar.

Procedura kundër 44 personave në suazën e lëndës së ashtuquajtur “Ministria e Policisë”, P. 9/95. Në mesin e Nëntorit 1994, fillon arrestimi masiv i ish kuadrit udhëheqës të Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Kosovës dhe të ish punëtorëve të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të kombësisë shqiptare. Të gjithë ata s’pranuan të vazhdojnë punën kur u flak autonomia e Kosovës dhe kur punët e brendshme u vunë në kontrollin e drejtpërdrejt të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Atëbotë të gjithëve u pushoi marrëdhënia e punës.

Prej të gjithë të arrestuarve janë krijuar grupe të pandehurish kundër të cilëve janë iniciuar procedura penale në Prishtinë (grupi prej 77 të pandehurve), në Prizren (grupi prej 44 të pandehurve), në Gjilan dhe në Mitrovicë... Kundër të gjithëve është zhvilluar procedura për shkak të veprës penale të bashkimit për kryerjen e veprimtarisë armiqësore nga neni 136 i LP RFJ lidhur me nenin 116 al.1 i LP RFJ (shkëputje e pjesës së territorit...).



Në ndryshim prej regjioneve tjera, në mesin e të arrestuarve në regionin e Prizrenit s'ishin vetëm ish policët, por edhe persona tjerë: inxhinier i gjeodezisë, deputeti i parlamentit paralel të Kosovës, punëtori i arsimit, tregtari – biznesmen, shef i Partisë turke, ofiqar i gjendjes civile, ish kryetari i Gjykatës Komunale në Rahovec, dy bujq.⁴¹

⁴¹ Struktura e të akuzuarve në këtë lëndë penale ishte: (1) grupin e parë përbënin të ashtuquajturit “anëtarë të qeverisë së komunës së Rahovecit”: Xhelal Canziba, kryetar, Esad Jaha, sekretar, krye shef i shtabit të mbrojtjes popullore, Rexhep Oruci, sekretar i punëve të brendshme, por edhe shef i Sigurimit Shtetëror për regjionin e Prizrenit, Xhemal Haxhimustafa, sekretar – anëtar i shtabit të mbrojtjes popullore, Nahit Elshani, sekretar për financa – anëtar i shtabit të mbrojtjes popullore, Gani Mullaabazi, komandant i shtabit të mbrojtjes popullore, Salih Sokoli, anëtar i shtabit të mbrojtjes popullore, Shaban Dana, komisar i shtabit të mbrojtjes popullore, Dr. Osman Vuçitërna, shërbimi shëndetësor, Halil Kafegjollli, shef i Stacionit të Policisë në Rahovec, (2) grupin e dytë përbënin anëtarët e sigurimit shtetëror dhe sigurimit publik: Rexhep Oruci, i cili ishte e vetmja lidhje ndërmjet Qeverisë së Komunës së Rahovecit dhe strukturave të sigurimit, ish pjesëtarëve të punëve të brendshme”, Xhelal Shasivari, shef i grupit operativ, Zehadin Ramadani, Sezair Shaiqi, kryetar i Partisë Popullore Turke, Arhimed Varolli, ofiqar në KK Prizren, Astrit Koshi, Emin Uka, Bashkim Brahaj, Liman Gashi, Besnik Baruti, Vezir Sela, Eshref Berisha, Rustem Palushi, Ajat Gashi, Ymer Kryeziu dhe Remzi Ademaj – të gjithë sigurim shtetëror, Shaip Mustafa, komandant i Policisë për regjionin e Prizrenit, Adem Shala, krye shef i Qendrës së sigurimit në Prizren, Halil Blakaj, zëvendës i krye shefit, Faik Jasiqi, shef i Stacionit të Policisë në Malishevë, Ramadan Ndrecaj, shef i Stacionit të Policisë në Suharekë, Salih Muriqi, shef i Stacionit të Policisë në Dragash, Ilmet Fanaj, zëvendës shefi i Stacionit të Policisë në Suharekë, Sylë Milaku, krye shef për kriminalitetin e përgjithshëm në QS në Prizren, Orhan Zajmi, operativ për kriminalin e përgjithshëm, Hilmi Bujari, zëvendës shefi i Stacionit të Milicisë në Suharekë dhe Sejdi Bytyqi,

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Prizren, PP 168/94, datë 7 Shkurt 1995, dispozita e përbashkët ishte: *“Në periudhën prej vitit 1991 deri më Nëntor 1994, në Kosovë e Metohi, në territorin e komunës së Prizrenit, Rahovecit, Suharekës dhe Dragashit, formuan grupin, anëtarë të cilit ishin, me qëllim që grupi, me përdorimin e forcës të ndryshojë rregullimin shtetëror dhe shoqëror të RFJ të përcaktuar me Kushtetutë, të shkëpus pjesën e territorit të Kosovës dhe Metohisë prej Republikës së Serbisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë, të banuar me pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare, në atë mënyrë që me iniciativën e “Qeverisë së Republikës së Kosovës”, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës”, “Ministrisë së Mbrojtjes Popullore të Republikës së Kosovës” janë qasur organizimit të shërbimit të sigurimit publik dhe shtetëror – formacioneve para milicë dhe paraushtarake të përbërjes rezerve dhe aktive... dhe kanë formuar shtabet e luftës në të gjitha vendbanimet e mëdha, me detyrë që në çastin e duhur, kur të plotësohen kushtet, të ndërmarrin veprime të dhunshme ndaj organeve legale të RS, që prijësit e grupeve dhe të nëngrupeve, sipas sistemit të “trashave” të okupojnë objektet me rëndësi jetike, kanë caktuar personat nga përbërja aktive dhe rezerve që të likuidojnë personat e kombësisë serbe, të cilët ndodheshin në funksionet e caktuara në komunë dhe organet shtetërore...”*

Sonja Biserko, kryetare e Këshillit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi, urgjent shkroi raportin mbi gjendjen shëndetësore të Sezairit dhe me këtë njoftoi opinion vendas

përdorues i radio stacionit. (3) Grupin e tretë përbënin personat “për punë të veçanta”: Rexhep Pista, biznesmen për furnizimin me naftë, Bedri Abazi, vozitës, Abdullah Haxhiimeri, person ushtarak që kishte doracakët, Muhedin Bekeri, ish kryetar i Gjykatës Komunale në Rahovec, i cili kishte statusin e “njeriut të besueshëm”, Ramush Krasniqi, bujk, kujdesej për pushkë-mitraloz dhe 2.003 plumba për këshillin ilegal të komunës së Rahovecit dhe Mitat Elshani, bujk, të cilit Ramushi i besoi dy/tre ditë ato që i besuan.

dhe ndërkombëtar, si edhe përfaqësitë diplomatike në Beograd. Kopje i dërgoi edhe ministrit të drejtësisë të Republikës së Serbisë, i cili dërgoi përgjigjen⁴².

Më 21 Shtator 1995, u shpall aktgjykimi, ashtu që gjykatësi s'lexoi diapozitivin e aktgjykimit, por vetëm komunikoi vendimin mbi dënimet, duke shqiptuar 11 vjet burgim për 38 persona (mesatarisht nga 2,9 vjet burgim), ndërsa pesë veta janë liruar. Dënimi më i lartë ishte 6 vjet dhe gjashtë muaj, ndërsa më i ulëti një vit.⁴³

Opinionin jugosllav u njoftua me karakterin e gjykimit, pikësëpari nëpërmjet analizave të prof. dr. Vladan Vasilijeviqit, i cili çdo ditë përcolli këtë procedurë penale.

⁴² Ministri i drejtësisë i Republikës së Serbisë dërgoi Këshillit të Helsinkit shkresën, Nr. 700-00-8/95-03 datë 15.02.1995, në të cilën sqaron tërë procedurën penale "kundër 45 personave" në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe mohon pohimet mbi torturën e të pandehurve. Veçanërisht sqaron sjelljet ndaj *Sezair Shaipit*, duke cekur se "gjatë zhvillimit të hetimeve dhe dëgjimit të tij s'është përdorur kurrfarë torture, as keqpërdorimi fizik i të pandehurit". Ministri s'komenton sjelljet e policisë, por në shkresë cekë: "Është e vërtetë se i njëjti gjykatësit hetues është ankuar se në hapësirat e Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Prizren ishte keqpërdor fizikisht. Pas marrjes së aktvendimit mbi zbatimin e hetimeve dhe caktimit të paraburgimit, kryetari i gjykatës personalisht ka kërkuar prej drejtorit të Burgut të Qarkut që sipas nevojës t'i jepet ndihme mjekësore".

⁴³ Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, P Nr. 9/95, datë 21 Shtator 1995: 1) Xhemail *Canziba* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 vjet dhe 6 muaj, 2) Esad *Jahja* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 vjet, 3) Rexhep *Oruçi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 vjet, 4) Xhemail *Haxhimustafa* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 vjet, 5) Nahit *Elshani* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 vjet dhe 6 muaj, 6) Gani *Mullaabazi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 vjet, 7) Salih *Sokoli* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 vjet dhe 6 muaj, 8) Shaban *Dana* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 vjet dhe 6 muaj, 9) Osman *Vuçitërna* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 vjet dhe 6 muaj, 10) Halil *Kafegjollli* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vjet, 11) Shaip *Mustafa* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet dhe 6 muaj, 12) Ahmet *Shala* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vjet, 13) Faik *Jasiqi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet, 14) Ramadan *Ndrecaj* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vjet, 15) Salih *Muriqi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet, 16) Ilmet *Fanaj* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 vjet dhe 6 muaj, 17) Sylë *Millaku* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet, 18) Xhemail *Shasivari* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet dhe 6 muaj, 19) Zihadin *Ramadani* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vjet, 20) Sezair *Shaipi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vjet dhe 6 muaj, 21) Hilmi *Bujari* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet dhe 6 muaj, 22) Sejdi *Bytyqi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 vjet dhe 6 muaj, 23) Astrit *Koshi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet dhe 6 muaj, 24) Emin *Uka* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet dhe 6 muaj, 25) Bashkim *Braha* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet dhe 6 muaj, 26) Liman *Gashi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vjet dhe 6 muaj, 27) Besnik *Baruti* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet dhe 6 muaj, 28) Vezir *Selaj* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet, 29) Eshref *Berisha* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet, 30) Rrustem *Palushi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet, 31) Orhan *Zajmi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet dhe 6 muaj, 32) Ajet *Gashi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet dhe 6 muaj, 33) Ymer *Kryeziu* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 vjet, 34) Remzi *Ademaj* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vjet dhe 6 muaj, 35) Arhimed *Varoll* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vjet, 36) Gani *Shasivari* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 vjet, 37) Ramush *Krasniqi* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 vjet, 38) Mitat *Elshani* është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 viti. Janë liruar nga akuza Bedri *Abazi* dhe Abdullah *Haxhiimeri*. Akuza është refuzuar kundër Bajram *Megjuani*, Rexhep *Pista* dhe Muhamed *Bekeri*.

Gjatë gjykimit, ai në gazetën “Nasha Borba” më 23 Gusht 1995, në artikullin “Gozhdimi i drejtësisë”⁴⁴, qysh në nëntitull jep vlerësimin e parë: *“Procesi në Prizren në mënyrën e vet bëhet paradigmë e shurdhimit të shtetit në postulatet e drejtësisë dhe të drejtës, tashmë është shumë vonë që ky proces, me elemente të politikës, por s’është politike / por policore. Fatkeqësisht, gjykata është vetëm marionetë në duart e policisë”*. Gjithashtu, ai në gazetën “Nasha Borba” boton artikullin me titull *“Seria e gjykimeve politike në Kosovë”*. Në fillim të artikullit cekë: *“Me siguri rastësisht, sivjet dita ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, në këto hapësira jugosllave, kaloi në shenjën e edhe një skandali në mesin e shumë skandaleve të pushtetit aktual. Gjykatësi Kërstiq me siguri nuk e di se 10 Dhjetori është dita e të drejtave të njeriut. Dijeni të tilla për të janë luks i panevojshëm*.

Procesin në Prizren e ka përcjell edhe gjykatësi i gjykatës së shkallës së parë në Stokholm, Bengi Bondeson. Atë e ka deleguar Komiteti Ndërkombëtar i juristëve nëpërmjet *Ordre de Mission*. Në raportin e tij prej 9 faqe datë 25 Gusht 1995, së pari ka dhënë pasqyrën e “Parakushteve”, ku flet mbi ndryshimet e Kushtetutës, mbi Kushtetutën e vitit 1974, mandej mbi heqjen e autonomisë në vitin 1989 *“pasoja ishte bashkimi i krahinave të mëparshme autonome Serbisë”*. Në këtë pjesë, autori jep pasqyrën e strukturës nacionale. Në kapitullin “Gjykimet në Kosovë më 1994–1995”, thekson se *“në vjeshtën e vonshëm të vitit 1994, është realizuar numri i madh i arrestimeve dhe kryesisht të shqiptarëve në Kosovë. Paditë janë ngritur gjatë pranverës së vitit 1995, ndërsa gjykimet kanë filluar në maj, kundër 72 të akuzuarve në Prishtinë, 44 të akuzuarve në Prizren, 25 të akuzuarve në Pejë dhe afro 30 në Gjiilan. Gjykimi në Prizren ende vazhdon, derisa në gjykimet tjera aktgjykimet janë marrë...në kapitullin “Gjykimi në Prizren”, gabimisht vlerësohet “se gjykata pasandaj ka pranuar se*

⁴⁴ Gazeta “Nasha Borba”, më 23 Gusht 1995, në artikullin “Gozhdimi i drejtësisë”.

deklaratat dhe pranimet nga ana e të akuzuarve në hetime, s'janë dhënë me vullnet të lirë. Duket se gjykata ka pranuar se ka pasur torturë dhe dhunë ndaj të dyshuarve. Prokurori nuk kërkoi që të vërtetohet e kundërta.

Në kapitullin *“Përshtypjet e mia nga gjykimi”*, referuesi thekson: *“Në gjykatore gjendej numri më i vogël i gardianëve, por pa armë. Sipas shënimeve që sigurova mbi gjykimin e 72 të akuzuarve në Prishtinë, atje situata ka qenë tejet ndryshe – në gjykatore ka pasur sasi të madhe armësh automatike...”. mandej përshkruan rrjedhën e gjykitimit lidhur me sigurimin e ndihmës mjekësore për të akuzuarit. Është interesant kapitulli *“Nocioni i gjykitimit politik”*. Referuesi sqaron se nocioni i gjykitimit politik në Perëndim dhe në Jugosllavi ndryshon. Në Perëndim me gjykim politik emërohen deliktet me *“motiv politik”*. Derisa në Jugosllavi, ato janë procese gjyqësore *“një metodë e regjimit për të ulur opinione publike të padëshirueshme”*.*

Në kapitullin *“A është procesi në Prizren proces politik?”*, referuesi, pa mëdyshje, përfundon: *“Çdo gjë thelbësore tregon se në Prizren ka të bëjë me procesin e pastër politik dhe se janë parashtruar veprat penale të konstruktura... Përshtypja ime në përgjithësi është se provat kundër numrit të madh të akuzuarve janë tejet të dobëta. Shumica e të akuzuarve janë policë shqiptarë, të cilët janë përjashtuar ose kanë pushuar të punojnë në polici në periudhën prej 1990 deri 1992. Ata kanë ngelur në sindikata dhe prokurori konsideron se sindikatat paraqesin organizatë të fshehur dhe të rrejshme për veprën penale, e cila parashihet në Nenin 15, të Ligjit Penal. Si provë paraqet se një mitraloz është ruajtur te dy persona në fshat. Ata dy persona s'janë anëtarë të sindikatës. Duhet thënë se në Jugosllavi, sasia e armëve është shumë e madhe te popullata serbe në Kosovë, në vitin 1992. Mandej, si provë thotë se një biznesmen ruan 800 litra benzinë për sindikatën.*

Referuesi përfundon: *“Sipas mendimit tim gjykimi në Prizren është një proces politik në kuptim më parë të përshkruar. Proceset e tilla politike janë keqpërdorim i procesit penal dhe sipas mendimit tim edhe të paarsyeshëm.*

Në fillim të Shkurtit 1996 u dorëzua aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. 9/95, datë 21 Shtator 1995, në 191 faqe. Afati i ankesës është 15 ditë. Por, Gjykata Supreme e Serbisë, seancën publike ka caktuar për 1 Shtator 1997, afro dy vjet pas përfundimit të gjykimit. Mbi përfundimin e gjykimit në Gjykatën Supreme s’kishim iluzione. Qysh në këtë lëndë, dukeshin shenjat e sjelljes kundërligjore të asaj gjykate, posaçërisht i kryetarit të saj, *Ballshi Govedarica*. Gjithashtu, ajo gjykatë tregoi dobësi dhe varësi prej vullnetit të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror në këso lëndësh.

Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Serbisë, PA Nr. 624/96, datë 2 Shkurt 1998, janë refuzuar të gjitha vërejtjet e ankesave. Me aktgjykim simbolikisht janë zbutur dënimet: *Esad Jaha dhe Salih Sokoli* janë gjykuar me pesë vjet burgimi, *Xhemail Haxhimustafa* dhe *Gani Mullaabazi* me dëmin burgimi prej katër vjet; *Nahit Elshani* me dëmin burgimi prej tri vjet dhe dhjetë muaj; *Zehadin Ramadani, Sezair Shaipi dhe Liman Gashi* me dëmin burgimi prej tri vjet; *Halil Kafegjolli, Adem Shala, Ramadan Ndrecaj dhe Arhimed Varolli* me dëmin burgimi prej dy vjet e gjashtë muaj; *Mustafa Shaipi, Hilmi Bujari, Emin Uka, Orhan Zajmi dhe Ajet Gashi* me dëmin burgimi prej dy vjet; *Faik Jasiqi, Salih Muriqi, Astrit Koshi, Vezir Selaj, Eshref Berisha, Rustem Palushi dhe Ymer Kryeziu* me dëmin burgimi prej një vjet dhe gjashtë muaj, *Shaban Dana, Ilmet Fanaj dhe Sylë Millaku* me dëmin burgimi prej një vjet; *Ramush Krasniqi* me dëmin burgimi prej dy vjet.

4.2.16. Shkelja e ligjit në procedurë penale

Duke e bërë një vështrim kronologjik dhe duke analizuar përgjigjet e avokatëve të anketuar nga të cilat përgjigje na rezultojnë defekte serioze të sistemit të drejtësisë në

aplikimin e politikave penale në harkun kohor 81/99. Këto defekte bazën e kanë në shkeljen e ligjit, nga ata të cilët kanë qenë të obliguar në zbatimin e drejtë të tij. Pra, shkelësit kryesor të ligjit në këtë sistem del të jenë vetë ata të cilët thirren në ligj dhe kanë qenë të obliguar të zbatojnë ligjin. Prej 47 avokatë të pyetur se, sipas mendimit tuaj profesional a mendoni se është shkelur ligji gjatë zhvillimit të procedurës penale kundër personave të dënuar për këto vepra? Prej 47 avokatë , 96.6% janë deklaruar po, dhe, vetëm 6.4% janë deklaruar jo. Duke i analizuar dhe krahasuar gjetjet që kanë rrjedhur nga përgjigjet e këtij pyetësi, mund të konstatojmë se, shkelësit kryesor të ligjit janë ata të cilët kanë vepruar në emër të ligjit. Dukuria e shkeljeve të ligjeve penale të aplikueshme nga organet e rendit dhe drejtësisë të RFSJ dhe Republikës së Serbisë në Kosovë gjatë viteve 1981/1999, është normë e pashkruar e cila shpërfaqet sheshazi në të gjitha fazat e procedurës penale të zhvilluara në Kosovë kundër personave të ndjekur për bindje politike. Pra, ligji shkelej nga të gjithë, për të gjithë. Nga Sigurimi sekret shtetëror që bënte punën e policit, prokurorit dhe gjyqësorit, nga prokurori që miratonte dhe koketonte me sigurimin sekret shtetëror dhe nga gjyqësori që duke u vu në funksion të politikës nxirrte vendime gjyqësore të pa bazuara në ligj.

4.3. Diskutim dhe analizë mbi rezultatet e pyetësorit për prokurorë

Gjinia		Nr.	%
Femër		2	6.5
Mashkull		29	93.5
Totali		31	100

1	Në periudhën kohore 1981-1999, e keni ushtruar profesionin e:	Nr.	%
	Prokurores	2	6.5
	Prokurorit	29	93.5
	Totali	31	100

2	Gjatë kësaj periudhe kohore që keni ushtruar profesionin e prokurorit, sa e keni ndier veten të lirë dhe të sigurt në ushtrimin e profesionit tuaj?	Nr.	%
	Pak	2	6.5
	Pjesërisht	11	35.5
	Shumë	15	48.4
	Plotësisht	3	9.7
Totali		31	100

3	Në kujtesën tuaj, a ka pasur aktakuza kolektive, e kemi fjalën për persona të akuzuar në grup?	Nr.	%
	Po	31	100

3.1	Nëse PO, në sa raste?	Nr.	%
		1	3.2
	Kryesisht	1	3.2
	mendoj të gjitha rastet	2	6.5
	pothuajse të gjitha rastet	5	16.1
	shumica e rasteve	2	6.5
	të gjitha	1	3.2
	të gjitha rastet	1	3.2
	të gjitha rastet	17	54.8
	të gjitha rastet	1	3.2
Totali		31	100

4	Sa ju kujtohet ju në këtë periudhë kohore, nga viti 1981-1999, cila ishte natyra e aktakuzave që dominonte?	Nr.	%
	Vepra penale me karakter politik	22	71.0
	Vepra penale apo krime të rëndomta	9	29.0
	Totali	31	100

5	Bazuar në eksperiencën tuaj, gjatë fazës së hetuesisë sa respektoheshin liritë dhe të drejtat e njeriut?	Nr.	%
	Shumë	3	9.7
	Pjesërisht	15	48.4
	Pak	13	41.9
	Totali	31	100

6	A ka qenë tortura vepër penale sipas legjislacionit në fuqi, gjatë viteve 1981-1999?	Nr.	%
	Po	31	100

7	Sipas mendimit tuaj a ka pasur torturë ndaj personave të akuzuar gjatë fazës së hetuesisë?	Nr.	%
	Pak	5	16.1
	Pjesërisht	12	38.7
	Shumë	14	45.2
Totali		31	100

8	Shikuar në retrospektivë, sa jeni të bindur se të akuzuarit për vepra penale politike kanë qenë fajtorë?	Nr.	%
	Shumë	2	6.5
	Pjesërisht	16	51.6
	Pak	13	41.9
Totali		31	100

9	Cili është mendimi juaj sot, sa kanë qenë të drejta ato akuza për vepra penale politike?	Nr.	%
	Shumë	2	6.5
	Pjesërisht	20	64.5
	Pak	9	29.0
Totali		31	100

10	Duke u bazuar nga eksperiencia juaj, a ka pasur mbrojtja e të akuzuarve kushte dhe trajtim të barabartë nga gjykata, në raport me institucionin e akuzës?	Nr.	%
	Plotësisht	2	6.5
	Pjesërisht	17	54.8
	Pak	12	38.7
Totali		31	100

11	Ju jeni profesionist i fushës tuaj, çfarë mendoni ju, cili ka qenë qëllimi i dënimit për veprat penale me karakter politik?	Nr.	%
	Ndëshkimi	18	58.1
	Ndëshkimi dhe risocializimi	13	41.9
Totali		31	100

12	A mendoni se vendimet e shqiptuara nga gjykatat kanë qenë meritore?	Nr.	%
	Po, plotësisht	2	6.5
	Pjesërisht	26	83.9
	Pak	3	9.7
Totali		31	100

13	Sipas mendimit Tuaj, sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore?	Nr.	%
	Shume	12	38.7
	Pjesërisht	16	51.6
	Pak	2	6.5
	Aspak	1	3.2
Totali		31	100

14	A mendoni se ka pasur procese të montuara politikisht, për vepra penale me karakter politik?	Nr.	%
	Po	9	29.0
	Jo	2	6.5
	Nuk e di	20	64.5
Totali		31	100

15	Të akuzuarit për vepra penale me karakter politik, sipas jush cilit nacionalitet i përkisnin	Nr.	%
	Shqiptarë	30	96.8
	Të tjerë	1	3.2
	Totali	31	100

16	Sa kanë pasur mundësi organizatat vendore që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?	Nr.	%
	Shumë	1	3.2
	Pjesërisht	13	41.9
	Pak	16	51.6
	Aspak	1	3.2
	Totali	31	100

17	Sa kanë pasur mundësi organizatat ndërkombëtare që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?	Nr.	%
	Shumë	1	3.2
	Pjesërisht	11	35.5
	Pak	19	61.3
	Totali	31	100

18	A ju kujtohet të keni ngritur ju ndonjë aktakuzë kundër policëve apo hetuesve që kanë keqtrajtuar apo torturuar të akuzuar për vepra penale me karakter politik?	Nr.	%
	Po	3	9.7
	Jo	13	41.9
	Nuk më kujtohet	15	48.4
	Totali	31	100

19	A ju kujtohet ndonjë rast që ndonjë polic apo hetues është dënuar për keqtrajtim apo torturim të personave të akuzuar për vepra penale me karakter politik?	Nr.	%
	Po	1	3.2
	Jo	7	22.6
	Nuk më kujtohet	23	74.2
	Totali	31	100

20	A mendoni se procedurat e zhvilluara në proceset gjyqësore kundër personave të dënuar, kanë qenë në harmoni të plotë me ligjet në fuqi dhe me konventat ndërkombëtare?	Nr.	%
	Plotësisht	1	3.2
	Shumë	2	6.5
	Pjesërisht	14	45.2
	Pak	13	41.9
	Aspak	1	3.2
Totali		31	100

21	Duke shikuar këtë çështje nga këndvështrimi historik, a mendoni se këto dënime kanë qenë vendime juridike me motive politike-etnike?	Nr.	%
	Shumë	1	3.2
	Pjesërisht	21	67.7
	Pak	7	22.6
	Aspak	2	6.5
	Totali	31	100

Një kategori e cila ka ngjallur interes të jashtëzakonshëm për këtë hulumtim është edhe përfshirja e institucionit të akuzës në interes dhe funksion të ndriçimit të dilemave të caktuara për këtë studim. Përgjigjet e pyetjeve të parashtruar në këtë pyetësorë, i kemi pare me interes specifikë, sepse institucioni i akuzës ka qenë palë në procedurën penale të zhvilluar në KSKA, gjatë viteve 1981/1999. Nga 31 prokurorë të anketuar, 93.5% janë meshkuj, dhe, 6.5% janë femra. Duhet cekur që në fillim se mundësia për të pasur qasje në anketimin e kësaj kategorie nuk ka qenë aspak e lehtë. Por, me insistimin konsistent kemi arritur që të kontaktojmë dhe sigurojmë një numër relativisht të konsiderueshëm dhe relevant të kësaj kategorie të anketuarve. Duke vu theksin se kjo kategori e kanë qenë protagonistë direkt dhe indirekt të ngjarjeve të zhvilluara në Kosovë gjatë viteve 1981/1999, ju kemi drejtuar me disa pyetje specifike lidhur me eksperiencën e tyre në zhvillimin e ngjarjeve të apostrofuara.

4.3.1. Siguria dhe liria në punë e prokurorit

Pyetja e parë e cila është parashtruar në drejtim të prokurorit ka të bëjë me faktin se sa të lirë dhe të sigurt jeni ndier në ushtrimin e profesionit tuaj në harkun kohor 1981–1999. Kjo pyetje nuk është aspak më e parëndësishme se pyetjet tjera, duke u nisur nga

fakti se sistemi gjyqësorë në Kosovë gjatë viteve 1981–1999, është shoqëruar me probleme serioze prej natyrave më të ndryshme, dhe kryefjala e problemit ka qenë ndërhyrja e politikës në drejtësi. Saktësisht në pyetjen drejtuar prokurorëve se, gjatë kohës që keni ushtruar profesionin e prokurorit sa e keni ndier vetën të lirë dhe të sigurt në ushtrimin e profesionit tuaj? Prej 31 prokurorëve 6.5% janë deklaruar pak, 35.5% janë deklaruar pjesërisht, 48.4% janë deklaruar shumë, dhe, vetëm 9.7% janë deklaruar plotësisht. Një sistem drejtësie ku një numër prokurorësh relativisht i konsiderueshëm deklarojnë se nuk janë ndier të sigurtë në ushtrimin e profesionit të tyre, ai sistem drejtësie lë shumë për të dëshiruar. Në kontekst të këtij rezultati shtrohet pyetja se, se si janë ndier personat e privuar nga liria në aspektin fizikë dhe juridik, përderisa një numër prokurorësh kanë deklaruar se nuk e kanë ndier sigurinë e plotë për të ushtruar profesionin e tyre. Por, analiza e jonë nuk do quhej e plotë dhe objektive, nëse nuk do t'i trajtojmë edhe tre faktorë të cilët kanë mundur të ndikojnë rezultatin e paraqitur. Faktori i parë i cili duhet merrej në konsideratë është fakti se ky anketim është bërë më shumë se 20 vite pas zhvillimit të ngjarjeve, me një sistem komplet tjetër politik dhe juridik, dhe natyrshëm këto elemente mund të kenë ndikimin në këtë rezultat. Faktori i dytë i cili konsiderojmë se është po aq i rëndësishëm sa i pari, ka të bëjë me faktin se një numër i të anketuarve mund të ndihen fajtorë për ngjarjet e ndodhura, dhe nëpërmjet justifikimeve të ndryshme pretendojnë në shfajësimin e tyre. Jam i detyruar të konstatojë se gjatë punës hulumtuese dhe zhvillimore të punimit tonë doktorat, kam hasur në hezitime serioze dhe në shumë raste dhe të pa kapërcyeshme të ish prokurorëve cilët kanë hezitur të bëhen pjesë e këtij hulumtimi, gjë e cila nuk ka ndodhur me avokatët dhe të dënuarit. Një element me relevancë në këtë temë dhe që është me rëndësi të potencohet se gjatë hulumtimit për këtë materie, kemi hasur në burime të ndryshme që në një formë apo tjetër pasqyrojnë ndërhyrjet dhe kurdisjet e Sigurimit shtetëror të Serbisë në organet e akuzës dhe gjyqësisë. Kjo e gjetur nuk e justifikon

punën e organit formal të akuzës, por konsiderojmë se për arsye objektive është e udhës të potencohet kjo rrethanë.

4.3.2. Lloji i akuzave që ka dominuar në harkun kohor 81/99, dukuria kolektive

Dukuria e akuzave, gjyqimeve dhe dënimeve kolektive është një dukuri dhe një karakteristikë e veçantë e cila e ka përcjell sistemin gjyqësor në periudhën 1981–1999. Në analizën krahasuese të rezultateve të personave të anketuar nga të gjitha kategorive, rezulton se, për vepra penale me natyrë politike, akuzat dhe gjykimet kanë qenë kolektive! Një konstatim të tillë e vërteton edhe rezultati i pyetësorit me të anketuarit prokurorë. Prej 31 të anketuarve në pyetjen e parashtruar se, a ka pasur aktakuza kolektive, në grupe? Përgjigja ka rezultuar 100% po! Pra, një ndër të metat bazike të institucionit të akuzës në harkun kohor 81/99, rezulton të jetë edhe pretendimi për gjetur dhe vërtetuar fajësi kolektive. Ky rezultat nuk e përjashton mundësinë e limituar të rasteve individuale të personave të ndjekur për vepra penale me karakter politik, por në masë absolute ky rezultat paraqet dukurin kolektive të akuzave dhe dënimeve në grupe. Për shkak të zhvillimeve politike që kanë ndodhur në Krahinën Socialiste Autonome të Serbisë gjatë viteve 81/99 edhe shtrirja e aktakuzave për vepra penale me natyrë politike ka marrë përmasa të gjëra në shoqëri. Segment i posaçëm i dhunës shumë të rëndë është kriminalizimi masiv i kërkesave legjitime të shqiptarëve për vetëvendosje. Kësisoj, vetëm gjatë periudhës dhjetë vjeçare (1981-1999), nga gjyqet e ish-Jugosllavisë, për vepra penale politike u dënuan me dënime drakonike 3.348 shqiptarë, kryesisht të rinjtë deri në moshën 26 vjeçare (Salihu I., 1995, 45).

Në pyetjen e parashtruar të anketuarve prokurorë, sa ju kujtohet juve në harkun kohor prej vitit 81/99, cila ishte natyra e aktakuzave që dominonte? Prej tyre, 71.0% janë deklaruar për vepra penale me karakter politikë, dhe, 29.0% janë deklaruar për vepra

penale apo krime të rëndomta. Zbërthimi i këtij rezultati ka të bëjë me lëvizjet studentore për liri, të manifestuara me demonstratat studentore të vitit 1981 dhe demonstratat gjithë popullore të mbajtura në vitin 1989. Pas këtyre zhvillimeve ka filluar edhe vala e arrestimeve, aktakuzave dhe dënimeve në masë, e cila valë ka zgjatur afërsisht dy dekenie.

Në harkun kohor 1981–1999 ka dominuar ndjekja penale për këto lloji veprash penale: Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror, Neni 114 i Ligjit Penal të RSFJ, Cenimi i tërësisë territoriale, Neni 166; Dhuna nga motive armiqësore kundër RSFJ, Neni 123; Terrorizmi, Neni 125; Pjesëmarrja në veprimtari armiqësore, Neni 131; Propaganda armiqësore, Neni 133; Nxitja e urrejtës, të përçarjes ose mos tolerancës nacionale, raciale dhe fetare, Neni 134; Bashkimi për veprimtari armiqësore, Neni 136; (Ligji Penal i RSFJ).

4.3.3. Shkelja e të drejtave të njeriut në fazën e hetuesisë dhe paraburgimit

Thembra e Akilit e sistemit gjyqësor dhe aplikimit të politikës penale ka qenë tortura e ushtruar kundër personave të privuar nga liria me qëllim të pranimi të fajësisë. Ndikimet politike në sistemin e gjyqësorit e kanë shfrytëzuar torturën si mjetë dhe metodë për t'i realizuar objektivat e tyre politike. Andaj, kjo pyetje jo rastësisht iu është parashtruar edhe të anketuarve të cilët kanë e përfaqësuar organin e akuzës. Kjo pyetje është parashtruar me synimin për të arritur deri të një vërtetë relativisht objektive. Në pyetjen parashtruar prokurorëve të anketuar, sipas mendimit tuaj a është ushtruar torturë kundër personave të privuar nga liria gjatë fazës së hetuesisë? Prej 31 prokurorëve, 16.1% janë deklaruar pak, 38.7% janë deklaruar pjesërisht, 45.2% janë deklaruar shumë. Nëse i referohemi burimit nga rrjedhë ky rezultat, atëherë mund të konstatojmë se gjatë zhvillimit të procedurës penale në mënyrë permanente janë shkelur dhe mohuar

liritë dhe të drejtat e njeriut nga organet e rendit dhe drejtësisë. Pra, faktet tregojnë se në periudhën 1945-deri në 1999 populli shqiptar i Kosovës ka kaluar nëpër tortura të rënda, keqtrajtime, maltretime, plagosje, gjymtime dhe vrasje, nëpër burgje dhe paraburgime të Ish-Jugosllavisë dhe Serbisë. Këto vuajtje, vrasje, tortura, burgime dhe keqtrajtime, nuk i ka përjetuar asnjë popull në Kontinentin Evropian, nga pas Lufta e Dytë Botërore e këndej.

4.3.4. Vështrim në retrospektiv–opinion nga prokurorët

Bazuar në faktin se anketimin e prokurorëve e kemi zhvilluar në një kohë relativisht të gjatë pas zhvillimit të ngjarjeve të ndodhura dhe duke i marrë parasysh faktin se kanë pushuar së vepruari rrethanat të cilat kanë ndikuar në ato ngjarje, e kemi parashtruar këtë pyetje? Shikuar në retrospektive, sa jeni të bindur se të akuzuarit dhe të dënuarit për vepra penale me natyrë politike kanë qenë fajtorë? Prej 31 të anketuarve, 6.5% janë deklaruar shumë, 51.6% janë deklaruar pjesërisht, dhe, 41.9% janë deklaruar pak. Në analizën tonë pasqyrën e këtij rezultati duhet lexuar nga dy këndvështrime. E para, duhet pasur parasysh faktin se në harkun kohor kur janë zhvilluar këto ngjarje ka qenë një sistem tjetër politik dhe juridik, dhe të anketuarit e këtij rezultati kanë qenë protagonistë në ngjarje të caktuara. E dyta dhe e fundit, duke u ndodhur tashmë në një realitet të ri politik dhe juridik, të anketuarit natyrshëm në vazhden e këtyre përgjigjeve tentojnë që të përfitojnë një “amnistie” morale, duke qenë se edhe vetë kanë përfaqësuar organin e akuzës në procedurë penale. Është i rëndësishëm fakti se në këtë përgjigje kemi një konstatim relativisht të pranueshëm nga prokurorët për ngjarjet e ndodhura në periudhën kohore 1981–1999.

4.3.5. Pozicioni akuzë–mbrojtje në zhvillimin e procedurës penale 1981–1999

Edhe në zhvillimin e procedurës penale në të drejtën penale bashkëkohore në kuptimin e gjerë, barazia e palëve dhe pozicioni i palëve në procedurë penale është një sfidë reale

për sistemin e drejtësisë. Të pretendosh në barazi të palëve në sistemin e aplikueshëm penal në KSAK, në harkun kohor 1981–1999, duke u bazuar në zhvillimin e ngjarjeve duket se nuk është pritje shpresëdhënëse. Meqenëse, kanë pushuar rrethanat të cilat e kanë determinuar dhe afektuar zhvillimin e atyre ngjarjeve, e kemi parë me interes që të marrim edhe opinionin e palës kundërshtare në procedurë penale. Në pyetjen e parashtruar prokurorëve të anketuar, duke u bazuar në eksperiencën tuaj, a ka pasur mbrojtja e të akuzuarve kushte dhe trajtim të barabartë nga gjykata, në raport me institucionin e akuzës? Prej 31 të anketuarve, 6.5% janë deklaruar shumë, 54.8% janë deklaruar pjesërisht dhe 38.7% janë deklaruar pak. Në analizën tone këtë pasqyrë të këtij rezultati e shohim me një relevancë, jo vetëm për faktin statistikor, por më shumë nga subjekti nga ka rrjedhë ky rezultat. Pra, kur një ish pale kundërshtare në procedurë penale, deklaron dhe pohon se ish palës kundërshtare ju ka mohuar e drejta në procedurë penale, kjo mbështet faktin se gjykata ka qenë e njëanshme dhe subjektive në procedurë penale duke i vendosë palët në pozitë të pabarabartë. Zhvillimet e ndodhura në Kosovë gjatë kësaj periudhe tregojnë se, trinomi, polici-hetuesi, akuzë dhe gjyqësor, ishin një palë në procedurë, përballë mbrojtjes me klientin e saj që ishin të vetmuar në këtë proces. Pra, këtu kemi shtetin-pushtetin në njërën anë dhe qytetarin e përndjekur në anën tjetër.

4.3.6. Qëllimi i dënimit sipas organit të akuzës

Nisur nga fakti se prokuroria ka qenë palë në zhvillimin e ngjarjeve të cilat i trajtoj në këtë hulumtim – studim, e kam konsideruar me interes t'i parashtrojmë disa pyetje specifike në funksion të shërbimit të hipotezave të ngritura në studim. Në pyetjen drejtuar prokurorëve të anketuar se, cili ka qenë qëllimi i dënimit për vepra penale me karakter politikë? Prej 31 prokurorëve, 58.1% janë përgjigjur ndëshkimi, 41.9% janë përgjigjur ndëshkimi dhe risocializimi. Ndërsa, në pyetjen e parashtruar, a mendoni se

vendimet e shqiptuara nga gjykata kanë qenë meritore? Prej tyre 6.5% janë deklaruar shumë, 83.9% janë deklaruar pjesërisht dhe 9.7% janë deklaruar pak. Referuar këtyre rezultateve mund të konstatojmë se gjatë vitit 1981/99, për vepra penale me natyrë politike në KSKA, qëllimi i dënimit nuk ka qenë në funksion të së drejtës penale bashkëkohore në kuptimin e gjerë, por, në funksion të politikave ditore, të cilat politika e kanë instrumentalizuar gjyqësorin në shërbim të interesave të tyre. Kjo pasqyrë e cila ka rrjedhur nga ky rezultat, i nxjerrë në sipërfaqe dy fakte shumë të rëndësishme. Fakti i parë ka të bëjë atë se, personat nuk janë dënuar në interes të së mirës së përgjithshme, pra në interes të shoqërisë dhe individit me qëllim të risocializimit të tyre apo ri-integritimit në shoqëri, por, në interes të pushtetit dhe politikës me qëllim ndëshkimit dhe persekutimit politik. Dhe fakti tjetër, ka të bëjë me atë se shumica e tyre janë dënuar në mungesë fajësisë. Pra, këto elemente ishin karakteristika të thekura që e karakterizuan sistemin e drejtësisë penale në Kosovë gjatë periudhës kohore 1981–1999.

4.3.7. Ndikimi i gjyqësorit nga politika–montimi i proceseve politike

Ngjarjet e zhvilluara politike në RSFJ, në harkun kohor 1981–1999, kanë afektuar dhe cenuar rëndë sistemin gjyqësorë në KSAK. Pas këtyre zhvillimeve dhe ndryshimeve politike dhe juridike, sidomos pas vitit 1989, nuk mund të bëhej fjalë më për një sistem të pavarur gjyqësorë. Në pyetjen drejtuar prokurorëve të anketuar se, a kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësor? Prej tyre 38.7% janë deklaruar shumë, 51.6% janë deklaruar pjesërisht, 6.5% janë deklaruar pak dhe vetëm 3.2% janë deklaruar aspak! Në analizën tonë është rëndësi që këto rezultate mos t'i lexojmë vetëm si statistika, por të futem në brendi të faktorëve që kanë nxjerrë këto rezultate. Mund të konkludojmë se ndryshimi i rrethanave politike, juridike dhe konteksti kohor na kanë ofruar pasqyrën një rezultat të tillë. Në të kundërtën, do të ishte irracional pretendimi që

këtë rezultat të siguruar nga këta pyetësorë, të pretendojë ta sigurosh në kohën kur këta prokurorë e kanë kryer detyrën e tyre shtetërore. Pra, faktori kohë, rrethanat e ndryshuara politike dhe juridike, kanë determinuar mundësinë e një rezultati të tillë.

Gjatë rrugës për hulumtim, duke shfletuar burime dhe material të natyrave të ndryshme, gjithmonë kemi hasur në pretendime relativisht të bazuara se, në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, në intervalin kohor 1981–1999, janë montuar shumë procese gjyqësore me motive politike. Kjo barrë ka rëndu mbi sistemin gjyqësorë të asaj kohe, i cili sistem ra në llupën e interesave politike dhe u shmang nga parimet bazë të drejtësisë. Andaj, në pyetjen drejtuar prokurorëve të anketuar të cilët kanë qenë palë në zhvillimin e këtyre ngjarje, e kemi pa me interes ta parashtrojmë në funksion të pasurimit të hulumtimit të studimit. Në pyetjen e parashtuar se, a mendoni se ka pasur procese penale të montuara politikisht, për vepra penale me karakter politikë? Prej tyre 29.0% janë deklaruar po, 6.5% janë deklaruar jo, dhe, 64.5 janë deklaruar nuk e dim. Nuk mund ta anashkalojmë analizën e kësaj përgjigje, duke e krahasuar me përgjigjën e pyetjes paraprake. Prokurorët e pyetur në pyetjen paraprake e cila ishte: A kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore? Përgjigja ishte 38.7% shumë dhe 51.6% pjesërisht. Por, në pyetjen pasuese, e cila ishte: A mendoni se ka pasur procese penale të montuara politikisht, për vepra penale me karakter politikë? Përgjigja ishte 29.0% po, dhe 64.5% nuk e dimë! Pra, prokurorët e pohojnë në shumicë absolute se rrethanat kanë ndikuar, por, nuk pranojnë të pohojnë me të njëjtën përqindje se kanë ekzistuar proceset e montuara. Përgjigja e pyetjes së dytë lë shumë për të dëshiruar, por, në anën tjetër mund të justifikohet me vet faktin se prek anën subjektive të personave në anketim. Proceset e montuara politike ishin prezent në të gjitha gjykatat e rregullta dhe ushtarake. Nga gjyqet ushtarake u dënuan 1.100 ushtarë shqiptarë. Procese penale politike të montuara ndaj shqiptarëve , nga gjyqet ushtarake u organizuan sidomos pas masakrës në

Kazermën e Paraqinit të vitit 1987. Ky kriminalizim masovik shpiu që shqiptarët të përbëjnë 90 për qind të të dënuarve politikë në ish-Jugosllavi, edhe pse në popullsinë e gjithëmbarshme participonin me rreth 12% (Salihu I., 1995, 45).

Montimet i proceseve gjyqësore, penale- politike, ishin prezent si në gjykatat të rregullta edhe në ato ushtarake, gjithmonë në funksion dhe shërbim të qëllimeve të caktuara politike.

4.3.8. Nacionaliteti i personave të dënuar për vepra penale të natyrës politike

Sa i përket nacionalitetit të personave të dënuar në KSAK gjatë viteve 1981–1999, nuk nevojitet ndonjë analizë e thellë për të arritur këtë rezultat. Këtë mendim e bazojmë në faktin se në këtë hark kohor ishte populli Shqiptarë i Kosovës që bënte përpjekje për t'i realizuar të drejtat e tij, dhe për të fituar lirinë. Në pyetjen drejtuar të anketuarve se, të akuzuarit për vepra penale me natyrë politike, sipas juve cilit nacionalitet i takonin? Prej tyre 96.8% janë deklaruar Shqiptarë dhe. Vetëm, 3.2% janë deklaruar të tjerë! Në fakt ky rezultat nuk paraqet ndonjë të papritur, sepse botërisht është i njohur fakti se, populli Shqiptarë për disa dekada ka bërë përpjekje për liri! Prandaj, edhe ky rezultat nuk paraqet ndonjë përjashtim. Fakti se shqiptarët përbënin shumicën absolute të burgosurve politikë në ish-Jugosllavi tashmë është katërcipërisht e vërtetuar. Pra, nga totali i të burgosurve politikë në ish-Jugosllavi, 90% e të burgosurve politikë ishin shqiptarë. Ky rezultat tregon dyndjen masive të pushteteve policore, gjyqësore dhe ushtarake të Federatës dhe Serbisë, për të kërkuar fajësi kolektive te një popull që bënte përpjekje për liri. Por, duhet potencuar se, në raste të izoluara gjatë këtij studimi kemi hasur edhe në qytetarë të nacionaliteteve tjera si, turq dhe goranë, të cilët janë konsideruar si të papërshtatshëm dhe janë ndjekur politikisht. Një rast i till ishte edhe ai i familjes Beshiri, që jetonte në Batajnicë të R.S. Goranët janë të fesë islame, flasin maqedonisht,

ndërsa vishen si shqiptarë. Kjo është arsyeja e përvetësimit të tyre prej serbëve, maqedonasve dhe shqiptarëve. Por, ata me kokëfortësi thonë se janë grupi etnik i veçantë “gorane”. Por, çdoherë janë varur nga pushteti. Për të mbrojtur familjet e tyre, e sidomos për të siguruar punën e pandërprerë në krahinat e ndryshme, në rrethanat e ndryshme historike, ata deklaroheshin me përkatësi kombësive të ndryshme. Kështu, në vitin 1956 dhe disa vjet më tej, deklaroheshin si “turq”, pasi vetëm ashtu mundnin të shkojnë lirisht jashtë, në Turqi në rend të parë. Më vonë u pajtuan që t’u përcaktohet origjina serbe dhe ortodokse, për ç’arsye gëzonin privilegje të veçanta nga pushteti serb “në kohën e Millosheviqit.

Në Beograd, një numër i Goranëve dhe shqiptarëve merrnin me shitjen e fareve të pjekura në garat e ndryshme sportive, para kinemave dhe rastet tjera ku tuboheshin shumë njerëz. Për shkak të propagandës kundër shqiptare, shqiptarët u tërhoqën, ndërsa Goranët vazhduan. Por, pasi kishin emrat dhe mbiemrat e njëjta si shqiptarët, atyre u ra ndërmend që para shportave të tyre me farë, venin pankartën me shkrim: “*Unë s’jam shqiptar, unë jam goran*”. Por, çdoherë s’mund të identifikohesh me kohë...

Në fillim të Janarit 1986, gorani *Miriman Beshiri*, i cili me familje jetonte në Batajnicë, ai dhe familja e tij s’ishin në marrëdhënie të mira me fqinjin, serb, i cili banonte në katin mbi këta. Shpesh harronte të mbyllë çesmën, për ç’arsye vinte deri te derdhja e ujit në banesën e tyre. Atë ditë, më 19 Qershor 1985, fqinji, njeri i moshuar, në mëngjes herët shkatërronte kopshtin e Beshirëve me kositëse. Goranka del jashtë dhe e pengon plakun, duke i‘a marrë kositësen për t’ia dorëzuar policisë, por pas saj fqinji vrapon me revole dhe shufër gome. Në banesë e çarmatosin anëtarët e familjes dhe të gjitha ia dorëzojnë policisë. Por, Policia, në vend që të parashtrojë fletëparaqitjen kundër fqinjit plak, i cili shkaktoi dëme dhe posedonte revole dhe shufër gome, paraqet kërkesë për zhvillimin e procedurës për kundërvajtje kundër të gjithë anëtarëve të familjes Beshiri.

Kështu, kjo ngjarje u shfrytëzua për zhvillimin e tri procedurave kundër familjes Beshiri: Në procedurën për kundërvajtje, UP 5063/85, datë 25 Nëntor 1985, *Beshiri Nexhida dhe Miriman*, shpallen përgjegjës “pse me datë 19 Qershor 1985, në ora 04:20, në Batajnicë, para ndërtesës për banim Nr. 34/1 në rrugën Aradhet e Podravinës kanë prishur rendin dhe qetësin publike në atë mënyrë se kanë rrahur V.T., nga Batajnica, dhe në rrahje e pandehura e parë e ka mëshuar nëpër këmbë me shufër druri, ndërsa i pandehuri i dytë kësaj i ka ndihmuar duke mbajtur V.T., meqë kanë kryer kundërvajtje ..., andaj të pandehurit gjobitë me nga 3.000 din. dhe dhe shpenzimet e procedurës.

Me siguri se, për shkak të faktit se fqinji V.T., pas paraqitjes së rastit duhej të përgjigjej për kundërvajtje për shkak të shkakimit të dëmit dhe rrezikimit të sigurisë së Beshirëve për shkak të bartjes së revoles dhe shufrës prej gome më datë 19 Qershor 1985, dikush “ka këshilluar” V.T. që të parashtrojë padi private penale kundër Beshiri Mirimanit. Padia është parashtruar më 6 Korrik 1985 për shkak të ofendimit “se me datë 14 Qershor 1985, afër orës 19, në Batajnicë, në korridorin e ndërtesës për banim Nr. 34, në rrugën Aradhet e Posavinës, ka nënçmuar paditësin privat V.T., duke folur në praninë e personave të tretë: “Tosho, Tosho, ta q... Zotin tënd serb”, çka mund t’i dëmtojë nderit dhe imazhit të paditësit privat”.

Gjykata e Katërt Komunale në Beograd me aktvendimin, VI P. Nr. 1639/85, datë 4 Tetor 1985, i shqipton Beshiri Mirimanit vërejtje gjyqësore. Shihet se ky aktvendim është marrë para aktvendimit të gjykatësit për kundërvajtje. Në atë procedurë, i padituri Beshiri ka mohuar ngjarjen. Kishte thënë se me paditësin privat ishin në marrëdhënie të keqija për shkak të “vërshimit të banesës nga uji” për çka shumë herë iu është ankuar kryetarit të këshillit shtëpiak. Monitorimi i procedurës penale nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare sipas organit të akuzës.

Organizatat që monitorojnë liritë dhe të drejtat e njeriut kanë një rol të rëndësishëm në funksion të përmirësimit të kushteve për personat që janë të privuar nga liria. Gjatë monitorimit të gjitha fazave të procedurës penale këto organizata japin kontributin e tyre duke dhënë sugjerime, këshilla, vërejtje dhe rekomandime, në drejtim të përmirësimit të sistemit gjyqësor, dhe, në funksion të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në procedurë penale. Në pyetjen parashtruar prokurorëve të anketuar se , sa kanë pasur mundësi organizatat që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut për t'i monitoruar proceset gjyqësore në të gjitha fazat e procedurës penale? Prej tyre janë përgjigjur 3.2% shumë, 41.9% janë përgjigjur pjesërisht, 51.6% janë përgjigjur pak, dhe, vetëm 3.2% janë përgjigjur aspak! Në analizën tonë na rezulton se sistemi gjyqësorë gjatë viteve 81/99, nuk ka qenë mjaftueshëm i hapur dhe transparent në drejtim të mekanizmave joqeveritarë të cilët kanë proklamuar liritë dhe të drejtat e njeriut në procedurë penale. Kjo mbyllje dhe hezitim i sistemit për të qenë kooperativë dhe bashkëpunues me mekanizma vendor dhe ndërkombëtar që monitorojnë liritë dhe të drejtat e njeriut në proces penal, ka ardhur më shumë si rezultat i vetë gjendjes në të cilën kanë qenë ata persona. Pra, sistemi i drejtësisë në Kosovë gjatë viteve 1981–1999 ka pasur shumë për të mos parë, dhe të mos thënë në drejtim të organizatave që monitorojnë liritë dhe të drejtat e njeriut në procedurë penale, andaj dhe ka hezituuar në bashkëpunim. Por, gjithsesi edhe me mundësitë e limituara dhe kufizimin e bërë nga sistemi, prapëseprapë roli që këto organizata kanë luajtur ka qenë me interes për personat e privuar nga liria.

4.3.9. Harmonizimi i ligjeve nacionale me aktet ndërkombëtare sipas akuzës

Harmonizimi i ligjeve nacionale me akte juridike ndërkombëtare është sfidë edhe për sistemin e drejtës penale bashkëkohore. Në intervalin kohor që është objektiv hulumtimi i studimit, kanë ekzistuar shumë akte dhe konventa ndërkombëtare me karakter

universal, të cilat janë afirmuar nga shtetet përkatëse, por më shumë kanë ngelur në suaza deklarative. Aktet më të rëndësishme në fushën e procedurës penale janë: Deklarata për mbrojtjen e të gjithë individëve nga tortura dhe veprimet e tjera johumane dhe poshtëruese përkatësisht nga dënimet (1975), Konventa kundër torturës dhe veprimeve të tjera mizore johumane dhe poshtëruese ose dënimet (1984), Garancitë për të mbrojtjen e personave të cilëve u kanoset dënimi me vdekje (1984), Deklarata mbi parimet themelore të jurisprudencës për viktimat e krimeve dhe keqpërdorimit të forcës (1985), Parimet themelore për pavarësinë e gjyqeve (1985), Rregullat standard minimale të gjyqeve penale për të mitur (të ashtuquajturat rregullat e Pekinit) etj. Fakti se të drejtat dhe liritë e njeriut mbroheshin me shumë akte dhe konventa ndërkombëtare, kjo nuk e pengoi aspak RFSJ dhe Serbisë që përmes dhunës policore, gjyqësore, ushtarake dhe politike, të ushtroi torturë, ndjekje, keqtrajtime, gjymtime, dënime drakonike dhe vrasje të shqiptarëve të pafajshëm. Të gjitha këto i ushtronte nën petkun e drejtësisë dhe flluskës së pushteti juridik.

Në pyetjen parashtruar prokurorëve të anketuar se, a mendoni se procedurat e zhvilluara në proceset gjyqësore kundër personave të dënuar kanë qenë në harmoni të plotë me ligjet në fuqi dhe Konventat Ndërkombëtare? Prej tyre janë përgjigjur 3.2% plotësisht, 6.5% janë përgjigjur shumë, 45.2% janë përgjigjur pjesërisht, 41.9% janë përgjigjur pak, dhe, vetëm 3.2% janë përgjigjur aspak. Nga ky rezultat mund të konstatojmë, gjithnjë duke u bazuar edhe në njohuri dhe burime tjera se, sistemi gjyqësorë i kohës nuk ka qenë fleksibël në drejtim të përqafimit të akteve dhe Konventave Ndërkombëtare të garantojnë mbrojtën e lirive dhe të drejtave të njeriut në procedurë penale.

Shprehja se “koha shëron plagë” është inkorporuar në pyetjen e fundit duke pretenduar që ngjarjet e zhvilluara në vitet 1981–1999 në sistemin gjyqësor, për një përgjigje të vetme tu qasemi nga këndvështrimi historik. Në pyetjen e parashtruar prokurorëve të

anketuar se, duke e shikuar këtë çështje nga këndvështrimi historik, a mendoni se këto dënime kanë qenë vendime juridike me motive politike–etnike? Prej tyre 3.2% janë deklaruar shumë, 67.7% janë deklaruar pjesërisht, 22.6% janë deklaruar pak, dhe, vetëm 6.5% janë deklaruar aspak! Rezultati i pyetjes së fundit siç duket e jep efektin final, bazuar në faktin se shumica e prokurorëve e pohojnë ose nuk e mohojnë faktin se dënimet janë shqiptuar me qëllime dhe motive politike-etnike.

4.4. Diskutim dhe analizë mbi rezultatet e pyetësorit me gjyqtarë

Gjinia		Nr.	%
Femër		6	18.2
Mashkull		27	81.8
Totali		33	100

1	Në periudhën kohore 1981-1999, ju keni ushtruar profesionin e:	Nr.	%
	Gjyqtarës	5	15.2
	Gjyqtarit	28	84.8
	Totali	33	100

2	Gjatë kësaj periudhe kohore që keni ushtruar profesionin e gjyqtarit, sa e keni ndier vetën të lirë dhe të sigurt në ushtrimin e profesionit tuaj?	Nr.	%
	Pak	7	21.2
	Pjesërisht	9	27.3
	Shumë	12	36.4
	Plotësisht	5	15.2
	Totali	33	100

3	Sipas mendimit tuaj, për veprat penale me karakter politik, pjesëtarët e cilit nacionalitet janë gjykuar më shumë?	Nr.	%
	Shqiptarë	33	100
	Totali	33	100

4	A keni pasur ankesa nga të akuzuarit me pretendimin se janë keqtrajtuar dhe torturuar nga policët dhe hetuesit gjatë fazës së arrestimit?	Nr.	%
	Plotësisht	1	3.0
	Shumë	17	51.5
	Pjesërisht	9	27.3
	Pak	5	15.2
	Aspak	1	3.0
	Totali	33	100

5	A keni pasur ankesa nga të akuzuarit me pretendimin se janë keqtrajtuar dhe torturuar nga policët dhe hetuesit gjatë fazës së hetuesisë?	Nr.	%
	Plotësisht	1	3.0
	Shumë	17	51.5
	Pjesërisht	9	27.3
	Pak	4	12.1
	Aspak	2	6.1
	Totali	33	100

6	Sipas Ligjit në fuqi gjatë viteve 1981/1999, tortura a ka qenë vepër penale?	Nr.	%
	Po	32	100
	Totali	33	100

7	A ka pasur zyrtarë, e kam fjalën për policë dhe hetues, që janë gjykuar dhe dënuar për veprë penale të torturës?	Nr.	%
	Po	4	12.1
	Jo	13	39.4
	Nuk më kujtohet	16	48.5
	Totali	33	100
7.1	Nëse PO, sa raste?	Nr.	%
	Pa përgjigje	29	87.9
	1 rast	4	12.1
	Totali	33	100

8	Me rastin e shqiptimit të dënimit, sa ju jeni referuar akteve dhe konventave ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut?	Nr.	%
	Aspak	9	27.3
	Pak	11	33.3
	Pjesërisht	3	9.1
	Shumë	6	18.2
	Plotësisht	4	12.1
	Totali	33	100

9	Sipas jush, cili ka qenë qëllimi i dënimit për veprat penale me karakter politik?	Nr.	%
	Risocializimi	6	18.2
	Ndëshkimi/Shpagimi	14	42.4
	Ndëshkimi dhe risocializimi	8	24.2
	Tjetër	5	15.2
	Totali	33	100

10	Duke u bazuar nga eksperiencia Juaj, a ka pasur mbrojtja e të akuzuarve kushte dhe trajtim të barabartë nga gjykata, në raport me institucionin e akuzës?	Nr.	%
	Plotësisht	3	9.1
	Shumë	4	12.1
	Pjesërisht	10	30.3
	Pak	9	27.3
	Aspak	7	21.2
	Totali	33	100

11	A mendoni se janë respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, gjatë procedurës penale, duke filluar nga hetuesia e deri te ekzekutimi i dënimit?	Nr.	%
	Plotësisht	3	9.1
	Shumë	1	3.0
	Pjesërisht	12	36.4
	Pak	12	36.4
	Aspak	5	15.2
	Totali	33	100

12	Sipas mendimit Tuaj, sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore?	Nr.	%
	Plotësisht	2	6.1
	Shumë	11	33.3
	Pjesërisht	13	39.4
	Pak	5	15.2
	Aspak	2	6.1
Totali		33	100

13	A mendoni se ka pasur procese të montuara politikisht, për vepra penale me karakter politik?	Nr.	%
	Po	25	75.8
	Jo	6	18.2
	Nuk jam i sigurt	2	6.1
Totali		33	100

13.1	Nëse PO, sa raste?	Nr.	%
	Pa përgjigje	8	24.2
	disa raste	12	36.3
	mjaft raste	3	9.1
	shumë raste	9	27.3
	shumica e rasteve	1	3.0
	Totali	33	100

14	Sa kanë pasur mundësi organizatat vendore që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?	Nr.	%
	Plotësisht	2	6.1
	Shumë	1	3.0
	Pjesërisht	7	21.2
	Pak	19	57.6
	Aspak	4	12.1
	Totali	33	100

15	Sa kanë pasur mundësi organizatat ndërkombëtare që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?	Nr.	%
	Plotësisht	3	9.1
	Shumë	1	3.0
	Pjesërisht	7	21.2
	Pak	19	57.6
	Aspak	3	9.1
	Totali	33	100

16	A mendoni se gjatë viteve 1981-1999, janë zhvilluar shumë procese gjyqësore kolektive, pra e kemi fjalën për persona të akuzuar dhe të dënuar në grup?	Nr.	%
	Po	31	93.9
	Jo	2	6.1
	Totali	33	100

16.1	Nëse PO, sa raste?	Nr.	%
	Pa përgjigje	3	9.1
	disa raste	1	3.0
	mjaft raste	3	9.1
	shumica e rasteve	21	63.7
	të gjitha rastet	5	15.1
	Totali	33	100

17	A mendoni se kanë qenë të rënda dënimet për veprat penale me karakter politik?	Nr.	%
	Plotësisht	2	6.1
	Shumë	19	57.6
	Pjesërisht	8	24.2
	Pak	2	6.1
	Aspak	2	6.1
	Totali	33	100

18	Sipas mendimit tuaj profesional, aktakuzat e prokurorit për vepra penale me karakter politik, a kanë pasur gjithmonë bazë juridike?	Nr.	%
	Po	3	9.1
	Jo	25	75.8
	Nuk jam i sigurt	5	15.2
	Totali	33	100

19	Sipas mendimit tuaj profesional, a ka qenë i ndikuar organi i akuzës nga politika ditore, pra e kemi fjalën për prokurorinë?	Nr.	%
	Plotësisht	3	9.1
	Shumë	13	39.4
	Pjesërisht	14	42.4
	Pak	2	6.1
	Aspak	1	3.0
	Totali	33	100

20	Cila ka qenë mundësia dhe hapësira e medias për ta monitoruar procesin gjyqësor nga faza e hetuesisë, deri te përfundimi i procesit gjyqësor?	Nr.	%
	Plotësisht	1	3.0
	Shumë	3	9.1
	Pjesërisht	8	24.2
	Pak	17	51.5
	Aspak	4	12.1
	Totali	33	100

21	A mendoni se procedura e zhvilluar në proceset gjyqësore kundër personave të dënuar, ka qenë në harmoni të plotë me ligjet në fuqi?	Nr.	%
	Plotësisht	2	6.1
	Shumë	3	9.1
	Pjesërisht	17	51.5
	Pak	11	33.3
	Totali	33	100

	Duke e shikuar këtë çështje nga këndvështrimi historik, a mendoni se këto dënime kanë qenë vendime juridike, me motive politiko-etnike?	Nr.	%
22	Po	26	78.8
	Jo	5	15.2
	Nuk jam i sigurt	2	6.1
	Totali	33	100

	Nëse PO, sa raste?	Nr.	%
22.1	pa përgjigje	7	21.2
	disa raste	12	36.3
	mjaft raste	5	15.1
	shumica e rasteve	9	27.4
	Totali	33	100

Në mozaikun e shumë pyetjeve me interes për studimin, i kemi konsideruar me peshë të veçantë përgjigjet dhe mendimet e gjyqtarëve të cilët kanë punuar në sistemin gjyqësor në KSAK, në intervalin kohor gjatë viteve 1981–1999. Kjo rëndësi u jepet për faktin se kjo kategori e të anketuarve kanë qenë protagonistët kryesor në zhvillimet e ndodhura në sistemin gjyqësorë gjatë viteve përkatëse. Prandaj, duke e përfshirë edhe këtë kategori në hulumtimin tonë, me të drejtë kemi pretenduar të arrijmë një rezultat më objektiv në trajtesën tonë studimore. Prej 33 gjyqtarëve të anketuar, 15.2% janë të gjinisë femërore dhe 84.8% janë të gjinisë mashkullore. Nuk besoj që është e tepërt të theksoj se, qasje në anketim dhe për këtë kategori nuk ka qenë aspak e lehtë.

4.4.1. Siguria dhe liria për të ushtruar profesionin e gjyqtarit 1981–1999

Jo rastësisht këtë pyetje u'a kemi parashtruar tre kategorive në anketim, duke qenë koshient për rrethanat nëpër të cilat ka kaluar sistemi gjyqësorë në KSA të Kosovës gjatë viteve 1981–1999. Në pyetjen e parashtruar gjyqtarëve se, gjatë kësaj periudhe kohore që ju keni ushtruar profesionin e gjyqtarit, sa e keni ndier veten të lirë dhe të sigurt në ushtrimin e profesionit tuaj? Prej tyre 21.2% janë deklaruar pak, 27.3% janë deklaruar pjesërisht, 36.4% janë deklaruar shumë dhe vetëm 15.2% janë deklaruar plotësisht. Duke mos e përjashtuar elementin e subjektivitetit në këtë përgjigje dhe

rrethanat e ndryshuara politike–juridike në kohën e anketimit, ku të anketuarit edhe mund të pretendojnë në shfajësime, por bazuar edhe në të tjerë faktorë tregues, mund të rezultojnë se përgjigjet e tyre janë relativisht objektive. E nxjerrim këtë konkluzion duke u bazuar në faktin se në Kosovë gjatë viteve 1981–1999, asnjë kategori e shoqërisë nuk ka qenë imun ndaj shantazheve të sigurimit sekret shtetëror të cytur nga politika të qëllimshme të pushtetit të asaj kohe. Por, ky konkluzion nuk e përjashton dëshirën dhe zellin e shumë gjyqtarëve të cilët me vullnet të lire e bënë “detyrën” e caktuar nga politika për të dënuar shqiptarë për qëllime politike dhe mbi baza etnie, me qëllim që duke i shërbyer sistemit në këtë mënyrë avancojnë në pozita më të larta brenda sistemit gjyqësor.

4.4.2. Nacionaliteti i personave të dënuar për vepra penale me karakter politik

Sa i përket nacionalitetit të personave të dënuar për vepra penale të natyrës politike në ish–Jugosllavi, duket që nuk ka dilema rreth përkatësisë etnike të personave të dënuar. Bazuar në ngjarjet e ndodhura në KSA të Kosovës, pas protestave gjithëpopullore të viteve 1968, 1981 dhe 1989 të popullit Shqiptar, për liri dhe barazi dhe Republikë në kuadër të RSFJ, filloi gjahu politik i ndjekjes së Shqiptarëve. Kjo ndjekje e cila rezultoi me arrestime, keqtrajtime, tortura, paraburgime, burgime, linçime. Kjo ndjekje e cila u është bërë shqiptarëve të Kosovës për dy dekada, konsiderohet dhe është ndjekja më e madhe nga pas Lufta e Dytë Botërore. Edhe gjyqtarët në përgjigjen e pyetjes së parashtruar e vërtetojnë këtë konstatim. Në pyetjen se, sipas mendimit tuaj për vepra penale me karakter politik pjesëtarët e cilit nacionalitet janë gjykuar dhe dënuar më shumë? Prej tyre 100% kanë deklaruar se janë Shqiptarë. Kjo përgjigje nuk e përjashton aspak mundësinë që në KSA të Kosovës gjatë viteve 1981–1999 të jenë dënuar edhe pjesëtarë të nacionaliteteve tjera, por në rezultatet e hulumtimeve tona, rezultojnë të jetë mundësi e kufizuar.

4.4.3. Ankesat e të akuzuarve në gjykatë për ushtrim torture ndaj tyre – kultura e mos ndëshkueshmërisë

Torturat, keqtrajtimet dhe shkeljet e lirive dhe të drejtave të njeriut rezultojnë të jenë karakteristikat themelore të cilat i kanë karakterizuar organet e policisë, hetuesisë dhe organet e akuzës në vitet 1981–1999 në KSA të Kosovës. Në pyetjen e parashtruar gjyqtarëve se, a keni pasur ankesa nga të akuzuarit me pretendimin se janë keqtrajtuar dhe torturuar nga policët dhe hetuesit gjatë fazës së arrestimit dhe paraburgimit? Prej 33 gjyqtarëve, 3.0% janë deklaruar plotësisht, 51.5% kanë deklaruar shumë, 27.3% kanë deklaruar pjesërisht, 15.2% kanë deklaruar pak dhe vetëm 3.0% kanë deklaruar aspak. Duke e analizuar rezultatin e kësaj përgjigje, i cili rrjedh nga personat që kanë qenë protagonistët kryesorë të sistemit gjyqësor në harkun kohor 81/99, mund të konstatojmë se organet e pushtetit të rendit dhe sigurisë torturën e kanë aplikuar në linjë sistematike kundër personave të privuar nga liria.

Një e metë serioze me të cilën është identifikuar sistemi i drejtësisë në KSA të Kosovës, gjatë viteve 1981–1999, është kultura e mos ndëshkueshmërisë kundër personave zyrtarë si policë dhe hetues të cilët kanë ushtruar torturë kundër personave të privuar nga liria. Në pyetjen e parashtruar gjyqtarëve se, a ka pasur zyrtarë, pra e kemi fjalën për policë dhe hetues që janë gjykuar dhe dënuar për vepra penale të torturës? Prej tyre 12.1% kanë deklaruar po, 39.4% kanë deklaruar jo dhe 48.5% kanë deklaruar nuk më kujtohet. Gjatë rrugëtimit tonë hulumtues në këtë studim, na rezulton se kemi një kulturë të instaluar për mos ndëshkueshmeri të kësaj kategorie personash të cilët përfaqësonin institucionet e caktuara të pushtetit dhe rrjedhimisht edhe politikën penale të atyre institucioneve. Nëse i marrim si pika të vetme referimi rezultatet e personave që deklarojnë se janë përballur me torturën gjatë ndalimit, arrestimit, hetuesisë dhe paraburgimit dhe përgjigjeve të gjyqtarëve për numrin e policëve dhe hetuesve të

dënuar, na del se kemi një disbalancë të madhe në mes krimit dhe dënimit. Pa hezitim mund të konstatojmë se mos ndëshkueshmëria e policëve dhe hetuesve të cilët kanë ushtruar torturë kundër personave të privuar nga liria, kryesisht për vepra të natyrës politike, ka qenë kulturë e instaluar ë sistemin e drejtësisë në vitet 1981–1999.

Fakti se tortura është aplikuar në mënyrë sistematike dhe në veçanti ndaj personave të privuar nga liria për vepra të natyrës politike dhe në anën tjetër ndëshkimi i kryerësve të kësaj torture është i papërfillshëm, pothuajse inekzistent, tregon sinkronizimin e mirë të programuar të organeve të rendit dhe gjyqësisë, në drejtim të persekutimit kolektiv të një etnie të targetuar. Është irracionale të mendohet se tortura e përmasave të tilla të kalojë pa u ndëshkuar, nëse në këtë program nuk kanë participuar të gjitha mekanizmat e sistemit të drejtësisë së bashku dhe secili sipas rolit të vet.

4.4.4. Harmonizimi i vendimeve të gjyqësorit me aktet dhe konventat ndërkombëtare

Kur bëhet fjalë për akceptimin dhe inkorporimin e akteve dhe konventave ndërkombëtare që ju referohen lirive dhe të drejtave të njeriut në procedurë penale edhe sot paraqitet si një lloji sfide për sistemin e të drejtës penale bashkëkohore në kuptimin e gjerë. Prandaj, mund të themi se sistemi i aplikueshëm penal në KSA të Kosovës gjatë viteve 1981–1999, nuk shquhej për ndonjë veti të tillë dhe aq më pak kur dihet mirëfilli se shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut në këtë hark kohor ishte kulturë sistematike e pushtetit. Duke qenë se kategoria e të anketuarve të pyetur ishin protagonistë të zhvillimit të këtyre ngjarjeve, me të drejtë e kemi vu theksin edhe në pyetjen se, me rastin e shqiptimit të dënimit sa ju keni referuar akteve dhe konventave ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut? Prej tyre 27.3% kanë deklaruar aspak, 33.3% kanë deklaruar pak, 9.1% kanë deklaruar pjesërisht, 18.2% kanë deklaruar shumë dhe vetëm 12.1% kanë deklaruar plotësisht. Shikuar në mozaikun e procedurës penale, nëpër të

cilën ka kaluar një person i privuar nga liria në harkun kohor 1981–1999 dhe natyrën e vendimeve gjyqësore të cilat janë shqiptuar, duket qartë se ka pasur shmangie substanciale nga këto akte dhe konventa ndërkombëtare. Këtë konstatim e bazojmë në faktin se, represioni i ushtruar sistematik i evidentuar me shkelje konstante të lirive dhe të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e procedurës penale, nuk mund të ishte si i tillë, nëse në brendi do të akceptonte dhe respektonte aktet dhe konventat ndërkombëtare referua lirive dhe të drejtave të njeriut. Vendimet dhe proceset gjyqësore të zhvilluara në Kosovë gjatë viteve 1981–1999, qëndronin shumë larg me aktet dhe konventat ndërkombëtare universale të cilat proklamnin liritë dhe të drejtat e njeriut në procedurë penale. Pra, mund të konstatojmë me saktësi objektive se, në harkun kohor 1981–1999, proceset gjyqësore dhe vendimet e dala nga këto procese, nuk kanë qenë aspak në harmoni me frymën e akteve dhe konventave ndërkombëtare, por, përkundrazi, kanë qenë në kundërshtim të plotë me rregullat e përcaktuara që garantojnë këto akte për liritë dhe të drejtat e njeriut në procedurë penale. Si përfundim në analizën tonë mund të konkludojmë se, politika penale e aplikuar në Kosovë nga RSFJ dhe Republika e Kosovës në harkun kohor 1981–1999, ka qenë në kundërshtim me parimet universale që proklamojnë dhe garantojnë respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procedurës penale.

4.4.5. Cili ishte qëllimi i dënimit për vepra penale me natyrë politike sipas gjyqtarëve

Një proces gjyqësor në të drejtën penale bashkëkohore nuk do ta bënte të rëndësishëm dhe me interes, vetëm fakti dhe mënyra se si është zhvilluar ai proces, nëse do t'i mungonte qëllimi final, përse është filluar, zhvilluar dhe si ka përfunduar ai proces. Edhe dënimi në të drejtën penale bashkëkohore në kuptimin e gjerë të saj, e ka të brumosur qëllimin e tij, i cili përbëhet nga disa elemente siç janë: ndëshkimi–shpagimi

për veprën e kryer dhe risocializimi, ri-integrimi i personit në shoqëri. Por, cili ishte qëllimi i dënimit në KSA të Kosovës gjatë viteve 1981–1999? Në pyetjen e parashtruar të anketuarve se, sipas jush cili ka qenë qëllimi i dënimit për vepra penale me karakter politik? Prej tyre, 18.2% kanë deklaruar risocializimi, 42.4% kanë deklaruar ndëshkimi/shpagimi, 24.2% kanë deklaruar ndëshkimi dhe risocializimi dhe 15.2% kanë deklaruar tjetër. Nga të gjeturat e këtij rezultati dhe shumë faktorëve të tjerë, mund të konstatojmë se qëllimi i dënimit për vepra penale të natyrës politike, ka rezultuar të dominojë më shumë ndëshkimi, se sa risocializimi. Me një vështrim kronologjik të zhvillimeve të ndodhura në sistemin e gjyqësisë penale në Kosovë gjatë viteve 1981–1999 dhe mbi bazën e një analize të përgjithshme të përgjigjeve të të anketuarve, na rezulton se dënimeve të shqiptuara për vepra penale të natyrës politike, u mungonte çdo element human brenda tyre. Në këto dy dekada të gjyqësisë penale kishte vetëm maltretime, ndjekje, torture, persekutime, akuza në grup, plagosje, gjymtime dhe vrasje të shqiptarëve të cilët bënë përpjekje për liri. Me shumë të drejtë mund të konkludojmë se këto veprime u bënë me qëllim të preventivës gjenerale, për të mbjellur terror dhe frikë te masat e gjëra të cilat bënë përpjekje për realizimin e të drejtave të tyre dhe për të drejtën elementare siç është liria. Në këtë mozaik dënimesh nuk mungon edhe preventiva speciale e cila kishte për qëllim të frikësonte individin dhe të ndëshkonte atë, qoftë edhe për mendimin e tij.

4.4.6. Respektimi i subjekteve në procedurë penale, mbrojtje–akuzë

Në hulumtim duke konsultuar burime të ndryshme në funksion të shërbimit të studimit, kemi hasur në shumë gjetje të cilat e pasqyrojnë pozitën e pafavorshme në procedurë penale të institucionit të mbrojtësit përballë institucionit të akuzës. Pozita e avokatit mbrojtës së bashku me të mbrojturin e tij, nuk ka qenë aspak e barabartë me

institucionin e akuzës. Në pyetjen e parashtruar gjyqtarëve të anketuar se, duke u bazuar nga eksperiencia juaj, a ka pasur mbrojtja e të akuzuarve kushte dhe trajtim të barabartë nga gjykata në raport me institucionin e akuzës? Prej tyre 9.1% kanë deklaruar plotësisht, 12.1% kanë deklaruar shumë, 30.3% kanë deklaruar pjesërisht, 27.3% kanë deklaruar pak dhe 21.2% kanë deklaruar aspak. Ky rezultat pasqyron dhe konstaton një shkelje të së drejtës të garantuar me ligj në procedurë penale, pra e drejta e “barazisë së armëve”. Duke e vendosur mbrojtjen në pozitë të pabarabartë përballë institucionit të akuzës, në fakt nga mohimi i pozitës së barabartë në mes mbrojtësit dhe prokurorit, dëmi substancial i bëhet vetë personit të akuzuar, sepse pozita e pafavorshme e mbrojtësit në procedurë shkon direkt në disfavor të personit të mbrojtur, zaten edhe ky ishte qëllimi final i këtij i këtij trajtimi.

4.4.7. Të drejtat e njeriut në procedurë penale sipas gjyqtarëve 1981–1999

Nga burimet e ndryshme kemi hasur në informacione të cilat argumentojnë se të drejtat dhe liritë e njeriut janë shkelur në masë të gjerë nëpër të gjitha fazat e procedurës penale gjatë viteve 1981–1999. Kjo shkelje enorme e këtyre të drejtave ka ndodhur nga organet gjegjëse në procedurë penale, duke filluar me theks të veçantë nga policë, hetues, prokurorë, gjyqtarë dhe gardian. Pra, gama e të drejtave të shkelura dhe mohuara, është po aq e gjatë sa lista e vetë këtyre të drejtave. Të drejtat e shkelura dhe të mohuara në harkun kohor 1981–1999 paraqesin edhe shkelje të vet ligjeve të aplikueshme në fuqi, akteve dhe konventave universale referuar lirive dhe të drejtave të njeriut. Këtë konstatim deri në njëfarë shkallë e vërtetojnë edhe përgjigjet e të anketuarve në pyetjen e parashtruar se, a mendoni se janë respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut gjatë procedurës penale, duke përfshirë nga hetuesia deri në ekzekutimin e dënimit? Prej tyre 9.1% kanë deklaruar plotësisht, 3.0% kanë deklaruar shumë, 36.4% kanë deklaruar

pjesërisht, 36.4% kanë deklaruar pak dhe 15.2% kanë deklaruar aspak. Në analizën tonë këtij rezultati nuk duhet t'i qasemi nga këndvështrimi sasior–statistikor, por duhet t'i qasemi nga pikëpamje e origjinës–burimit të këtij rezultati. Pra, është me rëndësi të potencojmë faktin se protagonistët e zhvillimit të këtyre ngjarjeve e pohojnë se në procedurë penale gjatë vite 1981–1999, janë shkelur liritë dhe të drejtat e njeriut.

4.4.8. Ndikimet dhe montimet politike në proceset gjyqësore

Sipas ligjit të aplikueshëm penal të ish–Jugosllavisë, gjykata dhe organet shtetërore që marrin pjesë në procedurën penale kanë për detyrë të konstatojnë në mënyrë të vërtetë dhe të plotë faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit të ligjshëm. Ata kanë për detyrë që me vëmendje të njëjtë të shqyrtojnë dhe konstatojnë, si faktet të cilat e ngarkojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që i shkojnë në favor (Ligji mbi Procedurën Penale i RSFJ, 1977, Neni 15).

Kur analizojmë historikun e ngjarjeve të ndodhura në sistemin e gjyqësisë penale në Kosovë, gjatë viteve 1981–1999, është i pashmangshëm të potencohet fakti se, në motivimin, ndikimin dhe zhvillimin e këtyre ngjarjeve, faktor kyç ishte politika. Kontaminimi politik i vendimeve gjyqësore në Kosovë, në mënyrë specifike pas demonstrative gjithëpopullore të vitit '81 dhe '89, ishte shpërfaqje e hapur e ndikimit politik mbi vendimet gjyqësore. Në dy pyetjet e parashtruara të anketuarve protagonistë të këtyre vendimeve, kemi pranuar rezultat shqetësues mbi ndërhyrjet politike në vendimet gjyqësore. Në pyetjen e parë se, sipas mendimit tuaj sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore? Prej tyre 6.1% kanë deklaruar plotësisht, 33.3% kanë deklaruar shumë, 39.4% kanë deklaruar pjesërisht, 15.2% kanë deklaruar pak dhe vetëm 6.1% kanë deklaruar aspak. Në pyetjen e dytë të parashtruar në këtë kontekst se, a mendoni se ka pasur procese të montuara politikisht, për vepra penale me karakter

politik? Prej tyre 75.8% kanë deklaruar po, 18.2% kanë deklaruar jo dhe vetëm 6.1% kanë deklaruar se nuk jemi të sigurt.

Ekzistojnë fakte shqetësuese se si politika dhe sigurimi i shtetit ka paracaktuar “rregulla” në procedurë penale dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në proceset gjyqësore kundër të burgosurve politik. Sipas një dokumenti tepër sekret, të lëshuar nga Sekretariati Krahinor i Juridikaturës, në mënyrë të hollësishme jepet radhitja e proceseve gjyqësore kundër të burgosurve politik në Kosovës. Nga ky dokument mësohet se në Kosovë asgjë nuk ndodhte rastësisht dhe se çdo gjë ishte planifikuar dhe analizuar nga ekspertët e Beogradit. Dokumenti është lëshuar me 8 Qershor 1982, një vit pas demonstratave të vitit 1981. Sipas dokumentit, gjatë muajve Qershor dhe Korrik, janë paraparë që para gjykatës të dilnin 44 grupe, që kishin marrë pjesë në demonstratat e vitit 1981. Të gjithë të pandehurit ishin shqiptarë nga Kosova. Po ashtu, në këtë dokument janë radhitur edhe seancat sipas kohës që do të mbahen, në vendin ku do të mbahen, gjyqtarin dhe prokurorin dhe veprat për të cilat akuzohen (Keçmezi, 2003, 73). Këto janë praktikat e ndërhyrjes flagrante të politikës dhe sigurimit të shtetit në sistemin e drejtësisë. Këto dukuri ku sigurimi sekret i shtetit dhe politika kanë ndërhyrë në punët e gjyqësorit në Kosovë, e kanë shoqëruar këtë sistem në më shumë se dy dekada.

4.4.9. Qasja e dhënë organizatave vendore dhe ndërkombëtare në monitorimin e gjyqësorit

Në sistemet gjyqësore ku cenohen liritë dhe të drejtat e njeriut në procedurë penale, monitorimi, raportimi, kontrollimi dhe vëzhgimi që bëjnë organizatat e tilla qofshin ato vendore apo ndërkombëtare, janë dritë shprese për personat e privuar nga liria. Roli që ka luajtur Kryqi i Kuq i Kosovës, Kryqi i Kuq Ndërkombëtarë, Këshilli Për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Amnesty International, etj, ka qenë i pazëvendësueshëm për ndihmën që u kanë ofruar personave të burgosur dhe familjeve

të tyre. Pavarësisht faktit se rezultatet tregojnë se pengesat e pushtetit kanë qenë të mëdha dhe mundësitë e tyre kanë qenë të kufizuara, prapë se prapë, roli i tyre mbetet shumë i rëndësishëm në këtë drejtim. Në pyetjen e parashtruar se, sa kanë pasur mundësi organizatat ndërkombëtare që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore? Prej tyre 9.1% kanë deklaruar plotësisht, 3.0% kanë deklaruar shumë, 21.2% kanë deklaruar pjesërisht, 57.6% kanë deklaruar pak dhe vetëm 9.1% kanë deklaruar aspak. Një rezultat relativisht i ngjashëm ka rezultuar edhe në pyetjen për organizatat vendore. Nga ky rezultat mund të konstatojmë se sistemi gjyqësor në atë periudhë, nuk e kishte rehatinë e të qenit transparent dhe i hapur në drejtim të këtyre organizatave. Kjo pengesë bëhej me qëllim të mos zbulimit të kushteve të rënda dhe trajtimeve ç'njerëzore që u bëheshin personave të privuar nga liria. Me gjithë sfidat dhe pengesat serioze me të cilat janë përballuar këto organizata në pengim të kryerjes së misionit të tyre, mund të konsiderojmë se nuk kanë munguar rezultatet që këto organizata kanë synuar.

Dy prej shumë karakteristikave negative që e kanë portretizuar sistemin gjyqësor në KSA të Kosovës janë, proceset penale kolektive, pra aktakuza në grupe dhe shqiptimi i dënimeve të larta për vepra penale me natyrë politike. Në dy pyetjet e parashtruara në drejtim të të anketuarve gjyqtarë ka rezultuar se kemi pasur akuza në grup dhe dënime të larta për vepra penale me karakter politik. Në pyetjen e parë se, a mendoni se gjatë viteve 1981–1999, janë shumë procese gjyqësore kolektive? Prej tyre 93.9% kanë deklaruar po dhe vetëm 6.1% kanë deklaruar jo. Në pyetjen e dytë se, a mendoni se kanë qenë të rënda dënimet për vepra penale me karakter politik? Prej tyre 6.1% kanë deklaruar plotësisht, 57.6% janë deklaruar shumë, 24.2% kanë deklaruar pjesërisht, 6.1% kanë deklaruar pak dhe vetëm 6.1% kanë deklaruar aspak. Këto rezultate dhe shumë burime tjera të konsultuara na japin një pasqyrë të qartë se këto dy karakteristika

kanë qenë mjaft të theksuar në aplikimin e politikave penale gjatë viteve 1981–1999. Duke qenë të vetëdijshëm se kanë pushuar faktorët dhe rrethanat prej të cilave janë ndikuar këto procese gjyqësore, e kemi pa të udhës që të anketuarve gjyqtarë t’u drejtohem me një pyetje pak më specifike, duke u mbështetur në faktin se të anketuarit tashmë janë të liruar nga barra juridike dhe politike, nisur nga fakti se në kohën e parashtrimit të kësaj pyetje, në Kosovë kemi një realitet të ri politiko–juridik. Në pyetjen drejtuar gjyqtarëve se, duke e shikuar këtë çështje nga këndvështrimi historik, a mendoni se këto dënime kanë qenë vendime juridike me motive politike–juridike? Prej tyre 78.8% kanë deklaruar po, 15.2% kanë deklaruar jo dhe vetëm 6.1% kanë deklaruar nuk jemi të sigurt. Fakti se ky rezultat rrjedh pikërisht nga personat të cilët direkt ose indirekt kanë qenë të përfshirë në zhvillimet e ndodhura në sistemin e drejtësisë gjatë viteve 1981–1999, është tregues relativisht relevant për të konstatuar se këto vendime kanë pasur motivacion politiko–etnik.

4.4.10. Këndvështrim historik i gjyqeve kolektive dhe dënimeve radikale

Dy prej shumë karakteristikave negative që e kanë portretizuar sistemin gjyqësor në KSA të Kosovës janë, proceset penale kolektive, pra aktakuza në grupe, dhe shqiptimi i dënimeve të larta për vepra penale me natyrë politika. Në dy pyetjet e parashtruara në drejtim të respondentëve gjyqtarë ka rezultuar se kemi pasur akuza në grup, dhe dënime të larta për vepra penale me karakter politikë. Në pyetjen e parë se, a mendoni se gjatë viteve 1981/1999, janë shumë procese gjyqësore kolektive? Prej tyre 93.9% kanë deklaruar po, dhe, vetëm 6.1% kanë deklaruar jo. Në pyetjen e dytë se, a mendoni se kanë qenë të rënda dënimet për vepra penale me karakter politikë? Prej tyre 6.1% kanë deklaruar plotësisht, 57.6% janë deklaruar shumë, 24.2% kanë deklaruar pjesërisht, 6.1% kanë deklaruar pak, dhe, vetëm 6.1% kanë deklaruar apsak. Këto rezultate dhe

shumë burime tjera të konsultuara na japin një pasqyrë të qartë se këto dy karakteristika kanë qenë majftë të theksuar në aplikimin e politikave penale gjatë viteve 1981/1999.

Duke qenë të vetëdijshëm se kanë pushuar faktorët dhe rrethanat prej të cilave janë ndikuar këto procese gjyqësore, e kemi pa të udhës që respondentëve gjyqtarë t'u drejtohem me një pyetje pak më specifike. Interesin për të parashtruar një pyetje më specifike, e kemi mbështetur në faktin se respondentët tashmë janë të liruar nga barra juridike dhe politike, nisur nga fakti se në kohën e parashtrimit të kësaj pyetje, në Kosovë kemi një realitet të ri politiko–juridik. Në pyetjen drejtuar respondentëve se, duke e shikuar këtë çështje nga këndvështrimi historik, a mendoni se këto dënime kanë qenë vendime juridike me motive politike-juridike? Prej tyre 78.8% kanë deklaruar po, 15.2% kanë deklaruar jo, dhe vetëm 6.1% kanë deklaruar nuk jemi të sigurtë. Fakti se ky rezultat rrjedhë pikërisht nga respondentët të cilët kanë direkt ose indirekt të përfshirë në zhvillimet e ndodhura në sistemin e drejtësisë gjatë viteve 1981/1999, është tregues relativisht relevant për të konstatuar se këto vendime kanë pasur motivacion politik.

KAPITULLI V –

Përfundimi – Gjetjet e studimit - Konkluzione

- **Përfundimi**

Mbaj mendimin se me gjithë vështirësitë e paraqitura gjatë studimit të kësaj teme në pjesën më të madhe, mbi 90%, është përmbushur objektivi i saj. Gjithnjë në koherencë me mendimin dhe studimet që janë bërë dhe do të bëhen në të ardhmen, kjo tematikë është e gjerë dhe përkundër faktit se në Qershor 1999, Kosova e fitoi lirinë dhe strukturat serbo-jugosllave nuk menaxhonin me organet e sigurisë dhe të drejtësisë, legjislacioni penal i aplikueshëm deri më 22 Mars 1989, në ish-Jugosllavi, ka vlejtur në Kosovë edhe gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar të Kosovës, së bashku me rregulloret e UNMIK.

Vlen të theksohet, se legjislacioni penal i aplikueshëm në ish-Jugosllavi deri më 22 Mars 1989, nga administrata ndërkombëtare që menaxhonte Kosovën – UNMIK, në aspektin formal ishin vlerësuar si jo diskriminues dhe për këtë, UNMIK vazhdoi zbatimin e tyre gjatë periudhës që administronte me Kosovën.

Është me rëndësi të potencohet fakti se në dy periudha të ndryshme kohore, nga dy administrata dhe sisteme të ndryshme politike, ishin në fuqi pothuajse të njëjtat ligje penale, por zbatimi i tyre praktik ishte krejtësisht me përmbajtje dhe formë të ndryshme. Përderisa në periudhën kohore 1981–1989, në Kosovë me ligjet e njëjta penale akuzoheshin dhe dënoheshin me mijëra njerëz për bindje të ndryshme politike, po në të njëjtin vend, me të njëjtat ligje, në periudhën kohore Qershor 1999–Shkurt 2008, me administrim dhe sistem politik të ndryshëm nga ai i mëparshmi, respektoheshin liritë

dhe të drejtat e njeriut dhe bindja dhe veprimtaria politike e çdo qytetari nuk përbënte shkelje ligjore.

Pas shpalljes së pavarësisë, më 17 Shkurt 2008, në Kosovë, janë miratuar Kushtetuta dhe legjislacioni penal, si dhe ligjet tjera, të cilat janë plotësisht në harmoni me të gjitha aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut duke i integruar në plotëni të tyre në Kushtetutën dhe legjislacionin e saj.

Në frymën Kushtetuese dhe të kompletimit të infrastrukturës ligjore, për pakicat në Kosovë zbatohet diskriminimi pozitiv edhe duke ju garantuar atyre njëzetë (20) vende në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Si pasojë e zbatimit të politikave ndëshkuese penale në Kosovë gjatë viteve 1981–1999, Kuvendi i Kosovës, ka miratuar Ligjin Nr. 03/L–095, datë 29 Tetor 2010, Për të Drejtat e ish të burgosurve dhe të përndjekurve politik⁴⁵. Në bazë të Raportit Nr. 27/20⁴⁶, datë 04 Shtator 2020, të Komisionit qeveritar Për Njohjen e Statusit të ish të burgosurve, të dënuarve dhe të përndjekurve politik, drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës, deri më tani rezulton që kanë aplikuar 10402 persona. Po në këtë raport, nga Komisioni respektiv, kërkohet shuma pesëdhjetëmilion Euro (50.000.000 €) për kompensim.

⁴⁵ Shpallur me Dekretin Nr. DL–076–2010, datë 18 Nëntor 2010. Gazeta Zyrtare Prishtinë: Viti V, Nr. 91, datë 10 Dhjetor 2010.

⁴⁶ Në dispozicion te zyra e Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të Burgosurve, të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë.

- **Gjetjet e studimit**

Gjatë hulumtimit të këtij studimi, kemi arritur në këto rezultate:

Për hipotezën themelore:

1. Më shumë se tre të katërtat ($\frac{3}{4}$) e të anketuarve, kanë konstatuar se: Politikat penale në Kosovë gjatë viteve 1981–1999, kanë qenë të motivuara dhe ndikuara nga faktorët politikë dhe etnikë.
 - Të dhënat (96%) tregojnë se hipoteza themelore e ngritur në fillim të studimit vërtetohet plotësisht.

Për hipotezat ndihmëse:

- 1.1 Më shumë se tre të katërtat ($\frac{3}{4}$) e të anketuarve, kanë konstatuar se: Në procedurën penale të zhvilluar për veprat penale politike, gjatë viteve 1981–1999, është përdorur tortura si mjet dhe metodë për pranimin e fajësisë.
 - Të dhënat (99%), tregojnë se hipoteza ndihmëse në lidhje me torturën është vërtetuar plotësisht.
- 1.2 Më shumë se tre të katërtat ($\frac{3}{4}$) e të anketuarve, kanë konstatuar se: në procedurën penale të zhvilluar për veprat penale politike, gjatë viteve 1981–1999, kanë dominuar akuzat dhe dënimet në grupe, në fokus të një nacionaliteti dhe diskriminimit etnik.
 - Të dhënat (97%), tregojnë se hipoteza ndihmëse në lidhje me akuzat dhe dënimet në grupe, në fokus të një nacionaliteti dhe diskriminimit etnik, është vërtetuar plotësisht.

1.3 Më shumë se tre të katërtat ($\frac{3}{4}$) e të anketuarve, kanë konstatuar se: ligjet dhe sistemi i drejtësisë janë përdorur si mburojë juridike për qëllime politike.

- Të dhënat (99%), tregojnë se hipoteza ndihmëse në lidhje me ligjet dhe sistemin e drejtësisë që janë përdorur si mburojë juridike për qëllime politike, është vërtetuar plotësisht.

1.4 Më shumë se tre të katërtat ($\frac{3}{4}$) e të anketuarve kanë konstatuar se: procedurat penale për veprat penale politike, të zhvilluara në ish–Jugosllavi gjatë viteve 1981–1999, në shumicën e rasteve nuk janë mbështetur në prova dhe fakte juridike.

- Të dhënat (98%), tregojnë se hipoteza ndihmëse në lidhje me procedurat penale për veprat penale politike, të zhvilluara në Kosovë gjatë kohës së ish–Jugosllavisë, gjatë periudhës 1981 – 1999, është vërtetuar plotësisht.

Në funksion të vërtetimit të hipotezës themelore dhe hipotezave ndihmëse, nga të gjeturat të cilat u siguruan nëpërmjet të anketuarve, rezulton se hipoteza themelore e ngritur për studim është vërtetuar plotësisht duke u konfirmuar edhe me rezultatet nga hipotezat ndihmëse, të cilat po ashtu janë vërtetuar në tërësinë e tyre.

- **Konkluzione**

Si rezultat i studimit të aplikimit të politikave penale të ish–Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë në Kosovë gjatë periudhës 1981–1999, kam arritur në këto konkluzione:

- Zhvillimi i proceseve historike, politike dhe juridike në Kosovë, është ndërlidhur dhe ka ndikuar në organet e sigurisë dhe të drejtësisë mbi aplikimin e politikave penale të RS Serbisë dhe RSFJ, në Kosovë, në veçanti gjatë viteve 1981–1999;
- Aplikimi i politikave penale në Kosovë, gjatë viteve 1981–1999, pavarësisht faktit se mbante stemën e federatës, ishte i ndikuar dhe dirigjuar drejtpërdrejt nga institucionet e Serbisë dhe vartësit e tyre në Kosovë.
- Legjislacioni i aplikueshëm penal në Kosovë, deri në vitin 1989, në aspektin formal ishte i njësuar me të gjitha njësitë përbërëse të Federatës Jugosllave dhe *de iure* ishte legjislacion i harmonizuar me normat ndërkombëtare, por *de facto*, nëpërmjet organeve të sigurisë dhe të drejtësisë Serbia, duke mos pranuar dhe paragjykuar të drejtat politike të shqiptarëve, zbatonin direktivat politike kryesisht të Serbisë.
- Me Kushtetutën e vitit 1974, deri në vitin 1989, u avancuan të drejtat politike, juridike dhe sociale të shqiptarëve në ish–Jugosllavi edhe përse këto të drejta, në disa aspekte nuk ishin në nivel të barabartë me njësitë e tjera federative, sepse avancimi i pozitës politike dhe juridike i KSA të Kosovës në kuadër të ish–Federatës, çdo herë është penguar dhe sabotuar nga elementë nacionalistë serbë në kuadër të Federatës, duke e paraqitur këtë avancim si cenim të subjektivitetit të tyre republikan.
- Me ndryshimet e statusit juridiko–politik të Kosovës më 23 Mars 1989, sulmet dhe politika penale kundër shqiptarëve në ish–Jugosllavi nga institucionet serbe, nuk ishin më vetëm të natyrës politike dhe fizike, por edhe juridike, sepse diskriminimi dhe

shkelja e të drejtave civile dhe politike të shqiptarëve u institucionalizua në organet serbe, duke nxjerrë plan–programe dhe akte ligjore me karakter diskriminues një etnik.

- Pas vitit 1989, dhuna e organeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve, rezulton të jetë element përbërës i politikës penale në këtë periudhë kohore. Para dhe gjatë procedurës penale, për të ndjekurit për vepra penale me karakter politik, është aplikuar izolimi dhe tortura sistematike nga organet e rendit dhe sigurisë për t'i detyruar ata të pranojnë fajësinë;
- Institucionet e sigurisë dhe drejtësisë të Serbisë, pas zhvillimeve politike me demonstratat e viteve 1981 dhe 1989, në Kosovë, duke pretenduar në fajësinë kolektive të shqiptarëve, proceset penale politike i zhvillonte në grupe të mëdha. Republika e Serbisë, duke marr si shkas demonstratat e vitit 1981 dhe 1989, ndërmoi një ofensivë politike dhe juridike mbi KAS të Kosovës, e cila rezultoi me ndjekje politike, vrasje, plagosje, burgosje, internime, persekutime dhe linçime të shumicës shqiptare në Kosovë. Aplikuesit dhe ushtruesit e kësaj torture, nuk janë ndëshkuar nga shkelja e ligjit, por në shumë raste janë avancuar në pozita të lakmueshme.
- Montimi i rasteve penale nga politika, duke e përdorur si instrument sigurimin sekret shtetëror dhe sistemin e drejtësisë në tërësi, ishte dukuri si në proceset kundër politikanëve, qytetarëve të zakonshëm dhe ushtarëve shqiptarë në armatën jugosllave, sepse aktgjykimet e shqiptuara kundër personave të dënuar për vepra penale politike, në shumicën e rasteve nuk janë mbështetur në prova dhe nuk janë argumentuar në procedurë penale.
- Nga kjo rezulton se politikat penale të aplikuar në Kosovë gjatë viteve 1981–1999, nuk kanë qenë në funksion të risocializimit dhe ri integritetit të personave të dënuar, por si mjet për ndëshkimin e tyre, me qëllim të ruajtjes së *status–quos*.

- Përkundër faktit se në periudha të ndryshme, në institucionet e drejtësisë dhe veçanërisht pas vitit 1993, të gjitha gjykatat në Kosovë ishin një etnike, kishte edhe prej atyre gjyqtarëve që nuk binin në ndikimin politik dhe punën e tyre e kryenin në mënyrë profesionale. Po ashtu, nuk munguan zërat intelektual edhe pse të pakët, siç ishin avokatë, profesorë dhe një pjesë e shoqërisë civile që nuk pajtoheshin me politikën diskriminuese shtetërore ndaj shqiptarëve.

- **Shtojcë**

Pyetësorët

Të nderuar,

Ky pyetësor, zhvillohet për punimin e tezës së doktoratës, e cila ka për qëllim, hulumtimin mbi zhvillimin e politikës penale në Kosovë, gjatë viteve 1981/1999.

Pyetësi u shpërndahet personave të cilët, në periudhën kohore 1981 deri me 1999, kanë qenë të dënuar për vepra penale me karakter politik. Duke e pasur parasysh eksperiencën Tuaj, çdo informacion apo përgjigje që Ju na jepni në pyetësin tonë, e konsiderojmë me interes të veçantë për tezën e studimit.

Konfidencialiteti: Informacioni i mbledhur në këtë studim, do të përdoret vetëm për qëllime të studimit, dhe do të trajtohet në mënyrë konfidenciale, duke u siguruar anonimiteti i plotë i të anketuarve.

Rreth hulumtimit:

Hulumtimi zhvillohet për punimin e tezës së doktoratës;

Pyetjet janë të kuptueshme dhe kërkohet vetëm shënimi i përgjigjes së duhur;

Në rast të paqartësive, lidhur me një çështje në pyetësor apo nëse ju intereson të dini më shumë për studimin, mund të na kontaktoni në këtë adresë elektronike: flori1679@hotmail.com; apo Nr. Tel.: 044/564-000.

JU FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN TUAJ!

Pyetësor për persona të dënuar politikisht!

Gjinia (rrethoni a ose b)?

- a) Femër b) Mashkull

1. Në kohën kur jeni dënuar cili ka qenë statusi i Juaj civil?

- a) I / E martuar
b) I / E pamartuar
c) I/E ndarë
ç) I/E ve
d) I/E fejuar

2. Në kohën kur jeni dënuar cili ka qenë statusi i Juaj i punësimit?

- a) I/ E punësuar
b) I/ E papunësuar
c) I/E punësuar me raste [sezone];
ç) I/E larguar nga puna.

3. Në kohën kur jeni dënuar, cila ka qenë gjendja e juaj ekonomike?

Shumë e varfër	E varfër	E mesme	E pasur	Shumë e pasur
1	2	3	4	5

4. Mosha juaj në vite sot _____ vjeç

4.1 Në cilën moshë jeni dënuar? _____

4.2 Kohëzgjatja e burgimit në vite? _____

5. A jeni gjykuar/dënuar në grup?

- Po
- Jo

6. A jeni keqtrajtuar–torturuar nga organet e rendit dhe hetuesisë gjatë kohës së arrestimit, hetuesisë dhe paraburgimit?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

7. A jeni keqtrajtuar–torturuar gjatë kohës së burgimit?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

8. A janë keqtrajtuar të afërmit tuaj gjatë kohës së arrestimit tuaj?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

9. A janë keqtrajtuar të afërmit tuaj gjatë kohës sa keni qëndruar në burg?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

10. Nga çasti kur jeni arrestuar a ju kanë njoftuar organet e rendit se keni të drejtë në mbrojtje, për të pasur avokat?

- Po
- Jo

11. Gjatë kohës që keni qenë në hetuesi dhe paraburgim, a keni hasur në pengesa për t'i realizuar kontaktet me avokatin tuaj?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

12. A është ushtruar torturë ndaj jush, për ta pranuar fajësinë?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

13. Gjatë kohës që keni qëndruar në paraburgim, sa herë keni pasur vizita nga organizatat joqeveritare vendore që kanë monitoruar Liritë dhe të Drejtat e Njeriut?

VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA
Asnjëherë	1	2	3	4	Më shumë se 4

14. Gjatë kohës që keni qëndruar në burgim, sa herë keni pasur vizita nga organizatat joqeveritare vendore që kanë monitoruar Liritë dhe të Drejtat e Njeriut?

VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA
Asnjëherë	1	2	3	4	Më shumë se 4

15. Gjatë kohës që Ju keni qëndruar në paraburgim, sa herë keni pasur vizita nga organizatat joqeveritare ndërkombëtare që kanë monitoruar Liritë dhe të Drejtat e Njeriut?

VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA
Asnjëherë	1	2	3	4	Më shumë se 4

16. Gjatë kohës që ju keni qëndruar në burgim, sa herë keni pasur vizita nga organizatat joqeveritare ndërkombëtare që kanë monitoruar Liritë dhe të Drejtat e Njeriut?

VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA	VIZITA
Asnjëherë	1	2	3	4	Më shumë se 4

17. A mendoni se gjykimi juaj është mbështetur mbi prova dhe fakte, sa mendoni se ka pas bazë juridike?

Aspak	Pak	pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

18. Sa ka ndikuar dënimi (burgu) që ju keni vuajtur, në risocializimin dhe integrimin tuaj në shoqëri?

Aspak	Pak	pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

19. Sa ka ndikuar roli i organizatave joqeveritare që kanë monitoruar Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, lidhur me përmirësimin e kushteve në qendrat ku ju keni vuajtur dënimin me heqje të lirisë?

Aspak		Pak	pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1		2	3	4	5

20. Sa keni pasur përkujdesje shëndetësore në qendrat e paraburgimit?

Aspak	Pak	pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

21. Sa keni pasur përkujdesje shëndetësore në qendrat e burgimit?

Aspak	Pak	pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

22. A keni pasur cenim të korrespondencës tuaj, gjatë kohës sa keni qëndruar në paraburgim?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

23. A keni pasur cenim të korrespondencës tuaj, gjatë kohës sa keni qëndruar në burgim?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

24. A mendoni se proceset gjyqësore dhe dënimet kundër Jush, kanë qenë procese politike, me motive etnike?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

25. Në procesin gjyqësor kundër jush, a mendoni se janë zbatuar drejt ligjet në fuqi?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

26. A mendoni se vendimet e shqiptuara nga gjykatat kanë qenë meritore?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

27. Sipas mendimit tuaj, sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

Pyetësi për avokatët mbrojtës

Gjinia që Ju i përkisni (rrethoni a ose b)

a) Femër b) Mashkull

1. Në periudhën kohore 1981–1999, keni ushtruar profesionin e _____

2. Gjatë kësaj periudhe kohore që keni ushtruar profesionin e avokatit, sa e keni ndier vetën të lirë dhe të sigurt në ushtrimin e profesionit tuaj? [rretho opsionin që ju përshtatet]

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

3. Sipas përvojës tuaj, gjatë viteve 1981–1999, sa ka pasur mundësi një avokat ta ushtrojë profesionin e tij në mënyrë të pavarur?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

4. Gjatë viteve 1981–1999, personat që ju keni mbrojtur, për cilin lloj të veprave penale kanë qenë akuzuar më shumë?

- Vepra penale me karakter politik.
- Vepra penale me karakter ekonomik.
- Vepra penale apo krime të rëndomta.
- Kundërvajtje.
- Tjetër _____

5. Bazuar në eksperiencën tuaj, gjatë fazës së hetuesisë, sa respektoheshin Liritë dhe të Drejtat e Njeriut?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

6. A ka qenë tortura mjet për të marrë pohimin apo deklaratën e të akuzuarit gjatë viteve 1981/1998

- a) Po
b) Jo.

7. Ju keni pasur kontakt me klientët Tuaj, pra me të akuzuarit, a kanë qenë të keqtrajtuar – torturuar ata nga organet e rendit dhe hetuesisë?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

8. Sipas eksperiencës tuaj, a ju ka trajtuar gjykata drejtë dhe në mënyrë të barabartë në raport me institucionin e akuzës?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

9. A keni hasur në pengesa të qëllimshme procedurale gjatë procedurës për mbrojtjen e klientëve tuaj?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

10. Ju jeni profesionist i fushës tuaj, çfarë mendoni ju, cili ka qenë qëllimi i dënimit për veprat penale me karakter politik?

- Ndëshkimi.
- Risocializimi, ri-integrimi.
- Ndëshkimi për t'u arritur risocializimi – ri-integrimi
- Tjetër _____.

11. Si njohës i ligjeve dhe ekspert i fushës që jeni, a mendoni ju se janë akuzuar dhe dënuar klientët tuaj në mungesë të fakteve?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

12. A mendoni se vendimet e shqiptuara nga gjykatat kanë qenë meritore?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

13. Sipas mendimit Tuaj, sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

14. A mendoni se ka pasur procese të montuara politikisht, për vepra penale me karakter politik?

- Po
- Jo

15. Në bazë të eksperiencës tuaj, a mendoni se personat e akuzuar për vepra me karakter politik, janë trajtuar më ashpër se personat e akuzuar për vepra të rëndomta penale?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

16. Sa keni pasur mundësi që t'i realizoni të drejtat ligjore avokat-klient?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

17. Sipas ligjit, ju i keni vizituar klientët tuaj në polici, hetuesi apo paraburgim, si mund t'i përshkruani kushtet ku ata janë mbajtur?

Shumë të mira	Të mira	Të rënda	Shumë të rënda
1	2	3	4

18. Vendimet e shqiptuara nga gjykatat sa i kanë marrë për bazë konventat dhe aktet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

19. Sa kanë pasur mundësi organizatat vendore që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

20. Sa kanë pasur mundësi organizatat ndërkombëtare që janë marrë me liritë dhe të drejtat e Njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

21. A ju kujtohet të keni mbrojtur ju ndonjë klient që ka qenë polic apo hetues që është akuzuar për keqtrajtim apo torturim të të akuzuarve për vepra penale me karakter politik?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk më kujtohet.

21.1 Nëse Po, sa klientë? _____.

22. A mund ta kujtoni nga eksperiencia juaj apo që keni dëgjuar nga kolegët tuaj, se është dënuar ndonjë polic apo hetues për vepra penale të torturës ndaj të akuzuarve?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk më kujtohet.

23. Sipas eksperiencës tuaj, të akuzuarit për vepra penale me karakter politik a janë akuzuar në grupe?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk më kujtohet.

23.1 Nëse Po, sa klientë? _____.

24. Sa kanë pasur mediat qasje në monitorimin e proceseve gjyqësore për vepra penale me karakter politik, duke filluar nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procesit gjyqësor?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

25. A mendoni se pas këtyre vendimeve juridike, janë fshehur qëllimet politike me motive etnike?

- a) Po
- b) Jo

26. Sipas mendimit tuaj profesional, a mendoni se është shkel ligji gjatë procedurës penale të zhvilluar kundër personave të dënuar për këto vepra penale?

- a) Po
- b) Jo

Pyetësor për prokurorë

Gjinia që ju i përket (rrethoni a ose b)

a) Femër b) Mashkull

1. Në periudhën kohore 1981–1999, e keni ushtruar profesionin e _____.

2. Gjatë kësaj periudhe kohore që keni ushtruar profesionin e prokurorit, sa e keni ndier veten të lirë dhe të sigurt në ushtrimin e profesionit tuaj?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

3. Në kujtesën tuaj a ka pasur aktakuza kolektive, e kemi fjalën për persona të akuzuar në grup?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk jam i sigurt?

3.1 Nëse Po, në sa raste? _____

4. Sa ju kujtohet ju në këtë periudhë kohore, nga viti 1981–1999, cila ishte natyra e aktakuzave që dominonte?

- Vepra penale me karakter politik?
- Vepra penale me karakter ekonomik?
- Vepra penale apo krime të rëndomta?
- Kundërvajtje?
- Tjetër _____?

5. Bazuar në eksperiencën tuaj, gjatë fazës së hetuesisë sa respektoheshin liritë dhe të drejtat e njeriut?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

6. A ka qenë tortura vepër penale sipas legjislacionit në fuqi, gjatë viteve 1981/1999?

- a) Po
- b) Jo

7. Sipas mendimit tuaj a ka pasur torturë ndaj personave të akuzuar gjatë fazës së hetuesisë?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

8. Shikuar në retrospektivë, sa jeni të bindur se të akuzuarit për vepra penale politike kanë qenë fajtorë?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

9. Cili është mendimi juaj sot, sa kanë qenë të drejta ato akuza për vepra penale politike?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

10. Duke u bazuar nga eksperiencia juaj, a ka pasur mbrojtja e të akuzuarve kushte dhe trajtim të barabartë nga gjykata, në raport me institucionin e akuzës?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

11. Ju jeni profesionist i fushës tuaj, çfarë mendoni, cili ka qenë qëllimi i dënimit për veprat penale me karakter politik?

- a) Ndëshkimi
- b) Risocializimi,
- c) Ri-integrimi
- ç) Ndëshkimi dhe Risocializimi
- d) Tjetër _____.

12. A mendoni se vendimet e shqiptuara nga gjykatat kanë qenë meritore?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

13. Sipas mendimit tuaj, sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

14. A mendoni se ka pasur procese të montuara politikisht, për vepra penale me karakter politik?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

15 Të akuzuarit për vepra penale me karakter politik, sipas jush cilit nacionalitet i përkisnin?

1) Shqiptar; 2) Serb; 3) Turk; 4) Boshnjak; 5) Rom; 6) Ashkali; 7) Të tjerë.

16) Sa kanë pasur mundësi organizatat vendore që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Plotësisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

17. Sa kanë pasur mundësi organizatat ndërkombëtare që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Plotësisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

18. A ju kujtohet të keni ngritur ndonjë aktakuzë kundër policëve apo hetuesve që kanë keqtrajtuar apo torturuar të akuzuar për vepra penale me karakter politik?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk më kujtohet

19. A ju kujtohet ndonjë rast që ndonjë polic apo hetues është dënuar për keqtrajtim apo torturim të personave të akuzuar për vepra penale me karakter politik?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk më kujtohet.

20. A mendoni se procedurat e zhvilluara në proceset gjyqësore kundër personave të dënuar, kanë qenë në harmoni të plotë me ligjet në fuqi dhe me konventat ndërkombëtare?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

21. Duke shikuar këtë çështje nga këndvështrimi historik, a mendoni se këto dënime kanë qenë vendime juridike me motive politike-etnike?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

Pyetësor për gjyqtarë

Gjinia që ju i përkisni (rrethoni a ose b)?

a) Femër b) Mashkull

1. Në periudhën kohore 1981–1999, e keni ushtruar profesionin e _____.

2. Gjatë kësaj periudhe kohore që keni ushtruar profesionin e gjyqtarit, sa e keni ndier veten të lirë dhe të sigurt në ushtrimin e profesionit tuaj?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

3. Sipas mendimit tuaj, për veprat penale me karakter politik, pjesëtarët e cilit nacionalitet janë gjykuar më shumë?

1) Shqiptar 2) Serb 3) Boshnjak 4) Turq 5) Rom 6) Ashakli; 7) Të tjerë.

4. A keni pasur ankesa nga të akuzuarit me pretendimin se janë keqtrajtuar dhe torturuar nga policët dhe hetuesit gjatë fazës së arrestimit?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

5. A keni pasur ankesa nga të akuzuarit me pretendimin se janë keqtrajtuar dhe torturuar nga policët dhe hetuesit gjatë fazës së hetuesisë?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

6. Sipas ligjit në fuqi gjatë viteve 1981/1999, tortura a ka qenë vepër penale?

a) Po

b) Jo

7. A ka pasur zyrtarë, pra e kam fjalën për policë dhe hetues, që janë gjykuar dhe dënuar për vepër penale të torturës?

a) Po

b) Jo

c) Nuk më kujtohet.

7.1 Nëse Po, sa raste _____

8. Me rastin e shqiptimit të dënimit, sa ju jeni referuar akteve dhe konventave ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut?

Aspak	Pak	Pjesërisht	Shumë	Plotësisht
1	2	3	4	5

9. Sipas jush, cili ka qenë qëllimi i dënimit për veprat penale me karakter politik?

- a) Risocializimi/ri-integrimi;
- b) Ndëshkimi-shpagimi
- c) Ndëshkimi dhe Risocializimi;
- ç) Tjetër_____

10. Duke u bazuar nga eksperiencia juaj, a ka pasur mbrojtja e të akuzuarve kushte dhe trajtim të barabartë nga gjykata, në raport me institucionin e akuzës?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

11. A mendoni se janë respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut gjatë procedurës penale, duke filluar nga hetuesia e deri te ekzekutimi i dënimit?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

12. Sipas mendimit tuaj, sa kanë ndikuar rrethanat politike në proceset gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

13. A mendoni se ka pasur procese të montuara politikisht, për vepra penale me karakter politik?

- a) Po;
- b) Jo;
- c) Nuk jam i sigurt.

13.1 Nëse Po, në sa raste?_____.

14. Sa kanë pasur mundësi organizatat vendore që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore, nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Plotësisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

15. Sa kanë pasur mundësi organizatat ndërkombëtare që janë marrë me liritë dhe të drejtat e njeriut, për t'i monitoruar proceset gjyqësore nga faza e hetuesisë, deri në përfundim të procedurës gjyqësore?

Plotësisht	Shumë	Plotësisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

16. A mendoni se gjatë viteve 1981–1999, janë zhvilluar shumë procese gjyqësore kolektive, pra e kemi fjalën për persona të akuzuar dhe të dënuar në grup?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk jam i sigurt

16.1 Nëse Po, në sa raste?_____.

17. A mendoni se kanë qenë të rënda dënimet për veprat penale me karakter politik?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

18. Sipas mendimit tuaj profesional, aktakuzat e prokurorit për vepra penale me karakter politik, a kanë pasur gjithmonë bazë juridike?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk jam i sigurt

19 Sipas mendimit tuaj profesional, a ka qenë i ndikuar organi i akuzës nga politika ditore, pra e kemi fjalën për prokurorinë?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

20. Cila ka qenë mundësia dhe hapësira e medias për ta monitoruar procesin gjyqësor nga faza e hetuesisë, deri te përfundimi i procesit gjyqësor?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

21. A mendoni se procedura e zhvilluar në proceset gjyqësore kundër personave të dënuar, ka qenë në harmoni të plotë me ligjet në fuqi?

Plotësisht	Shumë	Pjesërisht	Pak	Aspak
1	2	3	4	5

22. Duke e shikuar këtë çështje nga këndvështrimi historik, a mendoni se këto dënime kanë qenë vendime juridike, me motive politiko-etnike?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk jam i sigurt?

22.1 Nëse Po, në sa raste?_____.

BIBLIOGRAFIA – REFERENCAT – WEBLIOGRAFIA

- 1 Ahmeti, S., Veprimet gjenocide serbe ndaj femrës shqiptare. Prishtinë: ASHAK, 2001.
- 2 Bajrami, Dr. Arsim, E Drejta e Kosovës në Tranzicion (E Drejta Kushtetuese – Libri II), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2002.
- 3 Bajrami, Prof. Dr. Arsim, Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Universiteti Fama, Prishtinë, 2011.
- 4 Bajrami, Dr. Hakif, Fenomeni i kthesave historike në Kosovën e robëruar 1945–1999, gazeta Epoka e Re, 14 Dhjetor 2014.
- 5 Buda, Prof. Aleks, Studime Historike, AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS, Prishtinë, 2006.
- 6 Cariq, A., E drejta penale e jugosllavisë dhe të drejtat e njeriut. Revista e Drejta, Nr. 3–4, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, 1988;
- 7 Gellner, Ernest, Nationalism, Weidenfeld & Nicolson, Great Britain, 1997.
- 8 Glenney, Misha, The Balkans, 1804–1999, Nationalism, war and the great powers Granta Books, Londër, 2000.
- 9 Gruda, Z., Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, E Drejta – Pravo. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 1989;
- 10 Gruda, Dr. Zejnullah, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2002.
- 11 Hadri Ali, Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2003.
- 12 Hibbert, Reginald, Fitorja e hidhur/Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë, Përktheu Xhevat Lloshi, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Shtypur në Shtypshkrojnën “A. Z. ÇAJUPI”, Tiranë, 1993, Kreu 4 – Misionet britanike në Shqipëri, 1943.
- 13 Ignatieff, Michael, Fizika e Ballkanit, Lufta Kundër Luftës, ORA, Tiranë, 2001.
- 14 Kadriu, Prof. Dr. Sabri, Financimi Publik me Vështrim të Posaçëm në Kosovë – I – Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2002.
- 15 Keçmezi-Basha, Sabile, Eksodi masiv, pasojë e shtypjes dhe e terrorit serb”, Simpozium shkencor me temë: “Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës 1877–1995, Prishtinë 1997.

- 16 Keçmezi-Basha, Sabile, Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë (sipas aktgjykimeve të gjykatave ish-jugosllave). Prishtinë: Instituti i Historisë, 2003;
- 17 Keçmezi-Basha, Sabile, Të Burgosurit Politik Shqiptare në Kosove Gjatë Viteve 1945–1990. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2009.
- 18 Kekezi, Harrillaq dhe Hida, Rexhep, Ç’thonë dhe ç’kërkojnë kosovarët. Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1990.
- 19 Latifi, Vesel, Revista E Drejta, Fakulteti Juridik I Universitetit të Prishtinës, 1995.
- 20 Macmillan, Margaret, Paris 1919 Six Months That Changed The World, UK 2001.
- 21 Malcolm, Noel, KOSOVA një histori e shkurtër, Koha, Prishtinë, Qershor 2011.
- 22 Malnar, Dario, Kosova dhe SHBA, KOHA, Prishtinë, 2013.
- 23 Matthews, Bob dhe Ros, Liz, Metodot e Hulumtimit, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2010.
- 24 Mesiq, Stipe, Si u shkatërrua Jugosllavia, Prishtinë, 2011.
- 25 Muja, Hajrudin, LUFTA E KOSOVËS në shtypin amerikan 28 Shkurt 1989–10 Qershor 1999, Logos–A, Shkup, Tiranë, Prishtinë, 2009.
- 26 Nushi, Pajazit, Etiologjia e krimit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovën e viteve ’90, të shekullit XX, ASHAK, Prishtinë, 2001;
- 27 Osmani, J., KRIMET E SERBISË NDAJ FËMIJËVE NË KOSOVË 1998–1999. Prishtinë: ASHAK, 2012;
- 28 Qehaja, Florjan, & DCAF, Strengthening Intelligence Governance in the Western Balkans, Kosovo;
- 29 Regjepi, Fatmir, Rrënimi i institucioneve shkencore dhe kulturore të Kosovës për qëllime gjenocidale, ASHAK, Prishtinë, 2001;
- 30 Salihu, Ismet, Ndjekjet penale politike masive të pushtetit serb ndaj pjestarëve të popullit shqipëtar në funksion të rrënimit dhe të mohimit të subjektivitetit politik dhe kulturor të Kosovës. E drejta, 1995;
- 31 Salihu, Dr. Kurtesh, “Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të KSAK në Jugosllavinë Socialiste”, Prishtinë, 1984.
- 32 Stavileci, Akademik Esat, SHTETI, shqyrtime të përgjithshme teorike me vështrim rasti i Kosovës, AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS, Prishtinë, 2008.

- 33 Stefanović, Jovan, Ustavno pravo, Nakladni zavod Hrvatske, Zagreb, 1950.
- 34 Shala, Prof. Dr. Xheladin, Çështja Shqiptare dhe Diplomacia Serbe 1912–1913, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2006.
- 35 Shamiq, M., Si shkruhet vepra shkencore, Logos A, 2009.
- 36 Shatri, B., dhe Hyseni, H. (2001). Sjelljet dhe veprimet etnocide dhe gjenocide serbe mbi arsimin dhe shkollën shqipe në Kosovë në dritën e të drejtës ndërkombëtare, ASHAK, Prishtinë, 2001;
- 37 Shatri, H., Gjenocidi serb mbi bazën socio-ekonomike të Kosovës, ASHAK, Prishtinë, 2001.
- 38 Vllasi, Azem, Kosova: Fillimi që nuk harrohet, Koha, Prishtinë, 2017;
- 39 Weller, Marc, Shtetësia E Kontestuar, Administrimi Ndërkombëtar i Luftës së Kosovës për pavarësi, KOHA, 2009.
- 40 Von Kohl, und Libal, Kosovo, Gesellschaft für bedrohte Völker, The Albanians, Magnusson, “Serbian Reaction”.
- 41 Zajmi, Akademik Gazemend, “Çështja e Kosovës në Kuadër të Çështjës Shqiptare si Sfidë e Madhe dhe Madhore e Kohës dhe Ndaj Kohës”, Revista e Drejta 1/96, FJ i UP, Prishtinë, 1996.
- 42 Zajmi, Akademik Gazemend, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 2004.
- 43 Instituti i kërkimeve juridike dhe shoqërore, 21 Dhjetor 1979;
- 44 Human Rights Watch, 2002.
- 45 KMLDNJ, Krimet e luftës në Kosovë, KMLDNJ, 2010;
- 46 Chronology for Kosovo Albanians in Serbia, DATA, Minorities at Risk Project Center for International Development and Conflict Management, University of Maryland.
- 47 Financial Time, 8 Shtator 1981 (2 mijë arrestime);
- 48 Daily Telegraf, 24, 28, 29, 31 Mars 1989;
- 49 Der Spiegel, 26 Qershor 1989.
- 50 Gazeta “Nasha Borba”, më 23 Gusht 1995;
- 51 Gazeta Epoka e Re, 14 Dhjetor 2014
- 52 https://en.wikipedia.org/wiki/Shaban_Polluzha

53 https://sq.wikipedia.org/wiki/Rasti_Helmimi

54 https://sq.wikipedia.org/wiki/Masakra_e_Burgut_të_Dubravës

Akte juridike të shfrytëzuara

- Ligji mbi luftimin e spekulimit të pa lejuar dhe sabotimit ekonomik, më 23 Prill 1945;
- Ligjin mbi mbrojtjen e pasurisë popullore dhe qeverisjen e saj, më 24 Maj 1945;
- Ligji mbi ndalimin e nxitjes së urrejtjes dhe të përçarjes kombëtare, racore dhe fetare, Maj 1945;
- Ligji mbi veprat penale kundër popullit dhe shtetit, Maj 1945;
- Ligji mbi llojet e dënimeve, 05 Korrik 1945;
- Kodi Penal i RSFJ, Pjesa e Përgjithshme, 04 Dhjetor 1947, hyri në fuqi më 12 Shkurt 1948;
- Kodi Penal i RSFJ, 27 Shkurt 1951, hyri në fuqi më 01 Korrik 1951;
- Fletorja zyrtare e RSFJ, Nr. 15/65;
- Fletorja Zyrtare e RSFJ, Nr. 6/73, datë 16 Shkurt 1973;
- Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, miratuar nga Kuvendi Federativ më 21 Shkurt 1974;
- Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë, miratuar nga Kuvendi Republikan më 25 Shkurt 1974;
- Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, miratuar nga Kuvendi Krahinor më 28 Shkurt 1974;
- Ligji Penal Federativ i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, 28 Qershor 1977, hyri në fuqi më 01 Korrik 1977;
- Ligji Penal i Republikës Socialiste të Serbisë, 28 Qershor 1977, hyri në fuqi më 01 Korrik 1977;
- Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 28 Qershor 1977, hyri në fuqi më 01 Korrik 1977;

- Ligji Mbi Procedurën Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, hyri në fuqi më 01 Korrik 1977;
- Aktakuza e Prokurorisë së Qarkut në Sarajevë Nr. PP. 118/83 datë 17 Qershor 1983;
- Aktgjykim PA Nr. 1208/83, datë
- Aktakuza e Prokurorisë Ushtarake e Shkup, PPU. 146/87, datë 14 Dhjetor 1987;
- Aktgjykimi i Gjykatës Ushtarake në Shkup, IP. Nr. 108/87, datë 18 Janar 1988;
- Aktgjykim i Gjykatës Supreme Ushtarake, Beograd IIP. 129/88, datë 27 Maj 1988.
- Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 11/90, datë 26 Nëntor 1990.
- Fletorja zyrtare e RS Serbisë”, Nr. 15/90, datë 30 Mars 1990.
- Fletore zyrtare e RS, Nr. 16/90 datë 3 Maj 1990;
- Fletorja zyrtare e RS Serbisë, Nr. 30/90, datë 26 Qershor 1990.
- Fletore Zyrtare e RS, Nr. 52/92, datë 03 Gusht 1992.
- Fletore Zyrtare e RS Serbisë, Nr. 40/90, datë 26 Korrik 1990.
- Deklarata e Shërbimit të të ardhurave shoqërore të Kuvendit të Komunës Prizren, 4/4 Nr. 47–5–522, datë 25 Nëntor 1991;
- Fletore Zyrtare e RS Serbisë, Nr. 22/91, datë 18 Prill 1991;
- Vendimi K. Nr. 284/86 dhe K. Nr. 73/87, datë 27 Qershor 1990;
- Vendimi IK–12/1–88, IK–101/2–89, datë 27 Qershor 1990;
- Fletore zyrtare e RS, Nr. 24/92, datë 29 Prill 1992;
- Fletore zyrtare e KSAK, Nr. 7, datë 9 Shtator 1992.
- Fletore zyrtare e RS, Nr. 89/92, datë 7 Dhjetor 1992;
- Fletore zyrtare e RS, Nr. 53, datë 28 Dhjetor 1993;
- Aktvendimi Nr. 129/01–90, datë 18 Prill 1990.
- Aktvendim, II Nr. 2049/90, datë 7 Dhjetor 1990;
- Aktgjykim, P. Nr. 169/90, datë 21 Mars 1991;

- AP. 170/91, datë 21 Mars 1991;
- PM Nr. 2/82, datë 4 Mars 1982, Prizren;
- APM Nr. 24/82, datë 13 Korrik 1982, Prishtinë;
- PM Nr. 2/82, datë 7 Janar 1983, Prizren;
- APM Nr. 3/83, datë 9 Qershor 1983, Prishtinë;
- PM 17/82, Propozimi për dënim i PPQ Prizren, PPM. 27/82, datë 8 Korrik 1982.
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, PM 17/82, datë 14 Korrik 1982;
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, APM. 31/82, datë 9 Nëntor 1982;
- Aktgjykimi i Gjykatës Federative, PSHF. 8/83, datë 15 Mars 1983;
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, PM. 17/82, datë 26 Maj 1983;
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i Kosovës, APM 15/83, datë 24 Qershor 1984;
- Aktgjykimi i Gjykatës Federative PSHF. 10/85, datë 23 Prill 1984;
- Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, PM 24/85, datë 3 Korrik 1985;
- Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, AP Nr. 367/87, datë 29 Dhjetor 1987;
- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren P. Nr. 32/88, datë 25 Maj 1988;
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, AP Nr. 484/99, datë 9 Mars 1990;
- Propozim Akuza PP. Nr. 975/83, datë 16 Qershor 1983, Beograd.
- Aktgjykimi, P. Nr. 1231/83 datë 24 Prill 1984, Beograd;
- Shkresë Nr. 700-00-8/95-03 datë 15.02.1995, e Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Serbisë dërguar Këshillit të Helsinkit;
- Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P Nr. 9/95, datë 21 Shtator 1995;
- Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 37/97, datë 23 Korrik 1997;

- Rregullore Nr. 1999/24, datë 12 Dhjetor 1999, UNMIK, Mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë;
- Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, UNMIK/RREG/2003/25, datë 06 Korrik 2003, Huri në fuqi më 06 Prill 2004;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (teksti i pastruar). Vendimi Nr. V-027, datë 09 Prill 2008, i Kuvendit të Republikës së Kosovës, hyri në fuqi më 15 Qershor 2008 dhe *AMENDAMENTET I – XXII (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 25, datë 07 Shtator 2012); AMENDAMENTIN XXIII (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7, datë 26 Mars 2013); AMENDAMENTIN XXIV (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20, datë 05 Gusht 2015) dhe AMENDAMENTIN XXV (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9, datë 11 Mars 2016.*
- Ligji Nr. 03/L – 095, datë 29 Tetor 2010, Për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politik;
- Kodi Nr. 04/L-082, datë 20 Prill 2012, Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Ligji Nr. 04/L-088, datë 15 Shkurt 2012, Për Arkivat Shtetërore;
- Kodi Nr. 04/L-123, datë 13 Dhjetor 2012, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;
- Kodi Nr. 06/L-074, datë 23 Nëntor 2018, Kodi Penal i Kosovës;
- Raporti Nr. 27/20, datë 04 Shtator 2020, i Komisionit Qeveritar të Republikës së Kosovës, Për Kompensimin e ish të Përndjekurve dhe Dënuarve Politik drejtuar Kryeministrit të RKS.

